



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURAS
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
QERSHOR 2025

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i dytë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2025

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 2 datë 02.06.2025
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Kryetari i bordit

Gjeneral brigade **Bardhyl Nuredinaj**

Anëtarët e bordit

Kolonel Msc. **Ulsi Rexhaj**

Prof. Asoc. Dr. **Etleva Smaçi**

Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Nënkolonel (R) Dr. **Enrik Ago**

Nënkolonel Dr. **Fitim Karasani**

Kolonel Msc. **Hysni Gjergji**

Kolonel (R) Msc. **Dilaver Hoxha**

Përgatiti për botim: Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit

Art design: Engjellushe Llulla

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2025 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në “Revista Ushtarake” janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve dhe pozicioneve të tyre individuale, edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: Qershor 2025

PËRMBAJTJA E REVISTËS USHTARAKE

RUBRIKA E PARË VLERËSIME DHE ANALIZA NË MJEDISIN E SIGURISË

Zgjidhjet strategjike për t'i dhënë fund luftës Rusi-Ukrainë.....	11
<i>Dr. Glevin Dervishi</i> <i>Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA</i>	
Doktrinat e inteligjencës ushtarake, në epokën e militarizimit të internetit.....	21
<i>Kolonel Msc. Hysni Gjergji</i> <i>Shef departamenti në IKSHU</i>	
Analizë krahasuese e doktrinë inteligjente të NATO-s dhe qasja kolektive kundrejt neutralitetit sovran.....	37
<i>Dr. Drizan Shala</i> <i>Drejtore i Asociacionit të Kriminalistëve dhe Kriminologëve, Kosovë</i>	
Ballkani, laborator i bashkëpunimit të sigurisë.....	49
<i>Major Sonila Varfi</i> <i>Agjencia e Inteligjencës së Sigurisë së Mbrojtjes</i>	

RUBRIKA DYTË ARSIMIMI DHE STËRVITJA NË FA

Zhvillimi i arsimimit të lartë ushtarak dhe roli i tij në formimin profesional të oficerit në FARSH.....	61
<i>Dr. Enrik Ago</i> <i>Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak</i>	
Konceptet ushtarake: një horizont për zhvillimin e aftësive të ardhshme.....	73
<i>Nënkolonel (R) Msc. Besnik Daci</i> <i>Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak</i>	

Zhvillimi i Forcave të Armatosura përmes koncepteve operacionale: Një qasje strategjike.....	83
---	-----------

*Nënkolonel (R) Msc. Arben Zavalani
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak*

Roli i Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit në modernizimin e FARSH dhe garantimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale.....	99
--	-----------

*Kryekapiter Gëzim Mataj
Regjimenti i Operacioneve Speciale*

RUBRIKA TRETË ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT NË FUSHËN E MBROJTJES

Robotika në ushtri.....	111
--------------------------------	------------

*Kolonel Msc. David Rroku
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak*

Etika e inteligjencës artificiale.....	127
---	------------

*Dr. Ulsi Meta,
Nënkolonel Julian Myteberi
Ministria e Mbrojtjes*

Mbrojtja kibernetike dhe zhvillimet inovative në fushën e sigurisë kibernetike për vitin 2025.....	145
---	------------

*Kolonel Inxh. Gjergji Vasili
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak*

RUBRIKA E KATËRT STUDIME HISTORIKE

Konferenca e Munihut 2025: Shumëpolariteti përballë rendit aktual botëror.....	163
---	------------

*Prof. Asoc. Dr. Etleva Smaçi
Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA
Dr. Blerina Kuqi
Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA*

Pavarësia e Shqipërisë dhe roli i Ismail Qemalit në politikën e jashtme.....	179
<i>Major Msc. Kujtim Zeka, Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA</i>	
<i>Nënkolonel Msc. Rafael Memia Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA</i>	
Subjekte për luftërat e ardhshme.....	191
<i>Kolonel (R) Zeno Jahaj</i>	

RUBRIKA E PARË

VLERËSIME DHE ANALIZA NË MJEDISIN E SIGURISË

ZGJIDHJET STRATEGJIKE PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS RUSI-UKRAINË

Dr. Glevin DERVISHI

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar

Ky artikull shqyrton përpjekjet për t'i dhënë fund luftës Rusi-Ukrainë, duke analizuar pasojat dhe ndikimin që një paqe e mundshme mund të ketë jo vetëm për të ardhmen e Ukrainës, por edhe për ekuilibrat në arenën ndërkombëtare. Ndryshimet në realitetin evropian, zgjedhjet e fundit në SHBA dhe angazhimi amerikan për paqen në Ukrainë kanë ndikuar në dinamikën e sigurisë në kontinent, duke rritur pasigurinë dhe nevojën për një rol më aktiv evropian në menaxhimin e sigurisë. Artikulli eksploron përpjekjet diplomatike, ndryshimin e qasjeve dhe rrugët e ndjekura për institucionalizimin e paqes, si dhe mekanizmat që mund të sigurojnë një zbatim efektiv në terren.

Në tryezën e bisedimeve janë propozuar disa skenarë që mund të formësojnë të ardhmen politike të Ukrainës, një proces kompleks që duhet të adresojë një sërë çështjesh të ndërlikuara, duke përfshirë garancitë për sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit, statusin e tij në raport me NATO-n dhe BE-në, përcaktimin e statusit të rajoneve me shumicë ruse në Ukrainë, statusin e flotës ruse në Detin e Zi dhe garancitë që Rusia kërkon për rolin e NATO-s në kufijtë e saj.

Fjalët kyçe: aleanca ushtarake, lufta Rusi-Ukrainë, infrastruktura kritike, operacion ushtarak, negociim, marrëveshje, integritet territorial

Lufta në Ukrainë si një normalitet i ri

Lufta që zgjat tashmë prej më shumë se tre vitesh në kufijtë verilindorë të Evropës është kthyer në një “normalitet të ri”, i cili çdo ditë e më shumë prodhon ndryshime ekuilibrash në kontinentin evropian duke nxjerr në pah nevojën për pronësi të sigurisë në kontinentin tonë. Ndër ekuilibrat e ndryshuar vlen të veçohet Finlanda dhe Suedia të cilat braktisën neutralitetin e tyre historik për t’u anëtarësuar në NATO, ndërsa Gjermania, nga ana tjetër, ka vendosur të bëjë një kthesë historike duke zbatuar “Zeitenwende” në fushën e mbrojtjes dhe ka nisur të planifikojë ndryshime kushtetuese. Pak më shumë se një javë pas fitores së tij në zgjedhjet federale të Gjermanisë, kancelari i ardhshëm i mundshëm i vendit Friedrich Merz po planifikon të rrisë jashtëzakonisht shumë shpenzimet e mbrojtjes dhe infrastrukturës duke hequr kufizimet fiskale kushtetuese të njohura si “frena e borxhit”¹. Këto ndryshime parashikojnë krijimin e një fondi të posaçëm prej 500 miliardë eurosh për të ringritur infrastrukturën kritike të Gjermanisë në funksion të nevojave për mbrojtjen duke financuar projekte jashtë shpenzimeve normale buxhetore gjatë 10 viteve të ardhshme.

Për të përballuar luftën gjatë tre viteve të fundit, Ukraina ka qenë e angazhuar me sukses në një seri përpjekjesh rraskapitëse për të ndërtuar dhe mbajtur së bashku një koalicion kombesh dhe vlerash demokratike për të mbështetur përpjekjet luftarake të Ukrainës. Nga ana tjetër në përpjekje për të mbajtur Ukrainën të motivuar, BE-ja, përmes një lëvizjeje të fortë gjeopolitike, vendosi t’i japë statusin e vendit kandidat Ukrainës dhe Moldavisë, jo vetëm si shenjë mbështetjeje për sakrificat e qytetarëve të tyre, por edhe si dëshmi e përkushtimit të Bashkimit Evropian ndaj këtyre dy vendeve². Tre vitet e para të kësaj lufte është demonstruar një solidaritet unik brenda NATO-s, si dhe lufta ka shërbyer për të rijetësuar lidhjen transatlantike, apo dhe për të forcuar praninë e NATO-s në lindje përmes grupeve të batalioneve të vendosura nga Baltiku në Detin e Zi³. Nga ana tjetër, Rusia ka ndërmarrë një sërë ndryshimesh në korpusin e dokumenteve strategjike, më e rëndësishmja prej të cilave është miratimi i një strategjie të re të politikës së jashtme (prill 2023), në të cilën Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimi renditen si burim i “kërcënimit ekzistencial” për Moskën⁴.

¹ <https://www.euronews.com/my-europe/2025/03/07/special-funds-for-defence-legislative-change-in-the-fast-lane>.

² <https://www.euractiv.com/section/europe-s-east/news/eu-leaders-grant-candidate-status-to-ukraine-and-moldova/>.

³ https://www.nato.int/cps/fr/natohq/topics_136388.htm?selectedLocale=en.

⁴ <https://vesanews.al/strategjia-e-re-e-politikes-se-jashtme-ruse-perendimi-eshte-nje-kercenim-ekzistencial/>

Por kjo trajektore e tre viteve të para të luftës tashmë i përket së shkuarës. Zgjedhjet e nëntorit të vitit 2024 në SHBA, siç pritej, do të sillnin ndryshime të reja në raport me luftën në Ukrainë, marrëdhëniet SHBA-BE dhe marrëdhëniet SHBA-Rusi, siç deklaroi edhe vetë Presidenti Trump gjatë gjithë fushatës presidenciale. Edhe pse SHBA-ja dhe Ukraina kanë nënshkruar një deklaratë për partneritetin strategjik më 19 dhjetor 2008⁵, duke riafirmuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi, duke nënvizuar angazhimin e SHBA-së për sigurinë e Ukrainës dhe rrugën e Ukrainës në NATO, në mars 2025 ndodhi një ndryshim i fortë në angazhimin e SHBA-së ndaj Ukrainës dhe tashmë Evropa po përballlet me një tronditje sfiduese sa i takon lidhjes historike transatlantike.

Shenja e parë e një ndryshimi të madh në politikën e SHBA-së drejt luftës në Evropën Lindore ishte vendimi për të nisur bisedimet dypalëshe me Rusinë pa pjesëmarrjen ukrainase apo evropiane. Për herë të parë në historinë e krizave në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore, BE-ja e pa veten jashtë tryezës për një çështje që është thelbësore për sigurinë e saj dhe për më tepër SHBA-të po i shtojnë evropianët të paguajnë barrën e rëndë të rindërtimit të Ukrainës. Më pas erdhi një seri ndryshimesh në narrativë kur presidenti Trump e quajti presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky një “diktator”, madje duke vazhduar me një qasje krejt të re ku Ukraina bëhej përgjegjëse për krizën që çoi në agresionin rus⁶.

Në vazhden e këtyre ndryshimeve të mëdha për habinë e Ukrainës dhe të evropianëve zyrtarët amerikanë dhe rusë u takuan në Riad për bisedime të organizuara nga Arabia Saudite, duke lënë jashtë diskutimit Ukrainën dhe aleatët e saj evropianë. Për ta bërë dhe më të fortë kontrastin me administratën Biden, administrata e re vendosi: ndërprerjen e ndihmës ushtarake të SHBA-së për Ukrainën dhe pezullimin e shkëmbimit të inteligjencës me Kievin duke e vendosur Ukrainën në një pozicion shumë të cënueshëm ndaj Moskës dhe tani ajo po përballlet me mungesën e avantazhit taktik dhe strategjik për sa i përket operacioneve ushtarake në terren nga mungesa e kësaj ndihme. Inteligjenca amerikane i ofronte Ukrainës një kombinim të imazheve satelitore dhe interceptimeve, që u mundësonte forcave ukrainase paralajmërimin e hershëm mbi çdo sulm rus duke i dhënë asaj mundësinë që të mos gjendej e papërgatitur dhe minimizonte humbjet duke ndërmarrë masa parandaluese për sulmet ruse. Kjo asistencë në fushën e inteligjencës i ndihmonte forcat ukrainase të gjurmonin lëvizjet e trupave ruse dhe pozicionet e bazave të tyre,

⁵ <https://ua.usembassy.gov/our-relationship/u-s-ukraine-charter-strategic-partnership/#:~:text=Preamble,broad%20spectrum%20of%20mutual%20priorities>.

⁶ <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/ukrainealert/is-trumps-russia-reset-overshadowing-the-ukraine-peace-process/>.

duke u mundësuar atyre të përgjigjeshin ndaj sulmeve me raketa dhe të orientonin kundërpërgjigjen ndaj burimeve të sulmit. Falë kësaj ndihme, Ukraina arriti në jo pak raste të ndërmarrë sulme të suksesshme brenda territorit rus, duke përdorur armë me rreze të gjatë veprimi të dhëna nga SHBA-të dhe aleatët perëndimorë të saj, si sistemet ATACMS dhe HIMARS⁷. Efekti thelbësor i tërheqjes së ndihmës në fushën e inteligjencës ishte humbja e zonës së Kurskut të pushtuar nga ukrainasit të cilët donin ta përdornin atë si mjet shkëmbimi në negociatat e mundshme me Rusinë ku tërheqjen e tyre nga Kursku ta kushtëzonin me tërheqjen e rusëve nga rajonet e pushtuara të Ukrainës. Ky realitet i ri nuk i përgjigjet besimit të palëkundur të shprehur gjatë fushatës së ardhjen e administratës së re në Uashington do t'i jepej fund luftës në ditët e para të mandatit të ri. Tre muaj më pas nga ardhja në detyrë e Presidentit Trump, pavarësisht angazhimit diplomatik amerikan, realiteti në front duket më i vështirë për Ukrainën.

Gjatë këtyre tre muajve janë evidentuar një seri ndryshimesh të politikës dhe angazhimit amerikan ndaj Ukrainës, ku SHBA-ja është rreshtuar dy herë në krahë të Rusisë në shkurt të vitit 2025, gjatë votimit në Kombet e Bashkuara të një rezolute për të shënuar përvjetorin e tretë të pushtimit rus të Ukrainës, duke theksuar ndryshimin e qëndrimit të administratës Trump ndaj luftës. Madje SHBA-ja hartoi dhe votoi për një rezolutë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, e cila bënte thirrje për t'i dhënë fund konfliktit, por nuk përmbante kritika ndaj Rusisë⁸. Uashingtoni vendosi të pezullojë sulmet kibernetike ndaj Rusisë dhe agjencia CISA u urdhërua të zhvendosë përparësinë dhe të mos i konsiderojë më kërcënimet kibernetike ruse si prioritet. Me ardhjen e administratës së re të Trump është vënë re një lloj largimi i SHBA-ve nga partnerët tradicional transatlantik, duke i mëshuar më shumë rëndësi një afrim me Rusinë për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, por kjo ka rritur pasigurinë tek evropianët si dhe ka rritur frikën se Kievi mund të detyrohet të pranojë në një marrëveshje të pafavorshme.

Duke qenë të vetëdijshme se Ukraina e ka humbur këtë luftë në terren, SHBA-të po kërkojnë të krijojnë një dritare mundësie për një marrëveshje paqeje me Rusinë duke zbutur dhe përshtatur narrativen kundrejt Rusisë në funksion të krijimit të një hapësirë frymëmarrjeje dhe lëvizshmërie që mund të akomodonte interesat ruse dhe të mëkonte sedrën e sëmurë të saj. Ndërkohë, duke ulur mbështetjen ushtarake për Ukrainën, administrata amerikane po kërkon që të ulë angazhimin dhe moralin e ukrainasve për luftë, duke u përpjekur t'i shtyjë ata në tryezën e negociatave dhe për të ulur pritshmëritë e tyre.

⁷ <https://www.aljazeera.com/news/2025/3/6/how-will-us-pause-on-intelligence-sharing-affect-ukraine>.

⁸ <https://www.bbc.com/news/articles/c7435pnle0go>.

Një Ukrainë e dobët në terren dhe pa mbështetjen logjistike të SHBA-së është gjithashtu një Ukrainë e dobët në tryezën e negociatave, por e kombinuar kjo me mungesën e mbështetjes politike do ta detyrojë atë të pranojë një marrëveshje që fatkeqësisht nuk do të parashikojë rifitimin e territorit të humbur. Në qendër të kësaj strategjie mbetet logjika e sprapsjes së Ukrainës duke e lënë Rusisë pa argument (se i gjithë përfundimi është kundër Rusisë) dhe për ta shtyrë atë të mendojë për paqen dhe jo luftën, prandaj SHBA-ja e ka vendosur tashmë fokusin drejt shtyrjes së Ukrainës që të ofrojë një armëpushim në terren. Në një përpjekje për të rivendosur prestigjin, administrata e re amerikane e shtyu Ukrainën të nënshkruante një marrëveshje me SHBA-në për depozitat minerale të vendit, e cila mund t'i japë Trump-it dhe publikut amerikan një lloj rikthimi të parave të shpenzuara gjatë tre viteve për Ukrainën, duke e përdorur këtë marrëveshje si një përgjigje për të vazhduar mbështetjen për Ukrainën. E gjendur përballë këtyre sfidave të shumanshme dhe me paqartësitë në rritje, Ukraina kërkon që nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje të sigurojë një “paqe të drejtë dhe të qëndrueshme” me “garanci të fuqishme dhe të besueshme sigurie” që do të ndalonin në të ardhmen një agresion të ri rus. Prandaj Kievi kërkoj gjithashtu që kjo marrëveshje të përfshijë një garanci të fortë sigurie nga SHBA dhe jo të ishte vetëm një marrëveshje me aspekte financiare apo teknike për shfrytëzimin e nëntokës së Ukrainës për nxjerrjen e mineraleve të rralla⁹.

Ky ndryshim qasjeje i raporteve SHBA-Ukrainë dhe SHBA-Evropë është përcjellë me shqetësim legjitim në kontinentin e vjetër. Në këto kohë sfidash kur roli i gjatë i SHBA-së si garantues i fortë i hapësirës së NATO-s dhe sigurisë së Evropës është tronditur, liderët e BE-së u zotuan të rrisin në mënyrë të ndjeshme shpenzimet në fushën e mbrojtjes në një program riarmatimi prej 860 miliardë eurosh për të ndërtuar një bllok ushtarak më të fortë, më sovran, më të aftë për të përballuar krizat, në një përpjekje për të bashkuar Evropën dhe për të shkurajuar Rusinë¹⁰. Pavarësisht përpjekjeve për t'i dhënë fund luftës, ekipet diplomatike të nivelit të lartë të SHBA-së dhe Rusisë kanë rënë dakord deri më tani për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis SHBA-së dhe Rusisë, rikthimin dhe normalizimin e nivelit të tyre të angazhimit me kapacitete të plota në ambasadat përkatëse¹¹. Rusia i sheh këto negociata si një paketë gjithëpërfshirëse ku ka kërkuar lehtësimin e sanksioneve ndaj sektorëve kryesor të ekonomisë ruse si bankat, kompanitë e sigurimeve, portet, anijet

⁹ <https://www.bbc.com/news/articles/cn527pz54neo>.

¹⁰ <https://www.france24.com/en/europe/20250307-eu-leaders-vow-to-re-arm-europe-amid-us-retreat-on-ukraine>.

¹¹ <https://www.nbcnews.com/news/world/us-russia-move-normalizing-relations-easing-diplomatic-work-rcna200806>.

tregtare dhe kthimin në sistemin SWIFT (ndonëse për sistemin SWIFT duhet dhe miratimi i BE-së). Një çështje tjetër që ata ranë dakord, por nuk zgjati shumë, ishte një armëpushim në Detin e Zi¹² dhe ndërprerjen e sulmeve respektive mbi infrastrukturën kritike energjetike, por që ky zotim nuk zgjati as 24 orë pas marrëveshjes. Prishja e këtij armëpushimi ishte një test lakmuesi se një paqe e drejtë dhe e qëndrueshme pa garancitë përkatës ka potencialin të jetë vetëm një iluzion për Ukrainën. Zhvillimet e fundit në terrenin e luftës duken larg nga një paqe e mundshme sepse presidenti Putin ka nënshkruar një dekret për mobilizimin e 160.000 rekrutëve shtesë për ushtrinë ruse dhe shefi i Mbrojtjes i Ukrainës ka kërkuar që Ukraina të mobilizojë 30.000 trupa shtesë çdo muaj në mbështetje të operacioneve ushtarake për të mbrojtur vendin në prag të ofensivës së ardhshme të pranverës¹³. Ukraina ka konfirmuar se Rusia ka intensifikuar sulmet në të gjitha linjën e kontaktit të frontit dhe ka grumbulluar një forcë prej 70.000 trupash shtesë për inkursionin e radhës në rajonet e Kharkiv dhe Sumy dhe nuk po tregon se ka ndonjë shenjë për t'u tërhequr¹⁴. Me kalimin e kohës, në këtë luftë gërryese po bëhet edhe më e qartë se Rusia nuk dëshiron ta mposhtë Ukrainën ushtarakisht, por ajo është e angazhuar në një përpjekje për të shkatërruar shtetësinë, kombin, identitetin, konceptin "Ukrainë" dhe madje ajo e sheh Ukrainën si Oblastin e 47-të të Federatës Ruse, ose republikën e 23-të të saj, nëse kemi parasysh madhësinë fizike të Ukrainës.

Kjo luftë po thellon ndarjen mes Lindjes dhe Perëndimit dhe si rezultat i saj po krijohen dinamika të reja në fushën gjeopolitike. Rusia dhe partnerët e saj e panë këtë luftë si një mundësi për të thelluar bashkëpunimin mes tyre në një botë ku përplasjet për të strukturuar rendin e ri global multipolar po bëhen edhe më të thella. Në luftën e Rosisë në Ukrainë, aktorë të tjerë të pozicionuar kundër Perëndimit kanë parë mundësinë për të konsoliduar një koalicion "hegjemonist anti-unipolar", një koalicion që po merr ngjyra më të theksuara dita-ditës me fuqitë e mëdha dhe të mesme, globale dhe rajonale si Rusia, Kina, Bjellorusia, Irani, Koreja e Veriut, vendet e Kaukazit, Afrikës apo edhe të tjerë. Gjatë kësaj lufte trevjeçare, partneriteti midis këtyre vendeve kaloi nga ndihma teknike dhe logjistike në vendosjen e trupave nën komandën e ushtrisë ruse në terren siç është dhe rasti i divizionit të operacioneve speciale të Koresë së Veriut të përfshirë në operacionet për çlirimin e Kurskut.

¹² <https://www.whitehouse.gov/briefings-statements/2025/03/outcomes-of-the-united-states-and-russia-expert-groups-on-the-black-sea/>.

¹³ <https://www.reuters.com/world/europe/russias-putin-signs-decree-spring-military-conscription-2024-03-31/>.

¹⁴ <https://www.understandingwar.org/backgrounder/russian-offensive-campaign-assessment-april-9-2025>.

Përfundimi i luftës ende një bast i pa fituar

Me gjithë humbjet e mëdha njerëzore nga të dyja palët, humbjet materiale të pamatshme për Ukrainën dhe humbjet e pajisjeve ushtarake nga të dyja palët në konfliktin, miliona ukrainas të zhvendosur si refugjatë lufte, një krizë ekonomike në prag, problemet në furnizimin me lëndë të parë, kjo luftë do të zgjidhet vetëm me mjete politiko-diplomatike. Pas tre vite luftimesh, Rusia tani është e vetëdijshme se kjo luftë nuk ishte “një shëtitje në park” dhe arritja e të gjitha objektivave të saj do të marrë ende jetë rusësh si dhe të rritë kostot financiare e materiale më tej. SHBA, duke ndryshuar pozicionin nga një mbështetës i palëkundur i Ukrainës në një ndërmjetës në negocimin e një marrëveshjeje, synon që të rifitojë besimin e humbur mes tyre dhe Rosisë duke bërë që ta kenë në të ardhmen Rusinë në krah, në një rend botëror të riformatuar. Ukraina gjendet tashmë në një pozitë edhe më të vështirë dhe në pamundësinë e qartë për t'u bashkuar me NATO-n, larg ëndrrës për të rimarrë me forcë të gjithë territorin e saj, madje dhe me SHBA-në në një pozicion të ri mes saj dhe Rosisë, me pamundësinë në rritje për t'i përballuar rusët vetëm me ndihmën e evropianëve, sepse nevojat logjistike në terren janë shumë më të mëdha se sa Evropa mund të sigurojë. Nga ana tjetër, Rusia ka inkorporuar zyrtarisht në Federatën Ruse “Republikat Autonome të Luhanskut dhe Donetskut”, përveç Krimesë, të aneksuara ilegalisht në 2014. Nuk ka më dyshime që Rusia do t'ia kthejë këto territore Ukrainës, praktikisht këto territore kanë qenë jashtë kontrollit të plotë të Kievit që nga viti 2014 dhe tani me këtë luftë janë thjesht nën kontrollin faktik të Rosisë.

Rusia kërkon të fitojë maksimumin nga ky proces duke nisur nga eliminimi i pasojave në të drejtën ndërkombëtare, një riangazhim me perëndimin, çlirimin nga sanksionet, një paketë që përfshin statusin e 25 milionë rusëve që jetojnë në ish-republikat sovjetike, nga të cilët 8 milionë vetëm në Ukrainë. Por ajo që është më themelore për Rusinë është pikërisht se fundi i konfliktit nënkupton për të adresimin e shkaqeve rrënjësore të konfliktit (Ukraina jashtë NATO-s), e çmilitarizuar dhe perëndimi jashtë kopshtit të Rosisë. Basti dhe pritshmëritë janë bërë edhe më të larta pasi Rusia tashmë nuk pranon as propozimin për të ndarë Ukrainën në zona kontrolli sipas modelit të Berlinit të pas Luftës së Dytë Botërore, duke ngritur pyetjen themelore: Çfarë dëshiron vërtet Rusia? Për më tepër, Rusia po e bën të qartë se nuk dëshiron që të ketë njësi paqeruajtëse në terren që të zbatojnë armëpushimin, edhe pse në një front 1100 km të gjatë është praktikisht e pamundur vendosja e paqeruajtësve sepse do të kërkonte një forcë prej të paktën 300.000 trupash. Në këtë fazë që ka hyrë konflikti, është bërë edhe më qartë për kontinentin evropian se i vetmi aktor kryesor që mund të luajë një rol përballë Rosisë janë vetëm amerikanët dhe tani SHBA-të po luajnë një lojë shumëdimensionale. Nga takimet mes SHBA-ve dhe Rosisë

ajo që mund të kuptojmë është se deri më tani janë rivendosur pikat e kontaktit me Rusinë, po punohet për arritjen e një zgjidhjeje politike për të ardhmen e Ukrainës që akomodon dhe interesat ruse, duke vendosur garancitë përkatëse për territorin e mbetur ukrainas dhe duke zbehur apo shtyrë në kohë ëndrrën ukrainase për anëtarësim në NATO, por duke i lënë derën hapur për në BE-së dhe duke e angazhuar BE-në në procesin e rindërtimit të Ukrainës. Nga ana tjetër, administrata e re amerikane duket se po i shtyn vendet anëtare të NATO-s në thellimin e rritjes së buxhetit për mbrojtjen nga 2% të vendosur në administratën e parë mundësisht në 5% gjatë administratës së dytë Trump, si një mekanizëm për të rritur ndarjen e përgjegjësiave por edhe si një rritje e pronësisë evropiane për mbrojtje dhe siguri në kontinent. SHBA-të e kanë bërë të qartë se të gjithë ata që kundërshtojnë këto përpjekje do të shihen si të padobishëm dhe veçanërisht ky mesazh tingëllon më fort për presidentit ukrainas që do të vendosë të zgjedhë midis nënshkrimit të një marrëveshjeje që lë territorin për paqe, ose të shkojë në shtëpi dhe të humbasë gjithçka.

Shtetet e Bashkuara janë angazhuar në arritjen e një marrëveshjeje paqeje në kuadrin e një mekanizmi që ka në themel “rivendosjen e diplomacisë”, në vend të vazhimit të luftës në terren. Rusia pret që Perëndimi, si pjesë e kësaj paqeje, të përfshijë edhe riintegrimin e saj në forumet ekzistuese shumëpalëshe, si: Këshilli i Evropës, Këshilli NATO-Rusi, si dhe në traktatet ndërkombëtare si Traktatet për Reduktimin dhe Kufizimin e Armëve Bërthamore për Ofensivë Strategjike (START), Traktati i Qiejve të Hapur dhe rikthimin në Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Po ashtu, Moska kërkon riaktivizimin e interesave të saj ekonomike, përfshirë rifillimin e funksionimit të tubacioneve të gazit, heqjen e sanksioneve dhe riintegrimin në sistemin global të transaksioneve financiare. Nisur nga zhvillimet aktuale, duket se ka gjasa që SHBA-të dhe Rusia të jenë të gatshme të shkojnë përtej çështjes së Ukrainës në angazhimin e tyre dypalësh, gjë që mund të çojë në një paketë që do të ristrukturojë rendin global dhe do të ulë tensionet edhe përtej zonës së konfliktit. Presidenti Trump e ka bërë të qartë se kjo do të jetë arritja dhe produkti i tij, madje ai thekson se nuk i pëlqejnë spektatorët apo partnerët në një marrëveshje ku roli udhëheqës i SHBA-së merret i mirëqenë.

Në thelb, Rusia është një aktor që ka një sërë lidhjesh historike dhe ndërvepruese me Evropën, pa harruar faktin se qasja e saj shkatërruese mund të aktivizohet në disa vende evropiane ku jetojnë minoritetet ruse duke ndërmarrë aktivitete subversive dhe separatiste. Si një fuqi e madhe evropiane, Rusia natyrisht ka interesat e saj për të artikuluar, megjithëse forma agresive që ka zgjedhur nuk mund të justifikohet në asnjë rast, ajo po kërkon lëshime që kënaqin interesat ruse dhe e vendosin Rusinë si element të ekuacionit dhe jo një rezultat i ekuacionit. Nëse këto interesa nuk realizohen, agjenda e zhvillimeve në

Ukrainë do të mbetet kolaterale i përplasjes Rusi-(SHBA, NATO, BE), por edhe kolaterale i egos së rrënuar të Rusisë. Strategjia për daljen nga konflikti duhet të përfshijë një sërë elementesh shumë të kundërta si p.sh. garancitë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, statusin e saj në raport me NATO-n dhe BE-në, përcaktimin e statusit të rajoneve të banuara nga rusët në Ukrainë, statusin e flotës ruse në Detin e Zi, garancitë që Rusia kërkon për rolin e NATO-s në kufijtë e saj.

E kaluara e Ukrainës është përcaktuese edhe për të ardhmen e saj, të cilës do t'i duhet të dalë nga profili i së shkuarës si një “gur shahu” mes lindjes dhe perëndimit gjithmonë do të rrisë tensionet dhe do ta bëjë më të vështirë diplomacinë reale. Në vend të kësaj, kthimi në një Ukrainë neutrale do të ndihmonte në stabilizimin e marrëdhënieve midis Rusisë dhe Perëndimit. E ardhmja e Ukrainës së mbetur do të jetë shmangia e të qenët një aleat i perëndimit përballë Rusisë, por duke qenë një kështjellë gjeopolitike midis Rusisë dhe Perëndimit, por që për këtë status, nuk mund të ketë më në ekuacion pjesëmarrjen në aleanca ushtarake.

Burime të shfrytëzuara:

1. <https://www.euronews.com/my-europe/2025/03/07/special-funds-for-defence-legislative-change-in-the-fast-lane>.
2. <https://www.euractiv.com/section/europe-s-east/news/eu-leaders-grant-candidate-status-to-ukraine-and-moldova/>.
3. https://www.nato.int/cps/fr/natohq/topics_136388.htm?selectedLocale=en.
4. <https://vesanews.al/strategjia-e-re-e-politikes-se-jashtme-ruse-perendimi-eshte-nje-kercenim-ekzistencial/>.
5. <https://ua.usembassy.gov/our-relationship/u-s-ukraine-charter-strategic-partnership/#:~:text=Preamble,broad%20spectrum%20of%20mutual%20priorities>.
6. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/ukrainealert/is-trumps-russia-reset-overshadowing-the-ukraine-peace-process/>.
7. <https://www.aljazeera.com/news/2025/3/6/how-will-us-pause-on-intelligence-sharing-affect-ukraine>.
8. <https://www.bbc.com/news/articles/c7435pnle0go>.
9. <https://www.bbc.com/news/articles/cn527pz54neo>.
10. <https://www.france24.com/en/europe/20250307-eu-leaders-vow-to-re->

arm-europe-amid-us-retreat-on-ukraine.

11. <https://www.nbcnews.com/news/world/us-russia-move-normalizing-relations-easing-diplomatic-work-rcna200806>.
12. <https://www.whitehouse.gov/briefings-statements/2025/03/outcomes-of-the-united-states-and-russia-expert-groups-on-the-black-sea/>.
13. <https://www.reuters.com/world/europe/russias-putin-signs-decree-spring-military-conscription-2024-03-31/>.
14. <https://www.understandingwar.org/backgrounders/russian-offensive-campaign-assessment-april-9-2025>.

DOKTRINAT E INTELIGJENCËS USHTARAKE, NË EPOKËN E MILITARIZIMIT TË INTERNETIT

Kolonel Msc. Hysni GJERGJI
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar

Kypunim synon të propozojë përditësimin e doktrinat e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, duke u bazuar në analizën e fakteve, metodave dhe studimeve të grumbullimit tradicional të informacionit. Këto propozime do të mbështeten edhe në përvojën e fituar nga shtetet dhe ushtritë në konflikte të armatosura reale. Në vitin 2026, revolucioni teknologjik në fushën e informacionit pritet të sjellë zëvendësimin e analistëve të agjencive të inteligjencës me sisteme të avancuara të inteligjencës artificiale (IA). Kompanitë kryesore të inteligjencës artificiale, si OpenAI me GPT-4, po konkurrojnë për të krijuar zgjidhje që mund të digjitalizojnë dhe mbështesin rrjetet e klasifikuara në inteligjencën ushtarake. Këto sisteme pritet të bëhen funksionale brenda dy viteve, duke rritur efikasitetin në analizën dhe përpunimin e informacionit të ndjeshëm.

Digjitalizimi i fushëbetejës dhe përfshirja e IA¹ në luftën informative kanë sjellë shumë zgjidhje dhe lehtësi. Megjithatë, ato kanë krijuar sfida të reja në marrëdhëniet midis “inteligjencës sekrete” dhe burimeve mediatike të informacionit, si OSINT² dhe SOCMINT³. Këto ndryshime kërkojnë guxim për

¹ Shih linkun: <https://onlinewilder.vcu.edu/blog/ai-challenges-and-opportunities-national-security/>

² OSINT-Open Source Intelligence (Inteligjenca nga burime të hapura).

³ SOCMINT-Social Media Intelligence, është platforma që siguron informacion nga publikimi i rrjeteve sociale si nënkomponent i HUMINT.

t'u pranuar dhe për t'u përshtatur, por janë gjithashtu një domosdoshmëri për modernizimin e doktrineve të agjencive të zbulimit, të cilat tradicionalisht janë konservatore dhe evoluojnë me shumë kujdes.

Sfida aktuale e përzgjedhjes mes “lumis të të dhënave” i përzier me “dezinformacion” dhe “fake news” është një tjetër arsye pse duhen përditësuar këto dokumente për agjencitë e zbulimit. “Paralajmërimi” për një agresion ushtarak mbetet misioni kryesor i zbulimit strategjik⁴, por ai tashmë vlerësohet se duhet të bëhet paralelisht edhe me “informimin e publikut” edhe përmes SOCINT.

Dhënia e mesazhit publik të drejtorit të CIA-s William Burns, më 27 gusht 2024, në Ballkan, vlerësohet si lëvizje ku për herë të parë një drejtues i CIA-s jep mesazh të drejtpërdrejtë për opinionin publik, me qëllim që ai të mos keqinterpretohet dhe shtrembërohet nga dezinformacioni rus. Vala e teknologjisë në aspektet e informacionit ka mbërritur, kërkon me urgjencë përshtatjen e të gjithë dokumentacionit, doktrineve, koncepteve dhe manualeve të disiplinave të inteligjencës të epokës Chatgpt dhe IA gjeneruese⁵ dhe paradigmen e domenit V të luftës.

Fjalët kyçe: Koncept, paradigmë, doktrinë, paralajmërimi, inteligjencë, OSINT, HUMINT, MEDIA

Doktrina e re e burimeve të hapura (OSINT) dhe fuqizimi i nënkomponentit të saj SOCMINT⁶

Doktrina e inteligjencës është një përmbledhje e bindjeve, parimeve dhe udhëzimeve që përcaktojnë një strategji të përdorimit të tyre, cilat zbatohen nga shtete organizata apo individë. Doktrinat e inteligjencës ushtarake përkufizohen si një “set” udhëzimesh, strategjish dhe e mënyrave të veprimit që një forcë e caktuar e ka të nevojshme për të planifikuar, organizuar dhe kryer operacione të inteligjencës ushtarake. Lidhur me inteligjencën në luftë, deri para agresionit në Ukrainë, ka dominuar ideja se intelijenca dhe doktrinat e saj duhet të ishin sekrete. Publiku mund të shikonte vetëm rezultatet e arritura në fushën e luftimit dhe në bazë të tyre të gjykonte se kjo kishte ardhur si rezultat i punës së inteligjencës ushtarake. Koha tregoi se informacioni për armikun është shumë i rëndësishëm jo vetëm për vendimmarrësit politikë dhe komandantët ushtarakë, por edhe për opinionin publik.

⁴ OSINT Strategy 2024-2026 https://www.dni.gov/files/ODNI/documents/IC_OSINT_Strategy.pdf

⁵ Shih linkun: https://assets.publishing.service.gov.uk/media/650c03bf52e73c000d9425bb/AJP_10_1_Info_Ops_UK_web.pdf

⁶ SOCMINT - Intelijenca që përftohet nga shfrytëzimi i mediave sociale

Leksioni i parë në fushën e inteligjencës, nga pushtimi rus i Ukrainës, ishte rënia e mitit të “fshehtësisë”. Fshtësia e informacionit që lidhej me armikun, nuk rezultoi i dobishëm, madje klasifikimi i tij nganjëherë e vononte informimin për popullsinë, jeta e të cilit rrezikohej dhe nuk i jepte kohë dhe mundësi të ndërgjegjësohej për t’i dërguar vullnetarisht bijtë e vet në frontin e luftës. Agresioni rus rezultoi të jetë deri tani “lufta e epokës së militarizimit të internetit”, më e mbuluar në mënyrë digjitale ku Starlink ishte pjesa kryesore e SOCINT⁷, duke hapur diskutimin për doktrinat e reja në fushën e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, të kësaj epoke të re.

Perëndimi në këtë luftë guxoi për herë të parë të shmangë sekretet e panevojshme të shërbimeve të tyre të inteligjencës; duke i “deklasifikuar” menjëherë dhe pa procedurën standarde. Paralajmërimi për agresionin rus që po përgatitej, u realizua përmes SOCMINT, bindës dhe në kohë reale, si për qeveritë aleate ashtu dhe për opinion publik, në të njëjtën kohë. Zbulimi i pushtuesve rusë u bë përmes informacionit mediatik publik, vetëm me burimet të saj SOCMINT. Shpeshherë në situatë ankthi dhe frike të justifikuar të luftës, vetëm informacioni i medias sociale nuk mjafton për të pasur një pasqyrë të plotë të situatës, pasi të dhënat deformohen, manipulohen, fshihen si dhe përdoren për një qëllim dhe interes të caktuar të përpiluesit të tij.

Fuqia e burimeve të medias së shkruar, elektronike ELINT dhe SOCMINT, rezultoi i suksesshëm për herë të parë në këtë masë në historinë e luftërave, ku media është përdorur por gjithmonë në rend të dytë, si mbështetëse e inteligjencës sekrete. Komuniteti i inteligjencës perëndimore dhe NATO-s gjatë fillimit të vitit 2022 i analizonte burimet e hapura OSINT hap pas hapi dhe qëllimisht iu dha akses gazetarëve në informacione sekrete, që ata të shikonin dhe raportnin se si po armatosej dhe po përgatitej për luftë Rusia. Perëndimi dhe NATO kishin armë të “vërtetat” përballë armëve ruse “dezinformacion, spiunazh, sabotazh dhe subversionin”, siç janë të përshkruar në doktrinën Gerasimov⁸. Media perëndimore, por edhe ruse e ukrainase, e furnizuar nga agjencitë e inteligjencës paraqiste fakte të dukshme, në kohë reale dhe të prekshme nga shumë njerëz, rreth qëllimit dhe agresionit ushtarak rus, i cili po përgatitej. Raporti klasik i medias si burim i inteligjencës është përmbysur: tani, intelijenca është shndërruar në burim të vetë medias. Ky ndryshim përbën një paradigmë të re, e cila ka lindur nga fenomeni i njohur si

⁷ Sipas shkrimit të studiuesit britanik Matthew Ford, për “The telegraf”, më 19 dhjetor 2022.

⁸ Doktrina e Gjeneralit Gerasimov, SHSHP të Rusisë, publikuar në 2013, thotë: “*Rregullat e luftës kanë ndryshuar. Roli i mjeteve joushtarake për arritjen e qëllimeve politike dhe strategjike është rritur, madje në shumë raste ato kanë tejkaluar fuqinë e armëve të zjarrit, në efektivitetin e tyre*”.

“militarizimi i rrjetit të internetit.” Pa hapësirën që interneti ofron, nuk do të ishte e mundur as lufta mediatike, as informimi i publikut dhe as krijimi i një doktrine të re të domosdoshme për OSINT dhe SOCMINT. Nevoja për të ndarë informacionin rreth Ukrainës me opinionin ndërkombëtar u shfaq si thelbësore për strategjinë e re të komunikimit, e cila synonte jo vetëm informimin, por edhe sigurimin e mbështetjes publike - si nga ukrainasit, ashtu edhe nga skeptikët ndërkombëtarë⁹. Për të arritur këtë objektiv, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA luajtën një rol kyç, duke kërkuar zhvillimin e një koncepti të ri për përdorimin efektiv të inteligjencës paralajmëruese. Kjo doktrinë e re që po merr formë ka afruar qeveritë perëndimore, duke i bashkuar në qëndrimin e tyre për të dënuar agresorin dhe planin e tij, si dhe për t’u përgatitur përpara se të ndodhë sulmi.

Informimi në kohë reale “mori kohën e duhur” për të ndërgjegjësuar, pajisur dhe trajnuar ukrainasit në përgatitjet e tyre luftarake mbrojtëse. Inteligjenca nga OSINT dhe SOCMINT për Ukrainën ishte thelbësore, sepse u lejoi qytetarëve të postojnë foto dhe video, me vendndodhjet e pushtuesve. Madje qytetarët, me SOCMINT (Facebook, Twitter, Telegram) në celularët e tyre, patën mundësi të shërbenin si “operatorë” të dronëve Bayraktar¹⁰.

Dezinformacioni rus aktualisht paraqitet si kërcënim pa armë zjarri, por dëmi që ai sjell kur ka sukses dhe merr besim në audiencë, është ndoshta më i madh se sa nga armët e zjarrit. Presidenti Eisenhower e ka njohur aftësinë e “Luftës informative me dezinformacion si më të rrezikshme se sa lufta me armë zjarrit. Dezinformacioni në përgjithësi dhe ai rus në veçanti, vazhdon të ketë qëllim për të përçarë, mashtruar dhe manipuluar të vërtetën dhe mendimin kritik të perëndimit. Megjithatë propaganda dhe dezinformacioni ishin përdorur në historinë e luftërave për të destabilizuar dhe çorientuar forcat kundërshtare, në doktrinat aktuale të inteligjencës ka një nënvleftësim dhe mos përgatitje për metodat dhe mënyrat e reja që ka adaptuar në këtë fushë, epoka e internetit. Përgjatë shekullit të 20-të aleatët dhe kundërshtarët në konflikte, e kanë përdorur këtë “mjete influence” për qëllimet dhe objektivat e tyre strategjike.

Aktualisht, hapësira digjitale e luftës, bën që skenarët “me dezinformacion” të realitetit, të përhapen më shpejt dhe më larg se sa kurrë më parë. Sfidë është se kush e zotëron këtë hapësirë dhe kush arrin të bindë audiencat. Qëllimi i kësaj fushate ishte “blerja e vëmendjes” dhe fitimi i mbështetjes. Ka një numër vendesh ku kryeson Rusia, të cilat kanë një impakt shumë më të madh në përdorimin e taktikave informative, nëpërmes teknikave të dezinformacionit.

⁹ Thirrje publike e A. Blinken më 12 prill 2022.

¹⁰ Mykhailo Fedorov, ministri i transformimit digjital i Ukrainës për “The Washington Post”.

AI gjeneruese përbën një formë të re të dezinformimit, e cila mund të manipulojë përmbajtjet audio, video dhe vizuale në mënyra që i japin një pamje të rreme realitetit. Në duart e aktorëve keqdashës, këto teknologji mund të përdoren për të fabrikuar deklarata ose veprime të rreme dhe për t'ua atribuuar kundërshtarëve të tyre, duke krijuar një perceptim mashtrues të publiku. Fuqia e AI gjeneruese për të përhapur përmbajtje të falsifikuara në shkallë globale e bën veçanërisht sfiduese dallimin mes realitetit dhe manipulimit, duke kërkuar vigjilencë dhe mjete të avancuara për verifikimin e autenticitetit të informacionit. / Rusët po përgatisin një ushtri me (batalion, Brigadë) të hackerëve dezinformatorë, të cilët kanë qëllim të penetrojnë në rrjetet sociale të figurave të rëndësishme politike dhe ushtarake dhe të komentojnë pozitivisht sulmin në Ukrainë, apo të godasin me spiunazh, subversion dhe sabotazh.

Shoqëritë përballen me çështje të debatueshme dhe kompleksitete të mëdha, nga aborti dhe emigracioni deri te besimi, raca dhe përbërja etnike. Këto tema ngjallin reagime emocionale dhe shpesh çojnë në fenomenin e njohur si “pengmarrja e logjikës,” një term që i referohet humbjes së lidhjes midis pjesëve të trurit përgjegjëse për analizën shkakësore dhe evolutive të fakteve. Mungesa e trajnimit, e kohës dhe e qasjes në burime të besueshme e vështirëson ndarjen e fakteve nga dezinformimi. Si rezultat, individët shpesh mbështeten në burime të shpejta dhe të thjeshta, të cilat, megjithëse duken të vërteta, mund të jenë të manipuluara dhe të çojnë në përhapjen e keqinformimit. Njerëzit janë të prirur të besojnë në gjërat të cilat përkojnë dhe janë më afër me qëndrimet dhe idetë e tyre, si dhe kundër humbjes së kohës për të analizuar informacion kontradiktor shumë burimesh. Protestat në UK gjatë muajit gusht 2024 mendohen se janë nga dezinformacione islamofobike të sponsorizuara nga Rusia por edhe me ndihmën e platformave dhe veçanërisht X¹¹ që është pjesë e SOCMINT. Pamjet në foto dhe videot nga rrjetet sociale SOCMINT, kanë më shumë impakt dhe informacion se sa tekstet e shkruara, pasi e paraqesin shpejt dhe dukshëm realitetin, duke shmangur dyshimet për manipulim, gjë e cila ndodhi dhe u zhvillua me OSINT në Ukrainë.

Hapja e agjencive të inteligjencës amerikane ndaj publikut, duket se është pranuar si normë dhe si doktrinë tashmë. Si asnjëherë më parë po shohim drejtorin më të rëndësishëm të inteligjencës amerikane (CIA) që ndërmerr udhëtime, bën deklarata dhe drejton negociatat. Drejtori i CIA-s, William Burns viziton pas Bosnjë-Hercegovinës edhe Beogradin, edhe Prishtinën më 27 gusht 2024. Të gjitha mediat sociale furnizuan SOCMINT me të dhënat nga rrjetet sociale, si mjet për të përhapur mesazhet e Burns jo për t'i mbajtur

¹¹ Shih linkun: <https://www.dw.com/sq/britania-e-madhe-si-e-djathta-ekstreme-%C3%ABrfitoi-nga-zem%C3%ABrimi-popullor/a-69919516>

ata sekret. Këtë radhë udhëtimi dhe mesazhet nuk ishin sekrete, takimet nuk ishin kokë më kokë, por hapur. Njëloj si në Ukrainë SHBA-të po zgjedhin të informojnë paralelisht edhe publikun me qëndrimet dhe veprimet e saj. Në këtë mënyrë shmangen edhe dezinformacionet dhe interpretimet që mund të manipulohen qoftë edhe me AI gjeneruese. Pra, hapi i parë i deklasifikimit të panevojshëm të informacioneve të inteligjencës ka ndodhur, mbetet leximi dhe përgatitja jonë për këtë sfidë jo të lehtë.

Digjitalizimi i fushëbetejës¹² shtron nevojën për të përditësuar edhe doktrinat tradicionale të SIGINT¹³, HUMINT dhe SOCMINT

NSA (Agjencia e Sigurisë Kombëtare Amerikane) është përgjegjëse për ofrimin e inteligjencës së sinjaleve të huaja SIGINT për politikëbërësit dhe forcat ushtarake të SHBA-së. SIGINT luan një rol jetik në sigurinë kombëtare duke u ofruar liderëve të informacionin kritik që u nevojitet për të mbrojtur vendin, për të shpëtuar jetë dhe për të avancuar qëllimet dhe aleancat e SHBA-së në nivel global. SIGINT është inteligjencë që rrjedh nga sinjalet dhe sistemet elektronike të përdorura nga objektiva të huaja, si sistemet e komunikimit, radarët dhe sistemet e armëve e cila ofron një dritare dije për sigurinë kombëtare në aftësitë, veprimet dhe synimet e kundërshtarëve të vendit dhe aleatëve të NATO-s.

Misioni i SIGINT është i kufizuar në mënyrë specifike në mbledhjen e informacionit rreth kundërshtarëve ndërkombëtarë, fuqive, organizatave ose personave të huaj. NSA prodhon inteligjencë në përgjigje të kërkesave zyrtare të vendosura nga ata që kanë nevojë për inteligjencë, duke përfshirë të gjitha departamentet e qeverisë. NSA, duhet të mbajë hapin me përparimet në teknologjitë me shpejtësi të lartë dhe shumëfunktionale të epokës së sotme të informacionit. Vëllimi, shpejtësia dhe shumëllojshmëria gjithnjë në rritje e sinjaleve aktuale e bëjnë prodhimin e inteligjencës dhe në kohë për komandantët ushtarakë dhe politikëbërësit, më sfidues dhe emocionues se kurrë. Teknologjia moderne e telekomunikacionit paraqet sfida të rëndësishme për misionin SIGINT, pasi shumë gjuhë që përdoren në mbarë botën janë me interes për udhëheqësit ushtarakë dhe politikë.

NSA duhet të mbajë gjithashtu një shumëllojshmëri të gjerë të aftësive gjuhësore të zhvilluara nga AI gjeneruese. SIGINT-i i suksesshëm në të ardhmen do varet nga aftësitë e profesionistëve të gjuhës, matematikanëve,

¹² Shih linkun: <https://www.natohcoe.org/doctrine-and-standards/>, March 25, 2024.

¹³ SIGINT - Inteligjenca sinjalore

analistëve dhe inxhinierëve, etj., që të marrin maksimumin e rezultatit. Mendimi kritik i nevojshëm për të përmbushur qëllimet strategjike varen nga një fuqi njerëzore e kualifikuar, larmishme dhe me këndvështrime të ndryshme dhe një mjedis plotësisht sfidues dhe gjithëpërfshirës. NSA e ka një traditë të mirë të punësimit të njerëzve të përkushtuar, shumë të kualifikuar, të cilët janë thellësisht të dedikuar për të ruajtur sigurinë e vendit. Ndërsa teknologjia padyshim do të vazhdojë të jetë një element kyç i së ardhmes sonë, NSA, SIGINT, IMINIT¹⁴ dhe i gjithë komuniteti i inteligjencës e pranon se teknologjia është po aq e mirë sa njerëzit që e krijojnë dhe njerëzit që e përdorin atë.

Informacioni ushtarak që lidhet me armikun ka qenë shumë i domosdoshëm për vendimmarrjen e komandantit, ka pasur shpejtësinë e përhapjes së tij të njëjtë me mjetin që e transmetonte këtë informacion. Fillimisht me korrierë, më vonë me kalë, me automjet, me anije me avion dhe së fundmi në për herë të parë në përgatitjen e agresionit rus, por edhe më pas, në mënyrë digjitale, ose thënë ndryshe në kohë reale. Motorët e kërkimit dhe satelitët privatë komercialë ofronin pamje, foto dhe video direkt nga terreni “free” për këdo. Inteligjenca Njerëzore (HUMINT) është një formë e mbledhjes së informacionit “në terren” duke përdorur burime njerëzore, mund të përfshijë infiltrimin dhe angazhimin në aktorë kërcënimi në rrjetet e krimit të fshehtë, forume, platforma bisedash dhe mjedise të tjera të synuara, përfshirë rrjetin e errët¹⁵.

Qëllimi i HUMINT është të mbledhë informacione rreth kundërshtarëve dhe aktivitetit të tyre për të mësuar më shumë rreth njerëzve që qëndrojnë pas sulmeve kibernetike, duke përfshirë motivimet, objektivat dhe teknikat e tyre. Ky informacion, kur përdoret në kombinim me të dhënat dhe njohuritë e mbledhura nga burime të tjera teknike, përdoret për të ndihmuar forcat e armatosura që të identifikojnë rreziqet dhe të parandalojnë sulmet. Është e rëndësishme të theksohet se HUMINT është një disiplinë ligjore që kërkon trajnim të specializuar që jo vetëm të mbledhin informacione të dobishme, por të përdorin gjithashtu sigurinë operacionale (OPSEC), të cilat janë masat për të mbrojtur identitetin e vërtetë të oficerit ose lidhjet e tyre me agjencitë qeveritare. Ndërsa aktorët shtetërorë të kërcënimit përdorin teknika më të sofistikuar dhe të avancuara sulmi, të tilla si nisja e sulmeve pa “flamur”, të cilat janë të vështira për t’u zbuluar vetëm duke përdorur teknologjinë. HUMINT është bërë një komponent i domosdoshëm brenda strategjisë së sigurisë kibernetike. HUMINT ofron disa përfitime të rëndësishme për organizatat dhe agjencitë qeveritare. Marrja e të dhënave nga këto kanale për të parandaluar sulmet e afërta kërkon shumë më tepër sesa thjesht mbledhja e

¹⁴ IMINIT - Imazhery intelligence

¹⁵ Shih linkun: <https://www.crowdstrike.com/cybersecurity-101/the-dark-web-explained/>

të dhënave të papërpunuara. Me HUMINT, të aftë të mund të depërtojë në këto mjedise për të mbledhur informacion më të hollësishëm rreth këtyre sulmuesve dhe planeve të tyre dhe më pas të ndërmarrin hapin e rëndësishëm për të paralajmëruar viktimat për një sulm të afërt ose në vazhdim. Kundërshtarët e dinë rolin që luajnë mjetet e sigurisë në automatizimin e mbledhjes së të dhënave nga mjediset e synuara. Si rezultat, shumë prej tyre kanë filluar të errësojnë, mashtrojnë dhe dezinformojnë qëllimisht detajet në postime, të tilla si emrat ose domenet. HUMINT nevojitet për të zbuluar tendencat e reja dhe për të vërtetuar nëse të dhënat e mbledhura nga këto mjete janë të besueshme dhe të plota. HUMINT ka vlerë duke ndihmuar ekipin e sigurisë të kuptojë pretendimet e bëra nga një aktor. Për shembull, gjatë një sulmi ransomware, aktori mund të pretendojë se ka aftësi shumë më të mëdha se sa ata në të vërtetë, me shpresën për të përfituar një pagesë më të madhe shpërblimi.

Në këtë situatë, HUMINT mund të ndihmojë ekipin e sigurisë të vërtetojë pretendimet e aktorit dhe të përgjigjet në përputhje me rrethanat e vërteta. Krimet digjitale janë tejet të vështira për t'u hetuar dhe ndjekur penalisht, veçanërisht nëse aktori vepron në një vend tjetër nga ai ku ndodhet viktimja e sulmit. HUMINT i siguron nga një ofrues i shërbimit të sigurisë kibernetike është me vlerë të madhe për agjencitë e zbatimit të ligjit, sepse ekipi i sigurisë mund të ndajë informacionet përkatëse dhe të nevojshme të profilin e aktorit. Këtu përfshihen emrat e vërtetë, vendbanimi, shtetësia dhe detaje të tjera të rëndësishme, kur është e mundur. Siç u diskutua më lart, vetëm teknologjia nuk mund të identifikojë dhe parashikojë në mënyrë efektive sulmet moderne dhe të sofistikuar. Nga ana tjetër, monitorimi i të gjitha të dhënave nëntokësore vetëm me inteligjencën njerëzore do të ishte thjesht i pamundur. Kombinimi i grumbullimit të automatizuar dhe HUMINT-it, mund të përftohen në mënyrë efektive informacionet e duhura në lidhje me aktivitetet kryesore të kërcënimit.

Kur ndodh një sulm, veçanërisht në rastin e një sulmi ransomware, njohja e aktorit dhe aftësive të tij do të ndihmojë në mënyrën se si organizata reagon ndaj sulmit. Për shembull, gjatë një sulmi ransomware, kundërshtari mund të nxjerrë pretendime për të dhënat që janë vjedhur ose se si ato mund të korruptohen. HUMINT mund të ndihmojë në vërtetimin e këtyre pretendimeve dhe të ndihmojë në marrjen e vendimeve nëse duhet të bëhet një pagesë shpërblimi. Aktorët kërcënues ndryshojnë vazhdimisht taktikat dhe teknikat. Ata gjithashtu përdorin komunitetet e fshehta dhe klandestine për të kërkuar informacion dhe ndihmuar ata të kryejnë sulme, të tilla si shfrytëzimi dhe zhvillimi i malware. Duke monitoruar dhe kuptuar llojin e asistencës që u nevojitet këtyre aktorëve, sulmet mund të shmangen ose ndalohen përpara se të paraqesin rrezik për organizatat. Kur emërohet një personalitet, analistët e inteligjencës përdorin HUMINT për të kuptuar ekosistemin, aftësitë dhe

motivimet e aktorit. Kjo njohuri është e dobishme për të gjurmuar aktivitetin e tyre, si dhe për të vlerësuar një sulm për të cilin është përgjegjës ky individ ose grup. Duke filluar nga pushtimi i Ukrainës, hapet një kapitull krejtësisht të ri në përdorimin politik, ushtarak dhe diplomatik të inteligjencës OSINT me nëndegën e saj SOCMINT. Në kohë reale u arritën të bashkoheshin shumë “gurë” të “mozaikut të planit rus”, i cili qartësohej dita ditës me të dhëna nga burimet e hapura¹⁶.

Gjigandët e IA, si GPT-4 i OpenAI, po garojnë për të siguruar mbështetjen e agjencive të inteligjencës ushtarake në rrjetet e klasifikuara

Agjencitë amerikane me në krye inteligjencën ushtarake DIA¹⁷ po përpiqen të përqafojnë revolucionin e IA, duke besuar se përndryshe do të mbyten nga rritja eksponenciale e të dhënave pasi teknologjia e mbikëqyrjes e gjeneruar nga sensorët mbulon të gjithë planetin. Teknologjia është e re dhe e brishtë dhe IA gjeneruese, që prodhon modele të dhënash tekste sipas kërkesës, imazhe, video dhe biseda të ngjashme me njeriun real, është e krijuar kryesisht për mashtrim. Analistët e inteligjencës po kërkojnë sot “modele të sofistikuara të inteligjencës artificiale që mund të absorbojnë sasi të mëdha të informacionit me burime të hapur OSINT dhe SOCINT si dhe ato të fituara në mënyrë të fshehtë tradicionale. Mijëra analistë në 18 agjencitë e inteligjencës amerikane përdorin tani një gjeneratë IA¹⁸ të quajtur Osiris. Osiris¹⁹ funksionon me të dhëna të paklasifikuara dhe të disponueshme publikisht, që njihet si (OSINT).

Ky aplikacion i ri shkruan përmbledhje të grumbulluar nga një sasi e madhe informacioni dhe funksioni i tij chatbot i lejon analistët të thellohen me pyetjet e tyre. Është i rëndësishëm të shënohet nga analistët se nga vjen informacioni, cili është burimi fillestar, për të shmangur burimet “fake”. Aplikacioni i ri, i vënë në punë në prill 2024, përdor modele të shumta të inteligjencës artificiale nga ofrues të ndryshëm komercialë, sigurisht të klasifikuar, por nga kompani të ndryshme, pasi “gara” mes tyre i ka bërë ata të kapërcejnë shumë herë njëra-tjetrën. Gjenerata AI, e përdorur nga analistët e inteligjencës, funksionon si një asistent virtual, duke ndihmuar në gjetjen e hollësive që njerëzit nuk mund të zbulojnë vetë. Megjithatë, ajo nuk mund dhe nuk do të zëvendësojë kurrë ekspertizën dhe gjykimin njerëzor. Agjencitë tashmë po integrojnë IA në proceset e tyre, duke përdorur algoritme dhe teknologji të përpunimit të gjuhës

¹⁶ Erik J. Dahl, *Intelligence and Surprise Attack*, Publisher: Georgetown University Press, 2013

¹⁷ DIA- Defence Intelligence Agency

¹⁸ <https://www.thecipherbrief.com/podcasts/state-secrets-podcast-interview-cia-osint-randy-nixon-announcement>

¹⁹ <https://www.osiris-ai.co.uk/>

natyrore për përkthime, detyra analitike dhe studime. Sidoqoftë, IA mbetet një mjet ndihmës dhe nuk mund të përshkruajë drejtpërdrejt realitetin ose të zëvendësojë aftësinë njerëzore për të interpretuar kontekstin dhe nuancat e ngjarjeve. Përdorimi i aplikacionit më i përhapur do të jetë në analizat parashikuese. Kjo ndoshta do të jetë një nga ndryshimet më të mëdha të paradigmes në të gjithë sferën e sigurisë kombëtare; aftësia për të parashikuar se çfarë kanë të ngjarë të bëjnë kundërshtarët tanë. Makina e inteligjencës artificiale të Rhombus²⁰ bazohet në mbi 5000 transmetime të dhënash në 250 gjuhë të mbledhura gjatë 10 e më shumë viteve, duke përfshirë burimet globale të lajmeve, imazhet satelitore dhe hapësirën kibernetike të të dhënave. E gjithë kjo është me burim të hapur OSINT.

Ne mund të gjurmojmë njerëzit, ne mund të gjurmojmë gjithashtu edhe objektet. Kompanitë gjigande të AI që konkurrojnë për biznesin e agjencie të inteligjencës përfshijnë Microsoft, i cili njoftoi më 7 maj 2024 se po ofronte GPT-4 të OpenAI për rrjetet top-sekret, megjithëse produkti duhet të akreditohet, para se të bëhet për punë në rrjetet e klasifikuara. Primer AI, rendit dy agjenci të inteligjencës në mesin e klientëve të tij të cilat përfshijnë shërbime të inteligjencës ushtarake²¹. Primer AI ofron kërkim të thelluar nga AI në 100 gjuhë për të “zbuluar sinjalet e shfaqura të informacioneve nga burime duke përfshirë Twitter, Telegram, Reddit dhe Discord, për të ndihmuar në identifikimin e “njerëzve, organizatave, vendndodhjeve kryesore. Në një demonstrim në një konferencë të ushtrisë amerikane vetëm disa ditë pas sulmit të Hamasit²² në Izrael më 7 tetor 2023, drejtuesit e kompanisë përshkruan se si teknologjia e tyre arrinte të ndante faktin nga trillimi në “lumin” e informacionit online që vjen nga Lindja e Mesme. Në terma afatshkurtër, mënyra se si zyrtarët dhe agjencitë e inteligjencës e përdorin AI mund të jetë më pak e rëndësishme sesa kundërveprimi ndaj mënyrës sesi kundërshtarët tanë e përdorin atë. Është një shqetësim, për shembull, nëse agjencitë qeveritare vendosin të përdorin AI për të eksploruar teknologjinë e armëve bio dhe kibernetike.

William Hartung, një studiues i lartë në Institutin Quincy²³, është shprehur se “agjencitë e inteligjencës duhet të vlerësojnë me kujdes inteligjencën artificiale për abuzime të mundshme që të mos çojnë në pasoja të paqëllimshme, siç janë survejimi i paligjshëm ose një rritje e viktimave civile në konflikte”. E gjithë kjo vjen në kontekstin e rasteve të përsëritura ku sektorët e FA-ve dhe inteligjencës kanë reklamuar “armë të mrekullueshme” dhe qasje revolucionare

²⁰ Shih linkun: <https://rhombusai.com/>

²¹ Shih linkun: <https://jackpoulson.substack.com/p/your-ai-is-your-rifle>

²² Shih linkun: <https://primer.ai/news/c4isrnet-how-primer-parsed-misinformation-early-in-israel-hamas-war/>

²³ Shih linkun: <https://quincyinst.org/author/william-d-hartung/>

nga fusha e betejës elektronike në Vietnam te programi i Star Wars të viteve 1980 te “revolucionin në çështjet ushtarake në vitet 1990 dhe 2000 - vetëm për t'u gjetur se ato nuk mungojnë. Misionet e IA do të ndryshojnë shumë në varësi të agjencisë së përfshirë. Nuk ka një masë që i përshtatet të gjitha agjencive. Në SHBA, Agjencia e Sigurisë Kombëtare përgjon komunikimet, Agjencia Kombëtare e Inteligjencës Gjeohapësinore (NGA) përfshin vëzhgimin dhe analizimin e çdo centimetër katrorë të planetit. MASINT bën matje, të cilat agjenci të shumta i përdorin për të gjurmuar kërcënimet duke përdorur sensorët fizikë. Në dhjetor 2023, NGA²⁴ lëshoi një kërkesë për propozime për një lloj krejtësisht të ri të modelit gjenerues të AI. Qëllimi është të përdoren imazhet që mbledhen nga satelitët, në nivelin e tokës, për të mbledhur inteligjencë të saktë gjeohapësinore me komanda të thjeshta zanore ose tekste.

Aplikacionet e gjeneratës AI gjithashtu kanë shumë kuptim për konfliktin kibernetik, ku sulmuesit dhe mbrojtësit janë në luftë të vazhdueshme dhe automatizimi tashmë është në zhvillim. Por shumë çështje jetike të inteligjencës nuk kanë të bëjnë me shkencën e të dhënave dhe agjencitë e inteligjencës do të shkaktojnë katastrofë nëse miratojnë gjeneralitetin AI shumë shpejt ose plotësisht. Modelet nuk arsyetojnë, as thjesht parashikojnë ndërsa projektuesit e tyre nuk mund të shpjegojnë plotësisht se si funksionojnë. Analiza e inteligjencës si zemra e çdo agjencie është në sfidë nga AI. Analistët punojnë me “copëza jo të plota, të paqarta, shpesh kontradiktore të informacionit të pjesshëm dhe jo të besueshëm. Ajo ngjan më shumë si një libër orientues për bashkimin e një mozaiku, vetëm kur dikush tjetër përpiket të vjedhë gurët tuaj në mozaik. Analistët besojnë shumë në instinktin, kolegët, bazën e të dhënave dhe kujtesën institucionale.

Në epokën e globalizimit dhe digjitalizimit, sulmet kibernetike dhe ndërprerja digjitale po bëhen kërcënime serioze për sigurinë e informacionit edhe në Shqipëri. Ky hulumtim përdor një qasje cilësore për të analizuar sulmet kibernetike, llojet e sulmeve dhe ndikimin e tyre, duke u fokusuar në rolin e Inteligjencës Njerëzore (HUMINT) në adresimin dhe zbulimin e këtyre kërcënimeve dhe aktorëve që fshihen apo i financojnë ato. Sulmet kibernetike, duke përfshirë malware, phishing dhe DDoS, kanë ndikime shkatërruese financiare, reputacionale dhe operacionale ushtarake. Duke angazhuar HUMINT, ky hulumtim eksploroj rolin kryesor të HUMINT në kuptimin e motivimit të sulmuesit, analizës sociale dhe psikologjike dhe zhvillimit të informacionit të detajuar. Bashkëpunimi midis HUMINT dhe ekipeve të sigurisë teknike është theksuar gjithashtu për të përmirësuar reagimin ndaj kërcënimeve kibernetike. Rezultatet e këtij hulumtimi ofrojnë një bazë teorike

²⁴ Shih linkun: <https://sam.gov/opp/b292b00eac2648bd88549dd7a31b5252/view>

dhe praktike për zhvillimin e një strategjie sigurie gjithëpërfshirëse, duke theksuar rolin e rëndësishëm të HUMINT në trajtimin e dinamikës në zhvillim të sulmeve kibernetike.

Sfida e inteligjencës çdo luftë, ka qenë gjithmonë zbulimi i “qëllimit” të liderit dhe i kohës “kur” ushtria e tij do të sulmojë. Në të gjitha doktrinat luftarake, befasia vlerësohet si një avantazh që punon në anën e armikut deri në momentin e sulmit. “Ju keni orët ndërsa ne kemi kohën”, thotë një proverb afgan që ka parasysh rëndësinë e befasisë dhe lodhjen e kundërshtarit. Koha e një sulmi, ka qenë dhe do të jetë gjithmonë e vështirë të parashikohet, kështu që zbulimi strategjik ushtarak duhet të jetë i kujdesshëm për dhënien e “kushtimit. Përgjigja e pyetjes “kur do të sulmojë kundërshtari” bëhet më e ndërlikuar dhe më e vështirë, nëse ne përpiqemi të kuptojmë synimet e liderëve autokratë, aq më tepër kur këta janë edhe ekspertë të shërbimeve sekrete, si Vladimir Putin i cili i di pasi i ka drejtuar edhe vetë HUMINT. Projektimi i linjës logjike si ekspertë ushtarakë, ka vërtetuar se vetëm bërja e “avokatit të djallit”, rezulton si një nga rrugët drejt suksesit. Për të zbuluar vendimin e kundërshtarit, duhet futur në kokën e tij, ose të jesh pranë tij me HUMINT dhe të përpiqesh të mendosh, gjykos, analizosh dhe të funksionosh si ai.

Të arsyetosh si një amerikan, gjerman apo shqiptar për sjelljen e mundshme të një rusi, është e gabuar pasi ndërtimi i proceseve të gjykimit dhe arsyetimit, nuk janë të ngjashme. Shkërmoqja e paparashikuar e ushtrisë afgane, fill pas largimit të trupave të koalicionit, ndodhi si pasojë e këtij gabimi analitik, ku faktorët historikë, socialë, religjiozë, arsimorë, gjeografikë, ekonomikë, politikë etj., nuk u vlerësuan sa dhe si duhet nga perëndimi. “Nuk do të mund ta bënit këtë pa inteligjencën artificiale,” tha Brian Drake, drejtori i atëhershëm i AI i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes dhe koordinatori i projektit. Analistët kërkojnë modele të sofistikuara të inteligjencës artificiale që mund të përpunojnë sasi të mëdha të informacionit nga burime të hapura OSINT, me qëllim për të fituar në mënyrë klandestine, shkroi së fundi drejtori i CIA-s, William Burns, në Foreign Affairs²⁵. Por kjo nuk do të jetë e thjeshtë. Eksperti inaugurues i teknologjisë i CIA-s, Nand Mulchandani²⁶, mendon se për shkak se modelet e gjeneratës së inteligjencës artificiale “halucinojnë” ato trajtohen më së miri si një “mik i çmendur dhe i dehur”. Ekzistojnë gjithashtu çështje sigurie dhe privatësie: kundërshtarët mund t’i vjedhin t’i helmojnë ato të cilat mund të përmbajnë të dhëna personale të ndjeshme që jot ë gjithë janë të autorizuar t’i shohin.

²⁵ Shih linkun: <https://www.foreignaffairs.com/united-states/cia-spycraft-and-statecraft-william-burns>

²⁶ Shih linkun: <https://www.gsb.stanford.edu/programs/msx/why-stanford-msx/alumni-voices/nand-mulchandani>

Mijëra analistë në 18 agjencitë e inteligjencës amerikane përgjatë vitit 2022-2025 përdorin tani një gjeneratë AI të zhvilluar nga CIA të quajtur Osiris²⁷. Ai funksionon në të dhëna të paklasifikuara dhe të disponueshme publikisht ose komercialisht është ende herët, pasi analistët duhet të jenë në gjendje të dinë me siguri absolute se nga vjen informacioni. Agjencitë e inteligjencës po provojnë të gjitha modelet kryesore të gjeneratës së fundit të inteligjencës artificiale, duke mos i dhënë monopolin askujt sepse AI-të vazhdojnë të kapërcejnë njëri-tjetrin në aftësi konkurruese. General AI pritet të përmirësojë procese të tilla. Përdorimi i tij më i fuqishëm i inteligjencës do të jetë në analizat parashikuese, deklaroi CEO i Rhombus Power²⁸, Anshu Roy. Kjo ndoshta do të jetë një nga ndryshimet më të mëdha të paradigmes në të gjithë sferën e sigurisë kombëtare, aftësia për të parashikuar se çfarë ka të ngjarë të bëjnë kundërshtarët tuaj. Makina e inteligjencës artificiale të Rhombus bazohet në mbi 5000 transmetime të dhënash në 250 gjuhë të mbledhura gjatë 10 e më shumë viteve, duke përfshirë agjencitë globale të lajmeve, imazhet satelitore dhe hapësirën kibernetike të të dhënave. E gjithë kjo është me burim të hapur OSINT.

Gjigandët e AI që konkurrojnë për biznesin e agjencisë së inteligjencës amerikane përfshijnë Microsoft, njoftoi më 7 maj 2024 se po ofronte GPT-4 të OpenAI²⁹ për rrjetet top-sekret, megjithëse produkti duhet të akreditohet për punë në rrjetet e klasifikuara. Primer AI është një tjetër konkurrent në AI i cili punon për dy agjenci inteligjencës amerikane dhe përveç këtyre përfshijnë edhe FA. Primer AI ofron kërkim të fuqizuar nga AI në 100 gjuhë për të “zbuluar sinjalet e shfaqura të ngjarjeve dhe burimeve duke përfshirë Twitter, Telegram, Reddit dhe Discord, si dhe për të ndihmuar në identifikimin e dhe vendndodhjen e njerëzve, organizatave etj. Në një demonstrim në një konferencë të ushtrisë vetëm disa ditë pas sulmit të Hamasit në Izrael më 7 tetor 2023, drejtuesit e kompanisë Primer AI përshkruan se si teknologjia e tyre ndan faktin nga trillimi në vërshimin e informacionit online, që do të jetë maja e shkencës në fushën e informacionit.

²⁷ Shih linkun: <https://www.pbs.org/neeshour/world/u-s-intelligence-agencies-embrace-of-generative-ai-is-at-once-wary-and-urgent>

²⁸ Shih linkun: <https://craft.co/rhombus-power/executives>

²⁹ Shih linkun: <https://www.bing.com/videos/search?q=Microsoft,+i+cili+njoftoi+më+7+maj+2024+se+po+ofronte+GPT-4+të+OpenAI&qvt=Microsoft,+i+cili+njoftoi+më+7+maj+2024+se+po+ofronte+GPT-4+të+OpenAI+&FORM=VDRE>

Përfundime

- Inteligjenca si instrument i fuqisë kombëtare (IOP) dhe hapësira kibernetike, për arsye se veprojnë dhe zhvillohen në domenin e përbashkët të (të dhënave”, duhet të ecin në të njëjtin ritëm në shekullin e inteligjencës artificiale.
- Zhvillimet të fushën e informacionit ushtarak ³⁰ pas 24 shkurtit 2022 dhe luftës kundër Hamasit, nga 7 tetori 2023, kanë diktuar përditësimin koncepteve dhe manualeve të funksionimit të OSINT, SOCMINT, HUMINT³¹, SIGINT, IMINT, COMINT, TELINT, MASINT etj.
- Gjigandët e inteligjencës artificiale (përfshirë Microsoft, Primer AI, Rhombus Power, Osiris etj.), në kohën e përgatitjes së këtij shkrimi, po konkurrojnë për biznes me agjencitë e inteligjencës amerikane, të cilët sipas njoftimit më 7 maj 2024, janë të gatshëm të ofrojnë GPT-4 të OpenAI për rrjetet top-sekret.
- Produkti teknologjik mund të akreditohet për punë për rrjetet e klasifikuara në vitin 2025.
- SOCMINT i fuqizuar me IA dhe Chatgpt është e hapur dhe ofron jashtëzakonisht shumë informacion me vlerë, që analistët e kanë të pamundur për ta konkurruar.
- Mesazhi “publik” i drejtorit të CIA-s më 27 gusht 2024 në Ballkan³², është sinjali i parë i hapjes së agjencive të inteligjencës për të informuar direkt publikun, si ndryshimi thelbësor doktrinar duke përfshirë SOCMINT.
- Si FARSH dhe AISM, unë sugjeroj dhe ofroj asistencë për monitorimin e vazhdueshëm dhe përditësimin e doktrinaeve në fushën e inteligjencës, me qëllim mbështetje në vlerësimin e kërcënimeve reale ndaj Shqipërisë, Kosovës dhe rajonit, duke i analizuar ato nga një perspektivë afatgjatë, përtej vitit 2030.

³⁰ Komponentët e fuqisë kombëtare: Diplomaci, Informacion, Ushtri, Ekonomi, Financë, Inteligjencë, Zbatim i ligjit

³¹ Shih linkun: <https://www.natohcoe.org/ehat-is-humint-centre-of-excellence/>. July 10, 2023.

³² Shih linkun: <https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/politike/shefi-i-cia-s-ne-kosove-cilat-ishin-mesazhet-dhe-cfa-i1126719>

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Erik Dahl, “Suksesi dhe dështimi i inteligjencës”.
2. Tobias Liebetrau. (2023) *Organizing cyber capability across military and intelligence entities: collaboration, separation, or centralization*, *Policy Design and Practice*, 6:2, 131-145, DOI: 10.1080/25741292.2022.2127551
3. Michael Poznansky. *Në hijen e së drejtës së autorit: Sekreti dhe ndryshimet në botën e pasluftës* (Oxford, MB: Oxford University Press, 2020), 78–110.
4. OSINT Strategy 2024-2026. Shih linkun: https://www.dni.gov/files/ODNI/documents/IC_OSINT_Strategy.pdf
5. NATO OSINT Capability. Shih linkun: https://www.act.nato.int/wp-content/uploads/2023/05/rfi022059_qa1a.pdf; May 2023.
6. <https://www.natohcoe.org/what-is-humint-centre-of-excellence/> July 10, 2023
7. https://assets.publishing.service.gov.uk/media/650c03bf52e73c000d9425bb/AJP_10_1_Info_Ops_UK_web.pdf
8. <https://www.act.nato.int/article/nato-coes-humint/> April 3, 2024
9. <https://www.natohcoe.org/doctrine-and-standards/> March 25, 2024.
10. <https://www.natohcoe.org/what-is-humint-centre-of-excellence/>. July 10, 2023.
11. <https://www.gov.uk/government/publications/jdp-2-00-understanding-and-intelligence-support-to-joint-operations>; 17 gusht 2023.
12. Komanda e Ardhshme e Ushtrisë Amerikane (AFC), *Mjedisi Operacional i Ardhshëm: Formimi i së Ardhmes në një të Pasigurt Botë, 2035–2050*, AFC Pamflet 525-2 (Austin: AFC, 2021), 7–8.
13. Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës së Ushtrisë Amerikane (TRADOC), *Mjedisi Operacional dhe Ndryshimet Karakteri e Lufta*, TRADOC Pamflet 525-9 (Fort Eustis, VA: TRADOC, tetor 2019), 21–23.
14. <https://www.osintcoe.hr/department-of-doctrine-and-methodology/101>
15. <https://greydynamics.com/insight/a-guide-to-human-intelligence-humint/>
16. <https://www.crowdstrike.com/cybersecurity-101/threat-intelligence/human-intelligence-humint/>

ANALIZË KRAHASUESE E DOKTRINËS INTELIGJENTE TË NATO-S DHE QASJA KOLEKTIVE KUNDREJT NEUTRALITETIT SOVRAN

Dr. Drizan SHALA

*Drejtor i Asociacionit të Kriminalistëve
dhe Kriminologëve, Kosovë*

Trajtesë e shkurtuar

Doktrina e sigurisë, e mbrojtjes dhe e inteligjencës janë të ndërlidhura njëra me tjetrën gjithashtu edhe në këndvështrim zyrtar përkufizohen si shprehje të sigurisë kombëtare, por që është e domosdoshmëri të kemi një këndvështrim me të saktë i cili të bazohet në njësi të ndryshme politike.

Pra këto doktrina operojnë brenda formatit të zgjidhjeve strategjike dhe përpiqen të maksimizojë sigurinë e territorit si shqetësimin më të rëndësishëm politik në kuptimin e përgjithshëm dhe sigurisë në kuptimin e veçantë, duke ofruar strategji vendimmarrëse për drejtuesit e vendit.

Në këtë drejtim, studimi i zgjidhjeve strategjike doktrinare dhe krahasimi i doktrinë inteligjente në mes NATO-s dhe Zvicrës, është e ngjashme me Shqipërinë dhe Kosovën, por gjithashtu është e rëndësishë së veçantë në ndryshimet finale të gjeopolitikës si fenomen politik i cili ka theks në maksimizimin e fuqisë, sigurisë dhe kapacitetit të brendshëm territorial të një shteti.

Bazuar në atë të sipërshtënuar, sidomos shtetet e vogla, duhet të fillojnë të konceptojnë doktrinat e tyre inteligjente duke krijuar pavarësinë inteligjente e cila mbron interesat nacionale në raport edhe me detyrimet ndaj formacioneve të ndryshme ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes.

Rezultatet aktuale tregojnë se çdo teoricien nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes duhet të sugjerojë sigurinë e territorit, të siguruar nga zgjidhje të ndryshme strategjike të sigurisë, me një fokus të veçantë në mënyrë që të ketë sukses në fushat operative.

Fjalët kyçe: NATO, Doktrina e Sigurisë Ushtarake dhe Inteligjente, Shërbimi i Inteligjencës Federale (FIS)

Hyrje

Në një botë të karakterizuar nga paqëndrueshmëria gjeopolitike dhe kërcënimet komplekse, intelijenca strategjike ka një rol vendimtar në formësimin e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes. Organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe shtete sovranë zhvillojnë doktrina të sigurisë, mbrojtjes dhe të inteligjencës për të përballuar sfida si: terrorizmi, lufta hibride, sulmet kibernetike dhe spiunazhi. Në këtë kontekst, NATO dhe Zvicra përfaqësojnë dy qasje të ndryshme: njëra mbështetet në bashkëpunimin kolektiv dhe ndarjen e informacionit, ndërsa tjetra thekson neutralitetin dhe autonominë kombëtare. Doktrina inteligjente e NATO-s është ndërtuar mbi parimin e mbrojtjes kolektive (neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut) dhe promovon shkëmbimin e informacionit midis vendeve anëtare për të identifikuar dhe parandaluar kërcënimet e përbashkëta. Përmes strukturave si *NATO Intelligence Fusion Centre* (NIFC) dhe *NATO Intelligence and Security Division* (NISD), NATO bashkon burimet inteligjente për të rritur efektivitetin e sigurisë rajonale dhe globale.

Në të kundërt, doktrina inteligjente e Zvicrës është e ndërtuar mbi neutralitetin e përhershëm dhe pavarësinë strategjike. Përmes *Federal Intelligence Service* (FIS), Zvicra përqendrohet në mbrojtjen e sovranitetit dhe sigurisë së brendshme, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe duke shmangur angazhimet e jashtme të detyruara. Kjo qasje synon të ruajë stabilitetin dhe të minimizojë rrezikun e përfshirjes në konflikte ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë dhe krahasojë këto dy doktrina inteligjente, duke theksuar dallimet në strukturën institucionale, qasjen ndaj bashkëpunimit dhe ndikimin e politikës së jashtme në formësimin e strategjisë së inteligjencës. Objektivat kryesorë të trajtimit të kësaj teme janë:

- të kuptojmë dallimet ndërmjet doktrinës së sigurisë, asaj ushtarake dhe inteligjente;
- të shqyrtojmë parimet dhe strukturat kryesore të doktrinës inteligjente të NATO-s dhe të Zvicrës;
- të analizojmë ndikimin e neutralitetit në politikën e inteligjencës së Zvicrës.

Pyetjet kërkimore kryesore janë:

- Si ndryshon doktrina inteligjente e NATO-s nga ajo e Zvicrës?
- Si ndikon neutraliteti në qasjen zvicerane ndaj inteligjencës?

Rëndësia e këtij punimi qëndron në ofrimin e një analize të hollësishme krahasuese që mund të ndihmojë studiuesit, politikbërësit dhe ekspertët e sigurisë të kuptojnë më mirë ndikimin e strukturave dhe filozofi të ndryshme në efektivitetin e inteligjencës. Për më tepër, ky punim kontribuon në debatin akademik mbi balancën mes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pavarësisë kombëtare në një mjedis global të pasigurt.

Perspektiva realiste dhe liberale mbi përkufizimet e doktrinave të sigurisë, mbrojtjes dhe inteligjencës

Në analizën e marrëdhënieve ndërkombëtare, perspektiva realiste dhe liberale ofrojnë dy këndvështrime të ndryshme për doktrinat e sigurisë, mbrojtjes dhe inteligjencës dhe përdorimin e tyre. Këto dy qasje ndryshojnë thelbësisht në lidhje me rolin e forcës së sigurisë ushtarake, inteligjente dhe qëllimet e saj në sistemin ndërkombëtar. (Fredrik Doeser and Filip Frantzen 2022).

- Perspektiva realiste për doktrinat

Realizmi është një teori që thekson konkurrencën, sigurinë dhe rolin e shtetit në një sistem ndërkombëtar anarkik, ku nuk ka një autoritet të lartë që të mund të zbatojë rregulla. Nga ky këndvështrim, shtetet janë të shqetësuara kryesisht për mbijetesën e tyre dhe do të kërkojnë të maksimizojnë sigurinë e tyre në një mjedis pasigurie dhe konkurrencë. Sipas realistes, doktrinat formohen nga kërcënimi konstant i veprimeve të shteteve të tjera. (Fredrik Doeser and Filip Frantzen 2022). Rritja e forcës ushtarake nga një shtet mund të shkaktojë një garë armatimesh ose mund të nxisë një shtet tjetër të parandalojë veprimet. Doktrinat realiste shpesh përqendrohen në ndalimin e kërcënimeve përmes një mundësie të fuqishme mbrojtëse ose detyruese, si dhe në gatishmërinë për të reaguar ndaj një apo më shumë sulmesh. Realistët besojnë se, doktrinat në përgjithësi dhe atyre inteligjente në veçanti janë të orientuara nga ruajtja e interesave kombëtare, që zakonisht kuptohen si mbrojtje dhe forcë.

Kjo do të thotë se strategjitë e sigurisë ushtarake, përqendrohen në gatishmërinë për luftë apo njohuritë si **strategjitë e frikësimit** (p.sh., ndalimi bërthamor), dhe në përgatitjen për situatat më të këqija si luftë me shtete rivale. Pra realitetet i mbrojnë doktrinat që të përmbajnë një balancë të aftësive ofensivë dhe mbrojtëse, në varësi të mjedisit të sigurisë. Një shtet mund të adoptojë një doktrinë goditëse parandaluese ose të ketë një pozicion mbrojtës, në varësi të kërcënimeve të perceptuara nga shtetet e tjera. Doktrinat në kuadër

të realizmit janë të lidhura ngushtë me ruajtjen ose rregullimin e balancës së pushtetit në nivel ndërkombëtar. Shtetet mund të formulojnë doktrinat në varësi të lëvizjeve të pushtetit, për shembull, kur një shtet rival po rrit forcën e tij. (Collins 2007)

- Perspektiva liberale për doktrinat

Liberalizmi, nga ana tjetër, thekson bashkëpunimin ndërkombëtar, institucionet dhe mundësinë për paqe përmes normave, ligjeve dhe organizatave ndërkombëtare. Sipas kësaj perspektive, doktrinat formohen nga besimi se konflikti nuk është i pashmangshëm dhe shtetet mund të bashkëpunojnë për të arritur qëllime të përbashkëta. Liberali beson se doktrinat e sigurisë ato ushtarake dhe të inteligjencës duhet të përqendrohen në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes organizatave ndërkombëtare si NATO ose organizatave rajonale të sigurisë. (David Schwartz, Daniel Galily 2017).

- Përkufizimi mbi doktrinën e sigurisë

Është një set i parimeve dhe politikave që udhëzojnë një shtet ose organizatë në formimin e strategjive dhe masave për të siguruar mbrojtjen e interesave të tij kombëtare, territoriale, politike, ekonomike dhe sociale përballë kërcënimeve të mundshme. Ajo përfshin një kuptim të thellë të faktorëve të brendshëm dhe ndërkombëtarë që mund të ndikojnë në sigurinë e një shteti dhe si të menaxhohen kërcënimet që mund të rrezikojnë sigurinë kombëtare. (Sempa 2004)

- Përkufizimi mbi doktrinën e mbrojtjes

Është një grup parimesh, strategjish dhe politikash që udhëzojnë një shtet në përdorimin e forcës ushtarake dhe resurseve të tjera për të mbrojtur territorin, qytetarët, dhe interesat e tij kombëtare nga kërcënimet e brendshme dhe të jashtme. Ajo funksionon si një shtet planifikon dhe organizon mbrojtjen e tij, duke përfshirë përdorimin e forcës ushtarake, menaxhimin e kërcënimeve, dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e sigurisë. (LT. COL. G. R. MEYER 1939). Ndërsa sipas Hysni Gjergjit në punimin e tij “Modernizimi i forcave të armatosura nën ndikimin gjeopolitik dhe transformimin teknologjik” thekson që “doktrina ushtarake është tërësia themelore e parimeve që udhëheqin FA-të për të përmbushur objektivat e sigurisë kombëtare”. (Hysni Gjergji 2024)

- Përkufizimi mbi doktrinën e inteligjencës

Është një udhëzues i domosdoshëm që përcakton se si duhet të kryhen operacionet e inteligjencës për të siguruar mbrojtjen e interesave kombëtare dhe për të garantuar që informacioni i mbledhur dhe analizuar të shërbejë në mënyrë efikase dhe të sigurt për vendimmarrësit (KEVIN D. SCOTT Vice Admiral 2017).

Evoluimi i Doktrinë Inteligjente të NATO-s

Qëllimi kryesor i NATO-s është të ruajë lirinë dhe sigurinë e të gjithë anëtarëve të saj me mjete politike dhe ushtarake, dhe për këtë qëllim, në konceptin strategjik të vitit 2010 përcaktohen detyrat e saj kryesore: mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave dhe sigurisë bashkëpunuese dhe shkëmbimi i informacioneve në fushën e inteligjencës. (Rêgo 2018). Prandaj **Doktrina Inteligjente e NATO-s** filloi të theksonte nevojën për të **kompleksuar dhe diversifikuar mbledhjen e informacionit**. NATO filloi të zhvillonte një qasje më të integruar dhe të bashkërenduar për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit, duke përfshirë bashkëpunimin me organizata të tjera ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian duke zbatuar teorinë liberale mbi konceptin e sigurisë. (NATO 2024). Publikimet doktrinare të NATO-s shpesh kanë marrëdhënie funksionale dhe janë grupuar në një arkitekturë të quajtur Arkitektura e Përbashkët e Doktrinë Aleate (AJDA).




Fig.1. Arkitektura e Përbashkët e Doktrinë Aleate (AJDA) (Gubbels 2020)

Pra, mund të konstatojmë që në vitin 1996, NATO pati operacionin e parë tokësor në Bosnje dhe Hercegovinë ku gjatë këtij operacioni, NATO filloi të mbledh inteligjencën e saj përmes qelizave kombëtare lokale. Qelizat e inteligjencës mbështetën forcat e dislokuara dhe stafin e NATO-s. Prandaj duke parë nevojën, NATO vazhdoi të zgjeronte numrin e qelizave aktive të

inteligjencës ndërsa operacionet e tyre u rritën në shtrirje. Këto qeliza kishin gjithashtu një precedent të shkëmbimit të informacionit ndërmjet njëra-tjetrës, që është një koncept që do të vazhdonte në Qendra e *Intelligence Fusion Center* (NIFC). (Recio 2025).

Pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 dhe thirrja e mëvonshme e nenit 5 (i cili përcakton se një sulm kundër një anëtarë është sulm kundër të gjithë anëtarëve), nxitën organizimin e Samitit të Pragës. Samiti i cili përfundoi me një mandat për të përmirësuar strukturën e NATO-s dhe për të përmirësuar kapacitetin e NATO-s për të ndërmarrë dhe përfunduar me sukses operacione të reja. Kjo ishte shtysa për krijimin e NIFC. Qëllimi i NIFC është të krijojë një aparat më kohezive të inteligjencës për NATO-n dhe të korrigjojë boshllëqet e informacionit brenda organizatës. NIFC krijon produkte të inteligjencës që më pas ia shpërndan Operacioneve të Komandës Aleate dhe vendeve aleate të NATO-s. (Recio 2025)

Inteligjenca e NATO-s mbështetet nga një numër agjencish të inteligjencës kombëtare dhe të integruara në NATO. Inteligjenca e NATO-s u bë e rëndësishme, kur NATO filloi të ndërtonte organizata të forcave shumëkombëshe pranë shtabeve shumëkombëshe. (Korkisch 2010).




Fig. 2. Qendra e Intelligence Fusion Center (NIFC)

Një reformë gjithëpërfshirëse e sektorit të inteligjencës së NATO-s u avancua në 2010-2011 dhe solli përmirësime të konsiderueshme në sasinë dhe cilësinë e koordinimit ndërinstucional, analizës së informacionit dhe shkëmbimit të inteligjencës. Bordi Drejtues i Inteligjencës (ISB) kishte

për detyrë të mbikëqyrte dhe zhvillonte kërkesat strategjike të inteligjencës. Njësia e Inteligjencës Ushtarake (IU) u krijua në selinë e NATO-s si një organ i përbashkët civil dhe ushtarak që mbështet vendimmarrësit me analiza dhe vlerësime të bazuara në inteligjencë, të prodhuara në bashkëpunim të ngushtë me Divizionin e Inteligjencës IMS. Njësia ndërlidhëse e inteligjencës përmirësoi mekanizmin e ndarjes së inteligjencës civile dhe ushtarake me partnerët. Në dimensionin operacional, Komanda Aleate e Transformimit (ACT) rriti dhe përmirësoi analizat strategjike dhe parashikimet në lidhje me konceptet dhe aftësitë e inteligjencës. Komanda Aleate për Operacionet (ACO) përforcoi mbështetjen e inteligjencës për planifikimin dhe ekzekutimin operacional, duke përmirësuar sistemet e komunikimit dhe informacionit për qëllime të shkëmbimit të informacionit dhe ndarjes së inteligjencës. Në këtë drejtim, zhvillimi i Inteligjencës së Përbashkët, Mbikëqyrjes dhe Zbulimit (JISR) u njoh si një nga elementët vitalë të operacioneve ushtarake, duke përfshirë aftësitë para operative dhe ndërgjegjësimin e zgjeruar të situatës. (Gruszczak 2024) e cila është e paraqitur në figurën 3, ku procesi i inteligjencës, vëzhgimit, zbulimit, sinkronizimit dhe integritit, (ISR) është i sinkronizuar me inteligjencën dhe operacionet cikle. Edhe pse procesi ISR është shpesh në linjë me fazat e grumbullimit dhe përpunimit të ciklit të inteligjencës, ai nuk është ekskluzivisht i përafër, veçanërisht kur asetet ISR mbështesin operacionet drejtpërdrejt dhe në kohë reale. Pra, në figurën 3 është ilustruar përafrimi i procesit të ISR dhe ciklet të inteligjencës dhe vendimeve. (The Development 2023).




Fig. 3. Përafrimi i procesit të ISR dhe ciklet të inteligjencës dhe vendimeve

Evoluimi i Doktrinës Inteligjente të Zvicrës

Doktrina Zvicerane e Inteligjencës ka pësuar transformime të rëndësishme gjatë historisë së saj, duke reflektuar ndryshimin e peizazheve politike, sociale

dhe teknologjike. Fillimisht të formuara nga një përkushtim ndaj neutralitetit dhe privatësisë, praktikat e inteligjencës zvicerane kanë evoluar si përgjigje ndaj sfidave të brendshme dhe kërcënimeve të jashtme. Evolucioni historik i këtyre praktikave mund të gjurmohet në krijimin e strukturave formale të inteligjencës në fillim të shekullit të 20-të, të cilat ishin të fokusuara kryesisht në sigurinë kombëtare dhe stabilitetin e brendshëm (Haering 2002). Me kalimin e kohës, ndërsa dinamika globale u zhvendos, veçanërisht me rritjen e terrorizmit dhe kërcënimeve kibernetike, agjencitë e inteligjencës zvicerane përshtatën strategjitë e tyre për të përfshirë një gamë më të gjerë shqetësimesh të sigurisë. Kjo përshtatshmëri është e dukshme në raportet e fundit që nxjerrin në pah rreziqet në rritje nga aktivitetet e spiunazhit të huaj dhe lëvizjet ekstremiste vendase.

Për më tepër, diskutimet rreth mekanizmave të mbikëqyrjes kanë fituar rëndësi pas skandaleve financiare brenda shërbimeve të inteligjencës që kërkuan një shqyrtim më të madh parlamentar (Haering 2002). Pra qasja e Zvicrës ndaj inteligjencës ka ndryshuar me kalimin e kohës duke ruajtur parimet thelbësore të tilla si mbikëqyrja demokratike dhe respekti për liritë civile, ne mund të fitojmë një kuptim më të thellë të kornizës së saj aktuale operative. (Vestner 2022). Në thelb të Doktrinës Zvicerane të Inteligjencës është koncepti i bashkëpunimit në shumë nivele. Komuniteti i inteligjencës zvicerane përbëhet kryesisht nga Shërbimi Federal i Inteligjencës (FIS), i cili operon nën Departamentin Federal të Drejtësisë dhe Policisë. FIS punon në bashkëpunim me disa agjenci federale dhe kantonale, si dhe organe të zbatimit të ligjit. Kjo qasje e integruar lejon bashkimin e burimeve dhe ekspertizës, duke nxitur një sistem më efikas dhe efektiv të inteligjencës. Për më tepër, konfliktet dhe emergjencat shpesh kërkojnë bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, kështu që doktrina promovon lidhjet diplomatike duke mbështetur shkëmbimin e informacionit me vendet aleate. (Margelist 2024). Pajtueshmëria ligjore dhe respektimi i lirive civile janë komponentë thelbësorë të Doktrinës Zvicerane të Inteligjencës. Duke pasur parasysh ndikimin e fortë të Zvicrës mbi të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike, praktikat e inteligjencës i nënshtrohen mbikëqyrjes rigoroze legislative. Akti Federal për Shërbimin e Inteligjencës, i miratuar në vitin 2017, përshkruan kuadrin ligjor që rregullon aktivitetet e inteligjencës.

Ai vendos parametra për mbledhjen, mbikëqyrjen dhe analizën e të dhënave duke mbrojtur të drejtat e privatësisë së individëve. Ky kuadër jo vetëm që siguron llogaridhënie, por shërben edhe për të ruajtur besimin e publikut në operacionet e inteligjencës. (Margelist 2024). Vitet e fundit, doktrina zvicerane e inteligjencës është përshtatur me shfaqjen e kërcënimeve të reja, veçanërisht në fushën e sigurisë kibernetike. Digjitalizimi në rritje i shoqërisë ka çuar në një

rritje të sulmeve kibernetike që kërcënojnë sigurinë kombëtare. Si përgjigje, Zvicra i ka dhënë prioritet zgjerimit të aftësive të saj të mbrojtjes kibernetike, duke i përfshirë këto përpjekje brenda doktrinë së saj të inteligjencës. Baza e vendosur nga strategjia federale zvicerane e sigurisë kibernetike thekson parandalimin, mbrojtjen dhe reagimin në arenën digjitale, duke reflektuar natyrën në zhvillim të kërcënimeve. (Amherd 2022).

Si përfundim mund të themi që Doktrina Zvicerane e Inteligjencës është një qasje e shumanshme që balancon nevojat e sigurisë kombëtare me parimet demokratike. Ndërsa kërcënimet globale evoluojnë, në anën tjetër angazhimi i Zvicrës për bashkëpunim, përputhshmëri ligjore dhe strategji adaptive siguron një qëndrueshmëri dhe efektivitet të inteligjencës. Integrimi i këtyre elementeve është thelbësor që Zvicra të lundrojë në kompleksitetin e sfidave bashkëkohore të sigurisë.

Përfundime

Në këtë punim kemi arritur të shqyrtojmë dhe krahasojmë dy doktrina të ndryshme të inteligjencës në aspektin strategjike: ajo e NATO-s dhe atë të Zvicrës, e cila tani ka një reflektim në një kontekst të pasigurt dhe të paqëndrueshëm gjeopolitik.

Duke u bazuar në konceptin se NATO, është e mbështetur në parimin e mbrojtjes kolektive dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet vendeve anëtare dhe duke përdorur struktura si NATO Intelligence Fusion Centre dhe NATO Intelligence and Security Division.

Kjo për të identifikuar dhe parandaluar kërcënimet e përbashkëta tani po dëshmon që shumë shtete të NATO-s janë duke reflektuar dhe duke ndërtuar doktrinat e tyre inteligjente kombëtare ndërsa nga ana tjetër, Zvicra, e mbështetur në neutralitetin e saj të përhershëm dhe pavarësinë strategjike, zhvillon dhe forcon një doktrinë inteligjente që fokusohet në mbrojtjen dhe sigurinë e brendshme pa angazhime të jashtme duke ruajtur neutralitetin dhe operacionalitetin afatgjatë në përdorimin e informacioneve inteligjente për nevojat e saj duke i shkëmbyer me shtete që ka marrëdhënie dypalëshe në këtë fushë.

Nga sa më lart analizuam, arrijmë në përfundimin që:

- Të zhvillohen strategji të reja që adresojnë sfidat e neutralitetit të shteteve të vogla që mund të ndikojnë në bashkëpunimin e sigurisë ndërkombëtare.
- Të investojmë në forcimin e kapaciteteve dhe strategjive inteligjente për të mbrojtur më mirë interesat kombëtare dhe për të menaxhuar kërcënimet që mund të vijnë nga jashtë, duke ruajtur gjithashtu autonominë e saj.
- Të vazhdojmë të monitorojnë ndryshimet në kërcënimet globale dhe të

rishqyrtojnë doktrinat e sigurisë për t'u siguruar që ato mbeten efektive në përballimin e sfidave të reja. Diskutimi mbi balancën midis bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pavarësisë kombëtare duhet të jetë një temë qendrore në politikat e sigurisë dhe inteligjencës.

- Të inkurajohet një qasje më e hapur ndaj bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për të ndihmuar në luftën kundër kërcënimeve të përbashkëta si terrorizmi dhe sulmet kibernetike, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë dhe integritetin kombëtar.
- Kosova dhe Shqipëria duhet të hartojnë një doktrinë të përbashkët ushtarake dhe të asaj inteligjente në vijim të bashkëpunimit.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Amherd, Viola. Situation Report of the Federal Intelligence Service, Bern, October 10. 2022.
2. Collins, Alan. Contemporary security studies, Oxford Press University. 2007.
3. David Schwartz, Daniel Galily. Scientific Research Publishing (SCIRP). Aprill 26. 2017. Accessed March 01, 2025. <https://www.scirp.org/journal/paperinformation?paperid=75637>.
4. Fredrik Doeser and Filip Frantzen. 2022. "*The strategic and realist perspectives: An ambiguous relationship.*" Journal of Strategic Studies 919-922.
5. Gruszczak, Artur. 2024. "globsec." globsec. Accessed March 04, 2025. <https://www.globsec.org/sites/default/files/2018-03/NATOs-intelligence-adaptation-challenge.pdf>.
6. Gubbels, F.H.M.J. 2020. Naval Academy Strategic Research. December 10. Accessed March 4, 2025. https://www.mod.go.jp/msdf/navcol/assets/pdf/ssg2020_12_10.pdf.
7. Haering, Dr. Barbara. 2002. investigating the strategic intelligence service of Switzerland. Bern, October 02.
8. Hysni Gjergji, Msc. Kolonel. 2024. "Modernizimi i Forcave të Armatosura nën ndikimin gjeopolitik dhe transformimin teknologjik." Revista Ushtarake 31.
9. Kevin D. Scott Vice Admiral, USN, Director, Joint Force Development. 2017. Joint and National Intelligence Support to Military Operations. July 5. Accessed February 28, 2025. <https://irp.fas.org/doddir/dod/>

jp2_01. pdf.

10. Korkisch, Friedrich W. 2010. NATO Gets Better Intelligence- New Challenges Require New Answers to Satisfy Intelligence Needs for Headquarters and Deployed/Employed Forces. Vienna: Institut für Außen- und Sicherheitspolitik IAS.
11. LT. COL. G. R. MEYER, C.A.C. 1939. Armyupress. June. Accessed March 03, 2025. <https://www.armyupress.army.mil/Portals/7/military-review/Archives/English/100-Landing/Topics-Interest/Doctrine/June-1939-Meyer.pdf>.
12. Margelist, Sonja. 2024. Admin.ch. October 22. Accessed March 05, 2025. <https://www.admin.ch/gov/en/start/documentation/media-releases.msg-id-102858.html>.
13. NATO. 2024. NATO. March 7. Accessed March 04, 2025. https://www.nato.int/cps/uk/natohq/topics_111830.htm?selectedLocale=en.
14. Recio, Raquel Ramirez. 2025. Grey Dynamics. Feb 24. Accessed March 05, 2025. <https://greodynamics.com/nato-intelligence-fusion-center-nerve-center-for-western-forces/>.
15. Rêgo, Nelson José Mendes. 2018. “Repositório Comum,” Repositório Comum, April 15. Accessed March 4, 2025. https://comum.rcaap.pt/bitstream/10400.26/36212/2/Intelligence%20in%20NATO%20...%20%28Ing%29_Nelson%20Rego.pdf.
16. Sempa, Francis P. 2004. Ciaotest cc Columbia. April 19. Accessed March 03, 2025. https://ciaotest.cc.columbia.edu/olj/ad/ad_v9_2/sef01.html.
17. The Development, Concepts and Doctrine Centre. 2023. “gov.uk.” <https://www.gov.uk/>. August 15. Accessed March 05, 2025. https://assets.publishing.service.gov.uk/media/653a4b0780884d0013f71bb0/JDP_2_00_Ed_4_web.pdf.
18. Vestner, Tobias. 2022. From Strategy to Orders: Preparing and Conducting Military Operations with Artificial Intelligence. Geneva, October 7.

BALLKANI, LABORATORI I BASHKËPUNIMIT TË SIGURISË

Major Sonila VARFI

Agjencia e Inteligjencës së Sigurisë së Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar

Ballkani, një rajon me një histori të pasur dhe të trazuar, ka kaluar nëpër periudha të shumta të pasigurisë, konflikteve etnike dhe tensioneve territoriale. Megjithatë, ndonëse këto sfida janë ende të pranishme, Ballkani ka evoluar dhe ka krijuar mundësi unike për të shërbyer si një “laborator” i sigurisë, ku mund të zhvillohen dhe testohen modele të reja të bashkëpunimit rajonal.

Në këtë kuadër, Ballkani tashmë ofron mundësi për të krijuar dhe implementuar qasje inovative për sigurinë, që përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet shteteve, grupeve etnike dhe aktorëve ndërkombëtarë. Përdorimi i teknologjisë moderne, ndarja e informacionit dhe angazhimi i shoqërisë civile janë elemente kyçe për krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të qëndrueshëm.

Përballë kërcënimeve të përbashkëta si terrorizmi, krimi i organizuar dhe sfidat e sigurisë kibernetike, Ballkani ka mundësinë të shndërrohet në një model për të tjerët, duke shfrytëzuar integrimin e avancuar ndërkombëtar dhe zhvillimin e bashkëpunimit të ngushtë. Ky “laborator” mund të krijojë një model sigurie që është fleksibël, i qëndrueshëm dhe në përputhje me realitetet e reja të sigurisë globale.

Një nga sfidat kyçe që Ballkani ka hasur është mungesa e besimit ndërmjet shteteve të tij, një pengesë që ka bërë të vështirë krijimin e një strategjie të përbashkët të sigurisë. Megjithatë, mundësitë për t’u kapërcyer këto barrierë ekzistojnë, siç janë përpjekjet për integrimin evropian, mbështetje

nga organizata ndërkombëtare dhe angazhimi i shoqërisë civile. Në këtë kontekst, Ballkani mund të shërbejë ende si një laborator ku mund të testohen strategji të reja sigurie, që ndihmojnë në zhvillimin e politikave të sigurisë dhe bashkëpunimit që mund të përdorëshin edhe në rajone të tjera të botës. Ky model bashkëpunimi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe fleksibël, duke mundësuar reagime të shpejta dhe efikase ndaj kërcënimeve të reja që mund të lindin.

Në fund, Ballkani mund të bëhet një shembull i suksesit për bashkëpunimin ndërkombëtar, duke e përdorur konceptin e “laboratorit” si mundësi për të zhvilluar dhe testuar qasje të reja të sigurisë që mund të udhëzojnë rajonet e tjera drejt një të ardhmeje më të sigurt.

Fjalët kyçe: rajoni i Ballkanit, terrorizmi, krimi i organizuar, ndryshimet klimatike, kërcënimet kibernetike, bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar, integrimi evropian etj.

Ballkani ka qenë gjithmonë udhëkryqi i Evropës dhe kushdo që i kontrollon atë ka potencialin të dominojë...

George Friedman

Ballkani nga traumat e kaluara, në mundësitë e bashkëpunimit

Ballkani ka një histori të dhimbshme, të mbushur me gjurmë të luftërave dhe pasojat e një të kaluare të trazuar. Luftërat e ish-Jugosllavisë kanë lënë një trashëgimi të thellë që vazhdon të ndikojë në dinamikat e sigurisë të rajonit. Ky kontekst i pasigurisë dhe traumat e kaluara mund të shërbejnë si mundësi për krijimin e një të ardhmeje të qëndrueshme dhe paqësore përmes bashkëpunimit.¹

Ballkani paraqet një sfidë të veçantë, ku secili shtet ka kaluar një rrugë të ndryshme, përballë pasojave të luftërave dhe proceseve të ndërlikuara të integritetit. Disa shtete kanë bërë përparime të dukshme në integrimin në Bashkimin Europian dhe NATO, duke e forcuar stabilitetin politik dhe sigurinë. Ndërkohë, të tjerë mbeten përballë sfidave të brendshme dhe tensioneve me fqinjët, duke e bërë rajonin një hapësirë që, përtej pasigurisë, ofron mundësi të reja për bashkëpunim dhe zhvillim të përbashkët.

¹ Samuel P. Huntington, *The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order*, (Free Press, 2020).

Por, si mund të transformohen këto mundësi nga trauma dhe frika nga e kaluara? A është e mundur që historia e dhimbshme të shërbejë si një mundësi për ndërtimin e një të ardhmeje paqësore dhe të qëndrueshme?

Në vend të trajtimit të historisë si një ngarkesë që kufizon mundësinë për bashkëpunim, ajo mund të trajtohet si një udhërrëfyes për të mësuar nga dështimet e kaluara dhe për të kuptuar mundësitë që ofron të ardhmja. Pasiguria dhe trauma nga luftërat mund të bëhen elemente të rëndësishme për krijimin e një model të ri sigurie më gjithëpërfshirëse, më e mbështetur në besim dhe bashkëpunim.²

Ky proces kërkon një ri përkufizim të konceptit të sigurisë. Siguria nuk është më vetëm një çështje ushtarake ose territoriale; ajo është një çështje e bashkëjetesës, zhvillimit të përbashkët dhe mbështetjes reciproke. Ballkani mund të kalojë nga një rajon i fragmentuar dhe i ndarë në një hapësirë ku shtetet dhe popujt mund të bashkëpunojnë për të përballuar kërcënimet e përbashkëta, siç janë terrorizmi, krimi i organizuar, ndryshimet klimatike dhe kërcënimet kibernetike.

Një nga elementët kyç për zhvillimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm në siguri është krijimi i një strukture që tejkalon interesat politike të shteteve të Ballkanit, dhe që mbështetet në njohjen dhe respektimin e diversitetit kulturor dhe etnik. Identitetet kombëtare dhe etnike, të cilat pas luftërave janë bërë burime tensioni, mund të shndërrohen nga barrierë në mundësi për bashkëpunim. Ajo që është e nevojshme është një qasje që i vlerëson këto identitete jo si pengesa, por si elemente të një mozaiku të pasur dhe kompleks që mund të kontribuojnë në forcimin e sigurisë rajonale. Një mundësi e tillë është krijimi i institucioneve rajonale të sigurisë që janë të hapura dhe gjithëpërfshirëse, duke respektuar dhe integruar grupet etnike dhe kulturore të rajonit. Këto institucione mund të shndërrohen në platforma bashkëpunimi që nuk kërkojnë heqjen dorë nga identitetet kombëtare, por që ofrojnë mundësinë për të ndihmuar njëri-tjetrin në ndërtimin e një sigurie kolektive dhe të qëndrueshme.³

Kultura dhe trashëgimia kulturore janë gjithashtu elemente kyçe për bashkëpunimin rajonal. Ballkani ka një pasuri të madhe tradicionale dhe kulturore, dhe këto mund të përdoren si mjet për të ndihmuar përf forcimin e lidhjeve mes popujve të rajonit⁴. Përmes projekteve të përbashkëta kulturore,

² Kmezic, M. (2021). *The Politics of Security in the Western Balkans: Regional Dynamics, National Policies, and International Influences*. Routledge.

³ Ferguson, N. (2020). *The Square and the Tower: Networks and Power, from the Freemasons to Facebook*. Penguin Press.

⁴ Balfour, *The European Union and the Balkans*, (Oxford University Press, 2020), 34.

edukative dhe shkencore, mund të ndërtohet një ndjenjë e përbashkët identiteti dhe sigurie, që ndihmon në integrimin e popujve të rajonit dhe në forcimin e paqes. Në këtë proces, angazhimi i aktorëve ndërkombëtarë, si Bashkimi Europian dhe NATO, mund të luajë një rol të rëndësishëm. Ata mund të ofrojnë mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve të sigurisë të shteteve të Ballkanit dhe të ndihmojnë në procesin e integritit dhe stabilizimit afatgjatë. Ky angazhim mund të kontribuojë në ndihmën për ndërtimin e një rajoni më të qëndrueshëm dhe të sigurt.⁵

Përmes bashkëpunimit të thelluar dhe përpjekjeve të përbashkëta, Ballkani mund të kalojë nga një të kaluar e mbushur me dhimbje në një të ardhme të ndritshme. Përmes respektimit të diversitetit, zhvillimit të përbashkët dhe përdorimit të instrumenteve të reja, si arsimi, media dhe bashkëpunimi ekonomik, rajoni mund të krijojë një model të ri sigurie, që është i qëndrueshëm, transformues dhe i fokusuar në ndihmën reciproke. Kështu, trauma e kaluar mund të shndërrohet në një mundësi për një të ardhme paqësore dhe të sigurt për të gjithë rajonin.

Transformimi i asimetrive në mundësi

Ballkani duke qenë një rajon kompleks, ku historia, politika dhe siguria ndërthuren në një rrjet të ngatërruar, ofron si sfida ashtu edhe mundësi. Për shumë vite, ky rajon është parë si një terren eksperimentimi për sigurinë, një “laborator” që pasqyron pasojat e ndarjeve historike, luftërave dhe përpjekjeve për ndërtimin e paqes⁶. Megjithatë, një vështrim më i thellë i situatës ballkanike nxjerr në pah mundësinë unike për të shndërruar asimetritë ushtarake, ekonomike dhe kulturore në një burim bashkëpunimi të fuqishëm, të qëndrueshëm dhe progresiv.

Në këtë kontekst, asimetritë e sigurisë në Ballkan nuk duhet të konsiderohen si pengesa të natyrshme apo të papërballueshme, por si mundësi për krijimin e rrjeteve të reja të sigurisë dhe formateve të bashkëpunimit që tejkalojnë kufijtë historikë dhe sfidojnë paradigmat tradicionale të sigurisë. Ballkani mund të shndërrohet në një hapësirë ku shtetet që dikur ishin në konflikt mund të ndërtojnë ura të reja besimi dhe të angazhohen në forma të bashkëpunimit të përbashkët, që kalojnë përtej kufijve politikë dhe të sigurisë.

Në një nivel bazik, asimetritë e Ballkanit mund të ndahen në dy kategori kryesore: asimetritë ushtarake dhe ato ekonomike/kulturore. Disa shtete të rajonit janë tashmë pjesë e strukturave ndërkombëtare si NATO dhe BE, duke

⁵ Fisher, *Security and Democracy*, (Routledge, 2023), 87.

⁶ Aydın, M. (2020). *Security and Cooperation in the Balkans: A Historical Perspective*. *Balkan Journal of International Relations*, 15(2), 145-162.

forcuar sigurinë e tyre dhe duke marrë mbështetje për zhvillimin e brendshëm. Ndërkohë, shtete të tjera ende janë në procesin e integritimit dhe përballen me pasiguri në fushën e sigurisë. Kjo ndarje që shpesh shkakton një perceptim të pabarazisë mes shteteve të rajonit, por krijon edhe mundësinë për zhvillimin e një modeli bashkëpunimi të bazuar në teknologji dhe informacione.

Potenciali i teknologjisë mund të shërbejë si një mjet i fuqishëm për të kapërcyer hendekun midis kapaciteteve ushtarake tradicionale⁷. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, platformat digjitale dhe përdorimi i inteligjencës artificiale mund të krijojnë mundësi të reja për bashkëpunim dhe tejkalim të pabarazisë së fuqisë ushtarake. Për shembull, shtetet më të vogla ose ato me burime të kufizuara mund të kontribuojnë njësoj në sigurinë rajonale, përmes shkëmbimit të informacionit, mbështetjes teknike dhe shpërndarjes së njohurive, zhvillimit të politikave të përbashkëta të sigurisë për menaxhimin e kërcënimeve të përbashkëta, siç janë terrorizmi, krimi i organizuar dhe sulmet kibernetike.⁸

Asimetritë ekonomike dhe kulturore, në vend që të shihen si barrierë, mund të shfrytëzohen për të zhvilluar modele të reja bashkëpunimi që tejkalojnë kufijtë e një “shoqërie homogjene”⁹. Shtetet më të avancuara mund të ofrojnë mbështetje teknologjike dhe financiare për ato që janë ende në faza të hershme të zhvillimit, ndërkohë që këto shtete të fundit mund të kontribuojnë me perspektiva të freskëta dhe inovative në përdorimin e teknologjisë dhe krijimin e formateve të reja bashkëpunimi.

Ky proces i transformimit të asimetrisë në mundësi është një nga sfidat më të rëndësishme për rajonin, por gjithashtu një mundësi për të krijuar një model të ri të sigurisë që mund të shërbejë si shembull për rajone të tjera të botës. Ballkani mund të shndërrohet në një “eksperiment të suksesshëm”, ku rrjetet e sigurisë janë të barabarta, të qëndrueshme dhe të integruara, duke përdorur mundësitë e teknologjisë për të përballuar sfidat e përbashkëta dhe për të garantuar paqen dhe stabilitetin rajonal.¹⁰

⁷ Dimitrova, S., & Petkov, S. (2021). *Regional Security and Integration: The Impact of NATO and EU Membership on the Balkans*. Journal of Southeastern European Politics, 22(3), 221-236.

⁸ European Commission. (2022). Western Balkans and the Future of Regional Cooperation. Retrieved from <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/western-balkans>

⁹ Kovačević, M., & Jovanović, B. (2023). *Technological Advancements and Regional Security: How AI and Digital Platforms Are Transforming the Balkans*. International Security Studies, 37(4), 301-318.

¹⁰ United Nations Development Programme (UNDP). (2024). *Opportunities for Regional Cooperation in the Balkans: A Focus on Economic and Cultural Asymmetries*. UNDP Report. Retrieved from <https://www.undp.org/balkans>

Një aspekt tjetër kyç për këtë transformim është angazhimi i aktorëve të jashtëm, si Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë.¹¹ Ata luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e platformave të përbashkëta për sigurinë rajonale dhe mbështetje të vazhdueshme për ndihmën në forcimin e kapaciteteve të brendshme të vendeve të Ballkanit. Ky bashkëpunim krijon një mjedis më të fortë dhe të qëndrueshëm, ku çdo shtet mund të kontribuojë me atë që ka më shumë.

Për të munduruar që asimetritë të shndërrohen në mundësi, është e nevojshme që të hartohen strategji që mbështesin bashkëpunimin dhe angazhimin e të gjithëve. Këto strategji duhet të përfshijnë investime në edukimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e kapaciteteve teknologjike dhe krijimin e mundësive për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive. Vetëm në këtë mënyrë, Ballkani mund të shndërrohet në një rajon më të sigurt dhe më të qëndrueshëm, ku sfidat e sigurisë dhe mundësitë e bashkëpunimit janë të ndërthurura, duke krijuar një hapësirë të re për zhvillim dhe paqe të përbashkët.

Ballkani, laborator i sigurisë bashkëpunuese dhe përballimi i pandemisë teknologjike

Ballkani është në një periudhë reflektimi dhe përpjekjeje për të konsoliduar paqen dhe stabilitetin. Mundësia për të transformuar Ballkanin nga një rajon i copëzuar dhe i ndarë në një model të bashkëpunimit rajonal të sigurisë është premtuese, edhe pse e ndërlikuar. Ky proces mund të krijojë një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme për rajonin dhe mund të shërbejë si një shembull për rajone të tjera, duke promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën reciproke mes shteteve dhe qytetarëve të Ballkanit.¹²

Për të kuptuar më mirë mundësinë që ofron ky transformim, është e nevojshme të shqyrtojmë mënyrën sesi koncepti i sigurisë po evoluon, duke kaluar nga një fokus i ngushtë ushtarak dhe territorial në një qasje më gjithëpërfshirëse, që përfshin të gjitha nivelet e shoqërisë. Pasojat e luftërave të kaluara dhe ndarjet politike kanë penguar shpesh mundësinë për bashkëpunim, por këto barrierë mund të kapërcehen përmes një rikonceptualizimi të sigurisë si një projekt që përfshin shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe forcat ushtarake.¹³

¹¹ Kagan, Robert. *The Jungle Grows Back: America and Our Imperiled World* (New York: Alfred A. Knopf, 2018).

¹² Mearsheimer, John J. *The Great Delusion: Liberal Dreams and International Realities*. Yale University Press, 2021.

¹³ Fukuyama, Francis. *Identity: The Demand for Dignity and the Politics of Resentment*. Farrar, Straus and Giroux, 2020.

Një hap i parë në këtë drejtim mund të jetë zhvillimi i bashkëpunimit në nivelin lokal, ku qytetarët përballen drejtpërdrejt me pasojat e sigurisë dhe paqes. Për shembull, mund të krijohen mekanizma të përbashkët për menaxhimin e krizave, si dhe për të përmirësuar qasjen ndaj çështjeve të sigurisë publike.¹⁴

Aktivizimi i qytetarëve dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e sigurisë është esenciale për zhvillimin e politikave më gjithëpërfshirëse, të orientuara nga nevojat e qytetarëve. Opozita politike, organizatat joqeveritare (OJQ), sindikatat dhe mediat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e hapësirës për debate të hapura mbi politikat e sigurisë, duke rritur transparencën dhe duke ofruar mundësi për monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të tyre¹⁵.

Ky angazhim mund të ndihmojë në trajtimin e çështjeve të sigurisë, si lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe kërcënimeve të reja, siç janë përdorimi i teknologjive të reja, duke mundësuar një bashkëpunim më efikas dhe më të afërt mes shteteve. Koncepti i “rrjeteve të sigurisë” ka fituar një rëndësi të madhe, duke ofruar një mundësi të re për forcimin e stabilitetit rajonal dhe për krijimin e një strukture sigurie që është e qëndrueshme dhe e aftë për t’u përballur me sfidat e shekullit 21. Ky rrjetëzim mund të krijojë një mjedis më të sigurt dhe të qëndrueshëm për të gjithë rajonin dhe për të gjithë ata që jetojnë aty.¹⁶

Kjo qasje përfshin integrimin e aktorëve të ndryshëm, përfshirë shtetet, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat, në një sistem të sigurisë që tejkalon kufijtë tradicionalë të sigurisë shtetërore.¹⁷ Me këtë qasje, Ballkani mund të përdorë mundësitë që ofron bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal për të ndërtuar një rrjet të sigurisë që jo vetëm përballlet me kërcënimet aktuale, por gjithashtu është i gatshëm të parandalojë ato të ardhshme.

Rrjetet e sigurisë janë një përgjigje ndaj kompleksitetit të kërcënimeve moderne moderne, të cilat janë gjithnjë e më të ndërthurura dhe të sofistikuara. Krizat si ato të pasigurisë, terrorizmit, krimit të organizuar dhe kërcënimeve kibernetike kërkojnë një bashkëpunim të thelluar dhe koordinim ndërmjet shteteve dhe aktorëve të ndryshëm¹⁸.

¹⁴ Kupchan, Charles A. *Isolationism: A History of America's Efforts to Shield Itself from the World*. Oxford University Press, 2021.

¹⁵ Kagan, Robert. *The Jungle Grows Back: America and Our Imperiled World*. Vintage Books, 2020.

¹⁶ Lind, Michael. *The New Class War: Saving Democracy from the Managerial Elite*. Perseus Books, 2020.

¹⁷ Fukuyama, Francis. *The End of History and the Last Man*. Free Press, 2020.

¹⁸ Mearsheimer, John J. *The Great Delusion: Liberal Dreams and International Realities*, Yale University Press, 2021.

Krijimi i një rrjeti të përbashkët të sigurisë kibernetike mund të mundësojë një përgjigje më të shpejtë ndaj kërcënimeve që vijnë nga hapësira digjitale, duke përfshirë kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike dhe të dhënave sensitive.

Përveç krizave tradicionale, Ballkani është i përballur me një tjetër lloj “pandemie” atë të teknologjisë. Kjo ka krijuar mundësi të reja për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal, por gjithashtu ka sjellë kërcënime të reja, sidomos në fushën e sigurisë kibernetike. Në këtë kontekst, është thelbësore që siguria të evoluojë dhe të përfshijë kërcënimet e teknologjisë si një element kryesor të saj. Ndërkohë që siguria fizike ka qenë tradicionalisht një prioritet kryesor, tani siguria kibernetike është bërë një nga sfidat më të rëndësishme. Pandemia teknologjike ka nxjerrë në pah dobësitë e sistemeve tradicionale të sigurisë dhe ka krijuar mundësi për një transformim të madh, që do të kërkojë një bashkëpunim më të ngushtë dhe më të qëndrueshëm.¹⁹ Për Ballkanin, kjo paraqet një mundësi të rëndësishme për të rishikuar qasjen ndaj sigurisë dhe për të zhvilluar një rrjet të sigurisë që mund të përballojë kërcënimet e reja.

“Pandemia teknologjike”²⁰ që po ndodh në Ballkan paraqet një mundësi për të transformuar mënyrën se si konceptohet siguria dhe mund të ofrojë një mundësi për krijimin e një modeli të ri të bashkëpunimit rajonal, që është më i shpejtë, më efikas dhe më i përballueshëm. Ballkani ka mundësinë të mësojë nga përvojat ndërkombëtare dhe të përdorë mësimet e nxjerra nga rajone të tjera për të zhvilluar një rrjet sigurie që është fleksibël dhe i gatshëm të përballojë sfidat e sigurisë në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar. Ky model sigurie mund të shërbejë si një shembull për rajonet e tjera të botës, duke ofruar mundësi të reja për përmirësimin e bashkëpunimit dhe menaxhimin e kërcënimeve ndërkombëtare.

Përfundime

Rajoni i Ballkanit, i cili ka kaluar përmes periudhave të dhimbshme dhe traumave të thella historike, ka mundësinë të transformohet nga një hapësirë e pasigurisë dhe konflikteve në një laborator të avancuar të bashkëpunimit rajonal dhe sigurie. Kjo mundësi e re, e mbështetur në parimet e inovacionit dhe fleksibilitetit, ofron një mundësi të pazakontë për zhvillimin e modeleve të reja të sigurisë, që mund të shërbejnë si udhëzues për rajone të tjera të botës. Ballkani, përmes adaptimit të strategjive të reja dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, mund të bëhet një shembull për transformimin e mundësive të ndryshme të sigurisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

¹⁹ Zalman, Amy B. *The Global Security Challenge: The Intersection of Cyber Threats and National Security*, Stanford University Press, 2022.

²⁰ Harari, Yuval Noah. *21 Lessons for the 21st Century*, Spiegel & Grau, 2021.

Zhvillimi i një infrastrukture të sigurisë që përfshin teknologjinë moderne, ndarjen e informacionit dhe angazhimin aktiv të shoqërisë civile është një hap kyç për realizimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të sigurt. Sfidat tilla si terrorizmi, krimi i organizuar dhe kërcënimet kibernetike kërkojnë një bashkëpunim ndërkombëtar të ngushtë dhe të koordinuar, ku Ballkani mund të shërbejë si një model për mbledhjen e aktorëve të ndryshëm, përfshirë shtetet, grupet etnike dhe organizatat ndërkombëtare, për të adresuar këto kërcënime të përbashkëta.

Megjithatë, një nga pengesat më të mëdha që Ballkani ka hasur është mungesa e besimit ndërmjet shteteve të tij, një barrierë që ka minuar mundësinë e krijimit të një strategjie të unifikuar dhe të qëndrueshme sigurie. Sidoqoftë, mundësitë për të kapërcyer këtë mungesë besimi janë të pranishme përmes përpjekjeve të thelluara për integrim evropian, mbështetje nga organizatat ndërkombëtare dhe përfshirjes aktive të shoqërisë civile. Ky proces mund të kontribuoni në tejkalimin e asimetrive të sigurisë dhe në shndërrimin e këtyre sfidave në mundësi të zhvillimit të një bashkëpunimi të ngushtë dhe të qëndrueshëm.

Në përfundim, Ballkani, përmes potencialeve të tij të brendshme dhe angazhimit të aktorëve të jashtëm, mund të shndërrohet në një shembull të suksesshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të sigurisë kolektive. Me një strategji të koordinuar dhe të fokusuar në përdorimin e teknologjisë moderne dhe infrastrukturës së avancuar të sigurisë, ky rajon ka mundësinë të zhvillojë një model që mund të udhëzojë rajone të tjera të botës për të adresuar sfidat e sigurisë në një botë gjithnjë e më të globalizuar dhe të lidhur. I gjithë ky proces kërkon një angazhim të përbashkët dhe një vizion të përbashkët për të ndërtuar një të ardhme të sigurt dhe të qëndrueshme për të gjithë aktorët në rajon.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Fukuyama, Francis. *The End of History and the Last Man*. Free Press, 2020.
2. Lind, Michael. *The New Class War: Saving Democracy from the Managerial Elite*. Perseus Books, 2020.
3. Samuel P. Huntington, *The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order* (Free Press, 2020).
4. Ferguson, N. (2020). *The Square and the Tower: Networks and Power, from the Freemasons to Facebook*. Penguin Press.

5. Balfour, The European Union and the Balkans (Oxford University Press, 2020).
6. Fisher, Security and Democracy (Routledge, 2023).
7. Aydın, M. (2020). Security and Cooperation in the Balkans: A Historical Perspective. *Balkan Journal of International Relations*.
8. Dimitrova, S., & Petkov, S. (2021). Regional Security and Integration: The Impact of NATO and EU Membership on the Balkans. *Journal of Southeastern European Politics*.
9. European Commission. (2022). Western Balkans and the Future of Regional Cooperation. Retrieved from <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/western-balkans>
10. Kovačević, M., & Jovanović, B. (2023). Technological Advancements and Regional Security: How AI and Digital Platforms Are Transforming the Balkans. *International Security Studies*.
11. United Nations Development Programme (UNDP). (2024). Opportunities for Regional Cooperation in the Balkans: A Focus on Economic and Cultural Asymmetries. UNDP Report. Retrieved from <https://www.undp.org/balkans>
12. Kagan, Robert. *The Jungle Grows Back: America and Our Imperiled World* (New York: Alfred A. Knopf, 2018).
13. Mearsheimer, John J. *The Great Delusion: Liberal Dreams and International Realities*. Yale University Press, 2021.
14. Fukuyama, Francis. *Identity: The Demand for Dignity and the Politics of Resentment*. Farrar, Straus and Giroux, 2020.
15. Kupchan, Charles A. *Isolationism: A History of America's Efforts to Shield Itself from the World*. Oxford University Press, 2021

RUBRIKA E DYTË

ARSIMIMI DHE STËRVITJA NË FORCAT E ARMATOSURA

ZHVILLIMI I ARSIMIT TË LARTË USHTARAK: ROLI I TIJ NË FORMIMIN PROFESIONAL TË OFICERIT NË FARSH

Dr. Enrik AGO

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar

Evoluimi i mjedisit të sigurisë dikton zhvillimin, reformimin, modernizimin e forcës, rritjen e nivelit operacional, aftësive ndërvepruese, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit në operacionet luftarake dhe joluftarake brenda dhe jashtë vendit, si dhe rrjedhimisht një elitë ushtarake profesionale dhe të mirë trajnuar. Programet e reja arsimore në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) kanë krijuar mundësinë e formimit të drejtuesve dhe menaxhuesve të rinj më profesionistë, duke integruar kërkesat për një lider, komandant, menaxher apo profesionist të mirëfilltë ushtarak.

AFA, si Institucion i Arsimit të Lartë, në përgatitjen e programeve dhe kurrikulave, integron nevojat midis programeve universitare dhe fushave operationale të luftimit dhe atyre mbështetëse të luftimit, me qëllim përgatitjen e një trupe oficerësh sa më të përgatitur, ekuivalentë me ato të Aleancës. Nëpërmjet procesit arsimor, studentët arrijnë të kuptojnë dhe përvetësojnë programin përkatës, duke u formuar profesionalisht dhe krijojnë një bazë teorike për të qenë pjesë e grupeve dhe shtabeve në detyra stërvitore dhe operationale.

Formimi i profesionit të ushtarakut si lider kushtëzohet nga cilësia e arsimit të lartë, trajnimit dhe stërvitjes në përgatitjen e personelit ushtarak, për gjithë spektrin e misioneve që zhvillojnë FARSH dhe modeli i aplikuar për përgatitjen profesionale të ushtarakëve shqiptarë, përfshin arsimimin universitar e

institucional, në përshtatje me nevojat e funksionit organik, strukturës ku shërben dhe ecurisë në karrierë.

Natyra e re e konflikteve dhe kërcënimeve kërkojnë angazhim të vazhdueshëm të FARSH ndaj operacioneve për përballimin e rreziqeve të ndryshme, reflektim në zhvillimin e vazhdueshëm të programeve arsimore ushtarake dhe gjithë procesit edukativ profesional të ushtarakëve gjatë karrierës së tyre. Në lidhje me këtë, profesioni i ushtarakut përfshin gjithë spektrin e detyrave funksionale që kryhen nga ushtari deri te drejtuesi, menaxheri dhe komandanti, ku oficerët janë pjesa më e arsimuar dhe përbëjnë lidërshtypin e FA-ve.

Fjalët kyçe: arsimimi ushtarak, metodologji, program mësimor, doktrina ushtarake, oficer profesionist, trajnim ekstrakurrikular, program dhe kurrikula arsimore, kërkimi shkencor.

Hyrje

Sistemi i arsimimit ushtarak për oficerët, si pjesë integrale e Arsimit të Lartë, së bashku me trajnimin individual të personelit të FA, mundëson përgatitjen e kandidatëve për oficerë të rinj dhe personelin ushtarak sipas specialiteteve të ndryshme. Kjo përgatitje mbështet misionin e strukturave operacionale dhe mbështetëse, si dhe nevojat për pjesëmarrjen në operacionet e Aleancës. Ky proces realizohet përmes programeve të integruara të arsimimit dhe trajnimit ushtarak, të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe ofrojnë efikasitet optimal në kosto dhe kohëzgjatje.

Arsimimi dhe stërvitja ushtarake synojnë formimin e ushtarakëve të motivuar, të disiplinuar dhe të aftë për të vepruar si individë dhe si pjesë e njësisë ushtarake. Përveç aftësisë fizike dhe mendore, pjesëtarët e strukturave të FARSH pajisen me kompetencat dhe cilësitë që i karakterizojnë ata në ushtrimin e detyrave. Programet mësimore ushtarake ofrojnë njohuri shkencore, edukim dhe stërvitje për kandidatët për oficerë, duke u bazuar në doktrinën ushtarake, etikën dhe moralin. Këto programe synojnë rritjen e aftësive drejtuese dhe menaxhuese të efektivitetit, si dhe përgatitjen për përdorimin dhe administrimin e armatimit dhe teknikës luftarake, në nivel individual dhe kolektiv.

Profesioni i ushtarakut ka evoluar për shkak të ndryshimit të konceptit mbi operacionet dhe marrëdhëniet mes forcave ushtarake, shtetit dhe shoqërisë. Ky zhvillim ka sjellë një përmirësim të vazhdueshëm të rolit të ushtarakut, duke i shtuar vlerat civile dhe duke transformuar liderin tradicional në një menaxher ushtarak, për të rritur efektivitetin dhe ecurinë e tij. Institucionet arsimore ushtarake, si AFA dhe KMS, po zhvillojnë më tej kapacitetet e tyre duke shërbyer si qendra kryesore për promovimin, zhvillimin dhe konsolidimin e vlerave civile dhe ushtarake. Këto institucione ndihmojnë në

formimin e një elite oficerësh profesionistë me dije të plota ushtarake, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të FARSH përmes programeve arsimore dhe kërkimeve shkencore.

Cilësia e mësimdhënies - faktor për përgatitjen e oficerëve të rinj

“Arsimimi duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që t’i paraprijë transformimit të Forcave të Armatosura, duke përditësuar metodologjinë, programet mësimore e doktrinat ushtarake, hartuar dhe rishikuar procedurat standarde, për të normëzuar e unifikuar proceset dhe për të siguruar ndërveprueshmërinë me aleatët, me qëllim që t’u përgjigjet nevojave kombëtare, realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë dhe të jetë i përputhshëm me sistemin e arsimit kombëtar dhe shkollave të vendeve të NATO-s”¹.

Procesi mësimor mbështetet në tre elementë thelbësorë: studentët, personeli pedagogjik dhe programi mësimor, ku studentët përvetësojnë programin në mënyrë intelektuale dhe profesionale në bazë të objektivave mësimore, ndërthurin njohuritë e përvetësuar nga pedagogët, nga burimet e studimit dhe të kërkimit si dhe nga kolegët e tyre. Një program i plotë dhe efektiv i arsimit ushtarak përgatit drejtuesit e ardhshëm për përgjegjësitë e detyrave të nesërme gjatë karrierës ushtarake dhe kushtëzon aftësimin, që studentët të arrijnë rezultate të qenësishme në hierarkinë e detyrave komanduese.

Synimi i këtij procesi është shndërrimi në ushtarakë profesionistë të përgatitur dhe në drejtues të aftë si oficerë për të komanduar dhe menaxhuar operacione ushtarake, për të drejtuar ekipe dhe organizata në zbatimin e detyrave me përpikëri. Ecuria profesionale realizohet nëpërmjet sintezës së vazhdueshme të njohurive, aftësive dhe eksperiencës së fituar nëpërmjet trajnimit institucional dhe realizimit të programeve të studimit, trajnimit ekstrakurrikular, detyrave, eksperiencës operationale dhe vetëzhvillimit vetjak.

Në raport me natyrën e re të kërcënimeve, FARSH i nevojiten drejtues të zotë dhe profesionistë të aftë për të drejtuar dhe bashkëvepruar në operacione në zona dhe mjedise të ndryshme konfliktesh kombëtare, ndërkombëtare në bashkëveprim dhe me organizatat qeveritare, si dhe ato jofitimprurëse. Këtyre drejtuesve ushtarakë u kërkohet karakter dhe moral i lartë, të integruar me strukturat operationale ku veprojnë, vendimmarrës dhe zbatues urdhrash e detyrash. Procesi i arsimit të lartë që zhvillohet në AFA me tre ciklet e studimit dhe më pas me kurset e karrierës që zhvillohen në KMS, synon që studentët dhe oficerët e karrierës të përfitojnë njohuri të qëndrueshme për të

¹ Koncepti i arsimit dhe trajnimit individual të personelit të FARSH, www.aaf.mil.al, 2025

kryer detyra sipas niveleve hierarkike dhe edukohen me vlerat, karakterin, aftësitë, si dhe procesin e vendimmarrjes ushtarake për drejtimin e formacioneve ushtarake në misione/ detyra në kohë paqe, stërvitore dhe operacione luftarake.

“Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.”²

Objektivi i AFA është konsolidimi i një institucioni arsimor ushtarak universitar, që përveç arsimimit dhe trajnimit, të përgatisë drejtues oficerë të ardhshëm me karakter, moral të lartë dhe të përkushtuar ndaj vlerave që burojnë nga detyra, nderi, atdheu për një karrierë profesionale në shërbim të kombit si oficer i FARSH-së. Konkretisht në AFA zhvillohen disa programe studimi, si bachelor në shkencat ushtarake, teknologji informacioni dhe navigim detar, shkenca komunikimi, teknologji informacioni dhe komunikimi në fushën e mbrojtjes, marrëdhënie ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe të cikleve të tjera të studimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe eksperiencia institucionale akademike, janë bazë për ecurinë e mëtejshme të saj në përballimin e sfidave të reja të kohës, teknologjisë dhe modernizimit.

Sigurimi i cilësisë së arsimit të një Institucioni të Arsimit të Lartë shërben për fuqizimin e institucionit, duke përcaktuar pritshmëritë, synimet mbi arritjen e standardeve të arsimit dhe ka për qëllim të garantojë që procedurat sigurojnë zbatimin e cilësisë. Ky proces fillon me vendosjen e objektivave, ndaj të cilave duhet të bëhet një krahasim i performancës në mënyrë të vazhdueshme, i cili realizohet nëpërmjet procedurave të vetëvlerësimit ose vlerësimit të jashtëm.

Një element i rëndësishëm është dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, që sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit, i cili vlerëson performancën e stafit akademik, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektësia, vlerësimet e dijeve të studentit, etj.

Gjithashtu, rol për sigurimin e brendshëm të cilësisë përbën trajnimi i stafit akademik mbi metodikën e mësimdhënies, njohjen e gjitha dokumenteve të brendshme të IAL-së, përvoja e fituar ndër vite, transparencë në gjithë proceset akademike, si dhe takimet e drejtuesve të njërive kryesore dhe atyre bazë me studentët/ kursantët, ku tërhiqet mendimi i tyre mbi çdo program studimor në tërësi, lëndë të veçantë dhe çdo pedagog.

² Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të Republikës së Shqipërisë”, neni 103.

Vlerat dhe specifikat e arsimimit ushtarak dhe trajnimit individual të oficerit

“Edukoni, trajnioni dhe frymëzoni korpusin e kadetëve në mënyrë që çdo i diplomuar të jetë një lider i përgatitur me karakter, i përkushtuar ndaj vlerave të detyrës, nderit dhe vendit, si dhe i përgatitur për një karrierë të përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj kombit si oficer në ushtrinë e SHBA”³.

Roli i oficerit si drejtues apo menaxher në strukturat e FA-ve është që të demonstrojë karakterin, liderin, pjesëtarin e këtij profesioni dhe një shërbëtor të shtetit, ku karakteristikat e tij përfshijnë: detyra, nderi, besnikëria, shërbimi ndaj shtetit, kompetencë, punë në grup, bashkëpunim me pushtetin civil dhe një udhëheqës i suksesshëm, pra në këtë këndvështrim profesioni i oficerit ka një vend parësor në zhvillimin profesional të FA.

“Kultura profesionale ushtarake konsiderohet mënyra se si personeli mendon, ndjen dhe reagon në situata të ndryshme. Kultura profesionale ushtarake përbëhet nga kultura e lidershit, kultura luftarake, morali dhe kohezioni moral, si dhe mbështetet në kulturën kombëtare dhe vlerat e demokracisë”⁴.

Profesionit të ushtarakut si specifik i kërkohej aftësi të bazuara në përgjegjësi ndaj detyrës dhe arsimimit të aftësimin e tij, për kryerjen me cilësi të detyrës/misionit. Kështu, procesi i edukimit profesional përcaktohet nga nevojat për të arritur në mënyrë të njëtrajtshme të gjithë kategorive të ushtarakëve, sipas gradave dhe funksioneve organike. Kjo arrihet nëpërmjet një programi cilësor të natyrës ushtarake, duke përgatitur drejtues të aftë në hierarkinë e komandimit.

Të rëndësishme është vizioni dhe objektivat e arsimimit profesional ushtarak, duke shtuar në vijimësi detyrimet që lidhen me objektivin përfundimtar dhe mbi bazën e ekzistencës të përmirësohen programet dhe kurrikulat përkatëse. Duke mos pasur një objektiv të qartë nuk mund të përcaktohen nevojat dhe të arrihet synimi për të pasur një trupë oficerësh të formuar më së miri për komandimin dhe menaxhimin ushtarak në pozicionet funksionale.

Pavarësisht konceptit të arsimimit dhe trajnimit individual të personelit të FARSH, procesi arsimor ushtarak që zhvillohet në AFA dhe KMS ka vazhdimësi programore, bazuar në misionin/ detyrat operacionale që zhvillojnë strukturat e FARSH, sipas përcaktimit në DP-01 dhe doktrinat e Forcave, ndaj zbatimi i një kurrikule të përbashkët është e nevojshme. Kjo jo vetëm siguron përgatitjen e personelit ushtarak dhe civil të sigurisë kombëtare, por edhe lejon koordinimin midis niveleve taktike, operative dhe strategjike të operacioneve kombëtare dhe

³ Character Development Strategy, West Point, USA, 2014, fq.6

⁴ Doktrina e Përbashkët e FARSH, ed. 3, 2024, fq. 31

ndërkombëtare. Një kurrikulë e përbashkët do të siguronte një përvojë të ndërsjellë të edukimit ushtarak me një terminologji të tre niveleve të zhvillimit të operacioneve, që do të lehtësonte integrimin në operacionet e përbashkëta dhe ndëragjenci, si dhe do të zhvillonte më tej procesin e vendimmarrjes.

“Ushtarakët e dinë se mbijetesa e kombit varet nga masa se sa qytetarët me talent e karakter e bëjnë ushtrinë profesion të vetin, si dhe nga masa se sa aftësi dhe përvojë kanë FA në kohë”

Zhvillimi profesional i ushtarakut

Zhvillimi profesional është një proces gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm, i cili ndikon drejtpërdrejt në formimin e drejtuesve kompetentë dhe në përgatitjen e personelit për të përmbushur me sukses misionet e tyre në situata paqësore dhe operacionale. Ky zhvillim mbështetet në katër fusha kryesore: arsimimin dhe stërvitjen institucionale, përvojën praktike të fituar gjatë detyrave operacionale dhe të shtabit, vetëzhvillimin individual dhe këshillimin profesional. Integrimi i këtyre elementeve realizohet përmes përdorimit të informacionit të marrë dhe vlerësimeve të bazuara në burime dhe metoda të ndryshme, duke krijuar një bazë të fortë për formimin e liderëve të aftë.

Një aspekt kyç i këtij procesi është sigurimi i një zhvillimi uniform dhe progresiv për të gjithë personelin ushtarak, duke u garantuar atyre mundësinë për t'u trajnuar, edukuar dhe përgatitur në mënyrë të qëndrueshme. Stërvitja kolektive luan një rol vendimtar në ndërtimin e njësive kompakte, të gatshme dhe të mirëstërvitura, të cilat drejtohen nga individë me kompetencë, besim dhe karakter të fortë. Këto drejtues jo vetëm që udhëheqin me qartësi dhe vendosmëri, por gjithashtu frymëzojnë vartësit e tyre duke u ofruar një vizion të qartë dhe motivim për arritjen e objektivave të përbashkëta.

Ndërkohë, arsimimi dhe kualifikimet e marra në institucionet ushtarake shërbejnë si themeli i profesionalizmit. Megjithatë, për të garantuar një nivel të lartë të performancës profesionale, është e nevojshme që individit të angazhohet në një proces të vazhdueshëm vetëzhvillimi. Ky proces realizohet përmes stërvitjes së përditshme, përvojës praktike, si dhe përditësimit të njohurive me zhvillimet më të fundit në fushën ushtarake. Në thelb, arsimimi i jep individit profesionin, ndërsa përmes punës së përditshme dhe angazhimit për vetëzhvillim, ai fiton profesionalizmin. Kjo tregon se profesionalizmi nuk është vetëm rezultat i edukimit formal, por edhe i vullnetit, punës dhe stërvitjes së vazhdueshme.

Në skenarin e një stërvitjeje të simuluar për një operacion ushtarak, objektivi kryesor mbetet arritja e fuqisë luftarake të dëshiruar. Përveç aspektit teknik dhe pajisjeve moderne, një faktor vendimtar është motivimi dhe morali i

forcave pjesëmarrëse. Pavarësisht avancimeve në teknologji dhe armatime, një ushtri nuk mund të jetë e suksesshme nëse lidhja me arsimimin, vullnetin individual për vetëzhvillim dhe motivimin. Ndërsa programet e arsimit dhe kualifikimit janë të njëjta për një grup të caktuar ushtarakësh, japin të njëjtat dije dhe shprehje për të gjithë, ai që bën diferencën në profesionalizmin e tyre mbetet të jetë dimensionin i vullnetit për vetëzhvillim (vullneti individual për t'u stërvitur më shumë, për të shfrytëzuar përvojën individuale dhe përvojën e të tjerëve më mirë, për studim, për mësimin e gjuhëve të huaja, për të shfrytëzuar internetin, për aktualizimin e zhvillimeve bashkëkohore e zbatimin e tyre në profesionin etj.). Si në çdo profesion tjetër, edhe ushtarakët dallohen nga njëri-tjetri, pikërisht nga dimensionin vetëzhvillues, nga vullneti për ta ushtruar atë. Performanca e profesionalizmit të ushtarakut rritet proporcionalisht me vullnetin e tij për vetëzhvillim, pra sa më i lartë është vullneti për vetëzhvillim, aq më i madh është profesionalizmi.

Formimi profesional në grupe të ndryshme ushtarakësh

Niveli i profesionalizmit për çdo ushtarak, por edhe brenda një grupi ushtarakësh është i ndryshëm në lidhje me arsimimin, vullnetin individual për vetëzhvillim dhe motivimin. Ndërsa programet e arsimit dhe kualifikimit janë të njëjta për një grup të caktuar ushtarakësh, japin të njëjtat dije dhe shprehje për të gjithë, ai që bën diferencën në profesionalizmin e tyre mbetet të jetë dimensionin i vullnetit për vetëzhvillim (vullneti individual për t'u stërvitur më shumë, për të shfrytëzuar përvojën individuale dhe përvojën e të tjerëve më mirë, për studim, për mësimin e gjuhëve të huaja, për të shfrytëzuar internetin, për aktualizimin e zhvillimeve bashkëkohore e zbatimin e tyre në profesionin etj.). Si në çdo profesion tjetër, edhe ushtarakët dallohen nga njëri-tjetri, pikërisht nga dimensionin vetëzhvillues, nga vullneti për ta ushtruar atë. Performanca e profesionalizmit të ushtarakut rritet proporcionalisht me vullnetin e tij për vetëzhvillim, pra sa më i lartë është vullneti për vetëzhvillim, aq më i madh është profesionalizmi.

Brenda një grupi ushtarakësh kemi individë me dimension të ndryshëm vullneti për vetëzhvillim, prandaj jo të gjithë këta individë janë të njëjtë për nga vlerat profesionale, siç do të dëshironte komandanti i tyre. Individu që ka vullnet për t'u vetëzhvilluar, ngre profesionalizimin e tij në nivele të reja muaj pas muaji, vit pas viti, madje kërkon standarde të reja në vazhdimësi. Ai kupton se gjithmonë ka diçka për të arritur në raport me profesionalizmin, por nuk ndodh kështu me individin që nuk ka vullnetin e duhur, i cili mbetet pas duke rrezikuar performancën, rënien në diletantizëm dhe gradualisht bëhet pengesë për grupin dhe rrezikon kompaktësinë e tij.

Këtu qëndrojnë vështirësitë dhe njëherësh çelësi i suksesit, të edukosh dhe stërvitësh vullnetin e individit, grupit/ skuadrës, si dhe përvoja tregon se dimensionin i vullnetit të individit rritet kur ai motivohet, nxitet dhe orientohet drejt punës me objektiva dhe standarde.

Këtej dalim në përfundimin se vullneti për vetëzhvillim i çdo individit në grup rritet kur komandanti/ pedagogu është profesionalist i komunikimit me çdonjërin prej tyre, sipas veçorive të karakterit të secilit, është profesionalist në organizimin e stërvitjes, është metodist në mësimdhënie, kupton dobësitë e secilit, punon për shmangien e tyre me kujdes dhe kryen stërvitje shtesë, fut frymën e punës në grup dhe të ndihmës së secilit. Ushtarakët që kanë arritje

të mira profesionale janë ndihmësit më të mirë në arritjet e grupit prandaj, si të tillë duhen shpërblyer nga komandanti, ndërsa pjesëtarët e tjerë të grupit duhen nxitur drejt profesionalizmit.

“Nëasnjëfushëtjetër, çmimi qëpaguhetnga përdorimi i trupave tëpapërgatitur, nuk është kaq i tmerrshëm dhe i pandreqshëm sa në atë ushtarake”⁵.

Profesionalizmi është kërkesë e luftës dhe si i tillë, sfidë për të gjithë pjesëtarët e FA, prandaj rritja profesionale kërkohet të bëhet çdo ditë, javë, vit, si një proces pa ndërprerje. Përvoja në punë dhe përpunimi i përvojës së marrë nga të tjerët, janë dy nga format më të rëndësishme të zhvillimit të ushtarakut, të cilat vijjnë natyrshëm tek çdo individ, kur ka ambicien për t’u vetëzhvilluar.

Pjesëmarrja në trajnime me ushtarakë të vendeve të NATO-s, në interes të misioneve luftarake apo mbështetëse jashtë territorit të RSH, janë me vlera të jashtëzakonshme për ushtarakët tanë. Një përvojë e tillë në vetvete, është më shumë se një shkollë, ku dijet dhe profesionalizmi tregojnë vlerat e vërteta të tyre dhe nxjerrja e mësimave është thelbësore. Profesionalizmi përmes vetëzhvillimit, e mbështetur përmes teknologjisë digjitale rritet, duke shfrytëzuar studimin e ngjarjeve operacionale dhe taktikave të luftës, zhvillimin e publikimeve ushtarake, etj.

Një element i rëndësishëm është fakti, që personeli i FA-ve është njohës i gjuhës angleze dhe përdor terminologjinë operacionale të NATO-s. Në raport me zhvillimet reformuese në FA, janë në proces drejt profesionalizmit të tyre, me synime të qarta dhe ambicioze, për t’u barazuar në vlera me ushtarakët e vendeve të NATO-s. Vlerësime tepër dinjitoze për profesionalizmin e trupave tona në misione vijjnë nga të gjitha vendet ku ato kanë marrë pjesë në operacione përkrah forcave aleate në kuadrin e misioneve ndërkombëtare, si në Afganistan, në Irak, Bosnjë, Çad etj.

Sinergjia e përbashkët e performancës së profesionistëve

Profesionalizimi në shfaqjen e vet, parë nga jashtë është performancë shumë e mirë e individit në vlera profesionale, është nxjerrje në pah faktorizim i tij në krahasim me grupin. Në ndryshim nga disa profesione ku individi i gëzon vetë gjithë frytet e profesionalizmit, ai i ushtarakut i fiton vlerat maksimale kur ndikon në ngritjen e vlerave të grupit/ strukturës ku punon. Nuk ka vlerë për një skuadër kur njëri prej tyre është qitës i shkëlqyer dhe të tjerët janë qitës të dobët, këtui profesionalizmi i individit sfumohet, madje kur skuadra vlerësohetdobët, atij vetë i bie ndjesia e suksesit individual. Pra, profesionalizmi i ushtarakut

⁵ John G. Meyer, “Komandanti i kompanisë”, Tiranë 1995, faqe 58.

merr vlera të plota kur ndikon pozitivisht në grup, udhëheq, forcon frymën e grupit, tërheq grupin drejt realizimit të detyrës dhe forcimit të ndjenjës së përgjegjësisë për detyrën.

Këtej dalin dy përfundime: së pari, profesionalizmi i ushtarakut është i papajtueshëm me ndjenjën e të dukurit, e të shfaqurit si qëllim në vetvete, ai orientohet drejt kontributeve më të gjera në grup/ skuadër, për të bërë më të mirën drejt suksesit si ekip, përndryshe mbetet i izoluar; së dyti, komandantët duhet të mbajnë mirë parasysh dhe lipset të jenë mjeshtër në shfrytëzimin e profesionalizmit të individëve, për të marrë produkt pozitiv e për të rritur performancën e grupit që komandojnë.

Dalja para grupit për të trajtuar një temë personale apo demonstruar një veprim të ri profesional është një përgjegjësi dhe njëherësh motiv i fuqishëm që shtyn individin për të punuar shumë (lexuar, hulumtuar, vepruar) për të performuar atë pjese të “unit profesional” që mbart në vetvete (që po të mos e shfaqte, grupi nuk do ta merrte vesh se ky apo ai individ ka mesazhe me vlerë për të transmetuar). Komandantët duhet të nxisin vartësit e tyre për të zhvilluar punë individuale, të studiojnë, të eksperimentojnë në fushën e tyre të përgjegjësisë, të përgatisin detyra individuale, përmes të cilave të shprehin individualitetin profesional përpara grupit.

Përgatitja e temave individuale, metodikave stërvitore, leksioneve të dryshme, mësimëve treguese, ndërtimi i skemave të ndryshme taktike dhe detyrave stërvitore të përshtatura sipas misionit të repartit, përgatitja e analizave stërvitore dhe mësimëve të nxjerra, përfshirja në grupe studimi për zgjidhjen e një problemi të caktuar në fushën e programeve, stërvitjes, qoftë dhe demonstrimi para grupit i një veprimi teknik apo taktik tepër profesional, janë disa nga format efikase të cilat orientojnë individët drejt angazhimit për studim, kërkim, eksperimentim, stërvitje shitesë, pra drejt profesionalizmit. Përveç sa më sipër ato diskutohen në grup dhe kur kanë vlera për të gjithë, përgjithësohen.

Kjo është një mënyrë për të angazhuar gjithë grupin drejt profesionalizmit, ku komandantët i përdorin këto forma pune, por ndonjëherë ka shenja formalizmi, gjë e cila nuk sjell produktivitet. Ka komandantë të cilët i trajtojnë si ngjarje të rëndësishme këto aktivitete për gjithë repartin, duke përfshirë gjithë vartësit për të dëgjuar një leksion, apo në poligon për të vëzhguar një veprim tregues, duke i marrë produkt konkret këtij aktiviteti intelektual ose praktik. Në këtë rast, nga njëra anë vlerësohet puna individuale e ushtarakut dhe nga ana tjetër vilen frytet e punës së tij, duke i kthyer përfundimet e punës së tij, në përvojë për të tjerët apo në të mirë të fushave të ndryshme të veprimtarisë në repart, kështu drejtuesit që përdorin me efikasitet këto forma pune, rrisin ndjeshëm mundësitë për të krijuar një grup më të aftë profesionalisht.

Përfundime

Gjithë sistemi arsimor i lartë dhe trajnimi institucional i oficerit kërkohet të zhvillohet dhe konsolidohet më tej, bazuar në standardet kombëtare të arsimit dhe standardet e trajnimit të Aleancës, duke u paraprirë transformimit të forcës, rritjes së nivelit operacional të strukturave të FA, evoluimit të publikimeve doktrinare, teknologjisë ushtarake në funksion të realizimit të misionit të FA-ve në gjithë spektrin e operacioneve.

Një arsim i lartë cilësor ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përgatitjen profesionale dhe personale të oficerëve ushtarakë, jo vetëm që siguron bazën për profesionalizëm, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e liderëve me vizion të gjerë dhe kompetencë për të përballuar sfidat e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nxit motivimin për vetëzhvillim të vazhdueshëm, duke u dhënë atyre mundësinë për të ndjekur trajnime dhe kualifikime shtesë gjatë karrierës.

Cilësia e arsimit të lartë luan një rol të rëndësishëm në formimin e profesionalizmit ushtarak, duke ndikuar drejtpërdrejt në aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet e tyre si liderë në fushën e mbrojtjes, shërben në formimin e vlerave dhe etikës profesionale, duke krijuar liderë të përkushtuar ndaj parimeve të drejtësisë, integritetit dhe përgjegjësisë, si dhe ndihmuar në krijimin e një kulture respekti dhe besimi brenda forcave ushtarake dhe shoqërisë civile.

Përzgjedhja dhe promovimi i stafit akademik kanë qenë dhe ngelen sfida me rëndësi jetike për mësimdhënien, për kompetencën dhe kapacitetet e personelit mësimdhënës e kërkimor të departamenteve, për rrjedhojë të institucionit të AFA-së, ndaj reformat në strukturën arsimore ushtarake, hartimin e koncepteve, praktikave, projekteve, politikave, strategjive etj., duhet të fokusohen në rritjen e profesionalizmit akademik.

Profesionalizmi i ushtarakëve, si kërkesë e integritetit plotë në NATO, mbetet një objektiv ambicioz për t'u arritur nga çdo individ dhe strukturë ushtarake e FA, që arrihet përmes një procesi, ku çdo ushtarak zhvillon profesionalizmin e vet, çdo komandant planëzon, organizon, realizon masat dhe mban përgjegjësi për rritjen e profesionalizmit të të gjithë formacionit ushtarak që komandon.

Vizioni i komandantëve për zhvillimin me efikasitet dhe në mënyrë krijuese të kualifikimit dhe stërvitjes, zhvillimit me produktivitet të detyrave individuale dhe i formave të tjera trajnuese, janë rruga e zhvillimit të sigurt të profesionalizmit të drejtuesve të rinj dhe njëherësh mundësi për rritjen e kapaciteteve operacionale të strukturave që drejtojnë.

Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për oficerë të rinj dhe kandidatëve për kurset e karrierës të oficerit, është një përgjegjësi për zhvillimin e FA

dhe profesionalizmin e saj, prandaj kriteret e vlerësimit kërkohet të jenë në standardet më të larta profesionale, për t'i mundësuar karrierën personelit që mbartin vlera intelektuale dhe profesionale të spikatura.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Army Doctrine Reference Publication, 2013. The Army Profession, HQ, Department of the Army ashington DC, <http://data.cape.army.mil>.
2. NATO Generic Officer Professional, Military Education (Reference Curriculum), 2017.
3. Doktrina e Përbashkët e FARSH (DP-01), ed. 3, 2024.
4. Koncepti i arsimimit dhe trajnimit individual të personelit të FARSH, www.aaf.mil.al, 2025.
5. Urdhër i MM nr. 765, datë 08.06.2021 “Politika e arsimimit dhe kualifikimit të ushtarakëve të FARSH për përparimin në gradë”.
6. “Udhëheqja ushtarake” (Studime nga ushtarakë të lartë amerikanë), Biblioteka e AFA, 2005.
7. Huntington, Samuel, 1957, *The Soldier and the State* Cambridge, MA: Harvard University Press.
8. Macovei, Crenguta Mihaela, 2014, “*Factors that influence the commitment of military students to profession*”, Romanian Land Forces Academy, <http://www.uav.ro/jour/index.php/app/article/view/417>.
9. Snider, Don M., 2008, *Dissent and strategic leadership of the military professions*. Strategic Studies Institute, US Army War College, Carlisle Barracks, Pennsylvania, https://www.globalsecurity.org/military/library/report/2008/ssi_snider.pdf.
10. Lilo, Ardian. *Officer candidates education and training in the AAF*, US Army Command and General Staff College, Fort Leavenworth, Kansas, <http://www.dtic.mil>, 2008.
11. Hartle, Anthony E., *Moral Issues in Military Decision Making*. Kansas: University Press of Kansas, 2004.

KONCEPTET USHTARAKE: NJË HORIZONT PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË ARDHSHME

Nënkolonel (R) Msc. Besnik DACI
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar

Ky punim paraqet disa ide kyçe mbi konceptet ushtarake. Përgjithësisht, konceptet artikulojnë një vizion të së ardhmes mbi mënyrën se si Forcat e Armatosura të ardhshme do të operojnë në një mjedis operacional në ndryshim dhe përshkruajnë një qasje të mundshme me të cilën Forca e Armatosur do të mbrojë dhe sigurojë interesat e kombit kundër një game të gjerë kërcënimesh të sigurisë.

Qëllimi i tyre është të udhëheqin zhvillimin e forcës dhe zhvillimin e paketës së aftësive të ardhshme për të përballuar kërcënimet që po shfaqen në bashkëpunim me aleatët, partnerët dhe organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare.

Artikulli ofron kontekstin bazë të subjektit, terminologjinë, qëllimin, hierarkinë dhe karakteristikat e koncepteve, si një bazë solide për kuptimin e temës.

Fjalë kyçe: koncept ushtarak, doktrinë, zhvillim aftësish, Forcë e Armatosur, mjedis operacional, DOTMLPF, (akronim për doktrinën, organizatën, trajnimin, materialet, udhëheqjen dhe arsimimin, personelin dhe objektet).

“Një ide e re, së pari, kundërshtohet si qesharake dhe më pas injorohet si e parëndësishme, derisa në fund ajo bëhet diçka që të gjithë e dinë”.

William James, 1879

Hyrje

Dalja nga çdo organizatë për të arritur objektivat strategjikë të përzgjedhur është kryesisht e kufizuar nga aftësia e saj për të përcaktuar dhe zbatuar procedurat ose parimet kritike në hapat e ardhshëm. Organizatat ushtarake, të përfaqësuara nga Forcat e Armatosura (FA), udhëhiqen në aktivitetet e tyre nga aktet normative dhe planet e zhvillimit si: strategjitë, vizionet ose konceptet, të cilat ofrojnë ide për drejtimin dhe zhvillimin e ardhshëm të FA, sidomos në lidhje me sigurimin e interesave të kombit dhe përgjigjen ndaj kërcënimeve të parashikuara. Rëndësia e fjalës “koncept” brenda mjedisit ushtarak është kaq e gjerë sa që kuptimi, qëllimi dhe përmbajtja e saj e vërtetë ka humbur rëndësinë e saj origjinale, ose përkundrazi, në terma të përdorimit të fjalës me frekuencë të lartë, ajo çon në konfuzion në kuptim, terminologji dhe po kështu edhe në përmbajtje. Për shkak se në Forcat e Armatosura këto pasiguri dhe dallime në kuptimin dhe përmbajtjen e konceptit vazhdojnë të ekzistojnë, qëllimi i këtij artikulli është të shpjegojë disa çështje të përgjithshme lidhur me konceptet dhe të theksojmë qëllimin, rëndësinë dhe përmbajtjen e tyre. Kuptimi i vetë konceptit lidhet në këtë artikull kryesisht me mjedisin ushtarak, dhe kështu me kontekstin e “konceptit ushtarak”.

Qëllimi dhe rëndësia e konceptit

Termi “koncept” në përgjithësi do të thotë një ide ose vizion i përhershëm për *modus operandi*¹ “a particular way of doing something” (mënyra e veçantë e veprimit or metoda e veprimit), për mënyrën se si Forcat e Armatosura do të operojnë në operacionet e ardhshme. Ai përshkruan aftësitë e nevojshme për kryerjen e këtyre operacioneve në mjedisin operacional të parashikuar dhe mënyrën se si komandanti, duke përdorur njohuritë e artit dhe shkencës ushtarake, do të përdorë këto aftësi për të arritur efektet ose objektivat e dëshiruara.

Koncepti përcakton se si Forcat e Armatosura ose pjesët e tyre mund të operojnë, kornizën kohore dhe kushtet në të cilat ata operojnë (mjedisi operacional), si dhe aktivitetet individuale që duhet të jenë në gjendje të kryejnë, në varësi të aftësive të kërkuara. Koncepti gjithashtu përshkruan natyrën e problemit ose serinë e problemeve që duhet të adresohen, karakterin e aktorëve ose pjesëmarrësve individualë të përfshirë në zgjidhjen e problemit,

¹ Modus operandi - Wikipedia

si dhe ndërveprimet e tyre. Koncepti duhet të jetë i aplikueshëm brenda një periudhe mesatare deri afatgjatë, në varësi të ndryshimeve në politikë, strategji, siguri dhe/ose mjedisin operacional dhe teknologjinë. Koncepti nuk mund të jetë i kufizuar ose i ndaluar as nga aftësitë aktuale dhe as nga burimet financiare. Idetë kyçe të përshkruara në koncept duhet të çojnë në zhvillimin e aftësive të kërkuara, të cilat më pas vlerësohen përmes lojërave të luftës, studimeve, eksperimenteve dhe mënyrave të tjera. Koncepti është pika e nisjes e procesit të vlerësimit, ndërtimit, zhvillimit dhe implementimit të mëpasshëm të aftësive; ato shërbejnë për identifikimin e mangësive (gaps/ hapësira) në aftësi dhe për krijimin e zgjidhjeve të mëpasshme për t'i kapërcyer ato në fusha të caktuara të Doktrinës, Organizimit, Trajnimit, Materialeve, Lidershit dhe Edukimit, Personelit, Faciliteteve dhe Infrastrukturës (DOTMLPFI).

Nëse procesi është vendosur siç duhet, krijohen kushte të favorshme për zhvillimin e aftësive ushtarake. Së fundmi, konceptet janë një sfidë e rëndësishme për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, përcaktimin e prioriteteve të tyre, financimin dhe orientimin e zhvillimit të mëtejshëm të tyre. Përshkrimi i aftësive për operacionet ushtarake të ardhshme, në terma të aplikimit të tyre në kohë, është i deklaruar në konceptet e ndryshëm, por përgjithësisht për 8-20 vitet e ardhshme.

Forcat e Armatosura operojnë në misione krah për krah me partnerët ndërkombëtarë, kështu që koncepti duhet të marrë parasysh kërkesat për aftësitë jo vetëm të forcave të përbashkëta ose të llojeve të ndryshme forcash brenda kuadrit të FA kombëtare, por edhe kërkesat e partnerëve të koalicionit, kur veprimet e përbashkëta në operacione supozohet të realizohen. Prandaj, është e përshtatshme dhe e nevojshme të merret pjesë në zhvillimin dhe validimin e koncepteve së bashku dhe të përfitohet nga përvoja e koncepteve të përpunuara ose të vërtetuara më parë të atyre partnerëve individualë.

Koncepti duhet të përgjigjet ndaj faktit se forcat e përbashkëta të ardhshme do të duhet të adaptohen dhe të kombinojnë një seri aktiviteteve komplekse ushtarake dhe jo-ushtarake, si transporti dhe dislokimi i forcave, zhvillimi i aktiviteteve luftarake, stabilizimi dhe sigurimi i mjedisit, ndihma humanitare, detyrat e rindërtimit, etj., në përputhje me kërkesat e çdo shtate operative. Prandaj, koncepti i qaset çdo shtate sipas specifikave të saj në lidhje me kontekstin unik politik dhe strategjik, përkundrazi nga tentimi për ta “përshtatur” këtë shtatë me një shabllon të saktë. Megjithatë, koncepti nuk duhet të ketë udhëzime të detajuara që përcaktojnë metodat e realizimit të këtyre aktiviteteve dhe gjithashtu nuk duhet të krijojë ndonjë doktrinë autoritare. Ai duhet të përshkruajë një grup problemesh operative të shprehura në “scenarë”, përmes ideve kryesore të zgjidhjeve operative deri në gjetjen e implikimeve institucionale për miratimin e këtyre zgjidhjeve.

Koncepti përqendrohet në strategjinë e arritjes së objektivave ushtarake dhe njëkohësisht me kontributin e organizatave të tjera (ushtarake dhe jo-ushtarake) dhe partnerëve multinacionalë. Ai supozon zonat e mundshme ku Forcat e Armatosura dhe instrumentet e tjera të pushtetit shtetëror mund të gjejnë interesa të përbashkëta për integrimin më të mirë të përpjekjeve të tyre. Më tej, koncepti është i dobishëm për këto organizata dhe partnerë për të vlerësuar kërkesat dhe mundësitë për integrimin e mundshëm.

Koncepti dhe Doktrina - Në praktikë, takojmë pikëpamje të ndryshme mbi kuptimin dhe përmbajtjen e koncepteve dhe marrëdhënien e tyre me doktrinat ushtarake. Konceptet, në disa raste, gabimisht konsiderohen si doktrina dhe anasjelltas. Çelësi për të kuptuar kuptimin dhe dallimin midis konceptit dhe doktrinës është të identifikojmë marrëdhënien e tyre të ndërsjellë dhe të dallojmë ndryshimet thelbësore midis të dyjave.

Doktrina - (doktrina ushtarake) përmban dhe përshkruan parimet thelbësore mbi të cilat forcat e armatosura realizojnë aktivitetet (operacionet) për të arritur ose mbështetur objektivat kombëtarë dhe/ose multinacionalë. Ajo ofron një bazë teorike për planifikimin, zhvillimin, komandimin, kontrollin dhe mbështetjen e operacioneve dhe siguron një kuadër për të kuptuar qasjet doktrinale ndaj operacioneve. Ajo gjithashtu shërben si një *background* dhe burim informacioni për edukimin dhe studimin e parimeve për planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve. Është autoritative, por kërkon gjykim në aplikimin e saj - nuk është dogmë.

Doktrina përshkruan karakteristikat e Forcave të Armatosura ekzistuese (ose forcave të afërta në të ardhmen), aftësitë e tyre aktuale si dhe aftësinë për të përdorur këto aftësi në operacione ushtarake të përbashkëta ose operacione në të ardhmen e afërt. Koncepti, megjithatë, përshkruan mjedisin operacional të ardhshëm (të mundshëm) dhe kërkesat e ardhshme operative të lidhura që Forcat e Armatosura do të duhet të plotësojnë për t'u përballur me sfida të mundshme në këtë mjedis. Më shkurt, doktrina drejton aktivitetet e Forcave të Armatosura të ditëve të sotme, e ndikuar nga mjedisi aktual i sigurisë dhe operacioneve në afat të shkurtër ose mesatar, ndërsa koncepti përqendrohet në të ardhmen dhe specifikon kërkesat për zhvillimin e forcave të sotme drejt mundësive për operacione në mjedisin operacional të ardhshëm.

Konceptet historike, të sotme dhe të ardhshme² - Konceptet mund të konsiderohen përgjithësisht në terma të vlefshmërisë së tyre në një periudhë të caktuar kohe. Sipas kësaj, ato etiketohen si koncepte historike, të tanishme dhe të ardhshme. Karakteristikat e tyre të përgjithshme janë të paraqitura në tabelën 1, si më poshtë:

² <https://www.dtic.mil/futurejointwarfare/>

Periudha e Konceptit	Karakteristikat	Shembuj
Koncepte historike. Përshkruani subjektin (temën) dhe metodat e aplikimit të tyre në disa kontekste historike.	✓ Ata shpesh nuk shprehen saktësisht në kohë, por dalin nga regjistrimet historike ✓ Në momentin e aplikueshmërisë së tyre, ato nuk janë të kodifikuara (të ligjëruara) qartë ✓ Merren nga regjistrimet historike (analiza) ✓ Mund të vendosen nga rregullore dhe të ndryshohen vazhdimisht gjatë realizimit të tyre.	Plani i betejës së Torviollit*. ✓ Beteja e parë e ushtrisë shqiptare kundër turqve nën drejtimin e Skënderbeut në Dibrën e poshtme (viti 1444). ✓ Përdorimi i kalorësisë. ✓ Përdorimi i rezervave të rëndësishme. ✓ Operacionet e shpinëmarrjes me fshehjen e 3000 kalorësve. ✓ Sulmit të kalorësisë osmane, Skënderbeu iu përgjigj me një rendim të ri luftimi. ✓ Grupet e manovrës (futja midis dy zjarreve, nga balli dhe shpina rrethimi dhe asgjësimi i ushtrisë së madhe osmane).
<i>Koncepte të posaçme.</i> Përshkruani subjektin (temën) dhe aplikueshmërinë e tyre në ditët e sotme me organizatën, metodat dhe teknologjitë aktuale.	✓ Mund të miratohen qartë në dokumentet ekzistuese (doktrinare, taktike, teknike, procedurale) ✓ Mund të lindin nga kushtet aktuale (operacionale, teknologjike, institucionale). ✓ Duhet të formojnë bazën për planifikimin operacional dhe për fushat e DOTMLPFI	✓ Vizioni i Bashkuar (2018) për 2025. ✓ Ushtria Pasardhëse (2018) për 2030 ✓ Vizioni i Bashkuar (2025) për 2035 ✓ Koncepti bazë për Operacionet e Bashkuara (SHBA 2010) për 2015-2025.

* Beteja e Torviollit – enciklopedia shqiptare

<i>Koncepte të ardhshme.</i> Shprehin një ide se si do të përdoret subjekti (tema) e tyre në kontekstin e ardhshëm.	✓ Koncepte të ardhshme janë fillimisht të paprovuar dhe duhet të jenë subjekt i eksperimentimit dhe diskutimit. ✓ Mund të zhvillohen dhe të ligjërohen ose të shpallen të pavlefshme. ✓ Po zhvillohen nga hipoteza të paprovuar në përfundime të vendosura. ✓ Vetëm pasi koncepti të jetë verifikuar eksperimentalisht dhe të konfirmohet saktësia e tij dhe të ligjërohet, ai ofron bazën për planifikimin e forcave, zhvillimin e planifikimit dhe mbështetjen e aftësive ushtarake	Konceptet e Shteteve të Bashkuara, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë dhe vendeve të tjera.
--	--	--

Hierarkia e koncepteve³ - Konceptet janë të organizuara në mënyrë sistematike brenda një familje konceptesh në një hierarki. Në krye të hierarkisë është koncepti institucional, i cili dominon mbi të gjitha konceptet e tjera nënshtruese; konceptet operacionale (të njohura gjithashtu si funksionale), funksionale dhe mundësuese (të njohura gjithashtu si integruese). Koncepti institucional përcakton përmbajtjen, rolin dhe marrëdhënien e tij me zhvillimin dhe përdorimin e Forcave të Armatosura të ardhshme. Këto ide dhe zgjidhje zhvillohen më tej në konceptet nënshtruese. Konceptet e një niveli më të ulët duhet të jenë të përputhshme me konceptet e një niveli më të lartë, të cilat janë nënshtruese për to. Ndërsa konceptet e nivelit më të lartë përgjithësisht drejojnë zhvillimin e koncepteve nënshtruese, është e dukshme se kjo marrëdhënie funksionon gjithashtu në drejtimin e kundërt. Konceptet përcaktuese në nivelin më të ulët mund të çojnë ndonjëherë në nevojën për të rishikuar parimet e koncepteve të nivelit më të lartë. Nëse këto rregulla respektohen, rrjedha logjike dhe zhvillimi i koncepteve të sigurohet nëpërmjet; përcjelljes së vizionit strategjik, (direktivës) në rekomandimin për zhvillimin

³ <https://www.gov.uk/Development-concepts-and-doctrine-centre#futures-concepts>

e aftësive të kërkuara dhe përdorimin e tyre në operacionet e ardhshme. Karakteristikat e përgjithshme të koncepteve të përmendura më sipër mund të përmbliken në tabelën 2, si më poshtë:

Konceptet Institucionale	Përshkruajnë institucionet ushtarake
Konceptet Operacionale (të njohura gjithashtu si funksionuese)	Përshkruajnë si veprojnë forcat ushtarake
Konceptet Funksionale	Përshkruajnë efektin ose ndikimin (performancën, sjelljen) e funksioneve operacionale (bashkëpunuese) ose sub-funksioneve
Konceptet mundësuese (të njohura gjithashtu si integruese)	Përshkruajnë aftësitë e kërkuara për efektin ose ndikimin e funksioneve ushtarake ose sub-funksioneve dhe mënyrën e integritit të tyre brenda Forcave të Armatosura të tërësishme.

Tabela 2. Karakteristikat e koncepteve

Konceptet institucionale - Konceptet institucionale përshkruajnë konceptin, drejtimin dhe funksionimin e institucioneve ushtarake në planin/(horizontin) afatgjatë. Ato derivojnë drejtpërdrejt nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake dhe ofrojnë përmbajtje (kontekst) e këshilla për të gjitha konceptet e tjera. Konceptet institucionale të ardhshme shpesh publikohen (njoftohen) si shprehje e një vizioni për një horizont të caktuar kohor të së ardhmes.

Konceptet operacionale - Konceptet operacionale përshkruajnë se si të përdoren Forcat e Armatosura në operacionet e ardhshme, në varësi të interesave ose ambicieve politike-ushtarake. Ato diskutojnë më shumë mbi parimet dhe idetë themelore (temat) sesa mbi detajet e ekzekutimit. Ato trajtojnë më shumë situata operacionale të përgjithshme sesa specifike. Përfshijnë një gamë të gjerë aktiviteteve ushtarake, jo vetëm një fushë funksionale dhe përshkruajnë më gjerësisht se çfarë dhe si duhet të bëhet ushtarakisht në një situatë të caktuar – si do të përdoret fuqia ushtarake.

Konceptet funksionale - Konceptet funksionale përshkruajnë kontekstin (funksionimin) e funksioneve të veçanta të bashkëpunimit (Komandimi dhe Kontrolli, Inteligjenca, Manovra dhe Zjarri, Mbrojtja e trupave dhe të tjera) në një kontekst më të gjerë operacional. Për shembull: “Arritja e nivelit të kërkuar

të mbrojtjes së trupave kërkon përdorimin e përbashkët dhe të ndërsjellë të aktiviteteve mbrojtëse, të cilat mund të përfshijnë: identifikimin, vlerësimin, paralajmërimin, mbrojtjen, restaurimin, etj. Aktivitetet përfshijnë procesin e detyrave ushtarake të integruara, të cilat mund të pengojnë (ndalojnë), parandalojnë ose lehtësojnë efektet negative të aktiviteteve të kundërshtarit në aktivitetet e trupave të veta. Ato shërbejnë për të rritur funksionin mbrojtës duke përcaktuar aftësitë mbrojtëse të nevojshme”. Koncepti pastaj ofron udhëzime që përshkruajnë se si komponentët individualë të Forcave të Armatosura duhet të planifikojnë, integrojnë dhe ofrojnë mbrojtjen e trupave gjatë dislokimit, përdorimit, mbështetjes dhe tërheqjes së tyre nëpërmjet spektrit të operacioneve.

Konceptet mundësuese - Konceptet mundësuese përshkruajnë se si realizohet një detyrë ose procedurë duke aplikuar aftësi të pjesshme (brenda kontekstit të fushave më të gjerë funksionale, si teknologjitë specifike, programet e trajnimit/arsimimit, organizata, pajisjet, etj.). Për shembull, koncepti që përshkruan Aplikimin e Teknologjisë për Vizualizimin e Hapësirës së Betejës mund të jetë një koncept mundësues për konceptin funksional të Komandimit dhe Kontrollit.

Karakteristikat dhe kërkesat e koncepteve⁴

Koncepti i përpunuar duhet të jetë specifik në përmbajtjen e tij dhe të plotësojë disa kërkesa të përbashkëta:

- Pavarësisht se koncepti i ardhshëm është më shumë spekulim mbi të ardhmen, i plotësuar me informacion nga periudha e mëparshme, ai ka rrënjë historike. Pikënisja për përpunimin e konceptit mund të jetë, për shembull, doktrina ekzistuese, mësimet e nxjerra nga operacionet, rezultatet nga eksperimentet dhe studime të ndryshme (shkencore, akademike).
- Baza e konceptit përbëhet nga një sistem i pikëpamjeve mbi karakterin e operacioneve dhe realizimin e tyre të suksesshëm. Kështu, koncepti përfshin teorinë e operacioneve ushtarake.
- Koncepti harmonizon artin dhe shkencën ushtarake. Ai mund të theksojë rëndësinë e një prej fushave ose të dyja, raporti i tyre mund të ndryshojë për shkak të qëllimit të konceptit, por asnjëra prej të dyjave nuk duhet të injorohet.
- Koncepti është i rrënjësor fort në kontekstin ushtarako-teknologjik të caktuar. Koncepti duhet të marrë parasysh qasjen e një kombi (qytetarët e tij) ndaj luftës dhe operacioneve ushtarake si të tilla, sepse ato mund të përbëjnë një qëndrim të përgjithshëm ndaj vlerave kombëtare të gjera.

⁴ <http://www.tradoc.army.mil/tpubs/>

- Koncepti nuk nënkupton që aplikimi i teknologjisë është një zgjidhje, por merr parasysh që kjo zgjidhje e bën të mundur. Koncepti shfrytëzon një teknologji të re, ose përgjigjet pozitivisht ndaj përhapjes së saj. Aplikimi dhe supozimet teknologjike janë të kufizuara nga ajo që është e mundur financiarisht dhe teknologjikisht brenda periudhës kohore të konceptit.
- Koncepti duhet të verifikohet më pas. Fillimisht, asnjë koncept nuk e imponon prezumimin e vlefshmërisë, por e njeh se ai pranohet me mosbesim; justifikimi i tij duhet të demonstrohet përmes logjikës, eksperimentimit dhe mënyrave të tjera relevante. Koncepti duhet të vendosë njëkohësisht kritere për vlerësimin e realizueshmërisë dhe aplikueshmërisë së tij.
- Koncepti inkurajon diskutimin duke përshkruar kontekstin në terma të qartë dhe të kuptueshëm. Kjo u mundëson të gjitha palëve të interesuara të kuptojnë thelbin e konceptit dhe të shmangin negociatat për qëllimin e tij.
- Koncepti duhet të zbatohet në situata të ndryshme. Ai duhet të plotësojë kërkesat e disa skenarëve të mundshëm brenda parametrave të tyre të caktuar.
- Konceptet janë të shkurtra dhe përshkruajnë kontekstin e duhur. Koncepti paraqet idetë në mënyrë të shpejtë dhe efikase; “mesazhi” i tij mund të merret shpejt në konsideratë gjatë zbatimit të konceptit. Qëllimi është të ofrohet konteksti minimal i nevojshëm, të goditet thelbi i problemit sa më shpejt të jetë e mundur dhe të hiqet përmbajtja e panevojshme që nuk zhvillon idenë qendrore të konceptit.
- Koncepti përdor një gjuhë të thjeshtë dhe një terminologji të vlefshme; ai shmang përdorimin e frazave dhe krijimin e shkurtesave të reja, si dhe terma të rinj për qëllim “novacioni”. Termat e qarta duhet të sigurojnë qartësi dhe konsistencë të gjuhës. Përdorimi i shkurtimeve dhe “shprehjeve popullore” çon përdoruesit e konceptit në konfuzion më të madh sesa në kuptimin e tij. Koncepti duhet të shkruhet mjaft qartë për t’u kuptuar plotësisht që në leximin e parë.

Përfundime

Konceptet ushtarake përbëjnë bazën për zhvillimin e ardhshëm të Forcave të Armatosura dhe bazën për zhvillimet e mëvonshme të koncepteve mbështetëse. Ato përshkruajnë aftësitë e gjera që Forcat e Armatosura do të kenë nevojë në të ardhmen dhe shpjegojnë se si do të përdorin burimet e disponueshme për të mposhtur kundërshtarët adaptivë për të realizuar misione sfiduese në mjedise komplekse operationale të së ardhmes. Të gjitha informacionet e

nevojshme bazë në lidhje me përmbajtjen e konceptit dhe procesin e zhvillimit të konceptit do të vazhdojnë.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, 2024.
2. Koncepti i ri Strategjik i Aleancës, samiti i Madridit 2022, 29 qershor 2022.
3. Strategjia Ushtarake e NATO-s, e miratuar më 2019.
4. NATO's Concept for Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area (DDA).
5. The NATO Warfighting Capstone Concept (NWCC).
6. Capstone Concept for Joint Operations. Version 3.0, 2009. DoD USA.
7. Capstone Concept for Joint Operations Activity Concepts. 2010. DoD USA.
8. Joint Operations Concepts Development Process. 2007. Washington D.C. Joint Chiefs of Staff.
9. Joint Operations Concepts Development Process. Washington. 2007. 76 f. I disponueshëm nga: <http://www.dtic.mil/futurejointwarfare>
10. Major Combat Operations Joint Operating Concept. 2006. DoD USA.
11. MATTIS, James N. Joint Concept Development Vision. 2009. DoD USJFCOM, Norfolk. I disponueshëm nga: http://www.jfcom.mil/newslink/storyarchive/2009/jc_vision.pdf.
12. SCHMITT, John F. A Practical Guide for Developing and Writing Military Concepts. Defense Adaptive Red Team: Working Paper #02-4 [online]. Dhjetor 2002, I disponueshëm nga: http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/dod/dart_guide.pdf
13. The Future Land Operational Concept. 2008. The Development, Concepts and Doctrine Centre, Ministry of Defence, Shrivenham SWINDON, Wiltshire.
14. TRADOC Pamphlet 71-20-3. The U.S. Army Training and Doctrine Command Concept Development Guide. 2011. Department of the Army TRADOC Headquarters, US Army Training and Doctrine Command Virginia, 48 f. I disponueshëm nga: <http://www.tradoc.army.mil/tpubs/>.
15. Konceptet e SHBA të marra në: <http://www.dtic.mil/futurejointwarfare/>, konceptet e Mbretërisë së Bashkuar janë të disponueshme në: <https://www.gov.uk/Development-concepts-and-doctrine-centre#futures-concepts>.

ZHVILLIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA PËRMES KONCEPTEVE OPERACIONALE: NJË QASJE STRATEGJIKE

Nënkolonel (R) Msc. Arben ZAVALANI
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar

Konceptet operationale përfaqësojnë pikënisjen themelore për hartimin, zhvillimin dhe transformimin e Forcave të Armatosura, në përputhje me sfidat e mjedisit bashkëkohor dhe të ardhshëm të sigurisë. Ato ofrojnë një vizion strategjik dhe funksional për përshtatjen e strukturave, kapaciteteve dhe mënyrave të veprimit ushtarak, duke qenë një komponent thelbësor në ndërtimin e aftësive mbrojtëse të efektshme.

Ky punim shqyrton rolin dhe rëndësinë e koncepteve operationale ushtarake të vendeve të tjera, me fokus në përvojat e NATO-s, Bashkimit Evropian dhe disa shteteve me traditë të konsoliduar ushtarake. Përmes analizës së këtyre praktikave, artikulli synon të paraqesë qasje të vlefshme për zhvillimin dhe zbatimin e koncepteve operationale në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, në funksion të rritjes së efektivitetit, ndërveprueshmërisë dhe kapaciteteve strategjike e operationale të tyre.

Fjalët kyçe: Koncepti operacional, qasje strategjike, siguri kombëtare, evolucion teknologjik

Hyrje

Transformimi dhe përshtatja janë procese thelbësore për çdo organizatë që synon të realizojë objektivat e saj në një mjedis të ndryshueshëm dhe dinamik. Në kontekstin e Forcave të Armatosura, këto procese mbështeten në një kornizë strategjike të ndërtuar mbi dokumente programore të nivelit të lartë – si strategjitë kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, politikat publike, udhëzimet strategjike dhe dokumente të tjera orientuese – të cilat përcaktojnë gjendjen përfundimtare të dëshiruar, objektivat afatgjatë dhe drejtimet kryesore të zhvillimit të forcave.

Transformimi ushtarak përbën një proces kompleks dhe të qëndrueshëm, që realizohet përmes zhvillimit dhe zbatimit të koncepteve operacionale, strategjive të mirëmenduara, doktrinave bashkëkohore dhe përvetësimit të aftësive të reja teknologjike dhe funksionale. Qëllimi kryesor është rritja e efektivitetit dhe ndërveprueshmërisë së strukturave ushtarake, duke siguruar krijimin e efekteve të sinkronizuara në të gjitha fushat operacionale – tokë, ajër, det, hapësirë dhe kibernetikë. Këto transformime synojnë integrimin e kapaciteteve në nivele kombëtare dhe shumëkombëshe, reagimin e shpejtë ndaj zhvillimeve në mjedisin e sigurisë dhe realizimin me sukses të misioneve të ngarkuara.

Në një realitet të ri sigurie, ku kërcënimet konvencionale dhe asimetrike ndërthuren ngushtë dhe zhvillimet teknologjike po ndryshojnë thellësisht karakterin e luftës, kërkohet një qasje gjithnjë e më e sofistikuar dhe e parashikuar në zhvillimin e forcave të armatosura. Në këtë kuadër, konceptet operacionale përbëjnë një element kyç – ato përfaqësojnë ide novatore që përshkruajnë skenarët e mundshëm të së ardhmes, sfidat, problemet dhe zgjidhjet që duhet të shqyrtohen dhe zhvillohen në kohë.

Konceptet operacionale nuk janë thjesht dokumente teorike apo planifikime doktrinare të ngurta – ato shërbejnë si vizion strategjik mbi mënyrën se si një forcë e armatosur duhet të angazhohet në operacionet e ardhshme, duke marrë parasysh evolucionin teknologjik, ndryshimet në karakterin e luftës dhe ndërveprimin me aktorët ndërkombëtarë. Nëpërmjet tyre sigurohet koherenca ndërmjet objektivave strategjike politike dhe kapaciteteve reale të forcave, duke bërë të mundur që investimet në mbrojtje të jenë të orientuara dhe të justifikuara.

Ky artikull ka për qëllim të analizojë rolin e koncepteve operacionale në modernizimin dhe përshtatjen e Forcave të Armatosura me sfidat e reja të sigurisë. Nëpërmjet një qasjeje analitike dhe krahasuese, shqyrtohet rëndësia e koncepteve që përdoren nga forcat e armatosura të vendeve të tjera, të cilat ofrojnë mësim dhe qasje të dobishme për zhvillimin e modeleve të përshtatshme në Shqipëri. Artikulli ofron gjithashtu disa rekomandime për

thelimin e procesit të konceptualizimit operacional në kontekstin e vendit tonë dhe më gjerë.

Vendi dhe roli i koncepteve operative në literaturën ushtarake

Evolucioni i vazhdueshëm i mjedisit operacional dhe i mënyrës së zhvillimit të veprimeve ushtarake, i shoqëruar me shfaqjen e kërcënimeve të reja dhe përdorimin e qasjeve inovative nga aktorë ndërkombëtarë, paraqet sfida serioze për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare. Në këtë mjedis të ndërlikuar forcat e armatosura duhet të përshtaten dhe të transformohen, duke rishikuar përdorimin e kapaciteteve ekzistuese dhe të ardhshme. Projektimi dhe zhvillimi i forcave përfaqëson një proces strategjik afatgjatë, i cili përfshin jo vetëm hartimin e koncepteve dhe zhvillimin e aftësive të reja, por edhe testimin dhe përsosjen e tyre përpara se të zbatohen në praktikë. Në këtë proces, konceptet operative shërbejnë si ura lidhëse midis analizës së nevojave dhe zbatimit të zgjidhjeve të reja në fushën e mbrojtjes.

Konceptet operative lidhin analizën e nevojave me zbatimin e zgjidhjeve të reja në fushën e mbrojtjes. Një koncept operacional është një ide e strukturuar dhe e miratuar për adresimin e sfidave specifike, por paqartësia në hartim mund të krijojë pengesa. Prandaj, roli i tyre duhet të sqarohet përmes shembujve konkretë. Një koncept operacional mund të përkufizohet si një ide e strukturuar dhe e miratuar, e prezantuar zakonisht në formë dokumenti zyrtar, e cila ofron një qasje të re ose të përmirësuar për zgjidhjen e një problemi specifik operacional. Nëse një koncept hartohet në mënyrë të paqartë ose me terminologji të përgjithshme, ai mund të krijojë konfuzion dhe pengesa në zbatim. Për këtë arsye, është e domosdoshme të sqarohet vendi dhe roli i koncepteve operative në diskursin ushtarak, duke ilustruar qasjet përmes shembujve konkretë.

Konceptet ushtarake përcaktojnë mënyrat e përdorimit të aftësive ushtarake për realizimin e objektivave, duke qenë të përgjithshme ose specifike, në varësi të situatës. Zhvillimi i tyre fillon nga identifikimi i nevojave dhe përshtatet me ndryshimet në organizim, taktika dhe teknologji. Literatura ushtarake ofron klasifikime të ndryshme për këto koncepte, por mungon një hierarki universale. Sipas NATO-s (2021)¹, ato ndahen në strategjike, operative dhe funksionale, ndërsa disa vende përdorin edhe kategori shtesë si konceptet e shërbimeve dhe ato të komandave mbështetëse. Në këtë artikull, argumentohet në favor të një hierarkie të zgjeruar të koncepteve ushtarake,

¹ ACT/Allied Command Transformation, Centers of Excellence, <https://www.act.nato.int/about/centres-of-excellence/>

e cila ndërtohet mbi parimet e përcaktuara në Strategjinë Ushtarake 2024, si dhe në bazë të analizave teorike të autorëve Schmitt² dhe Galatik, Pikner, Spisak dhe Zuna³. Kjo qasje synon të ofrojë një strukturim më të qartë dhe sistematik të koncepteve, duke i renditur nga ato më të përgjithshme drejt atyre më të specializuara:

Konceptet institucionale – të lidhura me organizimin dhe funksionimin e përgjithshëm të institucioneve ushtarake (siç janë konceptet për besueshmëri strategjike, planifikim ndërinstitutional, apo ngritja e qendrave të ekselencës të akredituara nga NATO).

Konceptet operacionale – që përshkruajnë mënyrat e përdorimit të forcave ushtarake dhe aftësive të tyre për të përmbushur detyra të ndryshme, sipas parametrave të misionit, mjedisit operacional dhe nivelit të luftës etj.⁴

Konceptet funksionale – që adresojnë mënyrën e ushtrimit të funksioneve ushtarake specifike, si komandim dhe kontroll, manovrim, mbrojtje, logjistikë, etj.

Konceptet integruese (specifike) – që përfshijnë aftësi të specializuara ose me karakter ndërveprues, si mbrojtja ajrore e integruar (IAMD), mbrojtja nga raketat balistike (MDA),⁵ apo operacionet ndërinstitutionale dhe shumëkombëshe.

Përparësia kryesore e kësaj hierarkie është fleksibiliteti që ofron për përkufizimin e termit “koncept operacional”. Ky mund të nënkuptojë si konceptin operacional të një strukture force, që nga koncepti drejtues (*capstone concept*)⁶ deri te koncepti themelor (*cornerstone concept*),⁷ ashtu edhe kategorizimin e koncepteve sipas nivelit të luftës: strategjik, operacional apo taktik.

Në funksionin e tyre, konceptet ushtarake përfaqësojnë dokumente shumëfunktionale, të cilat ndihmojnë në përgatitjen teorike dhe praktike për

² A Practical Guide for Developing and Writing Military Concepts. Defense Adaptive Red Team: Working Paper, 23 September 2023 Schmitt, J.F. (2002)

³ Pikner, I., Zuna, P., Spisak, J., Galatik, V. (2013). Military Operating Concepts Development.

⁴ The term “operating” is preferred by some authors to avoid possible confusions of using the term “operational”, a term with double meaning – one as the operational level of warfare and the other as the attribute related to military operations (operational).

⁵ IAMD-Integrated Air and Missile Defense, MDA-Maritime Domain Awareness.

⁶ Në fushën ushtarake ose të zhvillimit strategjik, “capstone concept” është një dokument ose ide që përmbledh dhe drejton zhvillimin e strategjive të ardhshme, forcave ose operacioneve. Pra, është udhëheqësi konceptual që përcakton drejtimin e përgjithshëm. Në fushën akademike nënkupton projektin kryesor që kurorëzon dhe përmbyll një program studimi.

⁷ “Cornerstone concept” nënkuton “koncept themelor” ose “koncept gur-themeli”. Në kuptimin figurativ: Cornerstone (gur themeli) është pjesa më themelore dhe e rëndësishme mbi të cilën ndërtohet një strukturë ose një sistem. Cornerstone concept është ideja kryesore dhe bazë mbi të cilën mbështeten të gjitha zhvillimet e mëtejshme.

përballimin e sfidave të reja dhe zgjidhjen e problemeve komplekse. Niveli i detajimit të një koncepti varet nga fusha e aplikimit dhe niveli i veprimit për të cilin është zhvilluar. Në mënyrë thelbësore, konceptet ushtarake përdoren për:

- identifikimin e zgjidhjeve për zhvillimin e doktrinae, forcave dhe kapaciteteve të reja;
- formulimin e strategjive institucionale përmes përcaktimit të vizioneve, prezantimit të qasjeve novatore dhe ndërtimit të kornizave konceptuale të orientuara drejt zgjidhjes së problemeve.

Konceptet drejtuese operationale janë një hallkë thelbësore ndërmjet direktivave strategjike dhe zbatimit të integruar të kapaciteteve të forcave të përbashkëta. Ato artikulojnë vizionin për zhvillimin e forcave në një periudhë afatgjatë (15–20 vjet) dhe shërbejnë si bazë për transformimin e operationeve dhe aftësive. Të mbështetura në parime të integritetit shumëkombësh dhe ndërinstitucional, këto koncepte orientohen përmes mekanizmave të analizës së nevojave si DOTMLPFI⁸ (Doktrina, Organizimi, Trajnimi, Pajisje, Udhëheqje, Personeli, Infrastruktura dhe Ndërveprueshmëria).

Një shkallë më poshtë, **konceptet e bashkëveprimit operacional** përshkruajnë se si një komandant planifikon dhe zbaton operationet në mjedise specifike, duke u përqendruar në përcaktimin e sfidave konkrete, kapaciteteve kritike dhe kushteve të aplikimit operacional.

Këto koncepte shërbejnë si “motor transformues” i forcave të armatosura, duke udhëzuar zhvillimin e mëtejshëm të koncepteve funksionale dhe atyre mbështetëse, si dhe duke ndikuar në përcaktimin e strukturave buxhetore dhe të projekteve për mjediset e reja operationale.

Zhvillimi i tyre mbështetet në analiza të thelluara strategjike mbi prirjet globale demografike, sociale, teknologjike dhe ambientale, të cilat ndihmojnë në parashikimin e karakteristikave të mjedisit të ardhshëm të sigurisë, natyrës së konflikteve të mundshme dhe ndikimit të teknologjive të reja në mënyrën e zhvillimit të operationeve ushtarake.

Konceptet operationale në nivel ndërkombëtar

Konceptet ushtarake të NATO-s janë vendimtare për harmonizimin e strukturave me standardet e Aleancës, duke siguruar bazën për operationet shumëkombëshe dhe zhvillimin e kapaciteteve të forcave shqiptare. Për këtë

⁸ DOTMLPFI është një kornizë gjithëpërfshirëse që përdoret për të identifikuar dhe adresuar nevojat për ndryshim në Doktrinë, Organizim, Stërvitje, Pajisje, Udhëheqje, Personel, Infrastrukturë dhe Ndërveprueshmëri, me qëllim përmirësimin e aftësive ushtarake në përputhje me sfidat bashkëkohore.

analizë, një rëndësi të veçantë kanë konceptet e NATO-s, Bashkimit Evropian dhe vendeve me përvojë të konsoliduar si SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca, të cilat jo vetëm përcaktojnë standardet ushtarake, por edhe ndërveprueshmërinë globale.

Një vëmendje e veçantë meriton studimi i qasjeve alternative të vendeve si Kina, Irani dhe Koreja e Veriut, të cilat zhvillojnë kapacitetet e tyre ushtarake në mënyrë të veçantë. Këto perspektiva ofrojnë njohuri të rëndësishme për sfidat dhe kërcënimet potenciale në një mjedis global kompleks.

Për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, konceptet ushtarake të NATO-s kanë një rëndësi të veçantë, për shkak të rolit të tyre përcaktues në orientimin e zhvillimit të kapaciteteve kombëtare dhe në sigurimin e përputhshmërisë me standardet dhe kërkesat e Aleancës. Këto koncepte ofrojnë kornizën teorike dhe praktike për integrimin e forcave shqiptare në operacione shumëkombëshe dhe ndihmojnë në orientimin e zhvillimit institucional dhe transformimit të forcave të armatosura në funksion të mbrojtjes kolektive.

Zhvillimi i koncepteve operacionale të NATO-s bazohet në dokumente strategjike themelore, si **Koncepti Strategjik i NATO-s**, udhëzimet politike të Ministrave të Mbrojtjes dhe **Strategjia Ushtarake e Aleancës**. Këto dokumente, të plotësuara nga konceptet e zbatimit të hartuar nga Komandat Strategjike të NATO-s – veçanërisht Komanda e Aleancës për Operacionet (ACO) dhe Komanda e Aleancës për Transformimin (ACT) – përbëjnë themelin për përdorimin e instrumentit ushtarak në nivelin strategjik-ushtarak dhe operacional⁹.

Një ndër konceptet kyçe të NATO-s në këtë drejtim është Koncepti për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euroatlantike – Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area (DDA). I zhvilluar nga ACO dhe i miratuar në vitin 2020 si dokument i klasifikuar, DDA përfaqëson operacionalizimin e Strategjisë Ushtarake të NATO-s dhe adreson në mënyrë proaktive kompleksitetin e mjedisit të ri të sigurisë. Koncepti DDA përkufizon mënyrën e përdorimit të instrumentit ushtarak të Aleancës në kushtet e ndryshuara të kërcënimeve, duke synuar forcimin e mbrojtjes kolektive, garantimin e gatishmërisë së forcave dhe koordinimin efikas të operacioneve shumëkombëshe në kohë paqeje, krize dhe konflikti. Përveç forcimit të qasjes mbrojtëse të Aleancës, ky koncept kontribuon në rivendosjen e balancës së fuqisë përballë aktorëve që sfidojnë rendin ndërkombëtar të sigurisë, si dhe shërben si bazë për përcaktimin e prioriteteve të reja në fushën e parandalimit, dislokimit të shpejtë dhe ndërveprimet ndërkombëtar.

⁹ The NATO Warfighting Capstone Concept: Key Insights from the Global Expert Symposium Summer 2020. NATO Symposium Final Version For Publication.docx

a) *NATO Warfighting Capstone Concept (NWCC) dhe qasja e BE-së ndaj koncepteve ushtarake*

Mjedisi aktual i sigurisë ndërkombëtare karakterizohet nga dinamika të reja strategjike dhe kërcënime të shumanshme, të cilat sfidojnë qëndrueshmërinë dhe kohezionin afatgjatë të Aleancës. Edhe pse NATO mbetet një aleancë me karakter mbrojtës, sfidat bashkëkohore kërkojnë mënyra të reja të të menduarit, organizimit dhe veprimit. Në këtë kontekst, Aleanca synon forcimin e elasticitetit, ndërveprueshmërisë dhe përshtatshmërisë së saj strategjike.

Në këtë linjë, Koncepti Udhëheqës për Zhvillimin e Luftës së NATO-s – NATO Warfighting Capstone Concept (NWCC)¹⁰, i miratuar në vitin 2021, paraqet një dokument themelor për përgatitjen dhe përshtatjen afatgjatë të instrumentit ushtarak të Aleancës. NWCC ofron një vizion gjithëpërfshirës për ruajtjen e epërsisë strategjike të NATO-s deri në vitin 2040, duke identifikuar sfidat aktuale dhe të ardhshme që burojnë nga konkurrenca ndërmjet fuqive të mëdha, teknologjitë e reja dhe transformimi i karakterit të luftës.

Që nga fillimi i agresionit rus ndaj Ukrainës në shkurt të vitit 2022, është bërë e qartë se, pavarësisht përparimeve teknologjike dhe ndërlikimit të mjedisit operacional, përdorimi tradicional i forcës së armatosur mbetet një element kyç në arkitekturën globale të sigurisë. Si rrjedhojë, NWCC thekson nevojën për të kombinuar aftësitë tradicionale me qasje novatore dhe me gatishmëri të përhershme për përshtatje konceptuale, strukturore dhe teknologjike.

Në zbatim të Strategjisë Ushtarake të NATO-s (2019) dhe në koordinim me Konceptin për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euroatlantike (2020), NWCC përfaqëson një përpjekje të integruar për transformimin e instrumentit ushtarak të NATO-s (Military Instrument of Power – MIOp¹¹). Ai synon të orientojë zhvillimin e tij drejt një dizajni funksional të përshtatur me sfidat e vitit 2040 dhe më tej. Koncepti identifikon pesë imperativë për zhvillimin e luftës, të cilët përbëjnë shtyllat për sinkronizimin e përpjekjeve të Aleancës:

- Përdorimi i avancuar i të dhënave dhe teknologjive të reja.
- Fleksibiliteti organizativ dhe operacional.
- Zhvillimi i fuqisë njerëzore dhe përgatitjes ushtarake.
- Integrimi i thelluar ndërmjet aleatëve.
- Gatishmëria për të vepruar në të gjitha domenet operationale.

¹⁰ The NATO Warfighting Capstone Concept: Key Insights from the Global Expert Symposium Summer 2020. Final Version For Publication.docx

¹¹ Allied Command Transformation, NATO Warfighting Concept, <https://www.act.nato.int/ourwork/nato-warfighting-capstone-concept/>, retrieved on 28 September 2023.

Për më tepër, NWCC përfshin **Konceptin për Operacione Multi-Domain (MDO)**, i cili përfaqëson një ndryshim paradigmatic në mënyrën se si NATO e koncepton dhe realizon veprimin ushtarak. Ky koncept synon të integrojë operacionet në të gjitha domenet – tokë, ajër, det, hapësirë dhe kibernetikë – duke i ofruar Aleancës avantazhin për të vepruar në mënyrë të koordinuar, të sinkronizuar dhe të vendosur kundër çdo kundërshtari të mundshëm.

Nga ana tjetër, Bashkimi Evropian, ndonëse me një përbërje të ngjashme anëtarësie me NATO-n, ndjek një qasje të veçantë dhe të përshtatur me karakteristikat institucionale të tij. Politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes e BE-së ndërtohet mbi një kornizë më të gjerë strategjike, që synon të forcojë kapacitetet kolektive evropiane për ndërhyrje në kriza dhe mbrojtje të përbashkët.

Instrumentet kryesore që ndikojnë në zhvillimin e koncepteve operacionale të BE-së përfshijnë:

- Kompas in Strategjik, si dokumenti politik udhëzues për ambicien dhe veprimin e përbashkët të BE-së në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- Fondi Evropian i Mbrojtjes (EDF) dhe Programi Evropian për Zhvillimin Industrial të Mbrojtjes (EDIDP), që mbështesin zhvillimin teknologjik dhe kapacitetet novatore.
- PESCO (Bashkëpunimi i Strukturuar i Përhershëm), si platformë për bashkëpunim të thelluar mes shteteve anëtare.
- CARD (Rishikimi i Koordinuar Vjetor për Mbrojtjen), që synon harmonizimin e investimeve dhe prioritetëve në fushën e mbrojtjes.

Këto iniciativa formojnë bazën për hartimin dhe zbatimin e koncepteve operacionale në nivelin evropian, duke u fokusuar në fleksibilitetin e reagimit, bashkëveprimin e koordinuar dhe ndërlidhjen ndërinstitucionale. Për zbatimin praktik të këtyre qasjeve, Shtabi Ushtarak i BE-së¹², nëpërmjet Drejtorisë për Koncepte dhe Kapacitete, është përgjegjës për hartimin e koncepteve dhe doktrinëve ushtarake, planifikimin e kapaciteteve dhe garantimin e koherencës ndërmjet procedurave të menaxhimit të krizave dhe instrumenteve të mbrojtjes. Kjo strukturë bashkëpunon ngushtë me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes (EDA) për të mundësuar zhvillimin e përbashkët të aftësive dhe ndërtimin e një arkitekture të qëndrueshme të mbrojtjes¹³. Familja e koncepteve ushtarake

¹² Bashkimi Evropian ka një strukturë të quajtur “Shtabi Ushtarak i Bashkimit Evropian” (European Union Military Staff – EUMS), i cili është një organ permanent brenda Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS).

¹³ European Union External Action, European Union Military Staff; Concepts and Capabilities Directorate,

të BE-së përfshin elementë që lidhen me: Forcat e Reagimit të Shpejtë, të zhvilluara mbi bazën e Konceptit të Shtetit Kuadër (Framework Nation Concept); Aspekte institucionale dhe funksionale si komandimi dhe kontrolli, logjistika, inteligjenca dhe gjenerimi i forcave. Janë dhe dy koncepte të reja të përcaktuara nga Kompani Strategjik: Kuadri Ushtarak për Sigurinë dhe Mbrojtjen, si dhe Kapaciteti i Vendosijs së Shpejtë i BE-së (EU Rapid Deployment Capacity) – një strukturë novatore që synon të ofrojë aftësi të besueshme dhe të menjëhershme për reagim ndaj krizave ndërkombëtare¹⁴.

b) Konceptet Operacionale të SHBA-së dhe vendeve të tjera

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë demonstruar një zhvillim të vazhdueshëm dhe inovativ të koncepteve operacionale. Ky zhvillim fillon me konceptin historik “**AirLand Battle**”¹⁵, i cili shënoi një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën e operimit të forcave të armatosura. Pas kësaj, u zhvilluan një sërë koncepteve të tjera, që kulmojnë me **Konceptin Capstone për Operacione të Përbashkëta (Capstone Concept for Joint Operations – CCJO)**¹⁶. Ky koncept, hartuar nga Kryetari i Shefave të Përbashkët, shërben si platformë për zbatimin e Strategjisë së Sigurisë dhe Strategjisë Ushtarake Kombëtare. Ai përcakton zhvillimin e forcave në një horizont prej 8-20 vjetësh, duke u bazuar në kërkesat strategjike dhe identifikimin e sfidave operacionale.

Konceptet operacionale identifikojnë sfidat dhe kapacitetet thelbësore të nevojshme, si dhe kushtet në të cilat këto kapacitete duhet të përdoren. Kjo krijon një kontekst operacional të domosdoshëm për zhvillimin dhe testimin e koncepteve mbështetëse (funksionale, lehtësuese, integruese, etj.), si dhe për ndërtimin e aftësive operacionale që shërbejnë për realizimin e objektivave ushtarakë dhe për kontributin në arritjen e objektivave strategjikë. Disa prej koncepteve më të fundit përfshijnë JOAC (Joint Operational Access Concept)¹⁷, MDO (Multi-Domain Operations), DMO (Distributed Maritime Operations), JADC2 (Joint All-Domain Command and Control) dhe EABO (Expeditionary

¹⁴ Janë të përcaktuara si koncepte në dokumentet strategjike. Nuk janë përfunduar plotësisht në aspektin praktik – po kalojnë në fazën e zbatimit, organizimit dhe testimit.

¹⁵ AirLandBattle (ALB) – a concept implemented starting 1982 to operationalize the “containment” strategy and defeat the Soviet Union through the use of synchronized air and ground operations, impetuous manoeuvre, deep battlefield operations and a tempo to defeat the numerically superior Soviet force, with emphasis on operational level military actions. James L. Cook, The Importance of Joint Concepts for the Planner.

¹⁶ Joint Vision-JV 2010 in 1996, Joint Operations Concepts – JOpsC in 2003, CCJO: Joint Force 2020 in 2012 and CCJO: 2030 in 2018.

¹⁷ Joint Operational Access Concept – joint concept for operational access, concept created and used by the US since 2012 to respond to the challenge/problem of operational access in an area where an anti-access and area denial (A2AD) strategy is used.

Advanced Base Operations)¹⁸, të cilat kontribuojnë në përsosjen e kuptimit operacional.

Pas miratimit të Strategjive Ushtarake Kombëtare të SHBA-së (2019, 2022), u vendos një qasje e re që përfshin konkurrencën nën prapësi të konfliktit dhe kundërshtimit të formave hibride të kërcënimit, si milicite e armatosura dhe dezinformimi. Si rezultat, u zhvillua Koncepti i Përbashkët i Luftës (JWC), duke institucionalizuar një qasje të re për ndërtimin e aftësive, të udhëhequr nga koncepte dhe të informuar nga kërcënimet.

Në përputhje me zhvillimet në NATO dhe SHBA, edhe Forcat e Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar e kanë bazuar zhvillimin e koncepteve të tyre në kontekstin strategjik, në analizën e skenarëve të mundshëm dhe në identifikimin e fushave me ndikim të thellë teknologjik dhe shoqëror. Kjo bazohet në vlerësimet e Tendencave Strategjike Globale (Global Strategic Trends – GST) dhe Mjedisit të Ardhshëm Operacional (Future Operating Environment – FOE)¹⁹.

Mbretëria e Bashkuar ka zhvilluar konceptin e operacioneve ushtarake duke e bazuar në vlerësimin strategjik dhe skenarët e ardhshëm. Koncepti i Forcës së Ardhshme (Future Force Concept – FFC)²⁰, prezantuar më 2017, ofron një vizion afatgjatë për integrimin e forcave në pesë fusha operationale. Aktualisht, zhvillimi i forcave të armatosura të Mbretërisë së Bashkuar mbështetet në Konceptin e Operacioneve të Integruara (Integrated Operating Concept – IOpC)²¹, të publikuar për herë të parë në vitin 2020. IOpC u konceptua për të adresuar sfidat që lindin në një kontekst strategjik ku kufijtë tradicionalë midis paqes dhe luftës, sektorit publik dhe privat, çështjeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë, janë gjithnjë e më të paqartë. Në këtë mjedis, i karakterizuar nga konkurrencë strategjike e vazhdueshme, fuqitë autoritare përdorin në mënyrë të integruar të gjitha instrumentet e ndikimit, përfshirë ato ushtarake dhe jo-ushtarake. IOpC propozon një qasje transformuese, sipas së cilës forcat e armatosura duhet të jenë të efektshme në konkurrencën strategjike nën nivelin e luftës së hapur, duke ruajtur aftësinë për të zhvilluar luftë të nivelit të plotë, karakteri i së cilës

¹⁸ The US Services operating concepts (SC): the US Army Multi-Domain Operations (MDO) (initiated in 2013, became doctrine in 2022); the US Navy Distributed Maritime Operations (DMO); the US Air Force Joint All-Domain Command & Control (JADC2); the US Marine Corps Expeditionary Advanced Base Operations (EABO).

¹⁹ UK Global Strategic Trends – GST, and UK Future Operating Environment – FOE, .

²⁰ Future Force Concept (FFC) është një koncept që i referohet vizionit dhe udhëzimeve strategjike për zhvillimin e forcave të armatosura të ardhshme, duke marrë parasysh ndryshimet teknologjike, taktikat, rreziqet e reja dhe nevojat e sigurisë ndërkombëtare.

²¹ Integrated Operating Concept, The Development Concepts and Doctrine Centre (2021).

mund të ndryshojë me shpejtësi. Ai thekson nevojën për integrim jo vetëm në nivelet strategjik dhe operacional, por edhe në atë taktik, duke zgjeruar karakterin e përbashkët të operacioneve.

Një element thelbësor i IOPC është koncepti i qasjes së integruar në nivel kombëtar (integrated national enterprise), që kërkon ndërthurjen efektive të instrumentit ushtarak me burimet dhe kapacitetet e tjera shtetërore dhe joshtetërore. Për realizimin e kësaj qasjeje është ndërtuar Korniza Operacionale e Integruar (Integrated Operating Framework – IOPF)²², e cila dallon mes aktiviteteve të “operimit” dhe “luftës”. Sipas IOPF, forcat e armatosura duhet të jenë të afta të adaptohen në nivele të ndryshme të gatishmërisë, duke përfshirë rezerva dhe komponentë të gatshme për mobilizim, të përshtatura për konflikt të hapur. Ky dallim përbën një risi në filozofinë ushtarake britanike dhe kërkon një mendësi të re lidhur me përdorimin e instrumentit ushtarak, zhvillimin e forcave dhe përshtatjen e doktrinës për të mundur një reagim të vendosur ndaj kundërshtarëve që nuk bëjnë dallim mes paqes dhe luftës.

Në këtë kontekst, koncepti i Integritit Shumë-Dimensional (Multi-Domain Integration – MDI)²³, një iniciativë eksperimentale britanike e vitit 2020 e bazuar në IOPC, synon integrimin e aftësive ushtarake me instrumentet e tjerë të fuqisë kombëtare në të gjitha fushat operacionale dhe në të gjitha nivelet e veprimit: strategjik, operacional dhe taktik. MDI paraqet një vizion për ndërtimin e një force të integruar deri në vitin 2030 dhe më tej, në kuadër të një bashkëpunimi të gjerë ndërinstitucional, me përfshirjen e sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ky koncept mbështetet në katër parime themelore: përparësia e informacionit, qëndrimi strategjik, përshtatja me mjedisin dhe krijimi/shfrytëzimi i sinergjive. Ai synon të mundësojë integrimin, sinkronizimin dhe drejtimin e operacioneve të përbashkëta përmes funksioneve kryesore operacionale (komanda dhe kontrolli – C2; inteligjenca; zjarri; informacioni; manovrimi dhe shtrirja; elasticiteti; mbështetja), me objektivin për të arritur efikasitet të plotë në të gjitha nivelet e veprimit dhe ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë. Përfshirja e koncepteve IOPC dhe MDI në doktrinën e re të mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar tregon se këto janë tashmë koncepte të konsoliduara, që ofrojnë një kuadër të qartë për të kuptuar dhe trajtuar konkurrencën strategjike të kohës sonë.

Në përfundim, mjedisi operacional bashkëkohor kërkon tejkalimin e qasjes tradicionale të operacioneve të përbashkëta, të kufizuara në nivelin operacional,

²² Fusion Doctrine was introduced in the National Security Capability Review (NSCR), 2015, p. 10. The NSCR describes the UK’s collective approach to national security and provides the rationale and purpose of Fusion Doctrine, but does not explain its practical application 2021.

²³ Joint Concept Note 1/20 – Multi-Domain Integration (2020).

duke e zëvendësuar atë me një qasje të re, shumë-nivelëshe dhe gjithëpërfshirëse, që mundëson integrim vertikal dhe horizontal – nga niveli strategjik deri në atë taktik.

Transformimi i Forcave tona të Armatosura dhe rëndësia e koncepteve operacionale

Transformimi i thelluar i forcave të armatosura përbën një proces të domosdoshëm për çdo shtet që synon të përballët në mënyrë efektive me sfidat e sigurisë bashkëkohore dhe të përbushë angazhimet ndërkombëtare. Në vendin tonë, ky transformim është intensifikuar pas anëtarësimit në NATO, duke ndjekur parime të ngjashme me ato të vendeve të tjera aleate dhe duke u mbështetur në dokumente strategjike afatgjata, që orientojnë zhvillimin e kapaciteteve operacionale, strukturave dhe koncepteve ushtarake.

Transformimi ushtarak nuk është një proces i izoluar, por përkundrazi është thellësisht i ndërvarur nga zhvillimet në nivel aleat dhe ndërkombëtar. Ai kërkon zhvillimin dhe integrimin e strategjive, koncepteve, doktrinave dhe aftësive të reja, të cilat synojnë përmirësimin e efikasitetit të forcave dhe rritjen e ndërveprueshmërisë në një mjedis operacional të ndërlikuar dhe të ndryshueshëm. Ky proces është veçanërisht i rëndësishëm për Shqipërinë si një vend anëtar i NATO-s, për shkak të detyrimit për të kontribuar në mënyrë efektive në operacionet kolektive të Aleancës, si dhe për përbushjen e funksioneve të saj kushtetuese në mbrojtje të sovranitetit dhe sigurisë kombëtare.

Përbushja e objektivave të transformimit ushtarak në Shqipëri duhet të mbështetet në një program kërkimor dhe eksperimentues të mirëstrukturuar, ku konceptet e zhvilluara të përketohen në kërkesa konkrete dhe plane zhvillimi të qarta. Këto kërkesa duhet të integrohen në procesin e planifikimit të mbrojtjes dhe të gjejnë shprehje në programet e pajisjes dhe trajnimit, në përputhje me nevojat aktuale dhe të ardhshme të Forcave të Armatosura. Konceptet që përdoren aktualisht nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë rrjedhin nga një sërë dokumentesh të hartuara në nivele të ndryshme drejtimi dhe në periudha të ndryshme kohore, dhe përfshijnë të gjithë spektrin e hierarkisë konceptuale: nga ato strategjike dhe ushtarake, në nivel kombëtar dhe shumëkombësh.

Në këtë kuadër, një vend të veçantë zënë konceptet operacionale, të cilat ndërtohen mbi bazën e dokumenteve të nivelit të lartë strategjik – si Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake dhe dokumentet e Planifikimit të Mbrojtjes – dhe kanë për qëllim përcaktimin e mënyrës së përdorimit praktik të forcave ushtarake në nivele të ndryshme: strategjik, operacional dhe taktik. Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, konceptet që duhet të zhvillohen dhe zbatohen në Forcat e Armatosura të Shqipërisë përfshijnë:

Konceptet strategjike, të cilat përshkruajnë mënyrat e përdorimit të forcës në përputhje me politikën e jashtme dhe të mbrojtjes së vendit.

Konceptet institucionale, që burojnë nga dokumente si Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe përshkruajnë rolin e forcave të armatosura në arkitekturën e sigurisë së shtetit.

Konceptet operacionale, të cilat përcaktojnë përdorimin e forcave në situata konkrete në terren, për realizimin e objektivave të përcaktuara nga nivelet e larta të drejtimit.

Konceptet funksionale, që përshkruajnë mënyrën e veprimit në fusha të specializuara si mbrojtja kibernetike, logjistika, operacionet e informacionit, etj.

Për Shqipërinë, e cila është në proces të vazhdueshëm të përshtatjes me realitetin e ri të sigurisë dhe kërkesave të Aleancës, është thelbësore të fokusohet në ndërtimin dhe përditësimin e koncepteve operacionale, duke reflektuar zhvillimet teknologjike, kërcënimet hibride dhe dinamikën e ndryshueshme gjeopolitike. Zbatimi i modelit britanik të ciklit të zhvillimit përbën një mundësi reale për planifikimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të forcave të armatosura, duke siguruar koherencë dhe vazhdimësi në lidhjen ndërmjet burimeve, programeve dhe zhvillimit të kapaciteteve përtej horizonteve tradicionale të planifikimit. Miratimi i një qasjeje të tillë ofron disa avantazhe të rëndësishme për kontekstin shqiptar:

- Lehtëson harmonizimin dhe sinkronizimin e proceseve të zhvillimit kombëtar me ato të shteteve të tjera anëtare të NATO-s dhe BE-së, duke forcuar ndërveprimin dhe ndarjen e praktikave më të mira.
- Krijon mundësi për vendosjen e programeve afatgjata të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit, të cilat nxisin kërkimin shkencor në fushën e mbrojtjes dhe përshtatin industrinë vendase me teknologjitë e reja.
- Zgjeron hapësirën kohore për zhvillimin, eksperimentimin dhe implementimin e koncepteve të reja operacionale dhe teknologjike, duke ndihmuar në integrimin e tyre efektiv në strukturat ekzistuese.
- Informon procesin e edukimit dhe trajnimit të brezave të ardhshëm të personelit ushtarak, në mënyrë që ata të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë për të përvetësuar risitë konceptuale dhe teknologjike.
- Zgjat horizontin e planifikimit deri në 30 vjet, duke përfshirë të gjithë ciklin jetësor të sistemeve të mëdha luftarake dhe duke mundësuar përcaktimin e qartë të përmirësimeve gjatë fazave të ndërmjetme të funksionimit të tyre.

Në një kontekst ku nevojat për modernizimin e Forcave të Armatosura dhe përshtatja me zhvillimet teknologjike globale janë të theksuara, zbatimi i këtij

modeli përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një arkitekture të qëndrueshme dhe të integruar të mbrojtjes. Kjo do të siguronte jo vetëm përshtatjen e kapaciteteve ekzistuese me sfidat e ardhshme, por edhe do të rrisë kapacitetin e vendimmarrjes strategjike mbi baza shkencore dhe të parashikueshme.

Transformimi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë bazohet në parime të qarta konceptuale dhe në përputhje me zhvillimet në kuadër të NATO-s dhe BE-së, duke synuar ndërtimin e një force të ndërveprueshme, moderne dhe të gatshme për të përballuar sfidat e sigurisë së shekullit XXI.

Përfundime

Analiza e zhvilluar në këtë material nxjerr në pah se konceptet operacionale janë elementë themelorë në arkitekturën strategjike dhe operacionale të Forcave të Armatosura. Ato përbëjnë urën lidhëse ndërmjet vizionit të nivelit të lartë strategjik dhe veprimit konkret në terren, duke orientuar transformimin ushtarak, forcimin e ndërveprueshmërisë shumëkombëshe dhe rritjen e përgjegjësisë në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare.

Në një mjedis global të karakterizuar nga pasiguria, kompleksiteti dhe evolucioni teknologjik, transformimi efektiv i forcave të armatosura kërkon një bazë konceptuale të qëndrueshme, të përshtatshme dhe të harmonizuar me doktrinat dhe praktikën e partnerëve strategjikë. Përvoja e NATO-s, e BE-së dhe e shteteve të zhvilluara tregon se ndërtimi i kapaciteteve konceptuale është një faktor vendimtar për modernizimin e qëndrueshëm të instrumentit ushtarak.

Zhvillimi dhe institucionalizimi i një qasjeje të integruar konceptuale përfaqëson një nevojë strategjike për vendin tonë, në funksion të ndërtimit të një force të armatosur të aftë për të përballuar sfidat e shekullit XXI.

Për këtë arsye, rekomandohen veprimet konkrete si më poshtë:

1. **Adoptimi i një modeli të integruar planifikimi afatgjatë**, të ngjashëm me atë britanik, i cili siguron vazhdimësi në lidhjen ndërmjet planeve strategjike, burimeve financiare, teknologjive të reja dhe edukimit të personelit ushtarak.
1. **Forcimi i bashkëpunimit konceptual me NATO-n dhe BE-në**, përmes pjesëmarrjes aktive në proceset e zhvillimit të koncepteve shumëkombëshe dhe integritetit të standardeve të tyre në sistemin kombëtar.
2. **Përshtatja e koncepteve me sfidat e reja**, veçanërisht në fushat e operacioneve të përbashkëta, mbrojtjes kibernetike dhe kërcënimeve hibride, me qëllim sigurimin e një force të përgatitur për konfliktet e së ardhmes.

3. **Zhvillimi i një cikli të strukturuar kërkimor dhe eksperimentues**, i cili do të mbështesë vendimmarrjen strategjike mbi baza empirike dhe do të përshpejtojë integrimin e risive në praktikën ushtarake.
4. **Zhvillimi i koncepteve të reja operationale që adresojnë sfidat bashkëkohore**, veçanërisht në fushat e operationeve të përbashkëta, mbrojtjes kibernetike, operationeve hibride dhe menaxhimit të informacionit operational.
5. **Adoptimi i një modeli afatgjatë zhvillimi të forcave** (force development continuum), me horizont planifikimi deri në 30 vjet, është thelbësor për të mbuluar ciklin jetësor të platformave të mëdha ushtarake dhe për të orientuar investimet në teknologji të reja dhe përmirësime të qëndrueshme.
6. **Rishikimi dhe përmirësimi i programeve të edukimit ushtarak dhe trajnimit të personelit**, në mënyrë që brezat e rinj të oficerëve dhe specialistëve të pajisen me njohuritë konceptuale, kompetencat analitike dhe fleksibilitetin për të përballuar një mjedis operational në transformim të përhershëm.

Në përfundim, ndërtimi i një kapaciteti të qëndrueshëm konceptual nuk është vetëm një domosdoshmëri teknike, por një kërkesë strategjike për Shqipërinë. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, të harmonizuar dhe afatgjatë mund të ndërtohet një instrument ushtarak modern, fleksibël dhe i besueshëm, në funksion të interesave kombëtare dhe angazhimeve shumëkombëshe të vendit në sistemin ndërkombëtar të sigurisë. Zhvillimi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë përmes koncepteve operationale përfaqëson një rrugë strategjike drejt forcimit të kapaciteteve mbrojtëse dhe rritjes së rolit të vendit në sistemin ndërkombëtar të sigurisë. Këto koncepte nuk janë thjesht dokumente doktrinare, por instrumente thelbësore për të orientuar transformimin në përputhje me zhvillimet gjeopolitike, teknologjike dhe organizative.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. ACT/Allied Command Transformation, Centres of Excellence, <https://www.act.nato.int/about/centres-of-excellence/>, retrieved on 28 September 2023.
2. Allied Command Transformation, NATO Warfighting Concept, <https://www.act.nato.int/our-work/nato-warfighting-capstone-concept/>, retrieved on 2 October 2023.
3. Strategjia Ushtarake e RSH (2024).
4. Manual i Zhvillimit të Koncepteve Ushtarake në FA, 2009.
5. CJCSI 3030.01A – Implementing Joint Force Development and Design (2022), Joint Staff. USA: Washington.
6. NATO Standardization Office (NSO) - *AAP-06 NATO Glossary of Terms and Definitions*.

7. NATO ACT – Concept Development and Experimentation Handbook - 2019 OPEX Fact Sheets.
8. Cook, J.L. (2020). The Importance of Joint Concepts for the Planner. Joint Force Quarterly 99, U.S. Naval War College, retrieved on 23 September 2023.
9. Defence in a Competitive Age (2021), <https://www.gov.uk/government/publications/defence-in-a-competitive-age>, retrieved on 21 September 2023.
10. Dryad Global (2021). No Ordinary Boats: Cracking The Code On China's Spratly Maritime Militias, on 21 September 2023.
11. European Union External Action, European Union Military Staff; Concepts and Capabilities Directorate, https://www.eeas.europa.eu/eeas/european-union-military-staff-concepts-and-capabilities-directorate_en#top, retrieved on 28 September 2023.
12. Integrated Operating Concept (2021). The Development Concepts and Doctrine Centre. UK: SWINDON.
13. Joint Concept Note 1/20 – Multi-Domain Integration (2020). The Development, Concepts and Doctrine Centre. UK.
14. Joint Doctrine Publication 0-01 – UK Defence Doctrine (2022).
15. NATO CD&E Handbook – A Concept Developer's Toolbox (2021), CDE-Handbook_A_Concept_Developers_Toolbox-1.pdf, retrieved on 23 September 2023.
16. NWCC – NATO Warfighting Capstone Concept (2021).
17. Pikner, I. (2015). Concept Development&Experimentation As Tool For Capability Development. International conference KNOWLEDGE BASED ORGANIZATION, <https://www.researchgate.net/publication/284813252>, retrieved on 23 September 2023.
18. Pikner, I., Zuna, P., Spisak, J., Galatik, V. (2013). Military Operating Concepts Development.
19. Schmitt, J.F. (2002). A Practical Guide for Developing and Writing Military Concepts. Defense Adaptive Red Team: Working Paper.
20. Tammen, J.W. (2020). NATO's Warfighting Capstone Concept: anticipating the changing character of war, 9 July 2020, NATO Review, <https://www.nato.int/docu/review/articles/2021/07/09/natoswarfighting-capstone-concept-anticipating-the-changing-character-of-war/index.html>, retrieved on 23 September 2023.
21. UK Global Strategic Trends/GST, <https://www.gov.uk/government/publications/global-strategic-trends>, retrieved on 12 September 2023.
22. Freedman, Lawrence – *Strategy: A History*, Oxford University Press.
23. Gray, Colin S. – *Modern Strategy*, Oxford University Press.
24. Murray, Williamson & Millett, Allan R. – *Military Innovation in the Interwar Period*, Cambridge University Press.

ROLI I SISTEMEVE TË NDËRLIDHJES DHE INFORMACIONIT NË MODERNIZIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA DHE GARANTIMIN E SIGURISË KOMBËTARE DHE RAJONALE

Kryekapter Gëzim MATAJ

Regjimenti i Operacioneve Speciale

Trajtesë e shkurtuar

Ky punim analizon konceptet dhe implementimin e sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ai ofron një pasqyrë mbi rëndësinë strategjike të këtyre sistemeve në modernizimin e operacioneve ushtarake, duke theksuar përfitimet në rritjen e ndërveprueshmërisë, komandës dhe kontrollit, si dhe integrimin e teknologjisë së avancuar në operacionet e mbrojtjes.

Gjithashtu, materiali eksploron sfidat dhe mundësitë që lidhen me zbatimin e këtyre sistemeve në kushtet aktuale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke sugjeruar një metodë për zhvillimin e mëtejshëm.

Fjalët kyçe: C4ISR, C5ISR, C6ISR, NATO, teknologjia ushtarake, modernizimi i mbrojtjes, komandë dhe kontroll, ndërveprueshmëri.

Hyrje

Në një kohë kur siguria kombëtare është vazhdimisht e sfiduar nga zhvillimet globale, Forcat e Armatosura të Shqipërisë (FARSH) janë të angazhuara në përmirësimin e kapaciteteve të tyre operacionale dhe efikasitetit të vendimmarrjes.

Me evolucionin e kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare, bëhet gjithnjë e më e domosdoshme modernizimi i sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR. Këto sisteme janë thelbësore për përmirësimin e koordinimit operacional, sigurimin e një përgjigjeje më të shpejtë dhe rritjen e ndërveprimit me aleatët në kuadër të NATO-s, duke ndihmuar në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Shqipërisë.

C4ISR përfaqëson një “sistem nervor” për operacionet moderne ushtarake, duke siguruar vendimmarrje të shpejtë dhe efikase, komunikim të sigurt dhe integrim të inteligjencës për të menaxhuar më mirë mjedisin operativ. C5ISR zgjeron këtë koncept duke përfshirë sistemet luftarake, ndërsa C6ISR shton komponentin kibernetik, duke garantuar një siguri më të madhe në fushën e operacioneve digjitale. Megjithatë, aktualisht, FARSH nuk kanë implementuar akoma një arkitekturë të plotë C4ISR, C5ISR apo C6ISR. Ndërsa sfidat e sigurisë, përfshirë kërcënimet kibernetike dhe ndryshimet teknologjike globale, kërkojnë rritjen e kapaciteteve të ndërlidhjes dhe informacionit, Shqipëria duhet të fokusohet në modernizimin gradual të këtyre sistemeve.

Si një anëtar i NATO-s, Shqipëria synon të avancojë kapacitetet e saj për të ruajtur gatishmërinë operacionale dhe për të kontribuar në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Modernizimi i infrastrukturës së ndërlidhjes dhe informacionit është një hap i rëndësishëm drejt mundësisë të një sistemi të integruar C4ISR, C5ISR dhe C6ISR në të ardhmen.

Ky punim analizon rëndësinë e zhvillimit të sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, duke shqyrtuar mundësitë dhe sfidat që lidhen me këtë proces dhe duke vlerësuar ndikimin e tij në forcimin e mbrojtjes kombëtare dhe aftësitë operacionale të FARSH.

Sistemet C4ISR, C5ISR dhe C6ISR në operacionet e ndryshme ushtarake

Në epokën moderne të luftës, ku avancimet teknologjike vazhdimisht ripërcaktojnë teatrot e luftimit, posedimi i *një arkitekture të integruar dhe të avancuar të ndërlidhjes dhe informacionit* nuk është vetëm një avantazh strategjik, por është një nevojë e domosdoshme. Sistemet C4ISR, C5ISR dhe C6ISR janë bërë komponentë të pazëvendësueshëm për forcat e armatosura moderne. Këto sisteme mundësojnë koordinimin, komandimin dhe kontrollin

e operacioneve ushtarake, duke përmirësuar procesin e vendimmarrjes, reduktuar kohën e reagimit dhe duke rritur efikasitetin operativ. Roli i këtyre sistemeve shtrihet në fusha të tilla si: mbledhja e të dhënave të zbulimit, mbikëqyrja, komunikimi, mbrojtja kibernetike dhe komandimi dhe kontrolli (C2). Integrimi i këtyre sistemeve lejon shkëmbimin e të dhënave në kohë reale, një faktor thelbësor gjatë operacioneve ushtarake me rrezik të lartë. Në kontekstin shqiptar, si anëtar i NATO-s, krijimi i këtyre sistemeve është një hap i domosdoshëm për të përmbushur standardet e aleancës dhe për të siguruar që forcat e armatosura shqiptare mund të veprojnë në mënyrë të pandërprerë me forcat aleate në misione të përbashkëta, operacione paqeje dhe si përgjigje ndaj krizave rajonale.

Një arkitekturë dhe sistem i modernizuar dhe i sigurt C4ISR, C5ISR dhe C6ISR do të ofrojë mbrojtje gjithashtu për infrastrukturën kombëtare dhe asetet e mbrojtjes të Shqipërisë, duke siguruar gatishmërinë e saj kundër kërcënimeve konvencionale dhe jokonvencionale. Në një kohë kur sulmet kibernetike, kërcënimet hibride dhe aktorët jositetërorë janë gjithnjë e më të pranishëm, strategjia e sigurisë kombëtare të Shqipërisë duhet të përshtatet në mënyrë të tillë që t'i paraprijë dhe të përballët me sfidat e reja me efikasitet.




Figura 1. Arkitektura e sistemit C4ISR

Elementet kryesore të sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR janë:

Komandimi dhe Kontrolli (C2) - Suksesi i çdo operacioni ushtarak qëndron tek aftësia për të komanduar dhe kontrolluar forcat në mënyrë efikase. Sistemet C2 mundësojnë komunikimin në kohë reale të vendimeve strategjike, operative dhe taktike nëpërmjet niveleve të ndryshme të komandës. Këto sisteme sigurojnë që udhëheqësit të mund të marrin vendime të qarta dhe të sakta, bazuar në informacione të konfirmuara dhe të përditësuara. Sistemet C4ISR i ofrojnë komandantëve mundësinë të realizojnë operacione me një nivel saktësie të paimagjinueshëm. Ky aftësi është veçanërisht e rëndësishme në operacionet e përbashkëta, të cilat përfshijnë disa komponentë (tokësore, ajror, detar dhe kibernetik), ku shpejtësia e vendimmarrjes mund të përcaktojë suksesin apo dështimin e një misioni.

Komunikimi dhe Ndërlidhja - Komunikimi në operacionet ushtarake nuk është më i kufizuar vetëm në komunikimet radio bazike. Sistemet moderne C4ISR ofrojnë teknologji komunikimi me bandë të lartë që mbështesin transmetimin e shpejtë dhe të sigurt të sasisë së madhe të të dhënave, përfshirë video, të dhëna nga aparatura dhe pajisje të ndryshme të komunikimit. Kjo siguron që qendrat e komandës dhe njësitë e dislokuara në terren të qëndrojnë të lidhura në kohë reale, duke mundësuar operacione të koordinuara edhe në mjedise të rrezikshme. Gjithashtu, kjo mundëson ndërveprimin midis njësive ushtarake të ndryshme, shteteve dhe organizatave aleate.

Inteligjenca, Mbikëqyrja dhe Vëzhgimi (ISR) - Sistemet ISR ofrojnë informacion të çmuar për mjedisin operativ, lëvizjet e kundërshtarit dhe kërcënimet e mundshme. Këto sisteme mbështeten në një gamë teknologjish, përfshirë satelitët, mjete ajrore pa pilot (UAV), sensorë në tokë dhe inteligjencë njerëzore. Integrimi i këtyre sistemeve siguron që ata që marrin vendime të kenë një kuptim të plotë dhe në kohë reale të terrenit të betejës. Të dhënat e grumbulluara të zbulimit informojnë planifikimin operativ dhe përmirësojnë vetëdijen situacionale, duke i mundësuar forcave të parashikojnë veprimet e armikut dhe të kundërveprojnë në mënyrë efektive.

Lufta kibernetike (C6ISR) - Me rritjen e kërcënimeve kibernetike, forcat ushtarake duhet të implementojnë sisteme të fuqishme C6ISR për të mbrojtur rrjetet dhe sistemet e tyre. Mbrojtja kibernetike është një komponent thelbësor i luftës moderne, dhe C6ISR përqendrohet në mbrojtjen e komunikimeve ushtarake, sistemeve të armëve dhe informacionit nga sulmet kibernetike. Kjo përfshin zbulimin, parandalimin dhe zvogëlimin e kërcënimeve kibernetike, si dhe aftësinë për të realizuar operacione kibernetike ofensive. Pasi që sistemet ushtarake janë të ndjeshme ndaj sulmeve kibernetike, C6ISR është një pjesë e domosdoshme e arkitekturës mbrojtëse për të siguruar funksionimin dhe sigurinë e sistemeve.

Përfitimet e integritetit të sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR

Një nga përfitimet kryesore të implementimit të sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR është aftësia e përmirësuar për të operuar në bashkëpunim me forcat e NATO-s dhe partnerët ndërkombëtarë. Këto sisteme sigurojnë që të dhënat, inteligjenca dhe planet operationale të mund të shpërndahen shpejt dhe në mënyrë të sigurt, duke mundësuar zhvillimin e operacioneve të përbashkëta përtej kufijve. Ndërveprimi që krijohet nga këto sisteme është jetik për realizimin e misioneve shumëkombëshe, qoftë në operacione në mbështetje të paqes, humanitare apo luftarake.

Përmirësimi i gatishmërisë ushtarake dhe përgjigjes ndaj kërcënimeve.

Sistemet C4ISR, C5ISR dhe C6ISR ofrojnë forcat ushtarake mjetet për të reaguar shpejt ndaj një gamë të gjerë kërcënimesh, nga sulmet ushtarake konvencionale deri te kërcënimet e reja si lufta kibernetike dhe konflikti hibrid. Aftësia për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë inteligjencën në kohë reale mundëson vendimmarrje pro aktive, duke mundësuar që forcat të mbeten të lëvizshme në mjedise operationale që ndryshojnë shpejt. Gjithashtu, këto sisteme mbështesin shpërndarjen e shpejtë të forcave dhe koordinimin gjatë krizave, duke siguruar një reagim të shpejtë dhe efektiv.

Siguria më e madhe e komunikimeve dhe informacionit të ndjeshëm.

Sigurimi i kanaleve të komunikimit dhe të dhënave të ndjeshme është jetik për të parandaluar që forcat kundërshtarë të fitojnë avantazh. Sistemet C4ISR përdorin kodim, protokolle të sigurta komunikimi dhe masa të dubluara për të siguruar që komunikimet ushtarake të mbeten private dhe të sigurta. Në një kohë kur lufta elektronike është një kërcënim i madh, aftësia për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm është thelbësore për të ruajtur sigurinë operationale dhe për të parandaluar kompromisin e sistemeve.

Aftësi të avancuara të menaxhimit të krizave dhe operationeve. Integrimi i këtyre sistemeve përmirëson aftësinë e forcave ushtarake për të menaxhuar operatione të komplikua dhe shumëdimensionale, veçanërisht gjatë krizave. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për përgjigje ndaj katastrofave, kundër-terrorizëm apo operatione paqeje, sistemet C4ISR ndihmojnë komandantët të vlerësojnë situatën, të alokojnë burimet në mënyrë efikase dhe të koordinojnë përpjekjet ndërmjet agjencive dhe organizatave të ndryshme. Për më tepër, këto sisteme ofrojnë një kornizë për planifikimin afatgjatë strategjik, duke mundësuar që forcat ushtarake të ruajnë efikasitetin operativ edhe përballë konflikteve të zgjatura.

Roli i C4ISR, C5ISR dhe C6ISR në kontekstin e kërcënimeve bashkëkohore.

Në konflikte bashkëkohore, teknologjitë e avancuara janë thelbësore për të siguruar që forcat ushtarake të jenë në gjendje të reagojnë shpejt dhe me efikasitet ndaj kërcënimeve të ndryshme dhe të zhvillojnë operatione të suksesshme në një mjedis gjithnjë e më kompleks dhe të ndërvarur. C4ISR, C5ISR dhe C6ISR janë sisteme që luajnë një rol kritik në menaxhimin e informacionit dhe koordinimin e operationeve ushtarake, duke mundësuar një integrim të plotë të të dhënave, komunikimit dhe kontrollit në nivele të ndryshme.

Sistemi C4ISR (Komandë, Kontroll, Komunikim, Inteligjencë, Mbikëqyrje dhe Vëzhgim)

Është baza e çdo operacioni ushtarak në kohën moderne. Ai ofron mundësinë për të koordinuar dhe kontrolluar operatione të ndryshme në kohë reale, duke i mundësuar komandantëve të marrin vendime të informuara dhe të sakta. Roli

i C4ISR përfshin:

Integrimin e forcave dhe operacioneve - C4ISR mundëson bashkëpunimin dhe ndërveprimin midis njësive të ndryshme të forcave të armatosura, duke siguruar që çdo njësi të funksionojë në mënyrë të sinkronizuar. Ky integrim është thelbësor për të realizuar operacione të shpejta dhe efikase.

Vendimarrjen në kohë reale - Ky sistem mundëson komandantëve të marrin vendime në kohë reale bazuar në të dhëna të sakta dhe të përditësuara nga terreni. Informacionet e mbledhura nga inteligjenca, sensorët dhe satelitët mundësojnë reagime të menjëhershme ndaj kërcënimeve të mundshme.

Përmirësimin e inteligjencës dhe zbulimit - C4ISR është esencial për mbledhjen dhe analizimin e informacionit nga burime të ndryshme, duke përfshirë satelitët, dronët dhe sistemet e vëzhgimit. Kjo ndihmon në zbulimin dhe monitorimin e veprimeve të armikut dhe menaxhimin e situatës në terren.

Koordinimin me aleatët dhe partnerët ndërkombëtarë - Përdorimi i C4ISR lejon ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacionit me partnerët dhe aleatët ndërkombëtarë, duke krijuar mundësinë për operacione të përbashkëta dhe të sinkronizuara.

Sistemi C5ISR (Komandë, Kontroll, Komunikim, Inteligjencë, Mbikëqyrje, Vëzhgim dhe Lufta Kibernetike)



Figura 2. Arkitektura e sistemit C5ISR

Sistemi C5ISR është një zhvillim më i avancuar i C4ISR, i cili përfshin gjithashtu mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike dhe integrimin e sistemeve të sigurisë që mbrojnë infrastrukturën dhe informacionin e ndjeshëm. Roli i C5ISR në luftën moderne është:

Mbrojtja kibernetike - C5ISR është thelbësor për mbrojtjen e sistemeve dhe rrjeteve ushtarake nga sulmet kibernetike, të cilat mund të dëmtojnë rëndë operacionet luftarake. Mbrojtja e infrastrukturës kritike, si sistemet e komandës dhe kontrollit, është një pjesë kyçe e C5ISR, duke siguruar që informacionet e ndjeshme të mbeten të paprekura dhe të pasiguruara.

Menaxhimi i informacionit dhe të dhënave të shumta - C5ISR mundëson mbledhjen dhe analizën e të dhënave të shumta nga burime të ndryshme, përfshirë sensorët, satelitët dhe dronët. Kjo mundëson marrjen e vendimeve të sakta dhe të shpejta në kushte komplekse dhe dinamike.

Integrimi i sistemeve të përshtatura për luftë të përbashkët - C5ISR mundëson bashkërendimin e operacioneve ushtarake, duke integruar mundësitë e luftës kibernetike, inteligjencës dhe mbikëqyrjes në një sistem të vetëm dhe të sinkronizuar.

Sistemi C6ISR (Komandë, Kontroll, Komunikim, Inteligjencë, Mbikëqyrje, Vëzhgim dhe Lufta Kibernetike e Përsosur)

Përfshin përdorimin e sistemeve më të avancuara teknologjike për të mbrojtur dhe mundësuar operacione më të sofistikuar në luftën moderne. Roli i C6ISR përfshin:

Mbrojtja e sistemeve dhe infrastruktura të avancuara - C6ISR shkon përtej mbrojtjes së informacionit të ndjeshëm dhe shtrihet në mbrojtjen e të gjithë infrastrukturës ushtarakë nga sulmet kibernetike dhe shfrytëzimin e teknologjive për të parandaluar çdo lloj ndërprerjeje të mundshme të operacioneve. Kjo është e rëndësishme për të ruajtur integritetin dhe vazhdimësinë e operacioneve gjatë luftës.



Figura 3. Arkitektura e sistemit C6ISR

Reagimi i shpejtë ndaj kërcënimeve - C6ISR ndihmon forcat ushtarake të reagojnë më shpejt dhe me efikasitet ndaj kërcënimeve të papritura, si sulmet kibernetike, duke përdorur teknologji të avancuar për të identifikuar dhe neutralizuar kërcënimet në kohë reale.

Përmirësimi i inteligjencës dhe mbikëqyrjes për operacione të sofistikuar - Sistemet C6ISR ofrojnë mundësi për një menaxhim të avancuar të

informacionit dhe mbikëqyrjen për operacione luftarake komplekse, duke mundësuar reagime të menjëhershme dhe të sinkronizuara në një mjedis gjithnjë e më të sofistikuar.

Më poshtë kam paraqitur një tabelë përmbledhëse, e cila krahason sistemet e ndryshme të Qendrës së Komandim-Kontrollit:

Sistemi	Komponentët	Aplikacionet	Rëndësia në sigurinë elektronike	Novacionet dhe përparimet
C2	• Komandim • Kontrolli	- Operacionet ushtarake - Koordinimi i forcave	- Baza për sisteme me të avancuara - Thelbësore për çdo operacion sigurie	Bërthama e të gjitha sistemeve më të avancuara
C4ISR	•Komanda •Kontrolli •Komunikimet •Kompjuterët •Inteligjenca •Mbikëqyrja •Zbulimi	- Operacionet luftarake - Misionet e inteligjencës - Operacionet e paqes	- Zbulimi i ndërhyrjeve të paautorizuara - Sistemet e kontrollit të aksesit - Siguria e infrastrukturës kritike dhe mbrojtja kibernetike	Zgjatja C2 me aftësi të zgjeruara
C5ISR	•Komandim •Kontrolli •Komunikimet •Kompjuterët •Inteligjenca •Mbikëqyrja •Zbulimi •Mbrojtja kibernetike	- Operacionet e avancuara ushtarake - Misionet e inteligjencës kibernetike	Rrit sigurimin e sigurisë kibernetike në sistemet e kontrollit të aksesit dhe identifikimin e ndërhyrjeve të paautorizuara.	Optimizimi i mbrojtjes kibernetike për të garantuar qëndrueshmëri dhe reagim efikas ndaj kërcënimeve të mundshme

C6ISR	•Komandim •Kontroll •Komunikimet •Kompjuterët •Inteligjenca •Mbikëqyrja •Zbulimi •Mbrojtja kibernetike •Sistemet luftarake	- Operacionet luftarake ajrore, detare dhe tokësore	- Sistemet autonome të mbikëqyrjes - Sistemet e reagimit të shpejtë - Sistemet e mbrojtjes së perimetrit	Integrimi i sistemeve luftarake dhe shfrytëzimi i mundësive për zhvillimin e inovacioneve në inteligjencën artificiale dhe sigurinë kibernetike.
--------------	--	---	--	--

Përfundime

Sistemet C4ISR, C5ISR dhe C6ISR janë thelbësore për zhvillimin e operacioneve ushtarake të kohës moderne, pasi ato ofrojnë mundësinë për të siguruar një udhëheqje të integruar dhe efikase, si dhe koordinim të avancuar të forcave ushtarake gjatë operacioneve luftarake. Këto sisteme luajnë një rol kyç në forcimin e kapaciteteve të reagimit të Forcës së Armatosur të Republikës së Shqipërisë, duke mundësuar një menaxhim të përmirësuar të situatave të ndryshme, në kushte komplekse dhe të pasigurta.

Integrimi i teknologjive të avancuara dhe përdorimi i sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR janë të domosdoshme për të garantuar një qëndrueshmëri dhe efikasitet të operacioneve, duke mundësuar reagimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm ndaj kërcënimeve që paraqiten në fushën e betejës.

C4ISR siguron një komandë dhe kontroll të integruar, i cili është i domosdoshëm për një udhëheqje të centralizuar dhe për një koordinim të ngushtë midis njësive luftarake dhe komandës. Ky sistem është gjithashtu thelbësor për të mundësuar reagimin në kohë reale ndaj ndryshimeve në situatën operacionale, duke ruajtur në të njëjtën kohë informacionin e ndjeshëm dhe duke siguruar vazhdimësinë e operacioneve në çdo fazë të misionit.

Në kontekstin e zhvillimeve të fundit në fushën e sigurisë kibernetike, C5ISR është i nevojshëm për të siguruar që mbrojtja kibernetike të integrohet si pjesë e strategjisë ushtarake. Kjo është jetike për mbrojtjen e infrastrukturës dhe të dhënave kritike nga kërcënimet kibernetike, të cilat mund të cenojnë sigurinë kombëtare dhe mundësitë operacionale. Sistemet e integruara të mbrojtjes kibernetike në C5ISR mundësojnë monitorim dhe parandalim të ndërhyrjeve të paautorizuara, duke siguruar që informacionet ushtarake dhe komunikimet të mbeten të paprekura nga çdo kërcënim i mundshëm.

Ndërsa, C6ISR, duke përfshirë përdorimin e inteligjencës artificiale dhe të dhënave analitike, rrit mundësinë për një menaxhim më të avancuar të operacioneve luftarake dhe për përmirësimin e vendimmarrjes në kohë reale. Kjo është e domosdoshme për të garantuar që Forca e Armatosur e Republikës së Shqipërisë të mbetet konkurruese dhe e gatshme për të përballuar sfidat e ndryshme që mund të lindin nga natyra dhe karakteristikat e ndryshme të luftës moderne.

Në përfundim, implementimi dhe modernizimi i sistemeve C4ISR, C5ISR dhe C6ISR në Forcën e Armatosur të Republikës së Shqipërisë është një hap kyç për të siguruar reagime të shpejta, efektive dhe të qëndrueshme ndaj kërcënimeve të natyrës konvencionale dhe kibernetike, duke mundësuar një forcë të armatosur më të përgatitur dhe më të aftë për të ruajtur sigurinë kombëtare dhe stabilitetin në një mjedis të sigurisë gjithnjë e më kompleks. Këto sisteme sigurojnë që Shqipëria të mbetet në hap me zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë dhe të mbrojë interesat e saj kombëtare me efikasitet dhe siguri.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. FM 6-0 (Mission Command: Command and Control of Army Forces) – Manual fushor i Ushtrisë Amerikane mbi Komandim - Kontrollin (C2).
2. Joint Publication 3-0: (Joint Operations) – Dokument zyrtar i Departamentit të Mbrojtjes së SHBA mbi operacionet e përbashkëta.
3. JP 2-01 (Joint and National Intelligence Support to Military Operations) – Udhëzim mbi përdorimin e inteligjencës në operacione.
4. Jane's Defence – Një nga burimet më autoritative mbi teknologjinë dhe sistemet e mbrojtjes.
5. RAND Corporation Reports - Mbi teknologjitë e luftës moderne dhe integrimin e ISR dhe C2.
6. Defense Technical Information Center (DTIC) – Arkiv me dokumente teknike mbi C4ISR.

RUBRIKA E TRETË

ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT NË FUSHËN E MBROJTJES

ROBOTIKA NË USHTRI

Kolonel Msc. David RROKU
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar

Teknologjia po transformon mënyrën se si njerëzit dhe makinat bashkëpunojnë, duke revolucionarizuar operacionet ushtarake përmes robotikës. Përparimet në këtë fushë kanë sjellë një epokë të re të efikasitetit, saktësisë dhe përshtatshmërisë, si në fushëbetëje ashtu edhe jashtë saj.

Robotët ushtarakë po hulumtohen si mjete të mundshme për luftërat e së ardhmes, duke ofruar mundësi të reja për reduktimin e rrezikut për personelin njerëzor. Këta robotë—të pavarur apo të telekomanduar—janë të destinuar posaçërisht për aplikime ushtarake, duke kontribuar në shpëtimin e jetëve dhe optimizimin e operacioneve.

Disa besojnë se luftërat moderne do të zhvillohen nga sisteme të automatizuara të armëve, duke e bërë robotikën një element kyç në strategjitë mbrojtëse, operacionet luftarake dhe logjistikën ushtarake. Me mjete autonome, robotë humanoidë dhe pajisje të telekomanduara, kjo fushë po zhvillohet me ritme të shpejta, duke transformuar mënyrën e funksionimit të ushtrisë.

Fjalët kyçe: ushtri, mbrojtje, robotë, robotikë, ushtar robotik, luftë, robot lufte, llojet e robotëve ushtarakë.

Hyrje

Robotika është një nga fushat më emocionuese dhe dinamike të teknologjisë sot. Ajo përfshin projektimin dhe ndërtimin e makinave inteligjente, të njohura si robotë, të cilët janë pajisje mekanike autonome të afta për të perceptuar mjedisin e tyre, për të analizuar të dhëna, për të marrë vendime dhe për të kryer veprime në botën reale, ngjashëm me njerëzit. Interesi për robotikën është rritur ndjeshëm vitet e fundit, ndërsa robotët po integrohen gjithnjë e më shumë në jetën tonë. Ky zhvillim është rezultat i përparimeve teknologjike që kanë bërë robotët më inteligjentë, më kompaktë, më ekonomikë, më të shpejtë, më fleksibël dhe më autonomë se kurrë më parë.

Sot, robotët autonomë janë në gjendje të kuptojnë, arsyetojnë, planifikojnë, veprojnë, lëvizin, komunikojnë dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Ky revolucion teknologjik po ndryshon mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë me makinat, duke prekur shumë aspekte të jetës¹. Robotika, edhe pse një fushë relativisht e re, ka synime ambicioze dhe po prodhon një gamë të gjerë pajisjesh, përfshirë dronët ushtarakë.² Fillimisht të destinuar për mjedise industriale për të zëvendësuar njerëzit në detyra të lodhshme dhe të përsëritura, sot robotët ndihmojnë qeniet njerëzore në një gamë të gjerë aplikimesh, duke përfshirë mjekësinë, kujdesin për të moshuarit, rehabilitimin, arsimin, bujqësinë, pajisjet shtëpiake, kërkimin dhe shpëtimin, industrinë e makinave, mbrojtjen e më gjerë. Robotët ushtarakë po zhvillohen jo vetëm në tokë, por edhe në qiell, det dhe hapësirë, ku përdoren për mirëmbajtje, inspektim dhe optimizimin e operacioneve.

Njohja me robotët: Çfarë janë dhe si funksionojnë?

Termi “robot” u krijua për herë të parë në vitin 1920 nga dramaturgu çek Karel Čapek në dramën e tij “RUR (Robotët Universalë të Rossumit)”³, i cili përshkruante një të ardhme ku makinat humanoide të quajtura «robotë» përdoreheshin për punë. Ndërsa koncepti i “robotikës” u popullarizua nga Isaac Asimov në vitin 1942, i cili formuloi tre ligje për të udhëhequr sjelljen e robotëve dhe më vonë shtoi një ligj shtesë:

- Ligji zero⁴: Një robot nuk mund të dëmtojë njerëzimin ose nëpërmjet

¹ S. Brezgov, “*Robots in education: Is the educational revolution just around the corner?*” January 2020, <https://scholarlyoa.com/robots-in-education-is-the-educational-revolution-just-around-the-corner/>

² M. N. O. Sadiku, U. C. Chukwu. A. AjayiMajebi, and S. M. Musa, “*A primer on robotics*” International Journal of Trend in Scientific Research and Development, vol. 6, no. 7, November-December 2022, pp. 614-621.

³ Karel Čapek, R.U.R. | Goodreads/ First published January 1, 1920.

⁴ “Human-robot interaction,” Wikipedia, the free encyclopedia https://en.wikipedia.org/wiki/Human-robot_interaction/

mosveprimit, të lejojë njerëzimin të dëmtojë.

- Ligji 1: Një robot nuk duhet të dëmtojë kurrë një qenie njerëzore.
- Ligji 2: Një robot duhet të ndjekë udhëzimet e njerëzve, përveç rasteve kur ato bien ndesh me ligjin e parë.
- Ligji 3: Një robot duhet të mbrojë veten, përveç rasteve kur kjo bie ndesh me ligjin e parë ose të dytë.




Figura 1. Robotika është një nga degët e inteligjencës artificiale

Megjithëse ka shumë lloje robotësh të projektuar për mjedise të ndryshme dhe për qëllime/aplikacione të ndryshme, të gjithë ata ndajnë katër ngjashmëri themelore⁵:

1. Të gjithë robotët kanë një formë të ndërtimit mekanik të projektuar për të arritur një detyrë të caktuar.
2. Kanë komponentë elektrikë të cilët fuqizojnë dhe kontrollin e makinerive.
3. Të gjithë robotët duhet të jenë në gjendje të ndiejnë rrethinën e tij; një robot mund të ketë sensorë drite (sy), sensorë të prekjes dhe presionit (duart), sensorë kimikë (hundë), sensorë dëgjimi dhe sonar (veshët), etj.
4. Të gjithë robotët përmbajnë një nivel kodi programimi kompjuterik.

Programet janë elementi thelbësor i një roboti, pasi ato mundësojnë inteligjencën dhe funksionalitetin e tij. Ekzistojnë tre lloje kryesore programesh robotike: telekomandë, inteligjencë artificiale dhe sisteme hibride. Disa robotë janë programuar për të kryer me saktësi dhe besnikëri veprime specifike, të përsëritura dhe pa ndryshime, duke arritur një shkallë të lartë precizioni. Robotika është një fushë ndërdisiplinore që përfshin projektimin, ndërtimin,

⁵ “Robotics,” Wikipedia, the free encyclopedia. <https://en.wikipedia.org/wiki/Robotics/>

funksionimin dhe përdorimin e robotëve. Ajo është një degë e inxhinierisë dhe shkencave kompjuterike që merret me krijimin e makinave të afta për të kryer detyra të programuara, shpesh pa përfshirje të drejtpërdrejtë njerëzore. Kjo fushë ka si synim zhvillimin e sistemeve që mund të automatizojnë proceset, të kryejnë detyra me efikasitet dhe të realizojnë operacione që mund të jenë të vështira për njerëzit. Në të ardhmen, robotët mund të luajnë një rol të rëndësishëm si drejtues, shoqërues, bashkëpunëtorë, mësues, specialistë dhe pionierë në eksplorim.

Robotët ushtarakë

Robotët ushtarakë të definuar gjerësisht datojnë që nga Bota Lufta e Dytë dhe Lufta e Ftohtë në formën e gjermanit Goliath gjurmoi minat dhe tele-tanket sovjetike.

Interesi ushtarak në robotikë ishte i paqartë gjatë Lufta e Ftohtë, me shpikësit që vazhdimisht zbuluan se ajo që ishte teknikisht e mundur kishte më pak rëndësi sesa ajo që ishte burokratikisht e realizueshme. Me gjithë disa pengesa, komuniteti amerikan i robotikës ushtarake nuk u lëkund në besimin e tij në dobinë e punës së tij. Gjatë pjesës tjetër të viteve 1990, ndërsa sensorët dhe procesorët kompjuterikë u përmirësuan, sistemet pa pilot u bënë gjithnjë e më të aftë. Me një ndryshim në mentalitetin ushtarak, paratë dhe përdorimin, më në fund u hodhën bazat për një industri të vërtetë robotike ushtarake.

Shumë nga robotët ushtarakë në zhvillim sot mund të kryejnë detyra shumë të aftë me saktësi të jashtëzakonshme. Shumica e tyre janë të tele-operuar dhe të pajisur me armë; ata përdoren për zbulimin, vëzhgimin, zbulimin e snajperëve, neutralizimin e mjeteve shpërthyes, etj. Robotët ushtarakë përdoren për zbulimin dhe çarmatimin e bombave, zbulimin nënujor, transportin e mallrave dhe më shumë.

Shumica dërrmuese e robotëve ushtarakë janë duke u përdorur prapaskenave për të mbajtur gjithçka në funksion. Ushtarët amerikanë kanë qenë të njohur për emërtimin e robotëve që shërbejnë përkrah tyre. Këta emra janë shpesh për nder të miqve të njerëzve, familjes, të famshmëve, kafshëve shtëpiake, etj.

Llojet e robotëve ushtarakë

Robotët ushtarakë janë krijuar për të përmbushur një gamë të gjerë funksionesh, nga mbikëqyrja dhe zbulimi deri te mbështetja logjistike dhe luftimi. Disa shembuj të njohur përfshijnë⁶:


⁶ “7 types of robots used in the military,” January 2023, <https://www.adsinc.com/news/7-types-of-robots-used-in-the-military/>

1. *Robotët e armatosur:* Këta robotë janë të pajisur me armë për të ndihmuar ushtrinë të eliminojë kërcënimet në luftime, të përmirësojë operacionet e tyre dhe të ndihmojë në sistemet e mbrojtjes.



2. *Automjetet tokësore pa pilot:* Këta robotë përdoren për qëllime të ndryshme, duke përfshirë asgjësimin e bombave, zbulimin, komunikimin dhe patrullimin në terrene sfiduese.

3. *Robotët e trajnimit:* Këta robotë ushtarakë ofrojnë zgjidhje stërvitore që simulojnë luftime të drejtpërdrejta.



4. *GuardBot:* Ky robot amfib sferik mund të rrokulliset në çdo terren dhe përdoret për mbikëqyrje, siguri dhe misione ushtarake.

5. *Robotët e transportit:* Kjo teknologji robotike mund të ndihmojë ushtarët të transportojnë furnizime të ndryshme si p.sh artileri, bomba dhe furnizime të tjera. Këta quhen edhe robotë logjistikë.





6. Robotët e kërkimit dhe shpëtimit:

Këta robotë ushtarakë janë krijuar për të ndihmuar në misionet e kërkim - shpëtimit.



7. Robotët për pastrimin e minave:


Këta janë robotë ushtarakë që janë krijuar posaçërisht për të zbuluar dhe pastruar minat tokësore. Një shembull i robotit të pastrimit të minave është paraqitur në figurën e mëposhtme.

8. Robotët zjarrfikës: Këta robotë ushtarakë mund të ndihmojnë në shuarjen e zjarreve që mund të ndodhin gjatë luftarake.



9. Robotët e mbikëqyrjes: Këta robotë mund të ndihmojnë ushtria për të vëzhguar dhe spiunuar armikun ose kërcënimet e mundshme.

10. *Robotët mbrojtës*: Këta janë robotë të shërbimit profesional që vendosen nga ushtria në skenarë luftimi, duke mbrojtur dhe duke u mundësuar ushtarëve në luftime.



11. *Qeni robotik*: Një qen robotik është një robot me katër këmbë që lëviz nëpër një peizazh të shkretëtirës me rërë. Një shembull i një qeni robotik është paraqitur në figurë⁷

12. *Mushkat robotike*: Mushkat robotike mund të transformojnë shtyllën logjistike të operacioneve ushtarake, duke shfaqur lëvizshmërinë e të gjithë terrenit për të lundruar nëpër peizazhet më të ashpra. Figura tregon disa shembuj të mushkave robotike⁸.



13. *Dronë ushtarakë*: Këta janë robotë fluturues që përdoren kryesisht për zbulim dhe zbulim, të aftë për të hyrë në territore të rrezikshme dhe për të tërhequr inteligjencën.

⁷ J. Detsch, "America's next soldiers will be machines," April 2024, <https://foreignpolicy.com/2024/04/06/us-army-military-robots-soldiers-technology-testing-war/>

⁸ "The future of warfare: Robotic mules in military science fiction," <https://milsf.com/the-future-of-warfare-robotic-mules-in-military-science-fiction/>



14. Robotët e shërbimit:

Meqenëse ushtria nuk është kurrë e sigurt për atë që do të ndeshet në një mision, robotët e shërbimit mund të dërgohen në situata të rrezikshme për t'i mbajtur ushtarët në një distancë të sigurt.

15. Robotët nëndetëse: Këta janë robotë që veprojnë në domenin e detit. Ata quhen gjithashtu robotë nënujorë. Një shembull i robotit nënujor është paraqitur në figurën⁹.



Aplikimet e robotëve ushtarakë

Robotët ushtarakë përdoren për një sërë qëllimesh duke përfshirë mbrojtjen, kërkimin dhe shpëtimin, mbikëqyrjen, sigurinë dhe transportin. Sot, robotët përdoren për një gamë të gjerë detyrash, nga zbulimi në luftime. Ushtria po përdor robotikën në mënyrat e mëposhtme specifike¹⁰:

1. Transporti ushtarak - Transportimi i pajisjeve ushtarake, të tilla si bomba dhe furnizime artilerie, transportimi i ushtarëve në dhe nga fushat e betejës dhe rikuperimi i ushtarëve ose viktimave të plagosur janë role të ndryshme që mund të kryhen nga një ushtri. Këta robotë mund të nxisin efikasitetin e logjistikës, të zvogëlojnë ngarkesën fizike në kushte të pafavorshme të motit. Ata janë zakonisht robotë të automjeteve tokësore pa pilot (UGV) që vijnë të pajisur me rrota ose këmbë.

2. Mbikëqyrja - Të pajisur me armë, kamera me sensorë të lartë dhe vizion infra të kuqe, robotët e vëzhgimit janë kritikë për operacionet ushtarake.

⁹ E. Ackerman and E. Guizzo, "How Stanford built a humanoid submarine robot to explore a 17th-century shipwreck," December 2016, <https://spectrum.ieee.org/stanford-humanoid-submarine-robot/>

¹⁰ L. Ross, "6 Ways the military is using robotics," March 2023, <https://www.thomasnet.com/insights/6-ways-the-military-is-using-robotics/>

Ato mundësojnë monitorimin nga afër të territoreve të armikut për të siguruar inteligjencë në fushën e betejës dhe, në fund të fundit, avantazh taktik. Për shembull, *Guardbot* është një robot mbikëqyrës amfib sferik që mund të rrokulliset në çdo terren, duke përfshirë borën, rërën dhe papastërtitë. Ndonëse fillimisht i zhvilluar për misione në Mars, roboti ka aplikime në misione mbikëqyrjeje, sigurie dhe ushtarake.

3. Kërkimi dhe Shpëtimi - Viktimat shpesh ndodhin në zonat e luftës sepse është shumë e vështirë ose shumë e rrezikshme të nxirren ushtarë të plagosur. Këta robotë ushtarakë ofrojnë mbështetje kritike në gjetjen e personelit të zhdukur ose të kapur. Ata shpesh mund të shkojnë atje ku njerëzit nuk mundën, qoftë nën ujë, përmes përmbytjeve, zjarreve ose mbi male. Robotët autonome ose të telekomanduar të kërkimit dhe shpëtimit mund të reduktojnë në mënyrë drastike kohën e reagimit ndaj urgjencës, duke përcaktuar me saktësi vendndodhjen e jetës njerëzore dhe duke nisur menjëherë një mision shpëtimi.

Këta robotë janë veçanërisht të dobishëm në lehtësimin e fatkeqësive, të tilla si mbështetja e kërkimit dhe shpëtimit lokal pas një cunami, tërmeti ose fatkeqësish të tjera natyrore. Për shembull, një robot i ngjashëm me qenin i quajtur *Jueying X20* është në gjendje të lundrojë në terrene të pa mund të mbajë pajisje të rëndësishme mjekësore si rezervuarët e oksigjenit, duke e bërë atë të paçmuar në një mision kërkimi dhe shpëtimi.

4. Neutralizimi - Ka robotë që zbulojnë dhe heqin minat tokësore dhe detare dhe krahët robotikë të sofistikuar që neutralizojnë objekte ose bomba të dyshimta pa vënë në rrezik një jetë të vetme njeriu. Këta robotë zakonisht përdoren për pastrimin e rrugëve, pikat e kontrollit dhe kontrolllet e automjeteve.

5. Dronët: Dronët janë ndoshta aplikacioni më i njohur i robotikës në ushtri. Këta robotë fluturues janë ose të kontrolluar nga distanca ose të programuara për të fluturuar në mënyrë autonome përmes planeve të fluturimit të kontrolluara nga softueri. Dronët ushtarakë janë shpesh reaguesit e parë në një situatë emergjente. Me aftësinë për të qëndruar pezull mbi një zonë për një periudhë të gjatë, ata mund të vlerësojnë rreziqet, të mbledhin inteligjencë dhe të identifikojnë ushtarët e humbur ose të plagosur. Për shembull, Forcat Ajrore të SHBA-së kanë të vendosur mbi ushtarët dhe të lundrojnë në terrene të vështira zhvilloi teknologjinë për pajisjen e dronëve autonome me teknologjinë e njohjes së fytyrës. Këta drone janë të destinuara për t'u përdorur nga forcat e operacioneve speciale për të mbledhur informacione përpara misioneve në vendet e huaja. Dronët robotikë, detektorët e minave dhe pajisjet ndijuese janë të zakonshme në fushën e betejës, por kërkojnë kontroll të drejtpërdrejtë nga njerëzit.

6. Zjarrfikja - Zjarret janë të zakonshme në luftime dhe ato mbeten një

nga kërcënimet më të mëdha për jetën në anije, por kjo është diçka që Marina e SHBA-së shpreson ta ndryshojë. Në vitin 2015, ajo zbuloi *SAFFiR* (Robot Autonom Zjarrfikës i Bordit të Anijeve), një robot i tipit *humanoid* që mund të lundrojë në rrugët e ngushta të një anijeje dhe ka fuqi të mjaftueshme baterie për 30 minuta shuarje zjarri. Ai mund të lëvizë përmes tymit të zi, të manipulojë pajisjet e shuarjes së zjarrit dhe të hedhë granata të teknologjisë së agjentëve shuarës. Këta robotë ushtarakë mund të lidhen me një hidrant zjarri për të ndihmuar në hetimin e një vendi zjarri si dhe shuarjen e zjarreve në shpëtuar jetën e zjarrfikësve

7. Automjetet autonome - Automjetet me telekomandë ose autonome janë e ardhmja e robotëve të transportit ushtarak pasi ato mund të avancojnë në një zonë lufte, ose në një situatë tjetër të rrezikshme, pa vënë në rrezik jetë të tjera njerëzore. Ato janë të dizajnuara për aplikime të ndryshme ushtarake, nga transporti tek kërkimi dhe shpëtimi dhe sulmi.

Automjetet vetëdrejtuese do të ndihmojnë në automatizimin e mjeteve tokësore të ardhshme të ushtrisë, të dizajnuara për të lundruar në terrene komplekse dhe për t'i siguruar ushtrisë aftësinë për të operuar në distancë automjetet gjatë misioneve me rrezik të lartë. Ka pasur disa zhvillime drejt zhvillimit të avionëve luftarakë autonome dhe bombarduesve.

Megjithatë, armët ushtarake nuk lejohen të jenë plotësisht autonome; ato kërkojnë kontribut njerëzor në pika të caktuara ndërhyrjeje për të siguruar që objektivat nuk janë brenda zonave të kufizuara të zjarrit siç përcaktohet nga Konventat e Gjenevës për ligjet e luftës.

Robotët ushtarakë në të gjithë botën

Shtetet e Bashkuara nuk janë i vetmi vend i interesuar për avancimin e robotikës. Kjo fushë është një nga më të rëndësishmet në epokën moderne, ku shumë kombe po investojnë në teknologjinë robotike për qëllime ushtarake, si në kohë lufte ashtu edhe në periudha paqeje. Pritet që tregu global i robotëve ushtarakë të arrijë një vlerë prej 32.7 miliardë dollarësh deri në vitin 2030. Megjithatë, ritmi i shpejtë i zhvillimit të robotëve të aftë për menaxhimin e fatkeqësive dhe operacionet në fushëbetejë ka ngritur shqetësime në Kombet e Bashkuara dhe organizatat e të drejtave të njeriut. Ne do të shqyrtojmë mënyrën se si robotët ushtarakë po përdoren në vendet e mëposhtme¹¹.

Shtetet e Bashkuara - Kur bëhet fjalë për përdorimin ushtarak të robotëve, SHBA kryeson rrugën pavarësisht ndryshimeve të lidhshme dhe çështjeve

¹¹ "Defence Rover to fight against terrorism and natural disasters," December 2021, <https://www.electronicwings.com/users/ChiranjeeviGowda/projects/1672/defence-rover-to-fight-against-terrorism-and-natural-disasters>

të financimit, dhe vazhdon ta bëjë këtë në mënyra etike, me mbështetjen ndërkombëtare. Në Shtetet e Bashkuara, Departamenti i Mbrojtjes (DoD) është klienti më i madh për teknologjitë e sistemeve pa pilot. Ushtria amerikane po investon shumë në RQ-1 Predator, i cili mund të armatoset me raketa ajër-tokë dhe të operohet në distancë nga një qendër komandimi në role zbulimi. Një aeroplanmbajtëse e vetme kushton miliarda dollarë dhe Shtetet e Bashkuara mbështeten shumë në dhjetë grupet e saj të sulmit të aeroplanmbajtësve për të projektuar fuqinë në mbarë globin. Por ndërsa robotët ushtarakë përputhen me më shumë aftësi që gjenden në natyrë, gjërat mund të ndryshojnë. Ushtria amerikane tani po eksperimenton me mjete të ndjeshme pa pilot që fjalë për fjalë mendojnë si krijuesit e tyre njerëzorë.

Kina - Kina nuk është e huaj për robotët. Kina dhe rajonet e saj lidhëse kanë një ndikim bazë për të luajtur që do të ndihmojë tregun në nxitjen e vendndodhjes. Tregu i përgjithshëm i robotëve autonome parashikon përgjegjësinë e krijimit të shoqatave si Alibaba, Walmart dhe Amazon, gjë që inkurajon nevojën e krijimit të AGV-ve për motorizimin e fokusit të shpërndarjes në një shkallë të tërhequr për përcjelljen e qetë të tregut. Ushtria Çlirimtare Popullore Kineze (PLA) ka në posedim robotin e vogël tokësor, i cili mund të përshkojë terrene të ndërlikuara, të vëzhgojë me saktësi situatat e fushëbetejës dhe të sigurojë fuqi të egër zjarri. I pajisur me një mitraloz dhe pajisje vëzhgimi dhe zbulimi duke përfshirë pajisjet e shikimit të natës, roboti mund të zëvendësojë një ushtar njerëzor në misionet e rrezikshme të zbulimit.

Rusia - *Udhëheqja ruse e mbrojtjes, teoricienët ushtarakë dhe praktikuesit ushtarakë po tregojnë interes të madh për aplikacionet ushtarake robotike që paraqesin shkallë të ndryshme të autonomisë në kryerjen e detyrave të tyre. Fushatat ushtarake të Moskës kundër Ukrainës dhe Sirisë janë bërë shtrati i provës së aplikacioneve të tilla.*

India - Sot, India është një nga vendet në zhvillim në botë. Mbrojtja e vendit luan një rol të rëndësishëm në ngritjen e rritjes së kombeve dhe forcimi i sistemit të mbrojtjes është më i rëndësishmi për të mbrojtur vendin dhe njerëzit.

Ushtria indiane synon të shtojë një veçori shtesë në mekanizmin e mbrojtjes që ndihmon në luftën kundër terrorizmit dhe aktiviteteve antisociale. Roveri i tyre mbrojtës është një robot aplikimi me bazë ushtarake që mund të përdoret në kushte kritike si p.sh goditjet kirurgjikale, operacionet e fshehta të goditjes, kundër dhunës, antiterrorizmit dhe gjatë fatkeqësive natyrore. Është një sistem i operuar nga njeriu. Ai është krijuar për të luftuar terrorizmin dhe fatkeqësitë natyrore. Është një automjet shumë i adaptueshëm, autonom i pajisur me sensorë të avancuar, sisteme komunikimi dhe mjete të specializuara. Tipari i mrekullueshëm i këtij rover është se ai është në gjendje të fluturojë në ajër si dron dhe gjithashtu të udhëtojë në ujë.

Avantazhet e robotikës në ushtri

1. Ulja e rrezikut për personelin ushtarak¹² - Robotët mund të përdoren në misione të rrezikshme si: çminimi, zbulimi i bombave, patrullimi në zona të kontaminuara kimikisht ose spiunazhi në terrene të panjohura. Kjo ndihmon në mbrojtjen e jetës së ushtarëve dhe redukton nevojën për ndërhyrje direkte njerëzore në frontet më të rrezikshme.

2. Rritja e efikasitetit operacional - Robotët mund të operojnë 24/7 pa lodhje dhe me saktësi të lartë. Automatizimi i detyrave si transporti i furnizimeve, mbikëqyrja e kufijve apo sulmet precize ndihmon në përsheptimin dhe optimizimin e operacioneve.

3. Përmirësimi i zbulimit dhe inteligjencës - Dronët ajrorë dhe tokësorë mund të ofrojnë të dhëna në kohë reale për pozicionet e armikut, terrenin dhe ndryshimet taktike. Sensorë të avancuar dhe sisteme të inteligjencës artificiale ndihmojnë në analizimin e informacionit më shpejt dhe më saktë sesa njeriu.

4. Kosto më e ulët (në afatgjatë) - Edhe pse zhvillimi dhe prodhimi i sistemeve robotike ka kosto të lartë fillestare, mirëmbajtja dhe përdorimi i tyre në afatgjatë mund të jetë më ekonomik sesa trajnimi dhe logjistika për trupat njerëzore. Robotët mund të ripërdoren në shumë misione dhe nuk kanë nevojë për kujdes mjekësor ose pushim.

5. Integrimi me teknologjitë e avancuara¹³ - Robotët mund të punojnë në sinkron me inteligjencën artificiale, sistemet satelitore dhe rrjetet e komandimit për të krijuar një fushëbetejë të “zgjuar” dhe të lidhur. Kjo sjell përfitime në koordinimin e sulmeve, mbrojtjen kibernetike dhe komandimin në kohë reale.

6. Zvogëlimi i ndikimit psikologjik mbi ushtarët - Në operacionet ku përdoren robotë në vend të njerëzve për të marrë vendime kritike, ushtarët mund të shmangin përjetime traumatike dhe ndjenja faji nga veprime të dhunshme.

7. Aftësi të veçanta dhe superiore ndaj njeriut - Robotët mund të operojnë në kushte ekstreme: temperaturë të lartë apo të ulët, rrezatim, mjedise pa oksigjen, nën ujë, etj. Disa robotë kanë fuqi fizike, shpejtësi ose përqendrim që i tejkalojnë kufijtë e njeriut.

¹² “Revolutionizing defense: The role of robotics in military operations,” February 2024, <https://www.nextechsol.com/revolutionizing-defense-the-role-of-robotics-in-military-operation/>

¹³ “The future is here: How the military uses robots” October 2019, <https://community.robotshop.com/blog/show/th-e-future-is-here-how-the-military-uses-robots/>; M. N. O. Sadiku, Robotics and Its Applications. Moldova, Europe: Lambert Academic Publishing, 2023.

Dizavantazhet e robotikës në ushtri

1. Rreziku i dehumanizimit të luftës - Kur vendimet për të vrarë ose për të ndërmarrë sulme automatizohen, ekziston rreziku që lufta të bëhet më e lehtë për t'u nisur dhe më pak e ndjeshme ndaj pasojave humane. Mungesa e emocioneve, ndjeshmërisë apo ndërgjegjes morale të robotët mund të çojë në veprime çnjerëzore nëse nuk programohen me kujdes.

2. Mungesa e përgjegjësisë ligjore - Nëse një robot kryen një krim lufte, kush është përgjegjës? Komandanti, inxhinieri apo vetë sistemi autonom? Kjo krijon një vakum juridik dhe etik që sfidon Konventat e Gjenevës dhe ligjin ndërkombëtar humanitar.

3. Varësia nga teknologjia dhe cenueshmëria kibernetike - Robotët varen nga rrjete, komunikime dhe algoritme që mund të hakohen, sabotohet ose bllokohen nga palë armike. Një sulm kibernetik ndaj sistemit robotik të një ushtrie mund të rezultojë në katastrofa taktike ose që roboti të përdoret kundër vetë forcave të veta.

4. Kostoja e lartë fillestare - Investimi në kërkim-zhvillim, prodhim dhe trajnimin për përdorimin e teknologjisë robotike është shumë i lartë, sidomos për shtetet me buxhet ushtarak të kufizuar. Në disa raste, kostoja nuk përkethehet në avantazh real, sidomos në konflikte asimetrike.

5. Rreziku i përhapjes dhe përdorimit nga aktorë jo legjitimë - Teknologjitë robotike mund të përdoren nga organizata terroriste, grupe mercenare ose shtete autoritare pa ndonjë kontroll etik. Kjo përhapje rrit rrezikun e konflikteve të papritura ose të pakoordinuara.

6. Sfidat në vendimmarrje në situata komplekse - Algoritmet nuk mund të kuptojnë gjithmonë kontekstin kulturor, politik ose etik të një situatë në fushëbetë. Vendime, që për një njeri do ishin të qarta si ndalim i një sulmi mbi civilë, mund të mos dallohen nga një robot në mënyrë të saktë.

7. Ndikimi në moralin e trupave njerëzore - Përdorimi i gjerë i robotëve mund të ulë rëndësinë dhe rolin e ushtarëve njerëzorë, duke ndikuar në motivimin, besimin dhe strukturën klasike të komandës ushtarake. Kjo mund të krijojë tension mes njësive njerëzore dhe sistemit të automatizuar.

8. Rreziku i gabimeve algoritmike (false positives/negatives) - Edhe sistemet më të sofistikuar kanë gabime në njohje ose vendimmarrje, p.sh., mund të identifikojnë një civil si armik ose anasjelltas. Në luftë, një gabim i tillë mund të ketë pasojë të rënda diplomatike dhe njerëzore.

Përfundime

Robotët ushtarakë janë ende në fillimet e tyre. Forcat moderne ushtarake përdorin lloje të ndryshme robotë për aplikacione të ndryshme duke filluar nga operacionet e zbulimit, mbikëqyrjes, logjistikës dhe shpëtimit. Konflikti i armatosur modern mund të ndryshohet rrënjësisht në epokën e kompjuterëve dhe rrjeteve. Ata mund dhe do të luajnë një rol të madh në të ardhmen e luftës; është vetëm një çështje se kur vendimi për të përdorur robotë kërkon kërkime të rëndësishme, planifikim dhe ekzekutim të qëllimshëm.

Përdorimi i robotëve në ushtri do të rritet vetëm në vitet e ardhshme. Robotët janë e ardhmja e ushtrisë. Robotika është çelësi i sistemeve të ardhshme luftarake. Për ata që kërkojnë të kenë një karrierë të suksesshme në robotikë, ushtria është një opsion i shkëlqyeshëm. Ata ofrojnë trajnimin dhe përvojën në punë të nevojshme për të punuar me robotë.

Robotika ushtarake po evoluon drejt **inteligjencës artificiale (AI)**, e cila do të mundësojë sisteme më të avancuara për vendimmarrje autonome. Përdorimi i **ekipimeve hibride (njerëz-robotë)** do të bëhet gjithnjë e më i zakonshëm, duke krijuar një ekuilibër midis fuqisë njerëzore dhe teknologjisë.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. S. Brezgov, "Robots in education: Is the educational revolution just around the corner?" January 2020, <https://scholarlyoa.com/robots-in-educationthe-educational-revolution-just-around-the-corner/>
2. M. N. O. Sadiku, U. C. Chukwu. A. AjayiMajebi, and S. M. Musa, "A primer on robotics," International Journal of Trend in Scientific Research and Development, vol. 6, no. 7, November-December 2022, pp. 614-621.
3. "Human-robot interaction," Wikipedia, the free encyclopedia https://en.wikipedia.org/wiki/Human-robot_interaction
4. "Robotics," Wikipedia, the free encyclopedia <https://en.wikipedia.org/wiki/Robotics>
5. "7 Types of robots used in the military," January 2023, <https://www.adsinc.com/news/7-types-of-robots-used-in-the-military>
6. J. Detsch, "America's next soldiers will be machines," April 2024, <https://foreignpolicy.com/2024/04/06/us-army-military-robots-soldiers-technology-testing-war/>
7. "The future of warfare: Robotic mules in military science fiction," <https://milsf.com/the-future-of-warfare-robotic-mules-in-military-science-fiction/>

8. E. Ackerman and E. Guizzo, "How Stanford built a humanoid submarine robot to explore a 17th-century shipwreck," December 2016, <https://spectrum.ieee.org/stanford-humanoid-submarine-robo>
9. L. Ross, "6 Ways the military is using robotics," March 2023, <https://www.thomasnet.com/insights/6-ways-the-military-is-using-robotics/>
10. J. Judson, "The robots are coming: US Army experiments with human-machine warfare," March 2024, <https://www.defensenews.com/unmanned/2024/03/25/the-robots-are-coming-us-army-experiments-with-human-machine-warfare/>
11. "Defence Rover to fight against terrorism and natural disasters," December 2021, <https://www.electronicwings.com/users/ChiranjeviGowda/projects/1672/defence-rover-to-fight-against-terrorism-and-natural-disasters>
12. "Revolutionizing defense: The role of robotics in military operations," February 2024, <https://www.nextechsol.com/revolutionizing-defense-the-role-of-robotics-in-military-operations>
13. M. N. O. Sadiku, Robotics and Its Applications. Moldova, Europe: Lambert Academic Publishing, 2023.
14. T. Cooke, A Timeline of Military Robots and Drones. Capstone, 2017.

ETIKA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Dr. Ulsi META

Nënkolonel Julian MYTEBERI

Ministria e Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar. *Inteligjenca artificiale është një shkencë dhe teknologji e bazuar në disiplina të tilla si: shkenca kompjuterike, matematika, mekanika, inxhinieria, biologjia, psikologjia dhe gjuhësia. Një arritje e madhe për IA është zhvillimi i funksioneve kompjuterike të lidhura me inteligjencën njerëzore, si p.sh arsyetimi, të mësuarit dhe zgjidhja e problemeve. Nga fushat e mësipërme, një ose disa prej tyre janë shfrytëzuar për ndërtimin e një sistemi inteligjent. IA është zhvilluar duke studiuar se si truri i njeriut mendon dhe si njerëzit mësojnë, vendosin dhe punojnë duke u përpjekur për të zgjidhur një problem dhe më pas duke përdorur rezultatet e këtij studimi si bazë të zhvillimit të softuerëve dhe sistemeve inteligjente.*

Përdorimi i aplikacioneve të IA ka shënuar rritje të jashtëzakonshme vitet e fundit, duke sjellë përfitime dhe komoditete të shumta. “Inteligjenca artificiale është tashmë pjesë e jetës sonë - nuk është fantashkencë”¹. Ndikimi i IA në fusha të ndryshme të veprimtarisë social-shoqërore është i thellë dhe po ndryshon mënyrën se si organizmat shtetërorë, ekonomikë, shkencorë, institucionet arsimore, kompanitë private, organizatat e shoqërisë civile etj., të mendojnë, veprojnë, prodhojnë dhe ndërveprojnë. Nga ana tjetër, ky zgjerim ka provokuar edhe shqetësime etike, të tilla si shkeljet e privatësisë, diskriminimi algoritmik, çështjet e sigurisë dhe besueshmërisë, transparencës dhe pasoja të tjera të padëshiruara.

Fjalët kyçe: inteligjenca artificiale (IA), etika, elementet e IA, inteligjenca njerëzore.

¹ Communication from The Commission “Artificial Intelligence for Europe” {SWD(2018) 137 final}, Brussels 25.4.2018, COM(2018), faqe (f.) 1.

Elementet bazë të inteligjencës artificiale

Inteligjenca artificiale (IA) është “një fushë teknike dhe shkencore e përkushtuar ndaj një sistemi të ndërtuar që prodhon rezultate të tilla si përmbajtje, parashikime, rekomandime ose vendime për një grup specifik objektivash të përcaktuara nga njeriu”². Kuptimi i IA ka evoluar përtej përpunimit të thjeshtë të të dhënave, duke përfshirë zhvillimin e makinave të afta për të mësuar, arsyetuar dhe zgjidhur probleme.

Një sistem IA përbëhet nga një agjent dhe mjedisi i tij. Agjent konsiderohet “... çdo gjë që mund të perceptojë mjedisin e tij përmes sensorëve dhe vepron mbi këtë mjedis nëpërmjet efektorëve”³. Kështu, një agjent njerëzor ka organet shqisore të ngjashëm me sensorët dhe organet e tjera (duart, këmbët, gojën) për efektorë. Një agjent robotik ka si sensorë - kamerat dhe gjetësit me reze infra të kuqe - dhe si efektorë - motorë dhe aktivizues të ndryshëm. Një agjent softuerik kodon vargje shifrash binare (bit-esh) si programe dhe zbaton funksione të caktuara për një përdorues ose për programe të tjera. Në trajtimet teorike, grupimi i elementeve të IA është i ndryshëm për shkak të ndërveprimit, shfrytëzimit të algoritmeve dhe bazave të të dhënave të njëjta, të varësisë nga njëri-tjetri etj. Në përgjithësi, elementet bazë të IA janë:

Përpunimi i gjuhës natyrore (PGJN) - është një element i IA që lejon makinat të kuptojnë dhe përdorin gjuhën njerëzore natyrore. PGJN fokusohet në ndërveprimin midis kompjuterëve dhe gjuhës njerëzore. Ai përfshin aftësinë e një sistemi kompjuterik për të analizuar, interpretuar dhe gjeneruar gjuhën njerëzore në një mënyrë që është kuptimplote dhe e dobishme”⁴. Teknologjia e PGJN ka përdorim të gjerë, si në: përkthimin automatik dhe korrektimin e gjuhës së përdorur (nga tekst në fjalë dhe anasjelltas); nxjerrjen e të dhënave nga teksti, zëri dhe shkrimi i dorës; monitorimin e mediave sociale; analizën e ndjenjave dhe emocioneve; filtrimin e postës elektronike të padëshiruar dhe të përmbajtjes; asistentët e zgjuar (si Siri dhe Alexa); sistemet pyetje-përgjigje (si p.sh. GPT-4, etj.).

Sistemet eksperte - janë makina ose aplikacione softuerike që përmbajnë njohuri dhe rregulla të veçanta në një fushë të caktuar dhe “.... imitojnë aftësinë vendimmarrëse të një eksperti njerëzor...”⁵. Ato sigurojnë këshilla dhe zgjidhje të problemeve komplekse për përdoruesit përmes një sërë rregullash të ofruara

² ISO/IEC 22989: Information technology-Artificial intelligence-Artificial intelligence concepts and terminology”, 2022.

³ Tutorials Point (I) Pvt. Ltd: “Artificial Intelligence Tutorial”, 2015, f. 14.

⁴ <https://www.iso.org/artificial-intelligence/natural-language-processing>.

⁵ IRJET: “A Comparative Study on Artificial Intelligence and Expert Systems”, Volume 06, 02 Feb 2019; f. 1983-1985.

nga një ekspert. Shembuj të kësaj gjenden në fushat e mjekësisë, inxhinierisë, farmacisë, ligjit, shkencës, ushqimit, mirëmbajtjes etj.

Robotika - merret me krijimin e robotëve të llojeve të ndryshme, që programohen për të kryer detyra specifike, në mënyrë automatike bazuar në udhëzimet njerëzore. Roboti është “një makinë që e ndjen mjedisin e tij, llogarit një vendim bazuar në një program të ruajtur dhe kryen një veprim”⁶. Ato, në varësi të fushës ku operojnë, ndahen në disa lloje, si: industriale, të shërbimit, mjekësorë, humanoidë, bujqësorë, eksplorues dhe hapësinor, mbrojtës dhe ushtarakë, edukativë, argëtues, kobotë (robotë bashkëpunues), automjetet autonome, etj.

Mësimi i makinës - është aftësia e makinave për të mësuar automatikisht nga të dhënat, përvojat e mëparshme dhe algoritmet. Mësimi i makinës përmirëson saktësinë duke përdorur përvojat e kaluara dhe mund të marrë vendime pa u programuar në mënyrë specifike për ta bërë këtë. Procesi fillon me mbledhjen e të dhënave historike, udhëzimet dhe përvojën e drejtpërdrejtë, për të ndërtuar modele logjike për konkluzionet e ardhshme. Një sasi e madhe të dhënash krijon një model më të mirë, që nga ana tjetër rrit saktësinë e tij. Algoritmet e mësimi të makinës klasifikohen në tre lloje⁷: të mësuarit e mbikëqyrur, ku makinat përmbajnë të dhëna të caktuara për të parashikuar rezultatin; të mësuarit pa mbikëqyrje, ku makinat identifikojnë të dhëna të pacaktuara e të pa strukturuara në modelin e tyre për të nxjerrë rezultatin; të mësuarit përforcues, ku makinat mësojnë përmes provës dhe gabimit, duke përdorur reagime për të formuar veprime.

Vizioni kompjuterik - është një fushë e IA që synon të krijojë sisteme digjitale që janë në gjendje të përpunojnë, analizojnë dhe përdorin të dhënat vizuale njëllor si njeriu. Vizioni kompjuterik “... u mundëson kompjuterëve të interpretojnë dhe të marrin vendime bazuar në të dhënat vizuale nga mjedisi. Duke përdorur algoritme dhe modele, sistemet e vizionit kompjuterik mund të analizojnë imazhe, video dhe të dhëna të tjera vizuale për të kuptuar përmbajtjen e tyre dhe për të nxjerrë informacione kuptimplote”⁸. Me anë të vizionit kompjuterik realizohet: zbulimi i objekteve; analiza e lëvizjes video; rindërtimi i skenës; klasifikimi dhe restaurimi i imazhit; zbulimi i kufijve skajorë dhe segmentimi i imazhit; përputhja e veçorive të pjesëve të imazhit për të marrë më shumë informacion rreth objekteve specifike në imazh, etj. Kjo teknologji gjen aplikime në fusha të ndryshme, duke përfshirë njohjen e fytyrës, makinat vetëdrejtuese, analizën e imazhit mjekësor dhe kontrollin e cilësisë në prodhim.

⁶ <https://robotsguide.com/learn/robotics-glossary>.

⁷ Osvaldo Simeone: A Brief Introduction to Machine Learning for Engineers, 2018, f. 9-10.

⁸ <https://www.ituonline.com/tech-definitions/what-is-computer-vision/>

Sistemet e rrjeteve nervore ose të mësuarit e thellë - janë modele llogaritëse të bazuara në sistemin nervor të njeriut, të përbëra nga nyje të ndërlidhura (neurone) që përpunojnë informacionin në shtresa (katër shtresa me 256, 128, 64, dhe 32 nyje). Gjithashtu, ato njihen si rrjete nervore artificiale ose rrjete nervore të simuluar. “Rrjetet nervore, në thelbin e tyre, janë modele llogaritëse të krijuara për të simuluar funksionimin e rrjeteve nervore biologjike”⁹. Aplikacionet kryesore të të mësuarit të thellë janë: klasifikimi i imazheve (identifikimi i objekteve brenda imazheve dhe kategorizimi i tyre në klasa të paracaktuara, si p.sh. njohja e objekteve në foto); zbulimi i objekteve (gjetja dhe identifikimi i objekteve të shumta brenda një imazhi); segmentimi i imazhit (për analiza të hollësishme në imazhet mjekësore për identifikimin e indeve ose anomalive të ndryshme) dhe analiza e videove (ndjekja e objekteve dhe zbulimi i ngjarjeve brenda transmetimeve video, të përdorura në aplikacione të tilla si monitorimi i trafikut, analitika sportive dhe mbikëqyrja me video).

Logjika e pasigurisë (fuzzy) - është një tjetër element i IA që zbaton një metodë arsyetimi dhe llogaritje që i ngjan arsyetimit njerëzor. Baza e funksionimit të saj është një grup rregullash që mund të përdoren për të analizuar dhe arritur përfundime logjike nga grupe të mëdha e të paqarta të të dhënave. Ajo imiton mënyrën e vendimmarrjes së njerëzve që “ ... ndryshe nga kompjuterët, ... përfshin një sërë mundësish midis PO-së dhe JO-së”¹⁰. Logjika e pasigurisë përfshin të gjitha mundësitë e ndërmjetme midis vlerave digjitale PO dhe JO dhe merret me arsyetimin që është i përafërt dhe jo fiks dhe i saktë. Aplikimet e algoritmeve të saj janë: sistemet e kontrollit, sistemet e vendimmarrjes dhe njohja e modeleve.

Etika e inteligjencës artificiale

Etika është shkenca e studimit të parimeve morale që rregullojnë sjelljen e individëve në një shoqëri ose drejojnë një veprimtari dhe përbëhet nga një sistem parimesh, rregullash, standardesh ose udhëzimesh që ndihmojnë në përcaktimin se çfarë është e mirë ose e drejtë. Përgjithësisht, etika ndahet në katër degë kryesore: teorike (meta-etika), normative, përshkruese dhe e aplikuar (zbatuar). Etika teorike ka të bëjë me natyrën e teorive etike dhe gjyqimeve morale. Etika normative merret me kriteret e asaj që është moralisht e drejtë dhe e gabuar. Ajo përfshin formulimin e rregullave morale që kanë ndikime të drejtpërdrejta në atë se si duhet të jenë veprimet, institucionet

⁹ Shan Masood: *Neural Networks and Deep Learning: A Comprehensive Overview of Modern Techniques and Applications*, Journal Of Environmental Sciences And Technology”, Volume No: 02 Issue No: 02 (2023), f. 8-15.

¹⁰ L.A. Zadeh, *Fuzzy algorithms*, Info. & Ctl., Vol.12, 1968, f. 94-102.

dhe mënyrat e jetesës njerëzore”¹¹. Etika përshkruese synon një hetim empirik të sjelljes dhe bindjeve morale të njerëzve. Etika e aplikuar trajton zbatimin e teorive etike normative në probleme, situata dhe fusha të veçanta të jetës publike dhe private (si: shteti, politika, ekonomia, drejtimi, familja, teknologjia, profesioni, aspektet sociale etj.).

Etika e IA, si pjesë e etikës së aplikuar, është studimi i çështjeve morale, ligjore dhe sociale që përfshijnë IA. Ajo ka të bëjë me çështjet e rëndësishme se si duhet të sillen zhvilluesit, prodhuesit dhe operatorët në mënyrë që të minimizohen dëmet etike që mund të lindin nga IA në shoqëri, nga projektimi i dobët (jo etik), nga aplikimi i papërshtatshëm ose keqpërdorimi. Fusha e etikës së IA përfshin shqetësimet e menjëhershme, paragjykimet për sistemet aktuale të IA, shqetësimet afatshkurtra dhe afatmesme për ndikimin e IA në veprimtarinë social-ekonomike dhe shqetësimet afatgjata në lidhje me mundësinë e sistemeve të IA që arrijnë ose tejkalojnë aftësitë ekuivalente me njeriun.

- Bashkimi Evropian dhe etika e Inteligjencës Artificiale

Zhvillimi i hovshëm i IA ka diktuar që politikëbërësit e shteteve dhe organizatave rajonale e botërore të trajtojnë me seriozitet problemet etike të shfaqura prej saj. Bashkimi Evropian (BE) konsiderohet si një nga organizatat e para për krijimin e një kornize mbi rregullat etike për IA. Në janar të vitit 2017, Parlamenti Evropian (PE) i kërkoi Komisionit Evropian (KE) të vlerësojë ndikimin e IA dhe bëri disa rekomandime mbi rregullat e ligjit civil për robotikën¹². Në këto rekomandime u përfshi një kod etike për inxhinierët e robotikës dhe iu kërkua KE të konsideronte krijimin e një agjencie evropiane për robotikën dhe IA, për të ofruar ekspertizë teknike, etike dhe rregullatore të nevojshme në një mjedis të orientuar drejt IA. Në rekomandimet për Komisionin, PE paraqiti disa parime etike, ku theksohej se¹³:

- tensionet dhe rreziqet nga shtimi i përdorimit të robotikës “... duhet të vlerësohen seriozisht nga pikëpamja e mbrojtjes së njeriut, shëndetit dhe sigurisë; lirisë, privatësisë, integritetit dhe dinjitetit; vetëvendosjes, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”;
- duhet të përditësohet, plotësohet dhe përshtatet kuadri ligjor ekzistues i BE “... duke i drejtuar parimet etike në përputhje me kompleksitetin e robotikës dhe implikimet e saj të shumta sociale, mjekësore dhe bioetike”;
- duhet të zbatohet transparenca për të siguruar: arsyetim të saktë për çdo

¹¹ <https://www.britannica.com/topic/normative-ethics>

¹² European Parliament: “Report A8-0005/2017 with recommendations to the Commission on Civil Law Rules on Robotics”.

¹³ Po aty, par. nr. 10-14.

vendim të marrë me ndihmën e IA që mund të ketë një ndikim thelbësor në jetën e njerëzve; mundësi të reduktimit të llogaritjeve të sistemit të IA në një formë të kuptueshme nga njerëzit; pajisjen e robotëve të avancuar me një “kuti të zezë”, për regjistrimin e të dhënave për çdo transaksion të kryer nga makina, duke përfshirë logjikën që kontribuon në vendimet e saj;

- kuadri udhëzues etik duhet të bazohet në parimet e dobisë; autonomisë dhe drejtësisë; në parimet dhe vlerat e parashikuara në Traktatin e BE-së; në “... Kartën e të Drejtave Themelore (si dinjiteti njerëzor, barazia, drejtësia dhe paanësia, mosdiskriminimi, jeta private dhe familjare dhe mbrojtja e të dhënave); ... në parimet dhe vlerat e tjera themelore të ligjit të Unionit, (si mosstigmatizimi, transparenca, autonomia, përgjegjësia individuale dhe përgjegjësia sociale) dhe në praktikatat dhe kodet etike ekzistuese”;

- duhet t’i kushtohet vëmendje e veçantë robotëve që përfaqësojnë një kërcënim të rëndësishëm për konfidencialitetin për shkak të përfshirjes së tyre në fusha tradicionalisht të mbrojtura dhe private dhe për shkak se ata janë në gjendje të nxjerrin dhe dërgojnë të dhëna personale dhe të ndjeshme.

Bazuar në këto rekomandime, në vitin 2018 KE miratoi një komunikim për të reklamuar zhvillimin e IA në Evropë¹⁴. Në vitin 2019, ai publikoi një plan të koordinuar për IA, të miratuar nga Këshilli i BE¹⁵, për të koordinuar strategjitë kombëtare të IA të shteteve anëtare të BE-së. Mbi këtë bazë, në dhjetor 2018 u miratua “Karta etike evropiane mbi përdorimin e IA në sistemet e drejtësisë dhe mjediset e tyre”, ku u përcaktuan parimet bazë etike për të garantuar respektimin e të drejtave themelore të njeriut, mosdiskriminimin, cilësinë, sigurinë, transparençën, paanshmërinë, drejtësinë dhe kontrollin nga përdoruesit me futjen e IA në sistemet e drejtësisë të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës¹⁶.

Në prill 2019, KE publikoi “Udhëzimet etike për IA të besueshme”¹⁷, i hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë të Komisionit (HLEG) për IA. Në këtë dokument, IA e besueshme trajtohet e mbështetur në tre elementë bazë, të cilët duhet të përmbushen gjatë gjithë ciklit jetësor të sistemit. Këto elemente duhet të jenë: *të ligjshëm*, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi; *etike*, duke siguruar respektimin e parimeve dhe vlerave etike dhe *të fortë*, si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga ajo sociale, për të shmangur

¹⁴ European Commission (EC): “Coordinated Plan on Artificial Intelligence”, 7.12.2018 COM(2018) 795 final.

¹⁵ Council of the EU: “Artificial intelligence-Conclusions on the coordinated plan on artificial intelligence”, Brussels, 11 February 2019.

¹⁶ CEPEJ: “European Ethical Charter on the Use of Artificial Intelligence in Judicial Systems and their environment”, 4 December 2018, f. 7-12.

¹⁷ HLEG on Artificial Intelligence: “Ethics guidelines for trustworthy AI”; European Commission, 8 April 2019.

dëmet e paqëllimshme nga IA. Kërkesat kryesore të BE-së për arritjen e IA të besueshme janë: kapaciteti njerëzor dhe mbikëqyrja; qëndrueshmëria dhe siguria teknike; qeverisja e privatësisë dhe e të dhënave; transparenca; diversiteti, mosdiskriminimi dhe drejtësia; mirëqenia shoqërore dhe mjedisore, si dhe llogaridhënia¹⁸. Në dokumentet e mëvonshme në lidhje me IA, Komisioni Evropian¹⁹, Parlamenti dhe Këshilli Evropian²⁰, ndër të tjera, kanë vijuar të vënë theksin në zbatimin e detyrimeve të vendeve anëtare për etikën dhe besueshmërinë në sistemet e IA.

- Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe etika e IA

Më 22 maj 2019, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) miratoi parimet e saj për IA. Këto parime përbëjnë standardet e para ndërkombëtare të miratuara nga qeveritë për zhvillimin e përgjegjshëm të IA. Ato përfshijnë rekomandime praktike të politikave, si dhe parime të bazuara në vlerat për administrimin e përgjegjshëm të IA të besueshme, ku evidentohen²¹:

- nga zhvillimi i IA duhet të përfitojnë njerëzit dhe planeti, duke nxitur rritjen gjithëpërfshirëse, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien;
- sistemet e IA duhet të respektojnë sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe diversitetin, si dhe duhet të përfshijnë masa mbrojtëse të përshtatshme për të siguruar një shoqëri të drejtë;
- duhet të ketë transparencë rreth IA për të garantuar që njerëzit i kuptojnë rezultatet dhe mund t'i sfidojnë ato;
- sistemet e IA duhet të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës dhe duhet të vlerësohen vazhdimisht rreziqet;
- organizatat dhe individët që zhvillojnë, ndërtojnë dhe operojnë sisteme të IA duhet të jenë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës për këto sisteme.

- Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe etika e IA

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), nëpërmjet organizmave të saj, ka disa iniciativa në lidhje me IA. Standardi i parë global mbi etikën e IA është ai i Organizatës së OKB për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO). Në shtator 2017, Komisioni Botëror i UNESCO-s për Etikën e Dijes Shkencore dhe Teknologjisë (COMEST), paraqiti një raport mbi robotikën, ku u vu theksi

¹⁸ Po aty, f. 14.

¹⁹ European Commission: "Coordinated Plan on Artificial Intelligence 2021 Review", 21.4.2021 COM(2021) 205 final.

²⁰ Regulation (EU) 2024/1689 of the European Parliament and of the Council, 13 June 2024.

²¹ Organisation for Economic Co-operation and Development: "Recommendation of the Council on Artificial Intelligence", C/MIN(2019)3/FINAL, 24 May 2019.

në faktin se “Robotika dhe robotët ngrenë sfida të reja dhe të pashembullta ligjore dhe etike”; u propozua një kornizë rregullash etike dhe ligjore; u evidentuan sfidat e pritshme etike të krijuara nga aplikimi i teknologjive të ndryshme bashkëkohore robotike dhe u dhanë rekomandimet përkatëse”²². Në vlerat dhe parimet përkatëse etike për robotikën theksi u vu në: dinjitetin e njeriut, autonominë, privatësinë, përgjegjësinë, transparencën, llogaridhënien, dobishmërinë dhe drejtësinë²³.

Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), në Raportin e vitit 2018 “Vlerësimi i shoqërisë së informacionit”²⁴, evidentoi nevojën e strategjive për të garantuar zhvillimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të IA; aftësitë e duhura operacionale teknike, menaxhuese dhe sociale; krijimin e platformave neutrale për qeveritë, industrinë, institucionet mësimore dhe shkencore për të ndërtuar një kuptim të përbashkët të kapaciteteve të teknologjive të reja të IA dhe për standardizimin teknik dhe të politikave.

Në nëntor 2021, UNESCO miratoi dokumentin “Rekomandim për Etikën e Inteligjencës Artificiale”, i cili “... synon të sigurojë një bazë për t’i bërë sistemet e IA të funksionojnë për të mirën e njerëzimit, individëve, shoqërive, mjedisit dhe ekosistemeve, si dhe për të parandaluar dëmin prej tyre. Ai gjithashtu synon të stimulojë përdorimin paqësor të sistemeve të IA”²⁵. Rekomandimet përbëjnë një kuadër rregullator global që udhëzon vendet për krijimin e kornizave të tyre ligjore për të siguruar që IA të funksionojë në mënyrë etike.

Në rekomandime janë përcaktuar vlerat dhe parimet bazë për etikën e IA. Për vlerat²⁶, theksi vihet në: respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe dinjitetit njerëzor; zhvillimin e shpejtë të mjedisit dhe ekosistemit; sigurimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes dhe bashkëjetesën në shoqëri paqësore, të drejta dhe të ndërlidhura. Si parime etike²⁷ janë rekomanduar: proporcionaliteti dhe shmangia e dëmit (për të garantuar mbrojtje të balancuar dhe shmangur çdo teprim, rrezik apo dëm të panevojshëm); mbrojtja dhe siguria (për të shmangur rreziqet e sigurisë dhe dobësitë ndaj sulmeve); drejtësia dhe mosdiskriminimi (për të garantuar drejtësinë sociale, aksesin dhe përfitimin për të gjithë shtresat e popullsisë

²² World Commission on Ethics and scientific Knowledge and Technology: “Report of COMEST on Robotics Ethics”, SHS/YES/COMEST-10/17/2 REV; Paris, 14 September 2017; f. 36-48.

²³ Po aty, f. 49-52.

²⁴ ITU Publications: “Measuring the Information Society Report”, Volume 1, 2018.

²⁵ <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000380455>; UNESCO: “Recommendation on the ethics of artificial intelligence”, 2021, f. 5.

²⁶ Po aty, f. 6-7.

²⁷ Po aty, f. 7-10.

kudo ku banojnë); qëndrueshmëria (për të arritur objektiva të vijueshme në kontekstin njerëzor, social, kulturor, ekonomik dhe mjedisor); e drejta e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave (për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, autonomisë dhe inteligjencës njerëzore nga sistemet e IA dhe përpunimin e përdorimit të të dhënave personale); mbikëqyrja dhe vendimi njerëzor (atribuimi i përgjegjësisë etike dhe ligjore për çdo fazë të ciklit jetësor të sistemeve të IA, mbikëqyrja dhe vendimi individual njerëzor, publik dhe juridik përfundimtar); transparenca dhe kuptueshmëria (për të siguruar respektimin, mbrojtjen dhe reklamimin e të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe parimeve etike); përgjegjësia dhe llogaridhënia (garantimi nga aktorët e IA i detyrave, përgjegjësisë dhe llogaridhënies së tyre etike për vendimet dhe veprimet që bazohen dhe merren në një sistem të IA); ndërgjegjësimi dhe edukimi (për reklamimin, arsimimin, trajnimin me aftësitë digjitale dhe kultivimin e një kulture për IA etike) dhe qeverisja e bashkëpunimi i përshtatshëm (respektimi i të drejtës ndërkombëtare dhe i sovranitetit kombëtar në përdorimin e të dhënave, miratimi i standardeve të hapura dhe të ndërveprueshëm, qasja dhe pjesëmarrja gjithëpërfshirëse e aktorëve të ndryshëm për qeverisjen e IA).

Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO), në Udhëzuesin “Etika dhe qeverisja e inteligjencës artificiale për shëndetin”²⁸, evidenton disa parime etike të përshtatshëm për përdorimin e IA në fushën e shëndetit, si: mbrojtja e autonomisë; mbështetja e mirëqenies dhe sigurisë njerëzore dhe interesit publik; siguri i transparencës, shpjegueshmërisë dhe kuptueshmërisë; nxitja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies; garantimi i gjithëpërfshirjes dhe barazisë dhe mbështetja e IA që është e përgjegjshme dhe e qëndrueshme.

Çështjet kryesore etike që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e IA

Sistemet e IA, krahas përfitimeve, kanë aftësinë të krijojnë sfida të rëndësishme etike që lidhen me shoqërinë njerëzore, psikologjinë e njeriut, sistemin financiar, sistemin juridik, mjedisin dhe botën në tërësi. Ndikimi i IA në **shoqëri** është i lidhur me: shqetësimin për tregun dhe vendet e punës të fuqisë punëtore, sepse njerëzit mund të zëvendësohen nga makinat; perspektivën për rritjen ekonomike dhe produktivitetin e punës; diskriminimin në tregun e punës, ku ndryshimet nuk do të ndjehen në mënyrë të barabartë nga të gjithë shtresat dhe anëtarët e shoqërisë; pasojat që mund të sjellë zbatimi i IA në thellimin e ndarjes ekzistuese sociale dhe ekonomike, për shkak të shkurtimit të vendeve të punës; rritjen e papunësisë në sektorët e automatizuar dhe prekjen në mënyrë jo proporcionale veçanërisht të punonjësve pa trajnimin dhe arsimimin e duhur.

²⁸ World Health Organization guidance: “Ethics and governance of artificial intelligence for health”, 2021, f. 23-30.

Pabarazia është një çështje etike, por edhe një çështje e politikës se kush përfiton nga IA. IA mundëson kompanitë të riorganizojnë bizneset e tyre, për t'i bërë ato më efikase dhe më produktive dhe kjo do të sjellë që të ardhurat do të ndahen në më pak njerëz, duke rritur pabarazinë sociale. Nga ana tjetër, krijimi i vendeve të reja të punës do të kërkojë punëtorë shumë të kualifikuar, por që do të punojnë në procese të përsëritura dhe të lodhshme, si etiketimi, moderimi i përmbajtjes; menaxhimi dhe korrektimi i të dhënave etj. Pabarazia do të bëhet më shqetësuese për individët e punësuar në kompani të ndryshme, nëpërmjet kontraktorëve të palëve të treta, si punonjës të përkohshëm. Zakonisht, këto punë planifikohen, drejtohen, shpërndahen dhe paguhen në internet. Këta punëtorë të përkohshëm, në raport me të ardhurat përfundimtare, përgjithësisht paguhen dhe rimbursohen në mënyrë të padrejtë për punën që bëjnë. Motivi i bizneseve për përfitim financiar maksimal mund të sjellë pasurimin e pronarëve dhe drejtuesve të tyre, por mund të mos përfitojnë punëtorët.

Përqendrimi i fuqisë së IA në duart e vetëm disa kompanive u jep atyre ndikim të panevojshëm në drejtime që lidhen me ndërtimin e opinionit në demokraci, si te: qeveritë, ligjvënësit, shoqëria civile, partitë politike, arsimimi, gazetaria, media, shkenca dhe kërkimi etj. Kompanitë e mëdha të teknologjisë kibernetike ushtrojnë ndikim në drejtim të shitjes së ideve dhe bizneseve të reja në fushën e IA; kontrollojnë infrastrukturën përmes të cilave zhvillohet debati publik; mbledhin të dhëna personale për përfitime dhe i profilizojnë njerëzit bazuar në sjelljen e tyre. Fuqizimi i IA mund të çojë jo vetëm në pabarazi pasurie, por edhe në trazira, polarizim e paqëndrueshmëri politike.

IA ka ndikime të thella në **privatësinë, të drejtat dhe dinjitetin** e njeriut, veçanërisht përmes asistentëve personal inteligjentë (IPA), të cilët janë gjithmonë të aktivizuar/ndezur dhe duke dëgjuar në sfond²⁹. Ato mund të regjistrojnë sjelljen dhe interesat e përdoruesve. Teknologjia mund të ruajë të dhëna afatgjata për individët, duke përfshirë informacionin nga faturat, kontratat, pajisjet digjitale dhe mediat sociale. Kjo mund të çojë në humbjen e fshehtësisë dhe cenimin e privatësisë, sidomos nga robotët e shërbimit dhe të shoqërimit, të cilët janë të pranishëm në momente intime të jetës së përdoruesve. Njerëzit mund të identifikohen nga softueri i njohjes së fytyrës dhe nga nxjerrja e të dhënave të preferencave të tyre për blerje ose për mediat sociale në internet.

²⁹ Lydia Manikonda: *User Preferences and Privacy Concerns in Intelligent Personal Assistants*, AIES'18: Proceedings of the 2018 AAAI/ACM Conference on AI, Ethics, and Society; në f. 229-235 thekson: "Një sondazh i përdoruesve të IPA tregon se shqetësimi më i madh i njerëzve për privatësinë ishte hakerimi i pajisjes së tyre (68.63%), i ndjekur nga mbledhja e informacionit personal për ta (16%), dëgjimi i bisedave të tyre 24/7 (10%), regjistrimi i bisedave private (12%), duke mos respektuar privatësinë e tyre (6%), duke ruajtur të dhënat e tyre (6%) dhe natyrën shqetësuese të pajisjes (4%)".

Modelet e përdorimit të mediave sociale mund të parashikojnë kategoritë e personalitetit, preferencat politike, ekonomike dhe madje edhe përfitimet dhe ndryshimet e jetës. Zgjedhja e fjalës, apo edhe presioni i shkrimit në lapsin shkruar digjital, mund të tregojë gjendjen emocionale, përfshirë nëse dikush po gënjen. Kjo ka pasoja të rëndësishme për privatësinë dhe anonimitetin, si në internet ashtu edhe jashtë linje. Aplikacione të ndryshme të IA depozitojnë sasi të mëdha të dhënash, por individët kanë të drejta të kufizuara për të ditur se si përdoren të dhënat e tyre, veçanërisht kur ato shfrytëzohen për të testuar modelet e ndryshme të aplikacioneve.

Liria e fjalës dhe e shprehjes mund të ndikohet thellësisht nga IA. Kompanitë e teknologjisë e paraqitin IA si një zgjidhje për probleme të tilla si gjuha e urrejtjes, ekstremizmi i dhunshëm dhe keqinformimi digjital. Shpesh, mjetet e analizës së sjelljeve përdoren për të vlerësuar tonin dhe natyrën e komunikimit në internet dhe mund të fshijnë automatikisht përmbajtjen ose të identifikojnë lajmet e rreme. Kjo është një prirej e padrejtë, sepse kompetenca e mësimit të makinës ka kufizime për të kuptuar tonin dhe kontekstin. Heqja e automatizuar e përmbajtjes rrezikon censurimin e fjalës së lirë, aq më shumë kur kjo bëhet nga kompani private, që në disa raste veprojnë sipas udhëzimeve të qeverive.

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballlet zhvillimi dhe përdorimi i sistemeve të IA është prania e **paragjykimeve**. “Paragjykimi në IA mund të justifikojë dhe madje të përforcojë pabarazitë ekzistuese, që çojnë në diskriminim ndaj grupeve të përjashtuara dhe kufizojnë hyrjen e tyre në shërbimet thelbësore”³⁰.

Paragjykimet sistematike mund të lindin si rezultat i të dhënave të përdorura për të trajnuar sistemet, ose i vlerave të marra në konsideratë nga zhvilluesit dhe përdoruesit e sistemit. Shpesh, kjo ndodh kur aplikacionet e mësimit të makinës testohen mbi të dhëna që pasqyrojnë vetëm grupe të caktuara sociale dhe demografike ose bazuar në gjykimet shoqërore. Burimet e paragjykimeve në IA mund të lindin nga faza të ndryshme të konfigurimit të mësimit të makinës, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, hartimin e algoritmit dhe ndërveprimet e përdoruesve. Paragjykimet janë të llojeve të ndryshme³¹ (si: të kampionimit, algoritmike, të përfaqësimit, të konfirmimit, të matjes, të ndërveprimit dhe të gjenerimit).

Duke qenë se shumë modele të mësimit të makinës ndërtohen nga të dhënat e krijuara nga njeriu, paragjykimet njerëzore mund të rezultojnë të shpërndara brenda të dhënave të trajnimit³². Nëse zhvilluesit nuk punojnë për të njohur

³⁰Emilio Ferrara: *Fairness and Bias in Artificial Intelligence: A Brief Survey of Sources, Impacts, and Mitigation Strategies*, f. 4.

³¹Po aty, f. 3-4.

³²Të dhënat e trajnimit janë të dhëna të emërtuara që përdoren për të udhëzuar dhe mësuar modelet e IA ose algoritmet e mësimit të makinës, për të bërë parashikime dhe marrë vendime

dhe shmangur paragjykimet, aplikacionet dhe produktet e IA mund të nxjerrin rezultate të padrejta, diskriminuese dhe të njëanshme kundrejt grupeve të veçanta shoqërore. Përdorimi i IA në zbatimin e ligjit, p.sh., mund të rezultojë që disa grupe demografike të burgosen ose të ndalohen në mënyrë të padrejtë. Kryerja e kontrolleve të historikut të kreditit nga IA mund të rezultojë në refuzimin e padrejtë të kredive për disa individë, duke ndikuar në zgjidhjen e problemeve të tyre ekonomike. Nëse IA përdoret për të kontrolluar njerëzit për aplikimet për punë ose ndihmë sociale, kjo mund të rezultojë që shtresa të ndryshme të shoqërisë të jenë në dizavantazh. Ky problem përkeqësohet nga fakti se aplikacionet e IA janë zakonisht “kuti të zeza”, ku është e pamundur për përdoruesit të gjykojnë nëse të dhënat e përdorura për t’i trajnuar janë të drejta apo përfaqësuese.

Zbatimi i IA krijon probleme etike dhe mund të kërcënojë edhe **demokracinë**. Politikanët e përfshirë në fushata zgjedhore, duke pasur akses në sasi të mëdha informacioni, vënë në objektiv të fushatës së tyre kategori specifike votuesish dhe u dërgojnë mesazhe që në dukje përputhen me dëshirat e tyre. Nga ana tjetër, teknologjitë e IA mund të keqpërdoren për të manipuluar qytetarët në zgjedhje. Llogaritë e automatizuara (botët) janë përdorur dhe mund të përdoren për të përhapur lajme dhe propagandë të njëanshme në rrjetet sociale. Këto llogari mund të krijohen dhe funksionojnë edhe jashtë një vendi, duke ndikuar ndjeshëm në paragjykimin e përmbajtjes së pasqyruar në mediat sociale dhe duke transmetuar një përshtypje të rreme mbështetjeje për çështje apo persona të ndryshëm.

Vitet e fundit, mjaft vende, përfshirë shtetet autoritare apo edhe demokracitë, po përdorin “trupat kibernetike” për të manipuluar opinionin publik nëpërmjet aplikacioneve kryesore të rrjeteve sociale³³. Këto trupa kibernetike përdorin një sërë taktikash për të lëkundur opinionin publik, duke përfshirë abuzimin verbal dhe ngacmimin e përdoruesve të tjerë të mediave sociale që shprehin kritika ndaj qeverisë; shënjestrimin e gazetarëve dhe kundërshtarëve politikë; përdorimin e shpeshtë të robotëve të automatizuar për të mbushur rrjetet e mediave sociale me spam-e dhe lajme të rreme ose të njëanshme; përforcimin e zërave dhe ideve të përjashtimit dhe ndarjes sociale; rritjen e numrit të pëlqimeve dhe mesazheve të marra, duke krijuar një ide të rreme të popullaritetit, momentit ose rëndësisë. Mediat po përdorin gjithnjë e më shumë rekomanduesit algoritmik të lajmeve³⁴, duke synuar lajmet e personalizuar

të përshtatshme në varësi të konteksteve të ndryshme. Zakonisht, ato përbëhen nga tekst i shkruar, imazhe, video ose audio.

³³ Samantha Bradshaw, Philip N. Howard: *A Global Inventory of Organized Social Media Manipulation*, Working paper no. 2017.12, f. 9-17.

³⁴ Rekomanduesi algoritmik i lajmeve është një algoritm i IA, që parashikon preferencat e përdoruesve për leximin dhe rekomandon në mënyrë përzgjedhëse lajmet, bazuar në kritere të ndryshme, duke përfshirë blerjet e mëparshme, historikun e kërkimit, informacionin demografik, vendbanimin dhe faktorë të tjerë.

për njerëzit, bazuar në interesat e tyre. Kjo metodë ka krijuar shqetësime etike që lidhen me: autonominë personale (duke i shtyrë përdoruesit drejt një rezultati të caktuar, i cili mund të jetë i dëmshëm për ata); profilizimin e përdoruesit (ku përmbajtja e sugjeruar mund të burojë nga supozimet mbi informacionin demografik ose besimin fetar të përdoruesit, gjë që mund të krijojë paragjykime dhe pabarazi shoqërore); privatësinë (nga mbledhja, ruajtja dhe përdorimin e sasive të mëdha të të dhënave personale nga sistemet); transparencën dhe shpjegueshmërinë (pasi sistemet e rekomandimeve shpesh prodhojnë vendime që janë të vështira për t'u shpjeguar për ndjekësit e thjeshtë); polarizimin (i krijuar nga sistemet e rekomandimeve që ofrojnë një formë të personalizuar të lajmeve, mediave dhe ngjarjeve aktuale). IA po bëhet gjithnjë e më shumë prezente në modelimin e mendimit, përvojës, veprimit, komunikimit dhe marrëdhënieve njerëzore. Robotët pritet t'u shërbejnë njerëzve në role të ndryshme shoqërore si në: infermieri, mbajtjen e shtëpisë, kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit, mësimdhënien etj., si dhe të flasin njëllor si njerëzit. Në këto kushte, njerëzit mund të humbin aftësinë për të menduar vetë, të manipulohen ose mashtrohen, të fillojnë të krijojnë lidhje emocionale me robotët, ndoshta edhe të ndiejnë dashuri për ta. Nëse kjo ndodh, do të ndikojë në marrëdhëniet dhe në psikikën njerëzore. Njerëzit mund të bëhen të varur psikologjikisht nga robotët dhe kjo varësi mund t'i shtyjë njerëzit të besojnë dhe kryejnë veprime që ndryshe nuk do t'i kishin bërë. Robotët mund të ndikojnë në stabilitetin e marrëdhënieve njeri-njeri, marrëdhëniet martesore ose në ato seksuale³⁵.

IA po përfshihet gjithnjë e më shumë në detyra dhe vendime të kryera tradicionalisht nga njerëzit. Në këtë situatë, ka diskutime të shumta nëse sistemet e IA duhet të trajtohen si “personalitet” dhe veprues moralë ose ligjorë. Në vitin 2017, PE miratoi një rezolutë ku, ndër të tjera, kërkonte krijimin e një statusi ligjor specifik për sistemet e avancuara të IA, të quajtur **“persona elektronike”**³⁶. Kjo rezolutë adresoi kompleksitetin e përgjegjësisë dhe detyrimit në rastet kur sistemet autonome mund të marrin vendime të pavarura nga krijuesit ose përdoruesit e tyre. Si pjesë të kësaj rezolute, PE diskutoi të drejtat dhe detyrimet që mund të caktohen për këta “persona elektronike”. Këto përfshijnë aftësinë për të qenë palë në procedurat ligjore, kërkesën për të reaguar dhe shlyer çdo dëm që mund të shkaktojnë dhe nevojën për një skemë sigurimi për të mbuluar këto dëme.

³⁵ David Levy: *Intimate relationships with artificial partners*, DOI: 10.26481/dis.20071011dl, f. 113-129, 139-148.

³⁶ “Një status ligjor specifik për robotët, në mënyrë që të paktën robotët autonomë më të sofistikuar të mund të vërtetojnë se kanë statusin e personave elektronikë me të drejta dhe detyrime specifike, duke përfshirë atë të kompensimit të çdo dëmi që mund të shkaktojnë dhe duke aplikuar personalitet elektronik në rastet kur robotët marrin vendime autonome të zgjuara ose ndërveprojnë ndryshe me palët e treta në mënyrë të pavarur”.

Një nga fushat e para të ekonomisë ku teknologjitë e IA janë zhvilluar dhe zbatuar me ritme të shpejta është **sektori financiar**. Nëpërmjet IA, sektori financiar ka arritur disa përparësi, si: përsheptimi dhe automatizimi i veprimeve financiare, rritja e fitimeve për investitorët, tregtia e automatizuar dhe e shpejtë, personalizimi i klientit, menaxhimi i rrezikut dhe zbulimi i mashtrimit, analiza e përmirësuar e të dhënave, reduktimi i kostos etj. Megjithatë IA në financë operon brenda një kuadri të mirëpërcaktuar ligjor dhe të autonomisë, ajo mund të krijojë shqetësime etike me pasoja për njerëzit. Kështu mund të përmenden: përpjekjet për të ndikuar artificialisht në çmimet dhe simuluar ose dëmtuar tregjet; dezinformimi rreth vlerës së kompanive të dobëta financiarisht; paragjykimi algoritmik dhe drejtësia në marrjen e vendimeve të njëanshme, të pasakta, diskriminuese ose favorizuese për grupe ose klientë të ndryshëm; përdorimi antiligjor për pastrimin e parave dhe përfitime të paligjshme; dobësitë në zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit; marrja e të dhënave pa dijeninë e individëve për qëllime të kreditimit; pamundësia e klientëve për të njohur se si përdoren të dhënat e tyre personale, etj.

Përdorimi i IA në shoqëri ka një ndikim të madh në sistemin **ligjor** (*penal dhe civil*). Në kushtet kur vendimet gjithnjë e më të ndërlikuara dhe të rëndësishme po u besohen algoritmeve, ekziston rreziku që baza ligjore për përgjegjësinë të jetë e pamjaftueshme. Në përdorimin e IA në sistemin ligjor zbatohen disa parime bazë, si: respektimi i të drejtave themelore (projektimi dhe zbatimi i mjeteve dhe shërbimeve të IA në përputhje me këto të drejta); mosdiskriminimi (parandalimi i zhvillimit ose intensifikimit të çdo diskriminimi ndërmjet individëve ose grupeve të individëve); cilësia dhe siguria (në përpunimin e vendimeve dhe të dhënave gjyqësore, bazuar në burime të certifikuara dhe të dhëna të plota e të sakta); transparenca, paanshmëria dhe drejtësia (duke i bërë metodat e përpunimit të të dhënave të arritshme, të kuptueshme dhe të mundura për auditim të jashtëm) dhe parimi “nën kontrollin e përdoruesit” (duke përjashtuar një trajtim normativ dhe garantuar që përdoruesit janë aktorë të informuar dhe kanë nën kontroll zgjedhjet e bëra)³⁷.

Përdorimi i IA në fushën e drejtësisë krijon disa probleme etike, si: vështirësia në vlerësimin e veprimit ose mosveprimit të IA për një akt kriminal; përgjegjshmëria, transparenca dhe paragjykimi; mundësitë e pasaktësisë dhe njëanshmërisë; privatësia dhe mbrojtja e të dhënave; diskriminimi gjatë interpretimit të ligjeve; përcaktimi i të drejtës së autorit për pronësinë e përmbajtjes së gjeneruar; mungesa e besimit për shkak se ligji nuk interpretohet nga njerëzit në bazë të kuptimit kontekstual real, por në varësi nga sistemet e IA; humbja e aftësive të nevojshme ligjore nga juristët e rinj kur puna e

³⁷ European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ): “European ethical Charter on the use of Artificial Intelligence in judicial systems and their environment”; 3-4 December 2018; f. 7-12.

zakonshme ligjore u jepet ndihmësve të IA, etj. Sistemet e IA, për shkak të elementeve përbërës dhe të funksionimit, kanë ndikim dhe krijojnë disa probleme etike që lidhen me **mjedisin**. Qendrat e të dhënave, ku vendosen pajisjet e IA, kanë fuqi të konsiderueshme llogaritëse dhe emetuese, e cila shoqërohet me një konsumim të lartë të energjisë elektrike³⁸. Teknologjitë e IA kanë nevojë për elemente të rrallë të tokës (nikel, bakër, kobalt, grafit, arsenik, selenium, litium etj.), të cilët nxirren nga minierat, duke shkaktuar dëmtime mjedisore dhe pakësim të metaleve të rralla të tokës. Në fund të ciklit të tyre jetësor, pjesët elektronike të IA zakonisht shkatërrohen, duke çuar në një grumbullim të metaleve të rënda (si mercuri, plumbi, etj.) dhe materialeve toksike të rrezikshme në mjedis³⁹. Gjatë prodhimit dhe funksionimit të elementeve dhe sistemeve të IA, sidomos të qendrave të të dhënave, nevojitet një sasi të madhe uji për ftohjen e serverëve.

IA, për shkak të shtrirjes së saj të gjerë, po ndikon në marrëdhëniet e njerëzve me teknologjinë në mënyrën se si ata e perceptojnë, e përdorin dhe ndërveprojnë me të. Ky ndikim ka krijuar shqetësime të thella, që mund ta pranojnë ose dëmtojnë teknologjinë, në veçanti në lidhje me **besueshmërinë** ndaj saj. Duke qenë se shumë vendime i delegohen IA, njerëzit kërkojnë garanci që këto vendime të jenë të drejta, të paanshme, pa paragjykime e pa diskriminim dhe që nuk thellojnë pabarazitë sociale. Për rritjen e besueshmërisë ndaj IA ka rëndësi transparenca për vendimet e saj, me qëllim që njerëzit të kenë mundësi të njohin, kuptojnë, gjurmojnë dhe kontrollojnë rezultatet, informacionin dhe të dhënat konkrete; të reagojnë në rast të padrejtësive dhe shkeljes së të drejtave të tyre dhe të kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive për gabimet e ndryshme. Transparenca mund të jetë shumë e vështirë në sistemet e IA “kuti e zezë”, ku funksionimi i brendshëm i tyre është një mister për përdoruesit. Përdoruesit mund të shohin të dhënat hyrëse dhe dalëse të sistemit, por nuk mund të shohin se çfarë ndodh brenda pajisjes së IA, se si ajo i përpunon dhe nxjerr rezultatet përfundimtare.

Rritja e transparencës dikton që sistemet e IA të jenë të shpjegueshme, duke u mundësuar strukturave dhe përdoruesve të njohin procesin e vendimmarrjes;

³⁸ IEA: në “Electricity 2024-Analysis and forecast to 2026”, thekson: “Konsumi i energjisë elektrike nga qendrat e të dhënave, inteligjenca artificiale (IA) dhe sektori i kriptomonedhave mund të dyfishohet deri në vitin 2026. Qendrat e të dhënave janë shtytës të rëndësishëm të rritjes së kërkesës për energji elektrike në shumë rajone. Pas konsumimit global të rreth 460 teravat-orë (TWh) në vitin 2022, konsumi total i energjisë elektrike i qendrave të të dhënave mund të arrijë më shumë se 1000 TWh në vitin 2026. Kjo kërkesë është afërsisht ekuivalente me konsumin e energjisë elektrike në Japoni”. Revised version, January 2024, f. 8, 31-35.

³⁹ <https://globalewaste.org/>: UNITAR: “The Global E-Waste Monitor 2024” “Në vitin 2022, rajonet që prodhuan sasinë më të madhe të mbetjeve elektronike për frymë ishin Evropa (17.6 kg), e ndjekur nga Oqeania (16.1 kg) dhe Amerika (14.1 kg)”, f. 30.

të kërkojnë rregullimet e duhura nëse nevojitet; të dinë se çfarë bën një sistem i IA, si e zbaton dhe si/pse është projektuar në atë mënyrë. Kjo rrit bindjen se sistemi i IA garanton atë që synohet dhe shmang paragjykimet dhe pasojat e paqëllimshme.

Një tjetër kërkesë për të garantuar besimin tek IA është llogaridhënia. Llogaridhënia e IA siguron që, nëse një sistem i IA bën një gabim ose dëmton dikë, ekziston dikush që mund të mbajë përgjegjësi, qoftë projektuesi, zhvilluesi ose kompania që e shet këtë teknologji. Rastet e mos shpjegimit dhe mos interpretimit të plotë të një rezultati vështirësojnë shumë caktimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies nga palët përgjegjëse për dëmet e shkaktuara. Një mënyrë për të siguruar llogaridhënien dhe besimin e IA është rregulli dhe qeverisja etike, ku përfshihen një grup procesesh, rregullash, procedurash, kulturash dhe vlerash të projektuara për të siguruar standarde të larta të sjelljes dhe për të minimizuar rreziqet. Këto standarde të sjelljes duhet të pranohen dhe zbatohen nga projektuesit dhe kompanitë që i përdorin, në mënyrë që çështjet etike të trajtohen parimisht para se të lindin dhe jo të pritët derisa një problem të shfaqet gjatë përdorimit ose të konstatohet rastësisht. Përfshirja, bashkëpunimi dhe reagimi aktiv i njerëzve gjatë gjithë ciklit jetësor të sistemeve të IA është domosdoshmëri dhe mundëson saktësinë, besueshmërinë, përshtatshmërinë, ndërhyrjet dhe ndryshimet e duhura në sisteme, në përputhje me kërkesat reale.

Përfundime

Inteligjenca artificiale është një teknologji që po përparon me shpejtësi dhe po bëhet pjesë integrale në fusha të ndryshme, si në: qeverisje, industri, mjekësi, financë, arsim, transport, shkencë, jetën sociale etj. Ajo ka sjellë përfitime në këto fusha duke automatizuar detyrat, duke ofruar njohuri efikase dhe duke marrë vendime të informatizuara të shpejta. Gjithashtu, zbatimi i gjerë i saj ka krijuar shqetësime dhe ndikime etike gjatë përdorimit të saj. Sistemet e IA mund të marrin vendime që prekin individët, grupet dhe shoqërinë në tërësi. Këto vendime mund të përfshijnë informacione të ndjeshme, të tilla si të dhënat personale, të dhënat mjekësore, informacione financiare, të dhënat teknologjike etj. Prandaj, kërkohet që sistemet e IA të zhvillohen dhe përdoren në mënyrë etike dhe të përgjegjshme.

Etika e IA është një grup vlerash, parimesh dhe udhëzimesh që synojnë të sigurojnë zhvillimin dhe përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të saj. IA duhet të plotësojë vlerat dhe parimet etike bazë, duke përfshirë transparencën, drejtësinë, privatësinë, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë. Qëllimi i etikës së IA është të garantohen sisteme të IA që janë të sigurta, të besueshme dhe të dobishme për njerëzimin. Organizatat botërore dhe rajonale dhe shtetet kanë vlerësuar rëndësinë e etikës së IA duke e reflektuar këtë në ligjet,

direktivat, rregulloret dhe udhëzimet specifike të tyre. Në përputhje dhe në përshtatje me këto dokumente, strukturat tona shtetërore nevojitet të krijojnë udhëzimet dhe rregullat e nevojshme për etikën e IA.

Zhvillimi dhe përdorimi i sistemeve të IA, pa konsideratat e nevojshme etike, mund të çojë në rreziqe dhe pasoja të ndryshme. Mbetet e rëndësishme që të gjithë aktorët e përfshirë në ciklin e jetëgjatësisë së sistemeve të IA të njohin dhe zbatojnë pa devijim të gjitha parimet dhe kërkesat etike në sistemet e IA, ku një rol të veçantë për këtë kanë projektuesit, prodhuesit, strukturat shtetërore, shkencoret dhe të arsimimit.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Communication from The Commission “Artificial Intelligence for Europe” {SWD(2018) 137 final} Brussels, 25.4.2018 COM(2018), f. 1.
2. ISO/IEC 22989, 2022: Information technology-Artificial intelligence-Artificial intelligence concepts and terminology”.
3. Tutorials Point (I) Pvt. Ltd: “Artificial Intelligence Tutorial”, 2015, f. 14.
4. <https://www.iso.org/artificial-intelligence/natural-language-processing>.
5. IRJET: “A Comparative Study on Artificial Intelligence and Expert Systems”, Vol. 06, 02.02 2019; f. 1983-1985.
6. <https://robotsguide.com/learn/robotics-glossary>.
7. Osvaldo Simeone: “A brief introduction to machine learning for engineers”, 2018, f. 9-10.
8. <https://www.ituonline.com/tech-definitions/what-is-computer-vision/>
9. Shan Masood: “Neural Networks and Deep Learning: A Comprehensive Overview of Modern Techniques and Applications”, Journal Of Environmental Sciences And Technology”, Volume No: 02, Issue No: 02 (2023), f. 8-15.
10. L.A. Zadeh, “Fuzzy algorithms”, Info. & Ctl., Vol.12, 1968, f. 94-102.
11. <https://www.britannica.com/topic/normative-ethics>
12. European Parliament: “Report A8-0005/2017 with recommendations to the Commission on Civil Law Rules on Robotics”, par. nr. 10-14.
13. EC: “Coordinated Plan on Artificial Intelligence”, 7.12.2018 COM(2018) 795 final.
14. Council of the European Union: “Artificial intelligence-Conclusions on the coordinated plan on artificial intelligence” Adoption; Brussels, 11

February 2019.

15. CEPEJ: “European Ethical Charter on the Use of Artificial Intelligence in Judicial Systems and their environment”, 4 December 2018, f. 7-12.
16. HLEG on Artificial Intelligence: “Ethics guidelines for trustworthy AI”; European Commission, 8 April 2019, f. 14-20.
17. EC: “Coordinated Plan on Artificial Intelligence 2021 Review”, 21.4.2021, COM(2021) 205 final.
18. Regulation (EU) 2024/1689 of the European Parliament and of the Council, 13.06.2024.
19. OECD: “Recommendation of the Council on Artificial Intelligence”, C/ MIN(2019) 3/FINAL, 24 May 2019.
20. World Commission on Ethics and scientific Knowledge and Technology: “Report of COMEST on Robotics Ethics”, SHS/YES/COMEST-10/17/2 REV, Paris, 14 September 2017; f. 36-52.
21. ITU Publications: “Measuring the Information Society Report”, Volume 1, 2018.
22. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000380455>; UNESCO: “Recommendation on the ethics of artificial intelligence”, 2021, f. 5-10.
23. World Health Organization guidance: “Ethics and governance of artificial intelligence for health”, 2021, f. 23-30.
24. Lydia Manikonda: “User Preferences and Privacy Concerns in Intelligent Personal Assistants”, AIES’18: Proceedings of the 2018 AAAI/ACM Conference on AI, Ethics, and Society; f. 229-235
25. Emilio Ferrara: “Fairness and Bias in Artificial Intelligence: A Brief Survey of Sources, Impacts, and Mitigation Strategies”, f. 3- 4
26. Samantha Bradshaw, Philip N. Howard: “A global inventory of organized social media manipulation”, Working paper no. 2017.12, f. 9-17.
27. David Levy: “Intimate relationships with artificial partners”, DOI: 10.26481/bdis. 20071011dl, f. 113-129, 139-148.
28. IEA: “Electricity 2024-Analysis and forecast to 2026”, Revised version, January 2024, f. 8, 31-35.
29. <https://globalewaste.org/>: UNITAR: “The Global E-Waste Monitor 2024”, f. 30.

MBROJTJA KIBERNETIKE DHE ZHVILLIMET INOVATIVE NË FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE PËR VITIN 2025

Kolonel Inxh. Gjergji VASILI
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesa e shkurtuar

Në ekosistemin digjital bashkëkohor, mbrojtja dhe siguria kibernetike është komponenti thelbësorë që formëson sigurinë, funksionalitetin dhe efikasitetin e të gjitha teknologjive aplikative aktuale. Ndërsa bota bëhet gjithnjë e më e lidhur përmes internetit, shërbimeve në “cloud”¹ dhe “Internet of things (IoT)”², mbrojtja e infrastrukturave “hardware dhe software” dhe të të dhënave digjitale nga kërcënimet kibernetike nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme si dhe teknologjitë e mbrojtjes kibernetike po evoluojnë me një ritëm tepër të shpejtë, duke ofruar mjete dhe platformë shumë të avancuara për sigurimin e këtyre “pasurive digjitale”. Mbrojtja kibernetike i referohet praktikave, teknologjive dhe proceseve të dizenuara për të mbrojtur sistemet, rrjetet dhe të dhënat nga sulmet “digjitale”, hyrjet elektronike të “paautorizuara” dhe dëmtimet e sistemeve elektronike. Në ekosistemin digjital të sotëm, mbrojtja dhe siguria

¹ Cloud: është disponueshmëria e burimeve të sistemit kompjuterik (qendrat e të dhënave), veçanërisht në ruajtjen e të dhënave, pa menaxhimin e drejtpërdrejtë aktiv nga përdoruesi, në dispozicion të shumë përdoruesve përmes internetit (National Institute of Standards and Technology.)

² IoT: është një sistem pajisjesh kompjuterike të ndërlidhura, makinerive mekanike dhe digjitale të pajisura me identifikues unik (UID) dhe aftësi për të transferuar të dhëna përmes një rrjeti pa kërkuar ndërveprim njeri-njeri ose njeri-kompjuter – sipas ITU-T Y.4000/Y.2060 (06/2012).

kibernetike luan një rol shumë thelbësor në: - mbrojtjen e “të dhënave dhe data”; - mbrojtjen e infrastrukturave kritike; - zbulimin dhe parandalimin e kërcënimeve kibernetike; - sigurimin e privatësisë dhe pajtueshmërisë; - monitorimin në kohë reale dhe pjesëmarrjen në incidente.

Përgjatë vitit 2025, pritet që platformat e mbrojtjes kibernetike të fuqizuara nga inteligjenca artificiale³, të jenë më të integruara dhe që do të jenë në gjendje të adresojnë kërcënimet kibernetike gjithnjë e më të sofistikuara. Sistemet e mbrojtjes kibernetike të drejtuara nga IA do të jenë më proaktive, adaptuese dhe inteligjente, të afta për të parashikuar dhe minimizuar kërcënimet para se ato të ndodhin. Integrimi i IA në mbrojtjes kibernetike do të ndihmojë në zgjidhjen e çdo problematike mbi disponueshmërinë e profesionistëve të kualifikuar në mbrojtjen kibernetike duke automatizuar shumë nga detyrat komplekse dhe të përsëritura që përfshihen në zbulimin e kërcënimeve dhe përgjigjen ndaj incidenteve. Ekosistemi i ardhshëm digjital do të karakterizohet nga sisteme të mbrojtjes kibernetike që “mësojnë dhe evoluojnë”, duke përdorur IA për të ofruar mbrojtje në kohë reale dhe adaptuese kundër një gamë gjithnjë e më të gjerë kërcënimesh që po shfaqen. Për të realizuar vërtet këto inovacione, Institucionet qeveritare dhe të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe hulumtuesit duhet të thellojnë bashkëpunimin për të adresuar sfidat etike, teknike dhe teknologjike dhe rregullatore që lindin nga kryqëzimi i mbrojtjes kibernetike dhe inteligjenca artificiale.

Fjalët kyçe: ekosistemi digjital, mbrojtja digjitale, mbrojtja kibernetike, kërcënimet dhe krimi kibernetik, infrastruktura kritike e informacionit, inteligjenca artificiale, “cloud”, “IoT”, “ransomware”, komputimi dhe kompjuteri kuantik, kriptografi, sistemet “autonome”, qytetet “smart”, “startup”, teknologjia “blockchain”

Hyrje

Përgjatë vitit 2025, kërcënimet kibernetike do të vazhdojnë të evoluojnë në kompleksitet, duke synuar individë, biznese, infrastrukturën kritike, Institucionet qeveritare si dhe ato të sigurisë dhe mbrojtjes. Kriminelët kibernetikë do të përdorin gjithnjë e më shumë teknologji të avancuara për të kryer sulme. Organizatat kriminale do të operojnë në një mënyrë më të organizuar

³ Inteligjenca artificiale (AI): i referohet aftësisë së sistemeve elektronike llogaritëse për të kryer detyra që lidhen me inteligjencën njerëzore si të mësuarit, arsyetimi, zgjidhja e problemeve, perceptimi dhe vendimmarrja. Fushë kërkimi në shkencat kompjuterike që zhvillon dhe studion metoda dhe aplikacione që mundëson makineritë të perceptojnë mjedisin dhe të përdorin mësimin dhe inteligjencën për veprime që maksimizojnë shanset e tyre për të arritur qëllimet e përcaktuara.

dhe profesionale, duke përdorur mjete si “ransomware-as-a-service” dhe grupe “phishing”, të cilat lejojnë edhe individë me aftësi të kufizuara të kryejnë sulme në shkallë të gjerë. Krimi kibernetik do të vazhdojë të rritet, duke synuar të dhënat personale, sistemet financiare dhe pronën intelektuale, sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes, me një fokus në rritje për shfrytëzimin e dobësive në teknologjitë e reja. Sulmet kibernetike të sponsorizuara nga shteti po bëhen një kërcënim i rëndësishëm për sigurinë kombëtare dhe stabilitetin global. Përgjatë vitit 2025, kërcënimet kibernetike do të jenë më të përhapura dhe më shkatërruese, të nxitura nga rritja e përdorimit të infrastrukturës digjitale, teknologjive të avancuara si dhe të inteligjencës artificiale duke i bërë këto sulme më adaptuese dhe më të vështira për t’u zbuluar. Mbrojtja kibernetike do të kërkojë inovacion të vazhdueshëm në masat dhe teknologjitë e sigurisë kibernetike, së bashku me bashkëpunimin ndërkombëtar për të trajtuar rreziqet e reja në ekosistemin digjital si pjesë e strategjive gjeopolitike. Kërcënimet kibernetike ndaj sigurisë së Aleancës janë komplekse, shkatërruese dhe shtrënguese dhe po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Hapësira kibernetike është e kontestuar në çdo kohë dhe ngjarjet e dëmshme kibernetike ndodhin çdo ditë, nga sulme të nivelit të ulët deri tek ato teknologjikisht të sofistikuar.

Si do të evoluojnë kërcënimet kibernetike në 2025:

Tendencat kryesore

Kërcënime kibernetike dhe fizike - Integrimi në rritje i sistemeve kibernetike dhe fizike në sektorë si energjia, transporti, shëndetësia, mbrojtja dhe siguria do të ekspozojë dobësi të reja. Sulmet kibernetike ndaj rrjeteve “smart”, automjeteve autonome, sistemeve të kontrollit industrial, sistemet e mbrojtjes dhe të emergjencave civile mund të çojnë në ndërprerje të funksionalitetit operacional, duke ndikuar potencialisht në sigurinë publike, stabilitetin ekonomik dhe sigurinë kombëtare. Kriminelët kibernetikë mund të fillojnë të targetojnë infrastrukturën kritike me sulme “ransomware”. Kjo do të përfshijë bllokimin e centraleve të energjisë, sistemet e transportit, sistemet e mbrojtjes duke shkaktuar ndërprerje të gjerë dhe mundësisht edhe dëme fizike nëse këto sisteme nuk mbrohen siç duhet.

Kërcënime të avancuara të qëndrueshme (*advanced persistent threats*)⁴ - Kërcënimet e avancuara të qëndrueshme do të vazhdojnë të evoluojnë, duke u

⁴ Advanced persistent threat (APT): është një sulm i fshehtë kibernetik në një rrjet kompjuterik ku sulmuesi fiton dhe ruan akses të paautorizuar në rrjetin e synuar dhe mbetet i pazbuluar për një periudhë të konsiderueshme dhe ndërmjet infeksionit dhe rehabilitimit, hakeri monitoron, përgjon dhe transmeton informacione dhe të dhëna të ndjeshme. Synimi është të eksfiltrtojë ose vjedhë të dhëna në vend që të shkaktojë ndërprerje të rrjetit, mohim të shërbimit ose të infektojë sistemet me malware [4].

bërë më të sofistikuar si dhe më të vështira për t'u zbuluar. Këto sulme, zakonisht të sponsorizuara nga shteti, kanë për qëllim infiltrimin dhe qëndrimin në një rrjet të caktuar për periudha të gjata kohore, duke vjedhur të dhëna të çmuara ose duke sabotuar infrastrukturën. Përgjatë vitit 2025, kërcënimet e avancuara të qëndrueshme do të përdorin shumë “malware” të fuqizuar nga IA për t'u adaptuar dhe shpëtuar nga detektimi, duke e bërë më të vështirë për Institucionet qeveritare, mbrojtjes dhe sigurisë dhe organizatat të identifikojnë dhe lehtësojnë kërcënimin. Kërcënimet e avancuara të qëndrueshme do të targetojnë gjithnjë e më shumë “zinxhirët e furnizimit (*supply chain attack*)”⁵, duke shfrytëzuar furnizuesit e palës së tretë dhe ofruesit e aplikacioneve për të fituar akses në sisteme më të mëdha dhe më të sigurta.

Rritje të “automatizimit” të sulmeve kibernetike - Përgjatë vitit 2025, kriminelët kibernetikë do të zhvillojnë “korniza të plota automatike” sulmesh digjital që mund të kryejnë sulme të koordinuara multi-vektoriale pa ndërhyrje njerëzore. Këto sisteme mund të përdorin inteligjencë artificiale për të “mësuar” nga sulmet që janë duke ndodhur, për t'u adaptuar ndaj sistemeve mbrojtëse të reja dhe për të optimizuar strategjitë, duke i bërë më të vështira për t'u parandaluar dhe për t'u përgjigjur.

Sulme të fuqizuara nga inteligjenca artificiale - Sulmuesit digjitalë do të përdorin inteligjencën artificiale dhe “mësimin e makinerisë”⁶ për të automatizuar dhe përmirësuar sulmet e tyre. IA do të përdoret për të imituar sjelljen e përdoruesve legjitimë, për të kaluar mbrojtjet tradicionale dhe për t'u adaptuar në kohë reale ndaj masave të kundërsulmeve të sigurisë kibernetike. Teknologjia “deep fake” mund të përdoret gjithashtu për të realizuar sulme kibernetike më të besueshme të inxhinierisë sociale, si “spear-phishing” ose për të imituar individë ose institucione të besuara. Ndërsa teknologjitë si “5G, IoT dhe kompjutimi kuantik (*quantum computing*)”⁷ bëhen më të zhvilluara, kriminelët kibernetikë do të shfrytëzojnë gjithnjë e më shumë dobësitë në këto fusha. Rrjetet “5G” do të ofrojnë një sipërfaqe më të gjerë sulmi digjital, duke lejuar mundësinë që hakerët të ndërpresin shërbimet ose të kapin të dhëna të ndjeshme dhe sensitive nga një gamë e gjerë pajisjesh. Teknologjia “IoT” do

⁵ Supply chain attacks: sulme indirekte që synojnë varësitë e palëve të treta - të referuara kolektivisht si një “zinxhir furnizimi – për të depërtuar në sistemin ose rrjetin e një objekti. Këto sulme quhen edhe “sulme të palëve të treta” [5].

⁶ Machine learning (ML): është një fushë studimi në inteligjencën artificiale që merret me studimin dhe zhvillimin e algoritmeve statistikore që mund të mësojnë nga të dhënat dhe të përgjithësohen në të dhëna të padukshme dhe kështu të kryejnë detyra pa udhëzime të qarta.[2].

⁷ Kompjuteri kuantik (QC) është një kompjuter që shfrytëzon fenomene të mekanikës kuantike, ku lënda fizike shfaq vetitë e grimcave dhe valëve dhe llogaritja kuantike përfiton nga kjo sjellje duke përdorur pajisje të specializuara. Kompjuteri kuantik i shkallëzuar mund të kryejë disa llogaritje në mënyrë eksponenciale më shpejt se çdo kompjuter modern «klasik» [3].

të paraqesë gjithashtu rreziqe të tjera për shkak të pajisjeve të saj të përhapura dhe shpesh të pasigurura. Për shumë agjenci qeveritare, të sigurisë dhe mbrojtjes apo biznese që mbështeten në shërbimet e “cloud” për operacionet e tyre tekniko-administrative dhe financiare, sulmet në bazë të “cloud-it” do të rriten. Kriminelët kibernetikë mund të shfrytëzojnë dobësitë në ruajtjen e “cloud”-it ose konfigurimet e gabuara në infrastrukturën “cloud”⁸ për të fituar akses të paautorizuar në të dhëna dhe sisteme të ndjeshme.

“Targetimi” i sistemeve të inteligjencës artificiale - Ndërsa IA bëhet më e integruar në agjencitë qeveritare, sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes, biznese, ajo do të bëhet gjithashtu një objektiv për sulmuesit digjitalë. Teknikat si “helmimi i të dhënave (*data poisoning*)” dhe “mësimi i makinerisë kundërshtarë” (*adversarial machine learning*) mund të përdoren për të manipuluar algoritmet e IA, duke dëmtuar efektivitetin e sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike të bazuara në IA ose duke shkaktuar që aplikacionet e drejtuara nga IA të sjellin qasje të paparashikuara.

Kërcënimet kibernetike për teknologjinë “internet of things” - Rrjetet e pajisjeve elektronike të lidhura në teknologjinë “IoT”, si pajisje “smart”, teknologji dhe sensorët industrialë, etj., që pritet të shtohen ndjeshëm përgjatë vitit 2025, do të sjellin vulnerabilitete të reja dhe do të rrisin “sipërfaqen” e sulmeve digjitale, sikurse siguri i mbrojtjes së tyre që nga faza e dizajnit do të bëhet një prioritet. Prodhuarit do të kërkojnë të integrojnë “enkriptime” të fortë, mekanizma të sigurt përditësimesh të “firmware” për të mbrojtur pajisjet nga aksesimet e paautorizuara dhe shfrytëzimin e largët. Ndërsa pajisjet “IoT” operojnë në ekosisteme digjitale gjithnjë e më komplekse, siguri i “autentifikimit të sigurt” të pajisjeve do të jetë një prioritet. Përgjatë vitit 2025, sistemet e bazuara në IA do të përdoren për të menaxhuar dinamikisht “identitetet” e pajisjeve dhe për të zbatuar politikat e kontrollit të aksesit, duke siguruar që vetëm pajisjet e autorizuara mund të lidhen me rrjetet “IoT”. Rrjetet “IoT” do të kërkojnë mbrojtje më të forta kundër “botnets” dhe sulmeve “DDoS”, pasi sulmuesit digjitalë mund të shfrytëzojnë pajisje të dobëta për të kryer sulme kibernetike në shkallë të gjerë. Sistemet e zbulimit të ndërhyrjes-depërtimit (*intrusion detection systems*)⁹ dhe “segmentimi i rrjetit” do të përdoren për të parandaluar që sulmet bazuar në “IoT” të përhapen nëpër rrjete.

Siguria kibernetike në sistemet “autonome” - Sistemet autonome, përfshirë mjetet e vetëdrejtuara, dronët (civil dhe ushtarak) dhe makineritë industriale të automatizuara, do të përballen me shqetësime të theksuara në lidhje me

⁸ <https://cloudsecurityalliance.org/> (2009–2025 Cloud Security Alliance).

⁹ Intrusion detection system (IDS): janë sisteme sigurie rrjeti që monitorojnë trafikun e rrjetit dhe pajisjet për aktivitetet e njohura keqdashëse, aktivitetet të dyshimta ose shkelje të politikave të sigurisë [6]

sigurinë të varësia e tyre nga sensorët, softuerët dhe rritjet e rrjeteve të komunikimit. Në mjetet autonome dhe dronët, siguria kibernetike do të duhet të sigurojë që mjetet të mos hakohen (*haked*) dhe të ndryshojnë navigimin ose sistemet e kontrollit, duke shkaktuar aksidente ose keqpërdorime. Enkriptimi “fund-për-fund” (end-to-end encryption), protokollat e sigurt të komunikimit dhe zbulimi i anomalive të bazuar në IA do të përdoren për të parandaluar ndërhyrjet e dëmshme në sistemet autonome. Sistemet autonome do të luajnë një rol shumë të madh në industri si transporti, energjia, prodhimi si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Sigurimi i këtyre sistemeve nga sulmet kibernetike është thelbësor për të parandaluar ndërprerjet e shërbimeve dhe operacionalitetit, rreziqet mjedisore ose humbjet financiare, ku mbrojtjet e protokolleve të sigurisë dhe monitorimi në kohë reale do të jetë thelbësore për zbulimin dhe minimizimin e shpejtë të kërcënimeve kibernetike. Sistemet autonome do të varen gjithnjë e më shumë nga intelijenca artificiale dhe “machine learning” në proceset e vendimmarrjes. Sistemet e sigurisë kibernetike do të duhet të mbrojnë modelet e IA nga manipulimi ose sulmet kundërshtarë që mund të komprometojnë aftësitë vendimmarrëse të sistemit.

Siguria kibernetike në qytetet “smart” - Qytetet “smart” janë mjedise urbane të ndërlidhura shumë, të cilat përdorin teknologjinë IoT, “big data” dhe inteligjencë artificiale për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve dhe për të optimizuar shërbimet e qytetit. Sasia e madhe e të dhënave që gjenerohen dhe ndërlidhja e infrastrukturës kritike, sjell që qytetet “smart” janë objektiva kryesore për sulmet kibernetike. Masat e sigurisë kibernetike si “segmentimi i rrjetit”, arkitekturat “zero-trust”¹⁰ dhe sistemet e monitorimit të drejtuara nga IA do të jenë thelbësore për të mbrojtur këto sisteme kritike. Enkriptimi i të dhënave, teknologjitë që ruajnë privatësinë (si enkriptimi homomorfik) dhe protokollat e sigurt të shpërndarjes së të dhënave do të jenë thelbësore për të mbrojtur informacionet e ndjeshme nga aksesit-qasjet e paautorizuara. Këto sisteme do të kërkojnë protokolle të forta të sigurisë kibernetike për të siguruar që sulmuesit nuk mund t’i manipulojnë sistemet.

Sulmet “ransomware”¹¹ - Kriminelët kibernetikë po përdorin “ransomware” për të ndërprerë operacionet, vjedhur të dhëna të ndjeshme dhe shantazhuar viktimat për para.

¹⁰Zero trust architecture (ZTA): arkitektura e “besimit zero” ose siguria “pa perimetër” është një strategji projektimi dhe zbatimi i sistemeve të TI-së. Parimi është që përdoruesve dhe pajisjeve nuk u besohet si parazgjedhje edhe nëse ata janë të lidhur me një rrjet të privilegjuar (LAN) dhe edhe nëse janë “verifikuar” më parë [7].

¹¹Ransomware: është një formë “malware” që bllokoi përdoruesin nga skedarët ose pajisja e tij, më pas kërkon një pagesë për të rivendosur aksesin. Sulmuesit e Ransomware godasin bizneset, organizatat dhe individët [8].

Sulmet “phishing” - Sistemet e drejtuara nga IA do të mundësojnë skema “phishing” më të besueshme që mund të kalojnë metodat tradicionale të zbulimit.

Përgjatë vitit 2025, kërcënimet kibernetike do të bëhen më të synuara, më të qëndrueshme dhe më të adaptueshme, pasi kundërshtarët do të përdorin teknologji të reja si IA dhe “mësimi i makinerisë” për të përmirësuar sulmet e tyre digjitale. Kërcënimet e avancuara të qëndrueshme do të jenë më të fshehta dhe më të vështira për t’u zbuluar dhe kriminelët kibernetikë do të fokusohen gjithnjë e më shumë në infrastrukturën kritike, dobësitë e teknologjisë “cloud-it” dhe teknikat e reja. Sfidë kryesore do të jetë mbrojtja përpara kërcënimeve që evoluojnë, duke implementuar masa të avancuara sigurie dhe nxitur dhe forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar për të luftuar “peizazhin” në rritje të kërcënimit kibernetik.

Në vitin 2025, automatizimi do të jetë një karakteristikë kryesore e zgjidhjeve të mbrojtjes dhe sigurisë kibernetike të fuqizuara nga IA, duke mundësuar kohë më të shpejtë reagimi dhe duke zvogëluar ngarkesën mbi analistët e sigurisë njerëzore. Platformat e “orkestrimit” të sigurisë, automatizimit dhe përgjigjes të fuqizuara nga IA do të ofrojnë përgjigje autonome të shpejtë ndaj incidenteve, duke reduktuar kohën që i duhen për të reaguar ndaj sulmeve kibernetike dhe duke siguruar që sistemet kritike të rikuperohen shpejt. Ky automatizim gjithashtu do të ndihmojë në shmangien e gabimeve njerëzore dhe në uljen e ngarkesës operative mbi ekipet e mbrojtjes kibernetike, duke u mundësuar atyre të përqendrohen në detyra më strategjike.

Zgjidhjet e “zbulimit dhe përgjigjes në pikën e fundit” (endpoint detection and response)¹² të fuqizuara nga IA, do të jenë më të afta të identifikojnë aktivitetin keqdashës në pajisje të tilla si laptopët, serverët dhe telefonat celularë. Me rritjen e rrjeteve dhe teknologjive “5G” dhe “internet of things” në vitin 2025, zgjidhjet e “segmentimit të rrjetit” dhe kontrollit të aksesit të udhëhequra nga IA do të bëhen thelbësore për të mbrojtur rrjetet e mëdha dhe të ndërlikuara, duke kontrolluar automatikisht se cilat pajisje mund të komunikojnë dhe duke siguruar që çdo nyje e kompromentuar të izolohet shpejt. Bashkëpunimi midis organizatave, industrive dhe qeverive do të jetë thelbësor për përmirësimin e mbrojtjeve të përgjithshme të sigurisë kibernetike.

¹²Endpoint detection and response (EDR): teknologjia e sigurisë kibernetike që monitoron pikat përfundimtare për prova të kërcënimeve dhe kryen veprime automatike për të ndihmuar në zbutjen e tyre. Zgjidhjet EDR ndihmojnë analistët e sigurisë të zbulojnë dhe korrigjojnë kërcënimet në pikat fundore përpara se ato të përhapen në të gjithë rrjetin, mund të kryejë veprime automatike për të frenuar kërcënimet dhe për të alarmuar profesionistët e sigurisë [9].

Si do të zhvillohet mbrojtja kibernetike në 2025: Tendencat kryesore

Mbrojtja kibernetike e bazuar në inteligjencën artificiale - Përgjatë vitit 2025, pritet që mbrojtja kibernetike e fuqizuar nga inteligjenca artificiale të luajë një rol kryesor në forcimin e mbrojtjes ndaj kërcënimeve kibernetike gjithnjë e më të sofistikuar. Sistemet e bazuara në IA do të ofrojnë mundësi të avancuara për zbulimin e kërcënimeve, analizën e sjelljes dhe menaxhimin e përgjigjeve, duke përmirësuar ndjeshëm shpejtësinë, saktësinë dhe efikasitetin e përpjekjeve të sigurisë kibernetike. Mënyra se si IA do të revolucionarizojë mbrojtjen kibernetike mund të përmblihet në këto fusha: - zbulimin e kërcënimeve të bazuar në IA; - zbulimin në kohë reale të anomalive (identifikimin e menjëhershëm të kërcënimeve të mundshme, si infektimet me “malware”, tentativat e “phishing”, ose hyrje të paautorizuara); - kërkimin “aktiv” të kërcënimeve, ku algoritmet e “mësimit të makinerive” kërkojnë shenja të fshehta të sulmeve që mund të kenë shpëtuar nga mbrojtjet tradicionale; - analizimin e “sjelljes” të bazuar në IA (*“biometrikat e sjelljes”*); - sistemet e përgjigjes të fuqizuara dhe drejtuara nga IA (*përgjigja “automatike” ndaj ngjarjeve*).

Arkitektura “zero trust” - Përgjatë vitit 2025, pritet që arkitektura “zero trust” të bëhet një model kryesor i sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike. Qasja “zero trust”, e bazuar në parimin “asnjëherë mos besoni, gjithmonë verifikoni”, supozon se asnjë përdorues, pajisje, ose sistem – qoftë brenda apo jashtë rrjetit – nuk duhet të besohen automatikisht. Ky model po fiton rëndësi për disa arsye që lidhen me ndryshimet në peizazhin e mbrojtjes kibernetike si: - rritja e kompleksitetit të mjediseve të teknologjisë së informacionit si në adoptimin e “cloud”-it, dhe “punës në distance dhe remote”; - kërcënimet kibernetike në rritje dhe zhvillim (*kërcënimet e brendshme, lëvizja “anësore”*); - kontrollin e detajuar i aksesit/hyrjes në sisteme; - mbështetjen për teknologjitë moderne të sigurisë: - presionet rregullatore dhe të pajtueshmërisë.

Komputimi kuantik (*quantum computing*) - Përgjatë vitit 2025, komputimi kuantik do të fillojë të ketë një ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen kibernetike, veçanërisht në fushën e kriptografisë dhe mbrojtjes së të dhënave. Ndërsa kompjuterët “kuantikë” janë ende në zhvillim, potenciali i tyre për të thyer metodat aktuale të enkriptimit paraqet një kërcënim të rëndësishëm për sigurinë e sistemeve digjitale. Ndikimet e komputimit kuantik në mbrojtjen kibernetike përgjatë vitit 2025 parashtrohen si më poshtë:

- **Komputimi kuantik dhe kriptografia:** Kompjuterët kuantikë kanë potencialin të thyejnë algoritmet e kriptografisë të përdorura gjerësisht që mbështeten në vështirësinë e problemeve matematikore, si enkriptimi RSA

dhe kriptografia me “kurba eliptike” dhe “elliptic curve cryptography”¹³. Kompjuterët kuantikë mund të zgjidhin probleme shumë më efikase duke përdorur algoritmin “Shor”, i cili mund të ndajnë numrat e mëdhenj shumë më shpejt se algoritmet klasike. Kompjuteri kuantik mund të dëmtojë themelet e infrastrukturës së “çelësit publik” duke bërë që “enkriptimi” RSA dhe ECC të jenë të prekshëm ndaj sulmeve, duke e bërë të nevojshme kalimin në algoritme kriptografike të rezistencës kuantike (*quantum-resistant cryptographic algorithms*)¹⁴.

- **Kriptografia post-kuantike** (*post-quantum cryptography*)¹⁵: Përballë kërcënimit kibernetik që paraqet kompjuteri kuantik, po zhvillohet kriptografia post-kuantike, ku algoritmet kriptografike janë projektuar për të qenë më të sigurt kundër sulmeve të bazuara në kuantike, ndërkohë që janë mjaft efikase për t’u përdorur në aplikacione të përditshme. Përgjatë vitit 2025, do të bëhen përpertime të rëndësishëm në standardizimin dhe adoptimin e këtyre algoritmeve të rezistencës kuantike.

- **Sistemet kriptografike hibride**: Në të ardhmen e afërt, mund të implementohen sisteme enkriptimi “hybrid”, duke kombinuar kriptografinë tradicionale me algoritmet post-kuantike për të siguruar pajtueshmërinë me kompjuterët klasikë dhe kuantikë derisa të përfundojë kalimi në sisteme të plota të sigurt kundër kuantikëve.

- **Shpërndarja e çelësve kuantikë** (quantum key distribution dhe QKD)¹⁶: Shpërndarja e çelësve kuantikë është një teknologji që përdor parimet e mekanikës kuantike për të shkëmbyer “çelësa kriptografikë” në mënyrë të sigurt. Ndryshe nga metodat tradicionale të shkëmbimit të çelësve, QKD është teorikisht imun ndaj dëgjimit të “fshehtë” sepse çdo përpjekje për të ndërhyrë në çelësin kuantik do të ndryshonte gjendjen e tij, duke lajmëruar të dy palët për një mundësi shkeljeje. Përgjatë vitit 2025, distribuimi i çelësve kuantikë mund të fillojë të luajë një rol të rëndësishëm në sigurimin e rrjeteve të komunikimit, veçanërisht për të dhënat shumë të ndjeshme. Ajo ofron një nivel sigurie që kriptografia tradicionale nuk mund ta arrijë, duke siguruar një shtresë shtesë mbrojtjeje në një botë pas-kuantike.

¹³Elliptic curve cryptography (ECC): teknikë e bazuar në çelësa (çifte çelësash) publikë dhe privatë për deshifrimin dhe enkriptimin e trafikut në internet dhe të të dhënave, në kontekstin e algoritmit kriptografik Rivest–Shamir–Adleman (RSA), që arrin enkriptimin në një drejtim të emailleve, të dhënave dhe softuerëve duke përdorur faktorizimin kryesor [10].

¹⁴ <https://www.technologyreview.com/2022/09/14/1059400/explainer-quantum-resistant-algorithms/>

¹⁵ <https://www.nist.gov/cybersecurity/what-post-quantum-cryptography>.

¹⁶ <https://www.nsa.gov/Cybersecurity/Quantum-Key-Distribution-QKD-and-Quantum-Cryptography-QC/>

Kalimi dhe tranzicioni në mbrojtjen kibernetike “siguri-kuantike”:

Përgjatë vitit 2025, siç avancon komputimi kuantik, peizazhi i mbrojtjes kibernetike do të shohë një kalim të ngadalshëm drejt praktikave të mbrojtjes kuantike. Ky kalim do të përfshijë: - përditësimin e standardeve të enkriptimit; - rrjete të sigurta kuantike; - kërkime shkencore të pashkëputura-vazhdueshme (vazhdimi i investimeve në kërkime për komputimin kuantik dhe inovacionet në sigurinë kibernetike për të qëndruar përpara kërcënimeve të reja kuantike).

Zhvillimi i teknologjia “blockchain” për mbrojtjen kibernetike -

Në vitin 2025, pritet që teknologjia “blockchain” të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e sigurisë kibernetike duke rritur integritetin e të dhënave dhe proceset e auto-entifikimit. Natyrshmëria e decentralizuar, e pandryshueshme dhe transparente e “blockchain” e bën atë një mjet të shkëlqyer për të adresuar shumë prej sfidave të sigurisë në sistemet digjitale. Forca kryesore e “blockchain” është aftësia e tij për të siguruar që të dhënat të jenë të paprekshme dhe të pandryshueshme. Teknologjia “blockchain” përmirëson proceset e autentifikimit duke ofruar metoda më të sigurta, të decentralizuara dhe të verifikueshme për përdoruesit për të provuar identitetin e tyre. “Blockchain” do të përdoret për të krijuar identitete të vetë-kontrolluara, ku individët kontrollojnë informacionin e tyre të identitetit, i cili ruhet në “blockchain”. Kjo ul rrezikun e vjedhjes ose mashtrimit të identitetit, pasi përdoruesit mund të ndajnë të dhënat e verifikuara të identitetit pa ekspozuar informacionin e panevojshëm personal. “Blockchain” mund të përdoret gjithashtu për të zbutur rreziqet e lidhura me sulmet e shpërndara të mohuara të shërbimit (DDoS) dhe “malware”. “Blockchain” përmirëson komunikimin e sigurt duke siguruar që mesazhet ose të dhënat që dërgohen midis palëve të mos mund të ndërhyhet apo manipulohet. “Blockchain” mund të kombinohet me kriptimin nga “pika-në-pikë” (*end-to-end encryption*) për të siguruar komunikimet, duke ofruar një “shtresë shtesë verifikimi” dhe duke siguruar që vetëm “marrësi i synuar” të ketë akses në mesazhin.

Rritja e startup-eve të mbrojtjes dhe sigurisë kibernetike të drejtuara nga IA. Bashkëpunimi ndërkombëtar për të luftuar krimin kibernetik

Në vitin 2025, “startup”-et e sigurisë kibernetike të drejtuara nga IA dhe bashkëpunimi ndërkombëtar do të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër tablosë gjithnjë e më të sofistikuar të krimit kibernetik. Me kërcënimet kibernetike që po evoluojnë me një ritëm të paprecedent, modelet tradicionale të sigurisë kibernetike nuk do të mjaftojnë më për të mbrojtur individët, bizneset, agjencitë qeveritare si dhe ato të sigurisë dhe mbrojtjes. Për të përballuar këto sfida të reja, zgjidhjet e fuqizuara-udhëhequra nga IA dhe bashkëpunimi ndërkombëtar do të bëhen thelbësore për të siguruar mbrojtjen e infrastrukturave digjitale dhe mbrojtjen e informacionit kritik.

Mbrojtja kibernetike dhe inovacionet për sigurinë kibernetike në NATO, përgjatë vitit 2025

NATO dhe Aleatët e saj mbështeten në mbrojtje kibernetike të forta dhe elastike për të përmbushur detyrat kryesore të Aleancës. Hapësira kibernetike është e kontestuar në çdo kohë, pasi aktorët e dëmshëm përpiqen gjithnjë e më shumë të destabilizojnë Aleancën duke përdorur aktivitete dhe fushata kibernetike të dëmshme. Përgjatë vitit 2025, mbështetur në Konceptin Strategjik të vitit 2022¹⁷ dhe iniciativën NATO 2030¹⁸, NATO po zhvillon ndjeshëm aftësitë e saj teknologjike të mbrojtjes kibernetike përmes inovacioneve strategjike, iniciativave bashkëpunuese dhe integritit të teknologjive të reja, duke prezantuar disa risi inovatore në mbrojtje dhe siguri kibernetike. Këto përparime teknologjike pasqyrojnë angazhimin e NATO-s për të luftuar kërcënimet e reja kibernetike, për të integruar teknologji të avancuara dhe për të nxitur bashkëpunimin me industrinë dhe shtetet anëtare. Teknologjitë si inteligjenca artificiale, sistemet autonome, teknologjitë kuantike dhe rrjetet e komunikimit të gjeneratës së ardhshme po ndryshojnë botën dhe mënyrën se si NATO operon. Teknologjitë e reja paraqesin si rreziqe ashtu edhe mundësi të reja për NATO-n dhe Aleatët për të zhvilluar dhe adoptuar teknologjitë e reja dhe avancuara, për të vendosur parime ndërkombëtare të përdorimit të përgjegjshëm të tyre, për të ruajtur avantazhin teknologjik përmes inovacionit, duke rritur bashkëpunimin me partnerë nga sektori publik dhe privat, akademi dhe shoqërinë civile. Zhvillimet kryesore teknologjike për mbrojtjen kibernetike në NATO përgjatë vitit 2025 përmbledhen në këto drejtime kryesore:

Krijimi i Qendrës së Integruar të Mbrojtjes Kibernetike - NATO po krijon qendrën e re të integruar të mbrojtjes kibernetike, e cila pritet të jetë plotësisht funksionale deri në vitin 2028, me seli në Mons, Belgjikë. Kjo qendër do të bashkojë entitetet ekzistuese të mbrojtjes kibernetike, si Qendrën e Sigurisë Kibernetike, Qendrën e Operacioneve Kibernetike dhe Degën e Analizës së Kërcënimeve Kibernetike për të ofruar një qasje të unifikuar ndaj mbrojtjes kibernetike dhe të shpejtojë kohën e reagimit në të gjitha vendet anëtare¹⁹. Ajo synon të përmirësojë mbrojtjen e rrjeteve të NATO-s dhe aleatëve duke integruar ekspertizën civile dhe ushtarake, duke shfrytëzuar teknologjitë e avancuara dhe duke promovuar një qasje të bazuar në norma, të parashikueshme dhe të sigurtë ndaj hapësirës kibernetike.

Iniciativat për mbrojtje kibernetike të drejtuara nga inteligjenca artificiale - NATO, duke njohur përdorimin në rritje të inteligjencës artificiale

¹⁷ https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_210907.htm

¹⁸ <https://www.nato.int/nato2030/>

¹⁹ https://thedefensepost.com/2024/12/09/nato-cyber-defense-center/?utm_source=chatgpt.com

në mbrojtjen kibernetike, ka rritur fokusin në zhvillimin e mekanizmave të mbrojtjes kibernetike të përmirësuar me IA. Mbretëria e Bashkuar ka nisur krijimin e një laboratorit të ri kushtuar kundërpërgjigjes ndaj kërcënimeve kibernetike ruse, veçanërisht atyre që përfshijnë IA. Ky laborator do të bashkëpunojë me agjencitë e inteligjencës, institucionet akademike dhe industrinë teknologjike për të zhvilluar mjete të avancuara të mbrojtjes kibernetike²⁰.

Programi “Përsheptuesi i Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut dhe Fondi i Inovacionit” - DIANA (*Defense Innovation Accelerator for the North Atlantic dhe DIANA*) po zgjeron rrjetin e tij, tani me 23 qendra përsheptuese dhe 182 qendra testimi në 28 vende aleate, që përqendrohet në mbështetjen e startup-eve të teknologjisë së thellë që punojnë në teknologji me përdorim të dyfishtë, përfshirë ato të lidhura me mbrojtjen kibernetike. Fondi i Inovacionit të NATO-s, me një buxhet prej 1 miliard €, investon në këto startup-e për të nxitur inovacionin në fusha kritike për sigurinë e aleatëve. Kur të jetë plotësisht funksional këtë vit, DIANA do të ketë kapacitetin për të punuar qindra inovatorë çdo vit në një rrjet edhe më të gjerë qendrash përsheptuese dhe testimi në të gjithë Aleancën²¹.

Zhvillimi i një “sistemi imunitar kibernetik” - Strategjia e re teknologjike e NATO-s²² përshkruan planet për të zbatuar arkitektura moderne kibernetike në të gjithë vendet anëtare, duke vënë theksin te parimet e “besimit zero” dhe integrimi i sigurt i teknologjive të informacionit dhe atyre operacionale. Një komponent kyç i kësaj strategjie është zhvillimi i një «sistemi imunitar kibernetik» i aftë për të zbuluar, riparuar dhe përshtatur në mënyrë “autonome” ndaj kërcënimeve kibernetike. Ky sistem synon të përmirësojë aftësinë e Aleancës për të reaguar shpejt dhe efektivisht ndaj incidenteve kibernetike.

Zbatimi i kriptografisë post-kuantike - Duke njohur rreziqet e mundshme që sjell llogaritja kuantike për metodat tradicionale të enkriptimit, NATO i ka dhënë përparësi miratimit të zgjidhjeve kriptografike post-kuantike (PQC)²³. Qendra e Sigurisë Kibernetike e NATO-s ka testuar me sukses rrjedhat e komunikimit të sigurt duke përdorur një rrjet privat virtual (VPN) që përfshin algoritme PQC. Kjo qasje hibride kombinon kriptimin tradicional dhe atë rezistent ndaj kuantikut për të siguruar komunikime të sigurta edhe përballë përparimeve të llogaritjes kuantike.

²⁰ https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_184303.htm?utm_source=chatgpt.com

²¹ https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_216199.htm

²² https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_229801.htm#footnote1

²³ https://www.ncia.nato.int/about-us/newsroom/nato-cyber-security-centre-experiments-with-secure-network-capable-of-withstanding-attack-by-quantum-computers?utm_source=chatgpt.com

Përparimi i teknologjisë të “shpërndarjes kuantike të çelësave” - NATO po eksploron përdorimin e teknologjisë së “shpërndarjes kuantike të çelësave (*Quantum Key Distribution dhe QKD*) për të krijuar kanale komunikimi të sigurt, të cilat janë natyrshëm rezistente ndaj përgjimeve. QKD shfrytëzon parimet e mekanikës kuantike për të mundësuar shkëmbimin e çelësave të kriptimit në një mënyrë që zbulon çdo përpjekje përgjimi, duke garantuar kështu konfidencialitetin dhe integritetin e komunikimeve.

Bashkëpunimi industri - akademi përmes programit DIANA - Në muajin shkurt 2025 (datat: 25-27), DIANA lançoi “Continuum-in e Inovacionit” në Turqi, një platformë për eksperimentimin me teknologji inovative në operacione shumë-domen dhe transformim digjital. Kjo iniciativë përfshin bashkëpunimin me industrinë, akademinë dhe palët e interesuara të NATO-s për të përshpejtuar adoptimin e zgjidhjeve inovative, përfshirë ato të lidhura me mbrojtjen kibernetike²⁴.

Forcimi i qëndrueshmërisë kibernetike nga infrastruktura kritike - Duke njohur cenueshmërinë e infrastrukturës kritike, NATO (*NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence dhe CCDCOE*) po udhëheq kërkime për sigurimin e rrjeteve “5G” për lëvizshmërinë ushtarake. Projekti, i financuar nga Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së dhe Ministria e Jashtme e Estonisë²⁵, synon të ofrojë rekomandime për operimin në mënyrë të sigurt brenda rrjeteve tregtare evropiane “5G” gjatë operacioneve ushtarake. Për më tepër, NATO po zhvillon stërvitje për të trajnuar vendet në përgjigje ndaj sulmeve kibernetike ndaj burimeve të energjisë së rinovueshme, duke adresuar zinxhirët e ndërlikuar të furnizimit dhe vektorët e rinj të kërcënimeve të lidhur me këto sisteme.

Bashkëpunimi i përmirësuar i BE-së me NATO-n në fushën kibernetike - Në tetor 2024²⁶, Bashkimi Evropian dhe NATO zhvilluan dialogun e parë të strukturuar për çështjet kibernetike, me qëllim forcimin e bashkëpunimit nësigurinë kibernetike dhe mbrojtjen kibernetike. Dialogu u përqendrua në rritjen e koordinimit për të zbuluar, parandaluar dhe mbrojtur kundër sulmeve kibernetike, si dhe në harmonizimin e kornizave të mbrojtjes kibernetike për të reaguar efektivisht ndaj aktiviteteve keqdashëse kibernetike. Takimi i radhës do të mbahet në këtë vit 2025.

Automatizimi i “poligonit” kibernetik - NATO po përmirëson aftësitë e saj

²⁴ <https://www.ncia.nato.int/newsroom/news/new-edition-of-innovation-continuum-kickstarts-in-turkiye>

²⁵ <https://estonianworld.com/security/the-tallinn-based-nato-cyber-defence-centre-to-lead-research-on-securing-5g-networks/>

²⁶ https://digital-strategy.cc.europa.eu/en/news/european-union-and-nato-hold-first-structured-dialogue-cyber?utm_source=chatgpt.com

të trajnimit kibernetik duke zhvilluar një platformë të gjeneratës së ardhshme për planifikimin dhe kontrollin e “poligonit kibernetik të NATO-s”²⁷. Kjo platformë synon të automatizojë përgatitjen dhe ekzekutimin e ushtrimeve kibernetike, trajnimeve, testeve dhe certifikimeve. Qëllimi është të mundësojë ushtrime më komplekse dhe në shkallë më të gjerë me më pak burime, realizëm më të lartë dhe saktësi të shtuar në adresimin e kërkesave të trajnimit.

Përfundime

Mbrojtja kibernetike ka si “gur themeli” inteligjencën artificiale. Aftësitë e IA-së në analizimin dhe vlerësimin e të dhënave dhe “data”, njohjen e modeleve dhe “mësimin e makinerisë” do të luajnë një rol kyç në zhvillimin e strategjive të sigurisë kibernetike. Në vitin 2025, zhvillimet e teknologjisë së IA do të jenë thelbësor në identifikimin, analizimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve kibernetike në kohë reale. Sistemet e IA do të “mësojnë” vazhdimisht nga të dhënat e reja, duke ndihmuar në përmirësimin e saktësisë së detektimit dhe parashikimin e dobësive të mundshme, duke i bërë ato një pasuri të rëndësishme në mbrojtjen pro-aktive kibernetike. Kompleksiteti dhe shkalla e sulmeve kibernetike në vitin 2025 do të kërkojnë më shumë automatizim në operacionet e sigurisë kibernetike. IA do të automatizojë “detyrat” rutinë, si monitorimi i kërcënimeve kibernetike, reagimi ndaj incidenteve dhe menaxhimi i dobësive që shfaqen në sisteme, duke përmirësuar ndjeshëm kohën e reagimit dhe duke reduktuar ngarkesën mbi ekspertët njerëzorë. Ky automatizim në rritje do të ndihmojë gjithashtu në zbutjen e efekteve të sulmeve kibernetike, duke ofruar kundërmasa në kohë reale dhe duke reduktuar kohën e ndërprerjes të punës të sistemeve dhe proceseve teknologjike. Sofistikimi në rritje i kërcënimeve kibernetike kërkon bashkëpunim “ndërdisiplinar”. Ekspertët e IA, profesionistët e sigurisë kibernetike dhe organet rregullatore do të duhet të bashkëpunojnë për të ndarë njohuri, zhvilluar mjetet dhe teknologjitë më të mira detektimi dhe krijuar udhëzime special për sigurinë e sistemeve të TIK-ut. Ky bashkëpunim do të jetë thelbësor për adresimin e sfidave globale në fushën e sigurisë kibernetike.

Rritja e ndërvlerësimit mes inteligjencës artificiale dhe sigurisë kibernetike është e padiskutueshme. Ndërsa IA bëhet gjithnjë e më e pranishme, roli i saj në sigurinë kibernetike do të bëhet i pazëvendësueshëm për parandalimin dhe përgjigjen ndaj sulmeve kibernetike gjithnjë e më të sofistikuar. Njëkohësisht, siguria e sistemeve të IA do të bëhet një shqetësim kryesor, duke kërkuar strategji, mjete dhe “korniza” të reja për të mbrojtur këto teknologji nga kërcënimet kibernetike kundërshtare. Përgjatë vitit 2025, IA jo vetëm

²⁷ https://guardtime.com/blog/guardtime-to-develop-the-next-generation-planning-and-control-platform-for-the-nato-cyber-range?utm_source=chatgpt.com

që do të transformojë mënyrën se si mbrohemi nga kërcënimet kibernetike, por gjithashtu do të kërkojë “korniza” më të forta dhe më të qëndrueshme për sigurinë kibernetike. Ndërvarësia mes AI dhe sigurisë kibernetike në vitin 2025 nuk do të ndihmojë vetëm në zbutjen e rreziqeve, por gjithashtu do të nxisë inovacionin në mënyrën se si sigurojmë infrastrukturën kritike dhe të dhënat e ndjeshme. Ndërsa kërcënimet kibernetike vazhdojnë të rriten në sofistikim, IA do të shërbejë si shtylla kurrizore e strategjive të sigurisë kibernetike, duke mundësuar detektimin më të shpejtë, menaxhimin më të mirë të rreziqeve dhe mbrojtje më të forta. Megjithatë, kjo kërkon gjithashtu një përpjekje të koordinuar për të siguruar që sistemet e IA të jenë të sigurta, etike dhe transparente. Kombinimi i aftësive të IA dhe strategjive në zhvillim të sigurisë kibernetike do të përcaktojë “peizazhin” e sigurisë digjitale në vitin 2025 dhe më tej.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Russell, Stuart J.; Norvig, Peter (2021). *Artificial Intelligence: A Modern Approach* (4th ed.). Hoboken: Pearson. fq.1-4. ISBN 978-0-1346-1099-3.
2. *Artificial Intelligence in Design '96*. Dordrecht, Netherlands: Springer Netherlands. fq. 151–170. ISBN 978-94-010-6610-5.
3. Grumblin, Emily; Horowitz, Mark, eds. (2019). *Quantum Computing: Progress and Prospects*. Washington, DC. ISBN 978-0-309-47970-7.
4. <https://www.cisco.com/site/us/en/learn/topics/security/what-is-an-advanced-persistent-threat-apt.html>
5. <https://www.cloudflare.com/learning/security/what-is-a-supply-chain-attack/>.
6. <https://www.ibm.com/think/topics/intrusion-detection-system>.
7. Rose, Scott; Borchert, Oliver; Mitchell, Stu; Connelly, Sean. “Zero Trust Architecture” (PDF). Archived (PDF) from the original on 2021-04-21.
8. <https://www.malwarebytes.com/ransomware>.
9. <https://www.microsoft.com/en-us/security/business/security-101/>.
10. Miller, V. (1986). “Use of Elliptic Curves in Cryptography”. *Advances in Cryptology — Crypto '85*: fq. 417–426. ISBN 978-3-540-16463-0.
11. <https://www.nsa.gov/Cybersecurity/>.
12. The Cyber Security Hub™ (News Letter: World’s Premier Cyber Security Portal): <https://linktr.ee/thecybersecurityhub>.
13. Cyber Security News (News Letter: #1 World’s Most Followed Cyber

Security News Platform): <https://cybersecuritynews.com/>.

14. Cyber Security and Information Systems Information Analysis Center (<https://www.cisa.gov/>).
15. Cyber Security and Information Systems Information Analysis Center (<https://www.cisa.gov/>).
16. NATO Communications and Information Agency (NCIA - we are NATO's technology and cyber experts): <https://www.ncia.nato.int/>; <https://www.ncia.nato.int/newsroom/news>.
17. NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE) (As the NATO-accredited cyber defence hub we support our member nations and NATO with cyber defence expertise): <https://ccdcoe.org/>.
18. Cyber Security Global Alliance (CSGA aims to create a safer world tomorrow by protecting individuals dhe organizations from cyberattacks dhe quantum threats): <https://www.csga-global.org/>.
19. <https://www.sto.nato.int/Pages/default.aspx> (NATO Science dhe Tech. Org.).

RUBRIKA E KATËRT

STUDIME HISTORIKE

KONFERENCA E MUNIHUT 2025: SHUMËPOLARITETI PËRBALLË RENDIT AKTUAL BOTËROR

Prof. Asoc. Dr. Etleva SMAÇI

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Dr. Blerina KUQI

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar

Objekt i këtij punimi është analiza empirike dhe teorike e raportit të paraqitur në Konferencën e Munihut, shkurt 2025, me titull “Multipolarization”.

Punimi synon të hedhë dritë mbi sfidat e sigurisë që rendi i sotëm botëror po përballët dhe të analizojë hipotezat dhe faktet e trajtuara në këtë raport në një aspekt multidisiplinor: së pari, duke trajtuar aspektin historik dhe së dyti duke u ndalur në disa qasje thelbësore të politikave të sigurisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare të aktorëve të përmendur në këtë raport.

Për ta përmbyllur, autorët synojnë të kontribuojnë përmes këtij punimi në nxitjen e mendimit kritik të të gjithë profesionistëve në fushat e historisë, marrëdhënieve ndërkombëtare, sigurisë dhe mbrojtjes, duke sjellë në vëmendje teza dhe hipoteza mbi konfigurimin dhe ndryshimet e mundshme të rendit botëror.

Fjalë kyçe: Rend botëror, politika të sigurisë, fuqi të mëdha, rend i ri.

Një historik i shkurtër mbi Konferencën e Mynihut

Fillesat e Konferencës së Sigurisë të Mynihut i gjejmë në vitin 1963, me emrin “Wehrkunde- Begegnung”.¹ Ajo çfarë e ka karakterizuar këtë konferencë që në ditën e parë të saj ka qenë formati i ekspertëve të pavarur që kanë pasur dhe kanë në fokus çështjet më jetike të sigurisë që burojnë nga e tashmja dhe ndihmojnë në parashikimet e mundshme të së ardhmes.

Takimet e para përgjithësisht u dominuan nga *Think tank*-et, ekspertë, diplomatë etj., gjermanë ku ata kishin rastin jo vetëm të takoheshin por edhe të diskutonin me aleatin e tyre më të rëndësishëm për Evropën e pasluftës, SHBA dhe përfaqësues të vendeve të tjera që në atë kohë aderonin në NATO. Ky fakt gjeti jehonë në forcimin e idesë se konferenca ishte një formë takimi për “familjen transatlantike” jashtë ombrellës së NATO-s.

Kjo tipologji takimesh që karakterizoi periudhën e Luftës së Ftohtë do të ndryshonte në fillim të viteve 90-të. Shpërbërja e Traktatit të Varshavës do të sillte në vëmendje të organizatorëve se ashtu si vetë NATO, konferenca nuk mund të ishte më e njëanshme. Pra, zgjerimi i vendeve pjesëmarrëse në forum erdhi si logjikë e ndryshimeve që ndodhën në rendin ndërkombëtar dhe krijimin e realiteteve të reja në marrëdhëniet ndërkombëtare. Prania e pjesëmarrësve nga Rusia, vendet e Evropës Lindore dhe në dekadën e fundit përfaqësues të fuqive në rritje si Kina, Brazili, por nga vendet e Lindjes së Mesme nuk e ka cenuar aspak thelbin transatlantik të kësaj konference.

Duket se evolucionin më të madh konferenca e ka pësuar në gjenezën fillestare të emërimit që nënkuptonte “shkencat ushtarake” ose ndryshe “mbrojtje dhe diferencë”, konfliktin dhe rivalitetin e dy superfuqive në planin ushtarak. Sot çështjet ushtarake nuk janë më në plan të parë, pra konferenca nuk është më thjesht një forum mbi doktrinat ushtarake. Për rrjedhojë ushtarakët nuk janë ata që dominojnë forumin. Në ndryshim nga periudha kur ky takim zhvillohej me dyer të mbyllura për shkak të sekretit ushtarak, sot konferenca e Mynihut po bëhet gjithmonë e më shumë transparente. Po ashtu nuk është vetëm gjeografia e pjesëmarrësve ajo që ka ndryshuar, por edhe pozicionet e tyre jashtë sferës ushtarake, që lidhen me çështje shumë kritike të sigurisë, si klima, të drejtat e njeriut, globalizmi etj.²

Së fundmi, ashtu edhe si e thekson ambasadori Wolfgang Ischinger në esenë e tij me rastin e 50-vjetorit të konferencës së Mynihut, edhe pse në ditët e sotme nuk është më prezent konflikti mes NATO-s dhe Traktatit të Varshavës që çoi

¹ <https://securityconference.org/en/about-us/history/>

² https://securityconference.org/media-library/images/2014/Buchbeitr%C3%A4ge/Munich_Security_Conference_05_Ischinger.pdf

në domosdoshmërinë e këtij forumi, qeverisja globale, dhe siguria ndërkombëtare janë dy shtylla shumë jetike ku partneriteti transatlantik duhet të çimentohej, madje në kërkim të partnerëve të rinj.

Teza e multipolaritetit, realitet apo supozim

Teza e botës shumëpolëshe nga pikëpamja historike na lejon të shkojmë mbrapa në kohë veçanërisht kur marrëdhëniet ndërkombëtare u institucionalizuan si të tilla në kontinentin evropianë dhe SHBA apo fuqi të tjera joevropiane nuk ishin pjesë e sistemit ndërkombëtar. Le të sjellim në vëmendje zhvillimet në Evropë në vitin 1815, kur u themelua Koncerti i Vienës i përbërë nga aleanca e katërfishtë, Rusi, Prusi, Austri dhe Britani e Madhe me qëllimin e vetëm për të ruajtur balancën e fuqive dhe ruajtjen e Status Quo-së territoriale, pas luftërave hegjemoniste të Napoleonit. Pra, padyshim Koncerti i Vjenës është ndër ato shembuj historik që flet për zbatimin e një sistemi multipolar por me një gjeografi të kufizuar brenda një kontinenti. Po nga një qasje historike ky sistem rezultoi i dështuar dhe u kthye në burimin e dy luftërave të përgjakshme që nuk ngelën brenda kufijve të Evropës por morën karakter global. Pikërisht fundi i Luftës së Dytë Botërore do të fshinte çdo gjurmë të këtij sistemi, për t'u rikthyer gati gjysmë shekulli më vonë në teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare, por tashmë shumë më gjerë sesa një karakteristikë evropiane.³

Si edhe u përmend në hyrje të këtij punimi, raporti i paraqitur në konferencën e Munihut këtë vit titullohej “Multipolarization”. Pa u ndalur gjatë në domethënien e këtij titulli, pasi do të analizohet në vazhdimësi, do të dëshironim të evidentonim faktin se në aspektin historik supozimi i ardhjes së një rendi shumëpolësh nuk është risi për këtë konferencë. Nëse kthehemi pas në kohë, veçanërisht në 2014, që shënon edhe nisjen e konfliktit në Ukrainë, Javier Solana, do të paralajmëronte se bota po jetonte një iluzion, në raport me transformimin paqësor të rendit botëror nga unipolar në multipolar⁴. Po kështu, ministri i jashtëm gjerman, Frank-Walter Steinmeier, vetëm një muaj pas deklaratës së Javier Solanës në nëntor 2014 do të deklaronte se “bota ishte në kërkim të njohjes së një rendi të ri, pa pasur një të tillë. Dhe nisur nga këto rrethana po lindnin konflikte të cilat ishin më të vështira për t'u zgjidhur se ato të 10 apo 20 viteve më parë”.⁵ Duket se parashikimi i Frank-Walter Steinmeier ishte i saktë, pasi në 2025 konflikti në Ukrainë është më i ndezur se kurrë.

³ M. Peters, ‘The emerging multipolar world order: A preliminary analysis’, *Educational Philosophy and Theory*, DOI: 10.1080/00131857.2022.2151896.

⁴ <https://www.project-syndicate.org/commentary/tactical-foreign-policy-fixes-by-javier-solana-2014-10>

⁵ <https://www.nytimes.com/2014/11/20/world/europe/frank-walter-steinmeier-germanys-foreign-minister-a-man-in-the-middle.html>

Raporti i konferencës së Mynihut të vitit 2019, i titulluar “Pazëlli i madh: kush do t’i vendosë pjesëzat”, bazohet plotësisht në gjetjet se zhvendosja e rendit botëror ishte një fenomen epokal, i një rendi të cilit po i vinte fundi, duke e bërë të dukshme epokën e re gjeopolitike. Prej konferencës së vitit 2023, nisur edhe nga titulli i raportit “Revizion”, debate mbi vizionet e ndryshme mbi të ardhmen e rendit botëror janë tashmë jo më në nivelin e hipotezave abstrakte dhe teorike.

Në përmbledhjen e raportit të konferencës së Mynihut, 2025 që në paragrafin e parë autorët e shohin faktin se bota po bëhet gjithmonë e më shumëpolëshe, si një të vërtetë të rëndomtë në debatin që shoqëron marrëdhëniet ndërkombëtare. Si ilustrim ata sjellin në vëmendje se fuqia është tashmë duke u zhvendosur drejt një sërë aktorësh (duke mos konsideruar vetëm SHBA, apo Rusi e Kinë) të cilët kanë aftësi të ndikojnë në çështjet globale.⁶ Mbi të gjitha MSC⁷ u zhvillua këtë vit në kushtet e një paqartësie gjeopolitike më të thellë se kurrë më parë, aq sa nuk u hezituam që në diskutimet pas saj, të konsiderohej më tepër se një bashkim transatlantik idesh në përçarje të familjes transatlantike.⁸

Botë unipolare, bipolare apo multipolare?

Ekspertët e marrëdhënieve ndërkombëtare më së shumti flasin sot për një botë që në zhvillimet gjeopolitike shpërfaq karakteristika të një polarizimit, dy polarizimit dhe shumë polarizimit, por ajo çfarë i bashkon këta ekspertë është pikërisht qenia e një bote të polarizuar tejskajshëm, një polarizimi që po merr tipare ideologjike.⁹ Në këtë kuadër, që në faqet e para të raportit ngrihen disa pyetje jetike: A po hyn bota në një epokë që do të përkufizohet si epoka e shumë poleve? Cilat prej këtyre poleve kanë potencialin e duhur për të përcaktuar rendin e ri botëror? Çfarë implikimesh do sjellë në marrëdhëniet ndërkombëtare një rishumëpolësh? Dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, si do të menaxhohet ky rend i ri shumëpolësh nga komuniteti ndërkombëtar?¹⁰

Përpara se t’i përgjigjemi pyetjeve të mësipërme bazuar në analizën e raportit të konferencës së Mynihut 2025, më së pari le të japim një shpjegim mbi konceptin e polaritetit sipas përkufizimit që gjejmë mbi të në literaturën

⁶ <https://securityconference.org/en/publications/munich-security-report-2025/>

⁷ Munich Security Conference (MSC), ky akronim në anglisht do të përdoret për lehtësi gjatë gjithë artikullit.

⁸ Robin S.Quinville, Making Sense of the Munich Conference, 18 February 2025, aksesuar: prill 2025; <https://www.wilsoncenter.org/article/making-sense-munich-security-conference> Shiko gjithashtu: Richard Fontaine, The Superpower has left the bulding: Munich 2025, *War On The Rocks*, 17 february 2025, aksesuar: prill 2025. <https://warontherocks.com/2025/02/the-superpower-has-left-the-building-munich-2025/>

⁹ Munich Security Report 2025, page 9.

¹⁰ *Po aty* page 13.

bashkëkohore të marrëdhënieve ndërkombëtare. Një ndër përkufizimet më të njohura që e gjejmë të referuar edhe në raportin e konferencës së Mynihut është ai i Goedele De Keersmaeker i cili me polaritet në marrëdhëniet ndërkombëtare përshkruan prezencën e një ose më shumë fuqive dominuese në sistemin ndërkombëtar. Këto fuqi të cilat kanë kapacitete të jashtëzakonshme janë të ndara në pole sipas periudhave të ndryshme. Një përkufizim më i saktë sipas Goedele De Keersmaeker do të ishte: “Polariteti ka të bëjë me numrin e fuqive të mëdha ose fuqive polare”.¹¹ Ky autor shpjegon se si studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare u frymëzuan nga shkencat natyrore për konceptin e polaritetit duke përdorur konceptet “uni”, “bi” dhe “multi”¹² dhe ranë dakord që koncepti të ishte i përshtatshëm nga perspektiva e marrëdhënieve ndërkombëtare. Prej këtej rrjedhin edhe tre llojet e polariteteve: një fuqi e madhe ose një pol që nënkupton unipolaritetin, dy fuqi të mëdha ose dy pole që nënkuptojnë bipolaritetin dhe më shumë se dy fuqi të mëdha ose më shumë se dy pole që njihet si multipolaritet.¹³

Por krahas këtij përkufizimi, nuk mungojnë edhe argumentet ndryshe të lidhura me konceptin e polaritetit, sidomos ai që përfshin pabarazinë midis fuqive të mëdha dhe fuqive më të vogla. Për sa i përket unipolaritetit sipas disa autorëve kemi të bëjmë me një gjendje kur ekziston një pabarazi e madhe e fuqisë midis fuqive të mëdha dhe të gjitha shteteve të tjera. Ky është rasti i SHBA në përfundim të Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Bipolaritetit këta autorë i referohen kur dy fuqi të mëdha në sistemin ndërkombëtar kanë një pozicion afërsisht të barabartë dhe ekziston një pabarazi e madhe e fuqisë me fuqitë më të vogla. Së treti, multipolariteti është kur ka më shumë se dy fuqi të mëdha që kanë një pozicion afërsisht të barabartë dhe ekziston një pabarazi e madhe e fuqisë midis fuqive më të vogla në sistemin ndërkombëtar.¹⁴

De Keersmaeker në përkufizimin e tij, siç e përmendëm edhe më lart, u referohet fuqive të mëdha si kapacitete të jashtëzakonshme. Pra, kapaciteti është një gjë shumë e rëndësishme për fuqitë e mëdha për të ruajtur këtë status. Indeksi, të cilit ky autor i referohet “Correlates of War” (COW) ka gjashtë tregues: popullsia totale, popullsia urbane, shpenzimet ushtarake, personeli ushtarak, konsumi i energjisë, prodhimi i hekurit dhe/ose çelikut.¹⁵ Megjithatë, shumica e studiuesve e përkufizojnë polaritetin para përfundimit të Luftës së Ftohtë,

¹¹ Goedele De Keersmaeker, *Polarity, Balance of Power and International Relations Theory: Post Cold War and the 19 Century Compared*, Palgrave Macmillan:2016, page:232.

¹² *Po aty* page:13.

¹³ *Po aty* page:4.

¹⁴ Edward D. Mansfield, Concentration, Polarity, and the Distribution of Power. *International Studies Quarterly* 37: 105–128. doi:10.2307/2600833.

¹⁵ De Keersmaeker, vepër e cituar, faqja:36.

duke theksuar fuqinë ekonomike dhe ushtarake. Këto kapacitete luajnë një rol të rëndësishëm për të ndryshuar fuqinë nga një pol në një pol të ri¹⁶ Për Waltz në përcaktimin e statusit si pol të një shteti të dhënat e popullsisë dhe të ardhurat e qeverisë janë përcaktuese. Kurse kur vjen fjala për bipolaritetin Mansfield thekson se: “Në kushtet e bipolaritetit, dy fuqitë e mëdha kontrollojnë të paktën 50 përqind të kapaciteteve të fuqisë. Nga ana tjetër, në multipolaritet, fuqitë e mëdha kanë më pak se 50 përqind të këtyre kapaciteteve”.

E ndërsa siç theksohet në hyrje të raportit në përpjekje për të shpjeguar çfarë përfaqëson “multipolariteti” në marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare, nocioni është bërë kryefjala e ditës pa arritur të ketë qartësi konceptuale dhe shpesh duke iu referuar shpresave me natyrë emocionale për ndryshime globale. Në përmbyllje në lidhje me thelbin e debatit mbi multipolaritetin mund të themi se ky debat reflekton qasjet e ndryshme mbi të tashmen dhe të ardhmen e rendit botëror.¹⁷

Bazuar në përkufizimet e mësipërme autorët e raportit të konferencës së Mynihut sjellin disa ilustrime të rëndësishme mbi unipolaritetin, bipolaritetin dhe multipolaritetin. Kështu një ndër aspektet që sipas tyre e bën sistemin e sotëm ndërkombëtar të shfaqet si unipolar lidhet me faktin se sipas vlerësimit të SIPRI (Stockholm International Peace Research Institute), SHBA akoma ka në llogari të saj rreth 40% të shpenzimeve të mbrojtës globale, ndërsa Kina që renditet e dyta sipas këtij treguesi nuk llogaritet as me gjysmën e vlerës së shpenzimeve të përmendura më lartë për SHBA.¹⁸ Por nga ana tjetër, po në pasazhin pasardhës të këtij raporti për të shpjeguar trendin e një epoke të re bipolare, SHBA dhe Kina janë përsëri përballë njëra-tjetrës, me argumentin se janë të vetmet superfuqi të ditëve të sotme, pasi çdo shtet tjetër që pretendon statusin e fuqisë së madhe dëshmon mungesë të kapaciteteve ekonomike dhe ushtarake në raport me SHBA dhe Kinën.¹⁹

Mirëpo kriteret, që sapo përshkruam, duken mjaft strikte për një tjetër grupim studiuesish, të cilët ngrenë pretendimin se kufizimi vetëm të shpenzimit ushtarake apo ato për ekonominë në përgjithësi mund të çojnë në qasje që lënë

¹⁶ Franz Kohout, “Cyclical, Hegemonic, and Pluralistic Theories of International Relations: Some Comparative Reflections on War Causation.” *International Political Science Review / Revue Internationale de Science Politique* 24, no. 1 (2003): 51–66. <http://www.jstor.org/stable/1601329>.

¹⁷ Munich Security Report 2025, faqe 13.

¹⁸ Përveç sektorit ushtarak për studiuesit që mbështesin tezën e unipolaritetit, një ndër karakteristikat e shpërndarjes unipolare të fuqisë është e lidhur ngushtësisht me konceptin e ekonomistëve të njohur si “unipolar currency world”, që i referohet dominimit të dollarit si monedha globale.

¹⁹ Munich Security Report, faqe 14-15.

në hije zgjimin në rritje të një bote me shumë pole në marrëdhëniet ndërkombëtare. Te kjo tezë gjejmë veten edhe ata studiues të cilët nuk merren me zhvendosjen e rendit botëror, sesa me faktin se shpërndarja e fuqisë në ditët e sotme nënkupton se “klubi i fuqive të mëdha” ka më pak influencë se në të shkuarën për çështje të rëndësishme globale. Vetë hartuesit e raportit, duke përdorur si instrument matjeje Indeksën e Sigurisë së Mynihut në raport me perceptimin publik, japin këto të dhëna.

Një e treta e të pyeturve mendojnë se ne po jetojmë në një botë ku SHBA-të janë ende superfuqia zotëruese. Një e treta mendojnë se rendi i sotëm botëror kontrollohet nga SHBA dhe Kina. Një e katërta mendojnë se në botën ku jetojmë përtej SHBA-së dhe Kinës fuqi të tjera mund të kenë një influencë të fortë e të pavarur në çështjet globale.²⁰ Por kur pyetja e drejtuar në këtë indeks sigurie lidhet konkretisht me emrat e shteteve që ata mendojnë se janë fuqi të mëdha 80% e të anketuarve përbashkohen në idenë se SHBA, Kina dhe Rusia janë të tilla. Përsa i përket statusit të vendeve të tjera ka shumë mospërputhje që pasqyrohen në anketim duke çuar në klasifikimin nga 3 deri në 9 shtete si fuqi të mëdha (në Indi ka një perceptim të gjerë popullor se sot në arenën globale ka 9 shtete që mund të konsiderohen fuqi të mëdha, ndërsa po i njëjti anketim në Gjermani, nxjerr se perceptimi popullor është vetëm për 3 fuqi të mëdha)²¹.

Polarizimi ideologjik

Një ndër shqetësimet më të mëdha që buron nga raporti i vitit 2025 gjatë analizës që i bëhet polarizimit të sistemit ndërkombëtar është tendenca që ai të shndërrohet në një polarizim ideologjik. Për të bërë një dallim të qartë me atë çfarë autorët kuptojnë me polarizim ideologjik ata ndalen tek marrëdhëniet mes poleve bazuar në idetë që ata promovojnë.²² Përplasja e rendit ndërkombëtar që bazohet tek idetë liberale me idetë joliberalë gjithnjë në rritje përbën rrjedhojën më dramatike të këtij polarizimi ideologjik më shumë se sa rivaliteti i vetë fuqive. Aq sfiduese është kjo përplasja sa për hartuesit e raportit nuk shihet e pamundur si alterantivë “rikthimi i fuqive të mëdha autoritare” dhe amplifikimi i dikotomisë demokraci – autokraci, si dhe një ndarjen e botës në dy blloqe. Këtu ka burimin edhe narrative në rritje e një rendi multipolar, i cili ideologjikisht nuk synon të zhdukë rendin liberal por mund të karakterizohet nga pluralizmi i fuqive dhe identiteteve.²³ Indeksi i Mynihut identifikon një qasje optimiste më të dukshme në lidhje me një rend

²⁰ Po aty faqe.19.

²¹ Po aty

²² Po aty faqe 21.

²³ Po aty faqe 22-23.

multipolar veçanërisht në popullatën e vendeve të BRICKS ndryshe nga popullata e vendeve të G7. Kjo qasje optimiste e tyre lidhet specifikisht me rolin e Uashingtonit, i cili mund të kufizohet nga një rend shumëpolësh, pasi nuk konsiderohet në masën dërrmuese nga këto vende si një ankorë stabiliteti. Për optimistët e multipolarizimit, sa më shumë fuqi globale aq më e madhe është edhe mundësia e ndarjes së lidhshërisht global, pikërisht duke u bërë pengesë për fuqitë hegjemonike, si ata konsiderojnë Perëndimin.²⁴ Ajo që pritet nga ky qëndrim është një rend shumëpolësh, i cili do të demonstrojë një tolerancë më të madhe në raport me diversitetin kulturor dhe politik, teze që prevalon në qëndrimet ruse–kineze ndër mbështetësit më aktiv të një rendi të ri shumëpolësh.²⁵

Për më pak optimistët duket se të paktën dy aspekte të një rendi shumë polar mund të ndikojnë në një luftë të mundshme mes fuqive të mëdha. Së pari, kjo ka të bëjë me rritjen e fuqive të reja të mëdha dhe së dyti polarizimin ideologjik. Rritja e diversitetit ideologjik të fuqive të mëdha të reja jo vetëm nuk shihet nga pesimistët në funksion të balancës së fuqive, por përkundrazi, potencialisht mund të çojë në gara të reja armatimi, konvencionale dhe bërthamore njëkohësisht, me pasojë kriza dhe eskalimin e situatave. Një rend shumëpolësh mbi të gjitha shikohet nga ky grupim si një gjetje për të minuar rregullat dhe normat universal. Për rrjedhojë, duke pranuar epokën e shumpolarizimit, ekspertët e marrëdhënieve ndërkombëtare gjykojnë se tashmë duhet ndërtuar një strategji për depolarizimin që të mund ta vendosë rendin shumëpolësh në shinat e duhura.²⁶

Pole të vjetra dhe polet të reja

Dy nga fuqitë e mëdha të cilat përdorin më shpesh termin “shumëpolësh” si alternativën e tyre të parapëlqyer për rendin botëror në raport me atë aktual të dominuar nga SHBA janë Rusia dhe Kina, por së fundmi nuk kanë munguar deklarime të ngjashme edhe nga liderët evropianë.²⁷ Nisur nga analiza e mësipërme mbi uni, bi dhe multi polet, përdorimi i konceptit “pole” si një kategori analitike bazohet mbi një kuptim shumë specifik të marrëdhënieve ndërkombëtare. Aktorët qendror janë komb-shtetet të cilët përfaqësohen nga pushteti ekzekutiv dhe ndjekin një axhendë politike koherente dhe të integruar.

²⁴Me “perëndim” këtu nënkuptohet aleanca transatlantike, SHBA dhe vendeve të zhvilluara evropiane.

²⁵Po aty faqe 25.

²⁶Po aty faqe 31.

²⁷<https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2023/09/21/address-of-president-charles-michel-at-the-78th-session-of-the-un-general-assembly/> Gjatë fjalës së tij presidenti i Këshillit Evropian Charles Michel, deklaronte se “*The European Union is striving for a multipolar world, a world that cooperates and moves towards more democracy and more respect for human rights*” Po kështu në 2024, kancelari gjerman Olaf Scholz do të deklaronte në platformën X se “*The World is multipolar, so we have to act accordingly now*”.

Prej këtej dhe natyrshëm lind pyetja se kush do të konsiderohet pol? Raporti i vitit 2025 ka sjellë në vëmendje të studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare 8 aktorë, ku disa tashmë janë “mamuthët” e rendit botëror, kurse të tjerë u ngjajnë “rishtarëve” me besim dhe guxim të paepur se meritojnë një vend nderi në xhunglën e rendit të ri që ata jo vetëm e mbështesin, por tashmë e quajnë se është në praktik.

Shtetet e Bashkuara, Rusia dhe Kina nuk kanë asnjë dyshim se janë pole dhe kjo reflektohet qartë edhe në përgjigjet e dhëna në pyetësorin e indeksit të Konferencës së Mynihut. Bashkimi Evropian trajton si një i tërë, pa veçuar qoftë edhe një shtet të vetëm të pretendojë të jetë në rolin e një fuqie. Nga ana tjetër, India, Japonia, Brazili dhe Afrika e Jugut secili prej tyre po përpiqet të gjejë një shteg për t’u konsideruar jo vetëm fuqi, por edhe një pol. Le të ndalemi tani në një përshkrim analitik të shkurtër se çfarë vendi zë në rendin shumëpolësh secili prej tyre.

SHBA dhe MAGA

Analiza mbi SHBA mbështetet në tezën kryesore se rendi botëror i vendosur në fund të Luftës së Ftohtë kur SHBA u pa si një fuqi e vetme e pa rivalizuar²⁸ nga asnjë fuqi tjetër, është tronditur qoftë nga zhvillimet e brendshme, madje edhe para ardhjes së Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, ashtu edhe nga zhvillimet në politikën e jashtme. Presidenti aktual i SHBA-ve e sheh rolin e vendit të tij në marrëdhëniet ndërkombëtare në një prizëm shumë të ngushtë, duke u nisur vetëm nga interesat kombëtare të SHBA-ve që mori formën e frazës “Make America Great Again”(MAGA). Në këtë kuadër, duket se gjithçka do të prioritetizohet në rivalitetin me Kinën duke u larguar nga roli historik që SHBA kanë luajtur si garantor të sigurisë së Evropës nga fundi i Luftës së Dytë Botërore.²⁹ Nisur nga ky skenar, autorët e raportit nuk e shikojnë të pamundur që *trumpizmi* të ketë pasoja edhe për NATO-n. Kjo nuk nënkupton një tërheqje nga organizata si u veprua me marrëveshjen e Parisit për klimën, por pakësim të prezencës ushtarake dhe padyshim rritje tensioni mes aleatëve. Pasojat e kësaj politike selektive do të ndihmojnë në zgjerimin dhe avokatinë e tezës së shumë poleve, për të mbushur boshllëkun e krijuar nga SHBA.³⁰ Zhvillimet e fundit ndërkombëtare në Ukrainë po dëshmojnë pasojat e mos angazhimit amerikan. Në nivelin strategjik, *trumpizmi* duket se ka hequr dorë nga bindja prej gati

²⁸ Charles Krauthammer, “The Unipolar Moment”, *Foreign Affairs*, Nr. 70.1, 1990, page:23-33; Shiko gjithashtu: Samuel Huntington, “The Lonely Superpower”, *Foreign Affairs*, Nr.78.2, 1999, page:35-50.

²⁹ MSC Raport 2025, cituar më sipër, faqe 59.

³⁰ Fareed Zakaria, “The Rise of the Rest”. *Newsweek* 12 May 2008. Aksesuar prill 2024, <http://www.newsweek.com/id/135380/output/print>

8 dekadash se “SHBA-të janë të pazëvendësueshme në rolin e tyre për mbajtjen e botës si një e tërë”.³¹ Sjellja që buron nga kjo bindje hap rrugën që aleanca të reja të krijohen për rrjedhojë edhe pole të reja të shfaqen.

Kina – Poli i Pozicionuar

Kina është avokati më aktiv i mbrojtjes së tezës se bota tashmë ka nevojë dhe duhet të funksionojë mbi një rend të ri botëror i karakterizuar nga shumë pole. Të gjithë pyetësorit e hartuar nga indeksi i Konferencës së Mynihut nuk e fshehin faktin se ekonomikisht dhe ushtarakisht Kina është e vetmja fuqi që rivalizon si e tillë me SHBA pa përfshirë kritere të tjera për emërtimin fuqi të një shteti kombi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Thirrja e Kinës për një rend botëror me shumë pole ose sipas presidentit Xi Jinping “një rend botëror i barabartë multipolar ku çdo vend të gjej pozicionin e tij”³² është përqaftuar nga veçanërisht nga vendet anëtare të BRICS, të cilat tashmë përbëjnë gati gjysmën e popullsisë së botës dhe 1/3 e GDP botërore. Ajo çfarë indeksi i Konferencës së Mynihut evidenton për qëndrimin politik të Kinës si një fuqi botërore në kërkim të ndryshimeve të rendit botëror, duket se është në përputhje me perceptimin publik të shumicës së kinezëve të anketuar. Ata janë të bindur se një rend botëror shumëpolësh do të sjellë benefite, paqe dhe prosperitet.³³

Një ndër konkluzionet më të rëndësishme që mendoj se buron nga leximi i kujdesshëm i analizës për Kinën në raport është se qëllimi kryesor i pozicionimit si pol ka të bëjë me faktin se ky pol duhet të ketë rregullat e tij të qarta, të ndryshme nga ato të Perëndimit, të cilat duhet të jenë tërheqëse dhe të ushtrojë influencë jo vetëm përmes kulturës, ekonomisë por edhe përmes formës së qeverisjes (regjimit)³⁴ e deri tek ushtrimi i fuqisë ushtarake.

Rusia – Hapja e Carit

Për shkruarit e raportit të Konferencës së Mynihut 2025, nuk ka asnjë dyshim për ta etiketuar Rusinë si fuqi që ka tronditur më shumë gjatë këtij shekulli rendin botëror ekzistues. Autorët jo vetëm i referohen agresionit ndaj Ukrainës, një luftë vdekjeprurëse në zemër të Evropës që nga 1945, por edhe deklarimeve të Vladimir Putin se “lufta nuk është thjesht për Ukrainën, por edhe për principet në të cilat rendi i ri do të bazohet”.³⁵ Teza ruse e një rendi të ri shumëpolësh ka

³¹ *Po aty* faqe 56.

³² Ministry of Foreign Affairs of the People's Republic of China “The Conference Marking the 70th Anniversary of the Five Principles of Peaceful Coexistence Held in Beijing, June 28.2024.

³³ Shih *Raporti MSC 2025*, cituar më sipër, faqe 64.

³⁴ Kina përfaqëson shtetin më të madh autoritar socialist duke synuar pikërisht edhe polarizimin ideologjik. Qëndrimi i Pekinit ndaj të drejtave të njeriut, pronësisë intelektuale dhe transferimit të teknologjive janë ndër kundërshtitë dhe shqetësimet madhore të Perëndimit.

³⁵ MSC Raport 2025, cituar më sipër, faqe 79.

padysim hijet e saja të errëta. Ky rend i ri botëror nuk nënkupton shtete por civilizime ku bëjnë pjesë shtete të cilat janë të lidhura mes tyre përmes historisë e kulturës, janë sovran dhe të barabartë. Pikërisht duke e identifikuar veten si një shtet me një civilizim të hershëm, Rusia kërkon një rol dominant në rendin e ri botëror, duke mos i konsideruar shtetet e vogla si sovraane. Ata duhet të jenë nën influencën e një fuqie që buron nga koncepti i civilizimit sipas modelit rus. Megjithatë pavarësisht këtij vetëbesimi në përshkrimin e komb shtetit me një civilizim historik, ka një hendek real mes fuqisë dhe kapaciteteve për të dominuar skenën politike botërore. Kjo pasqyrohet qartë në përgjigjet e të anketuarve, që mendojnë se Rusia nuk është një fuqi botërore dominante për shkak të problemeve ekonomike me të cilat përballlet.

Evropa – poli që po përballlet me “acarin polar”

Evropa që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore ka përfaqësuar vizionin liberal në rendin botëror dhe duket se kërkesat për ndryshimin e këtij rendi po e bëjnë të përballlet me një stuhi polare. Lufta në Ukrainë ka shkatërruar pothuajse në tërësi arkitekturën e sigurisë kolektive me të cilën kontinenti evropian krenohet dhe mbështet vlerat liberale, duke cenuar principet ndërkombëtare mbi zaptimin e territoreve me forcë.³⁶ Duket se kriza ka arritur kulmin e saj pas ardhjes së Donald Trump në krye të Shtëpisë së Bardhë, në nëntor 2024 dhe deklarimeve të tij se SHBA do ta reduktojnë mbështetjen dhe angazhimin për sigurinë evropiane.³⁷ Evropa si fuqi botërore nëse do të ruaj këtë status sipas raportit të Konferencës së Mynihut, jo vetëm duhet të rrit shpenzimet ushtarake por duhet të kapërcejë edhe rreziqet që vijnë nga fragmentarizimi i sektorit të industrisë së armatimit, duke mos shmangur në këtë proces askënd.³⁸

Problemi i dytë dhe jo pak më i rëndësishëm që trajtohet në raport është modeli ekonomik që ka ndërtuar Evropa, një model i hiperglobalizimit dhe i tregtisë së lire. Lufta tregtare e shpallur nga presidenti Trump me tarifatat (që tashmë është një fakt dhe jo hipotezë si në raport) ka goditur industrinë evropiane në thelb të saj. Edhe në këtë rast Evropa ashtu sa i përket mbrojtjes duhet të diversifikojë marrëdhëniet tregtare dhe të forcojë marrëdhëniet me partnerë të rinj. Përfundimi: është koha që Evropa të ribëjë veten e saj.³⁹

Japonia – përfituesja kryesore e rendit liberal

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore do të ishte një erë e re për Japoninë

³⁶ Fazal M. Tanisha, “The Return of Conquest? Why the Future of Global Order Hinges on Ukraine”, *Foreign Affairs*, Nr 101:2, 2020, faqe: 20-27.

³⁷ Donald Trump në intervistën e dhënë për Kristin Welker, *NBC News*, 8 dhjetor 2024.

³⁸ MSC Raport 2025, cituar mësipër, faqe 73.

³⁹ Po aty, faqe 76.

humbëse të luftës. Nga vendi më i militarizuar në rajonin e Indo-Paqësorit, Japonia do të kthehet në vendet më të zhvilluara ndërkombëtare të dekadave që do të pasonin luftën në mbështetjen kryesore të rendit botëror liberal. Sfida e sotme është ndryshimi i balancës së fuqive që shihet nga Japonia si një shqetësim për mjedisin e sigurisë, ndoshta më e vështira qysh prej përfundimit të luftës. Kjo reflektohet edhe në indeksin e Konferencës së Mynihut, ku japonezët kanë përqindjen më të lartë për rrezikun që vjen nga një rend i ri shumëpolësh. Natyrshëm kjo lidhet me zvogëlimin e rolit të SHBA-s në marrëdhëniet ndërkombëtare, të cilat kanë shërbyer si një ombrellë sigurie dhe rritjen e rolit të Kinës si fuqi globale në atë që konsiderohet “Bota Jugore”. Vetë Japonia ka qenë një fuqi që ka ruajtur status quo-në në rajon, kur ndan kufijtë me tri fuqi bërthamore: Kinë, Rusi, Kore e Veriut. Përpjekja e vazhdueshme e Japonisë ka qenë jo vetëm të mos lejojë rënien e rajonit të Indo-Paqësorit nën influencën kineze, por edhe të shmang rivalitetin kino-amerikan, duke luajtur rolin e katalizatorit. Përfshirja në ASEAN e një sërë vendesh evropiane, është një ndër arritjet strategjike të Japonisë, e cila provon t’i jap formë rendit të ri multipolar sipas rregullave liberale demokratike. Me strategjinë e vitit 2022, duket se Japonia ka vendosur që, përmes rritjes së shpenzimeve për mbrojtjen, të përshtatë aftësitë e saj ushtarake, me peshën që do të ketë në marrëdhëniet ndërkombëtare.⁴⁰

Aktorë të tjerë: India, Brazili, Afrika Jugore

Indeksi i Konferencës së Mynihut i vendos kinezët të parët për besimin se vendi i tyre po e rrit gjithnjë e më shumë trajektoren e influencës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Të dytët renditen indianët. Duket se ky besim është i lidhur ngushtë edhe me vetë deklaratimet e kryeministrit Modi se “kur India artikulon një qëndrim për një vend në platformën globale, bota i kushton vëmendje”.⁴¹ India jo vetëm është një ndër ekonomitë që po rritet shumë shpejt⁴², por ka gjithashtu një potencial shumë të madh teknologjik. Jo pak më i rëndësishëm është fakti se India ka popullsinë më të madhe në botë. India bën pjesë te fuqitë në rritje e cila nuk del hapur si Kina kundër rendit aktual botëror por e sheh atë me kritikizëm. Ky kritikizëm ashtu si del edhe nga indeksi i konferencës nuk ka të bëjë me principet dhe rregullat ndërkombëtare të rendit aktual, por me dominimin nga ana e Perëndimit të rendit botëror. Pra, India është në kërkim të pozicionimit në tavolinën e të mëdhenjve.⁴³ Por çfarë nënkupton pozicioni i duhur për Indinë? Synimi i Indisë është të jetë një lojtare me shumë porta.

⁴⁰ Po aty faqe 101.

⁴¹ Po aty faqe 87.

⁴² India renditet si ekonomia e pestë më e madhe botërore për GDP e nominuar, me projektimin për të qenë e treta në 2027.

⁴³ Pas rizgjedhjes së tij Modi në 2019 do të deklaronte se: “India duhet të fitonte pozicionin e duhur në rendin botëror”.

Pra të mund të marrë sa më shumë përfitime nga shumë lidhje dhe bashkëpunime pa qenë e detyruar t'i bashkohet një poli të vetëm, duke sjellë në vëmendje politikën e mosangazhimit të Indisë gjatë Luftës së Ftohtë. Për këtë arsye, India jo vetëm ka krijuar lidhje të ngushta bashkëpunimi strategjik me SHBA-të në fushën e teknologjisë dhe mbrojtjes, por ka forcuar lidhjet edhe me Moskën.⁴⁴

Duke e konsideruar veten si një shtet joperëndimor, por jo antiperëndimore, India i është bashkuar platformave joperëndimore, si BRICS apo Organizata e Bashkëpunimit të Shangait. Një ndër përfundimet që tërheq vëmendje në raport në lidhje me qëndrimin e Indisë në marrëdhëniet ndërkombëtare është se: qasja mes Perëndimit dhe Rusisë e lejon atë të mbrohet nga Kina, të cilën e konsideron si një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe aspiratat globale.⁴⁵ Mbështetja ndaj Indisë për të shërbyer si kundërpeshë ndaj Kinës në rajonin e rëndësishëm të Oqeanit Paqësor dhe Indian dhe për të shërbyer si urë lidhëse me vendet që sot njihen si “Global South”, ka sfidat e veta. Këto sfida burojnë nga struktura e dobët ekonomike por edhe nga një rënie që shihet në kulturën politike të pluralizmit.⁴⁶

Brazili është gjithashtu një shtet tjetër që është kritik ndaj rendit të sotëm botëror. Vizioni i tij përfshin një “bashkëpunim shumëpolësh”. Tre janë sektorët kryesorë me të cilët Brazili kërkon të influencojë sistemin ndërkombëtar: ushqimi, ndryshimet klimaterike dhe debatet për energjinë. Flamurtari i përqaimit të tezës së shumëpolaritetit është presidenti Lula.⁴⁷ Edhe në rastin e Brazilit, si edhe për Indinë, strukturat e rendit aktual botëror dhe shpërndarja e fuqisë duhet të rishikohen, veçanërisht për t'i dhënë zë fuqive të reja në ngritje, ku edhe Brazili pretendon të jetë pjesë.⁴⁸ Vlen të theksohet se qasja për një rend shumëpolësh e Brazilit dhe kritikën e tij nuk kanë frymë antiperëndimore, pra njëlloj me Indinë ato dallojnë qartë nga Rusia dhe Kina. Edhe në këtë rast fokusi është pesha dominuese e Perëndimit në vendimmarrje më të rëndësishme të çështjeve globale. Parimi bazë që Brazili i jep jehonë në marrëdhëniet ndërkombëtare është ai i mosndërrhyrjes dhe mosangazhimit, ndaj edhe për të s'ka rëndësi forma e qeverisjes së një vendi nëse është demokraci apo regjim autoritar. Ajo që Brazili synon është arritja e statusit të një fuqie në mes, e një fuqie që shërben si urë mes palëve, duke u

⁴⁴ Pas zgjedhjeve në 2024, Modi vizitën e parë zyrtare e zhvilloi në Moskë.

⁴⁵ MSC Raport 2025, cituar më sipër, faqe 90.

⁴⁶ *Pa aty* faqe.91.

⁴⁷ Luiz Inaco Lula da Silva i njohur si Lula, është në mandatin e tij të tretë presidencial dhe është kundërshtar i hapur i qëndrimeve të Jair Bolsonaro, i cili pothuajse e tërhoqi Brazilin nga të gjitha angazhimet në organizatat botërore.

⁴⁸ Disa nga kritikën më të ashpra të Lulës janë të lidhura me faktin se në Këshillin e Sigurisë së OKB, America Latine dhe Afrika nuk kanë vende të përhershme. Propozimet e tij lidhen dhe me riorganizimin e Bankës Botërore dhe Fondin Monetar.

bërë kështu një aktor ndikues në sistemin ndërkombëtar. Pozicionimi i Brazilit synon rolin e mediatorit në konflikte globale si dhe mbajtjen e baraslarguar ndaj dy fuqive kryesore, Kinës dhe SHBA⁴⁹.

Afrika e Jugut, është gjithashtu një tjetër kritikuese e rendit aktual botëror. Edhe për Afrikën e Jugut, mosangazhimi me asnjë prej fuqive që dominojnë marrëdhëniet ndërkombëtare përbëjnë shtyllën e politikës së jashtme. Afrika e Jugut konsiderohet si një “soft power” nisur nga e shkuara e saj historike dhe tranzicioni demokratik. Për shkak të frustrimit në Afrikën e Jugut është rritur ndjeshëm fryma antiperëndimore, edhe pse anëtarësimi në BRICS nuk konsiderohet si një veprim antiperëndimore, por si shfrytëzim i një platforme zhvillimi që është më përfshirëse, që përqafon idealet progresive, qasja revizioniste e cila trumbetohet nga Rusia dhe Kina.⁵⁰ Një ndër pikat specifike që flet për një anim të Afrikës në retorikën antiperëndimore, është qëndrimi ndaj luftës në Ukrainë, duke i bërë jehonë narratives ruse se bëhet fjalë për një çështje Rusi – Perëndim. Kurse interesat ekonomike janë ato që krahas frustrimit, shtojnë drejt një orientimi politik pro Kinës për një rend të ri botëror shumëpolësh dhe dhënies fund zotërimit amerikan.⁵¹ Rënia e ndjeshme qoftë si fuqi “soft apo hard” e Afrikës së Jugut e bën edhe më të vështirë realizimin e objektivit politik për të rivitalizuar staturën e saj si një urëndërtuese në mjedisin rajonal dhe global.

Përfundime

Ashtu siç u theksua që në hyrje të këtij artikulli, nevoja e një rendi multipolar është teza më aktive që gëlon në agjendat e aktorëve që ndërveprojnë në sistemin ndërkombëtar, por edhe të studiuesve që merren me të. Këta të fundit, ku bëjnë pjesë dhe autorët e këtij shkrimi, gjykojnë se sistemi ndërkombëtar i sotëm është aq sa dinamik, fluid po edhe më kompleks sesa ajo që koncepti i polaritetit na sugjeron. Kështu nëse do t’i referoheshim vetëm kapaciteteve ushtarake dhe ekonomike, shekulli XXI po na bën të përvetësojmë zhvillime teknologjike të cilat mund ta ndryshojnë shumë më shpejt sesa zhvillimet ushtarake rendin botëror. Kjo do të thotë se edhe aktorë me kapacitete të limituara ushtarake edhe pse jo fuqi të mëdha mund të influencojnë në shpërndarjen e fuqisë. Për ta përmbyllur, orientimi në terrenin e sotëm gjeopolitik kërkon qasje sa të matur aq dhe strategjike, pasi komuniteti ndërkombëtar krahas sfidave ka edhe mundësi për ta forcuar sistemin dhe jo për ta dobësuar atë. Për aq kohë sa nuk

⁴⁹ Po aty faqe 104.

⁵⁰ Po aty faqe 112.

⁵¹ Afrika e Jugut është një ekonomi e vogël, e hapur dhe për shumë vite me radhë SHBA dhe veçanërisht BE ka qenë partneri më i rëndësishëm tregtar. Zhvendosja drejt BRICS është parë si një mundësi pragmatike.

ka një tezë të provuar se multipolariteti është më demokratik sesa uni apo bipolariteti nevojitet që në fokus të jenë pikërisht vlerat liberale dhe jo qasjet ideologjike. Duke iu referuar sistemit shumëpolësh të krijuar nga Koncerti i Vjenës në 1815 në Evropë si dhe studimeve të shkollës realiste, autorët e këtij punimi ndajnë mendimin, se një rend shumëpolësh nuk do të ofrojë siguri për asnjë aktor, pasi interesat kombëtare të secilit do të minojnë bashkëpunimin, ose do të prodhojnë aleanca të fshehta duke e bërë paqen në botë më pak të qëndrueshme.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. De Keersmaeker, G. *Polarity, Balance of Power and International Relations Theory: Post Cold War and the 19 Century Compared*, Palgrave Macmillan:2016.
2. Huntington, S. "The Lonely Superpower", *Foreign Affairs*, Nr.78.2, 1999.
3. Kohout, F. "Cyclical, Hegemonic, and Pluralistic Theories of International Relations: Some Comparative Reflections on War Causation." *International Political Science Review / Revue Internationale de Science Politique* 24, no. 1 (2003): 51–66.
4. Krauthammer, C, "The Unipolar Moment", *Foreign Affairs*, Nr. 70.1, 1990.
5. Mansfield, Edward D Concentration, Polarity, and the Distribution of Power. *International Studies Quarterly* 37: 105–128. doi:10.2307/2600833.
6. Peters, M. (2022), 'The emerging multipolar world order: A preliminary analysis', *Educational Philosophy and Theory*, DOI: 10.1080/00131857.2022.2151896.
7. Tanisha Fazal M. "The Return of Conquest? Why the Future of Global Order Hinges on Ukraine", *Foreign Affairs*, Nr 101:2, 2020.

Faqe web të shfrytëzuara:

- <https://securityconference.org/en/about-us/history/>
- https://securityconference.org/medialibrary/images/2014/Buchbeitr%C3%A4ge/Munich_Security_Conference_05_Ischinger.pdf
- <http://www.newsweek.com/id/135380/output/print>
- <https://www.project-syndicate.org/commentary/tactical-foreign-policy-fixes-by-javier-solana-2014-10>
- <https://www.nytimes.com/2014/11/20/world/europe/frank-walter->

steinmeier-germanys-foreign-minister-a-man-in-the-middle.html

- <https://securityconference.org/en/publications/munich-security-report-2025/>
- <https://www.wilsoncenter.org/article/making-sense-munich-security-conference>
- <https://warontherocks.com/2025/02/the-superpower-has-left-the-building-munich-2025/>
- <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2023/09/21/address-of-president-charles-michel-at-the-78th-session-of-the-un-general-assembly/>

PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE ROLI I ISMAIL QEMALIT NË POLITIKËN E JASHTME

Major Msc. Kujtim ZEKA

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA

Nënkolonel Msc. Rafael MEMIA

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar

Ky punim përqendrohet në veprimtarinë politike dhe diplomatike të Ismail Qemalit për pavarësinë e Shqipërisë, duke e vendosur atë në kontekstin e transformimeve historike dhe strategjike të fillimit të shekullit XX. Ai trajton jo vetëm përpjekjet e tij për shkëputjen nga Perandoria Osmane, por edhe sfidat e jashtme që rridhnin nga interesat të fuqive evropiane mbi Ballkanin. Një pjesë e rëndësishme e analizës fokusohet te situata politike dhe ushtarake e asaj kohe, si pasojat e disfatës osmane kundër Italisë dhe ndikimi i traktateve ndërkombëtare në fatin e territoreve shqiptare. Në këtë kuadër, shqetësimi kryesor ishte siguria e kufijve dhe ruajtja e integritetit territorial, pasi kompromiset ndërmjet shteteve ballkanike dhe Perandorisë Osmane mund të dëmtonin aspiratat shqiptare për shtetësi të pavarur.

Diplomacia e Ismail Qemalit dhe Qeverisë së Përkohshme të Vlorës ishte vendimtare për sigurimin e njohjes ndërkombëtare dhe legjitimitetit të shtetit të ri shqiptar. Veprimet e tij përfshinin takime me përfaqësues të fuqive të mëdha dhe dërgimin e memorandumeve ku theksonin aspiratat e kombit shqiptar për liri dhe pavarësi. Në këtë proces, ai mobilizoi diplomacinë dhe opinionin publik evropian përmes kontakteve me ambasadorë dhe intervistave

në shtypin ndërkombëtar. Përpyekjet e tij kulmuan në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, ku u përball me sfidën e njohjes dhe përcaktimit të kufijve në baza etnike. Përmes këtij angazhimi, ai kontribuoi në shtrimin e rrugës për themelimin e shtetit shqiptar në një moment kritik, kur balancat politike dhe ushtarake në rajon ishin në lëvizje të vazhdueshme.

Ky punim sintetizon një proces historik kompleks, ku politika, diplomacia dhe strategjia ndërkombëtare ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e shtetit shqiptar. Ai nxjerr në pah rolin e Ismail Qemalit si një figurë kyçe në realizimin e pavarësisë, duke shpjeguar sfidat e kohës dhe rrugën e ndërmarrë për njohjen e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: Pavarësia e Shqipërisë, fuqitë e mëdha, Perandoria Osmane, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, diplomacia, strategjia ndërkombëtare

Hyrje

Ismail Qemali ishte udhëheqës i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kryetari i parë i Shqipërisë së pavarur. Pasi kreu shkollën fillore në qytetin e lindjes dhe gjimnazin “Zosimea” në Janinë, në vitin 1859 u vendos me familjen e tij në Stamboll, ku u aktivizua në lëvizjen patriotike shqiptare dhe mori pjesë në përpyekjet për caktimin e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe dhe për formimin e një shoqërie kulturore shqiptare. Në Perandorinë Osmane pati funksione të rëndësishme administrative dhe u shqua shumë shpejt si personalitet me pikëpamje liberale. Për mbi katër dekada ai ka qenë pjesë e administratës së lartë në Perandorinë Osmane, deri dhe në disa pozicione të larta zyrtare si, guvernator në disa shtete, sekretar i përgjithshëm i ministrisë së jashtme, deputet në parlamentin osman etj.¹ Postet e tij i përdori jo vetëm për të ndihmuar lëvizjen çlirimtare të bashkatdhetarëve, por edhe për të lehtësuar sado pak gjendjen e vështirë të popujve të shtypur të perandorisë osmane duke luftuar kundër obskurantizmit e dallimit racor dhe duke përkrahur përhapjen e kulturës e të dijeve shkencore. Kërkesat e Ismail Qemalit për zbatimin e reformave demokratike e çuan në konflikt me rrethet konservatore të Stambollit. I. Qemali zhvilloi një aktivitet të dendur politik për njohjen e Shqipërisë në opinionin evropian. Platforma politike e Ismail Qemalit në përgjithësi përputhej me atë të ideologëve të tjerë të Rilindjes, por me disa veçori në lidhje me rrugët e mjetet për sigurimin e autonomisë. Në dhjetor të 1908, me gjithë luftën që i bënë autoritetet xhonturke, u zgjodh deputet i sanxhakut të Beratit në parlamentin osman ku, së bashku me grupin

¹ Agim Jazaj, “112 Vjetori i Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare dhe Delegatët”, Gazeta Telegraf, 24 Nëntor 2024.

e deputetëve patriotë, mbrojti interesat e kombit shqiptar. Në këtë kohë ai kaloi në pozitat më të përparuara duke e konsideruar kryengritjen e armatosur si mjetin kryesor për sigurimin e autonomisë së Shqipërisë. U dallua si frymëzues dhe organizator i kryengritjeve anti osmane të viteve 1910-1912. Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë, u mbështet fuqishëm nga deputetët shqiptarë në Parlamentin Osman, ku spikatën Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Nexhip Draga dhe Myfit Libohova. Ismail Qemali gjatë aktivitetit të tij politik në Parlamentin turk, mbrojti me kurajë luftën e shqiptarëve të Kosovës në kryengritjen e vitit 1910 kundër qeverisë xhonturke, e cila po dhunonte të drejtat dhe liritë e tyre. Së bashku me Luigj Gurakuqin dhe patriotë të tjerë hartuan memorandumën e Greçës të qershorit 1911, ku ky dokument ishte mishërim i kërkesave shqiptare për një autonomi të plotë. Në fund të atij viti mori nismën për organizimin e kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912. I ngarkuar nga rrethet patriotike të vendit shkoi në Stamboll për ta bindur qeverinë osmane që t'u jepte shqiptarëve autonominë. Në fjalimin e tij, ai u kërkonte xhonturqve që të mbanin fjalën e paraardhësve të tyre e të respektonin traditën shekullore në marrëdhëniet shqiptaro-turke, duke mos u përzier në punët e brendshme të Shqipërisë. Në përshkrimet e politikanëve dhe diplomatëve austriakë, kryengritja në Shqipërinë e Veriut shikohej si vepër personale e Ismail Qemalit. Sipas tyre, ai ishte i bindur se herët a vonë Austro-Hungaria do të detyrohet t'i ndihmojë shqiptarët në luftën e tyre për liri. Pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike ndërmori së bashku me Luigj Gurakuqin një aksion të ri politik për të shpëtuar Shqipërinë nga synimet ekspansioniste të shteteve ballkanike. Në mbledhjen e Bukureshtit më 5 nëntor 1912 gjeti përkrahjen e kolonisë shqiptare të atjeshme dhe prej andej shkoi në Vjenë ku u takua me personalitete politike austro-hungareze dhe me përfaqësues diplomatikë të Fuqive për të shtruar e mbrojtur çështjen shqiptare duke pasur parasysh kontradiktat që ekzistonin midis fuqive të mëdha.

Ismail Qemali dhe Pavarësia e Shqipërisë në kuadrin e zhvillimeve politike evropiane

Situata gjeopolitike në Evropë dhe Gadishullin e Ballkanit gjatë fillimit të shekullit XX, do të kishte patjetër një ndikim të drejtpërdrejtë edhe për fatin e tokave shqiptare të cilat ishin nën juridiksionin e Perandorisë Osmane. Dobësimi apo rënia e Perandorisë Osmane, ishte me pasoja fatale edhe për tokat shqiptare, të cilat rrezikoheshin të aneksoheshin nga vendet ballkanike si kompensim për fitoren ndaj Turqisë. Në këto kushte, shumë intelektualë atdhetarë e shihnin Perandorinë Osmane si mjet për të frenuar lakmitë shoviniste të fqinjëve. Por kishte një rrymë atdhetare radikale që mendonte se shqiptarët duhet të paraqiteshin para botës si komb me shtetin e tyre dhe

të përballeshin me fqinjët si të tillë². Për të njohur më qartë rrethanat politike dhe ushtarake evropiane të fillim të shekullit XX, po i referohemi luftës italo-turke 1911-1912 dhe ndikimit që pati ky konflikt për çështjen shqiptare dhe në zhvillimin e ngjarjeve të mëvonshme në Gadishullin e Ballkanit. Duhet theksuar se Italia kishte marrë pëlqimin e Francës në vitin 1900 dhe të Rusisë në vitin 1909, për pushtimin e Tripolit. Në datën 29 shtator të vitit 1909, qeveria italiane informoi qeverinë Turke se do të pushtonte Tripolin, por Turqia e hodhi poshtë këtë kërkesë e për pasojë, Italia i shpalli luftë Turqisë dhe në shtator të vitit 1911, ajo pushtoi Tripolin. Trupat italiane e thyen pa vështirësi ushtrinë turke. Për t'i bërë presion Turqisë, ushtria italiane pushtoi ishujt e Dodekanezit në detin Egje, si dhe bombardoi hyrjet e ngushticave dhe disa porte detare turke.

Në këto rrethana u krijua Aleanca Ballkanike anti osmane ku u përfshinë Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia. Në situatën e pafavorshme në të cilën u ndodh Turqia, më datë 18 tetor 1912 nënshkroi Traktatin e Paqes së Lozanës, ku sipas këtij traktati, Turqia do t'i njihte Italisë pushtimin e Tripolitanisë dhe të Kirenajkës³. Në përgjigje të veprimit të Italisë, vendet ballkanike u frikësuan se mos Austro-Hungaria merrte avantazhin e situatës së pafavorshme në Turqi për ti marrë asaj zotërimet që kishte në Ballkan siç ishin territoret shqiptare, maqedonase dhe Trake. Nisur nga këto rrethana, në mars të vitit 1912, Bullgaria dhe Serbia lidhen një aleancë duke premtuar ndihmë për njëra tjetrën në rast sulmi, si dhe të bashkëpunonin për të shmangur përpjekjet e Fuqive të Mëdha për të zënë territoret ballkanike dhe të ndiqnin një politikë të përbashkët konsultimesh për Turqinë. Brenda pak muajsh në këtë marrëveshje aderuan edhe Greqia dhe Mali i Zi. Në tetor të vitit 1912, katër shtetet ballkanike ndërморën një sulm ushtarak të bashkërenduar ndaj forcave turke në Evropë dhe brenda pak muajsh i detyruan të tërhiqen drejt ngushticave dhe më pas aleatët ballkanikë, iu rikthyen misionit të tyre për të ndarë plaçkën territoriale, duke futur ushtritë e tyre në territoret turke të Ballkanit për të realizuar synimet e tyre ekspansioniste⁴. Me fillimin e konfliktit ballkanik, çështja shqiptare u vendos në qendër të luftës diplomatike ndërmjet fuqive të mëdha, të cilat ishin Austro-Hungaria, Italia dhe Rusia. Dy vendet e para ishin për një Shqipëri autonome ose të pavarur e me kufij sa më të gjerë, por nën ndikimin e tyre. Në rrethanat e reja të krijuara nga shembja e sundimit osman në Ballkan, Shqipëria merrte rëndësi të veçantë në politikën ballkanike

² Nikollë Loka, “Pavarësia e Shqipërisë, një Proces Historik Gjithëpërfshirës”, Gazeta Shqip, 3 qershor 2012, 11:02.

³ Menduh Derguti, Romeo Gurakuqi, “Historia e Kohës së Re (3), Qytetërimi Perëndimor 1871-1918”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2004, f.306.

⁴ Po aty, f.307.

për Austro-Hungarinë, si një gardh që do të pengonte shtrirjen e sllavizmit në gadishullin e Ballkanit dhe si një urë për të dalë në Selanik të Greqisë.

Për Italinë, Shqipëria mund të shërbente si bazë për depërtimin e saj drejt lindjes⁵. Rusia kishte si qëllim zmadhimin e tokave shqiptare dhe ndarjen e tyre ndërmjet shteteve fqinje. Duhet theksuar se domosdoshmëria e ndalimit të luftës ballkanike u bë urgjente edhe për fuqitë e mëdha. Shpallja e pavarësisë u bë zgjidhja e vetme që mbetej, madje edhe urgjente në rrethanat kur shpartallimi i ushtrive osmane në Ballkan ishte bërë fakt i kryer dhe kur forcat e shteteve fqinjë kishin përparuar edhe më tepër në territoret shqiptare. Ismail Qemali gjatë qëndrimit të tij në Trieste, me datën 20 nëntor 1912, dha një intervistë në gazetën italiane “Il Piccolo”, ku deklaroi hapur, se menjëherë pas mbërritjes në Shqipëri, do të shpallej pavarësia e Shqipërisë e do të krijohesh një qeveri e përkohshme, ku për këtë çështje janë të gjithë në një mendje⁶.

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali, ngarkoi ministrin e Postë-Telegrafit, Lef Nosin, që të njoftonte Fuqitë e Mëdha, Anglinë, Austro-Hungarinë, Francën, Gjermaninë dhe Rusinë, si dhe vendet ballkanike, Rumaninë, Serbinë, Bullgarinë, Greqinë dhe Turqinë, me qëllim që ata të njihnin aktin e shpallje së Pavarësisë. Ky akt përbëhet prej një faqeje e gjysmë, ku ndër të tjera thuhet: “Kam nderin të njoftoj Shkëlqesinë tuaja se delegatët e të gjithë krahinave shqiptare, pa dallim feje, të mbledhur dje në Asamblenë Kombëtare në qytetin e Vlorës, shpallën pavarësinë e Shqipërisë dhe kanë ngritur një Qeveri të Përkohshme. Shqiptarët po gëzohen që mundën të hyjnë në familjen e popujve të lirë të Orientit, duke mos pasur për qëllim tjetër, veçse të jetojnë në paqe dhe harmoni me të gjitha shtetet fqinje; shpresojmë se ky ndryshim i jetës politike dhe kombëtare i Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë ka për t’u njohur prej qeverive tuaja dhe Evropës”. Kuvendi, duke pasur parasysh ekuilibrin e raporteve fetare, vendosi që qeveria të përbëhej prej 5 të krishterëve dhe 5 myslimanëve⁷. Ai kërkoi largimin e ushtrive të aleancës ballkanike dhe deklaroi se Shqipëria mban qëndrim asnjans në luftën ballkanike⁸. Ismail Qemali kërkoi fuqive të mëdha njohjen e shtetit shqiptar, por asnjëra prej këtyre fuqive nuk u përgjigj zyrtarisht, për shkak se fuqitë e mëdha nuk kishin një qëndrim të përcaktuar sa i takon çështjes shqiptare. Fuqitë e mëdha ranë dakord që të mbledheshin në Londër për të shqyrtuar çështjet kryesore nga lufta ballkanike. Në konferencën

⁵ Arben Puto, Kristo Frashëri, “*Historia e Popullit Shqiptar*” Vëllimi III, Sh. Botuese Toena, Tiranë 2007, f.19.

⁶ Paskal Milo, “*Politika e Jashtme e Shqipërisë I*”, Sh. Botuese Toena, Tiranë 2013, f.53.

⁷ Dorian Koçi, “*Rrugëtimi drejt Pavarësisë*”, Gazeta Dita, Tiranë 28 nëntor 2024.

⁸ Arben Puto, Kristo Frashëri, “*Historia e Popullit Shqiptar*” Vëllimi III, Sh. Botuese Toena, Tiranë 2007, f.18.

e Londrës nuk morën pjesë Shqipëria dhe vendet e Ballkanit⁹. Gjatë punimeve të Konferencës së Londrës 1913, Qeveria e Vlorës i paraqiti një memorandum ku ndër të tjera kërkoi që: Peja, Mitrovica, Prishtina, Presheva, Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Dibra, Manastiri, Kosturi, Janina, të mbeteshin Brenda kufijve të Shqipërisë, ndërsa për kufijtë jugorë, qeveria e Vlorës kërkoi që kufiri jugor të shtrihej deri në Prevezë¹⁰.

Në memorandumine qeverisë së Vlorës, hidhej poshtë teza e aleatëve ballkanikë se Shqipëria ishte e lidhur me Turqinë dhe për pasojë trojet shqiptare do të shërbenin si kompensim territorial për aleatët që fituan luftën. Së fundmi u kujtohej përfaqësuesve të konferencës së Londrës edhe kryengritjet shqiptare ndaj osmanëve, që kishin zhvilluar gjatë fillimit të shekullit të 20-të. Në intervistën e dhënë për gazetën më të madhe austriake të kohës, “Neue Freie Presse”, në Vjenë më 8 nëntor 1912, Ismail Qemali shpalosi idetë e tij për politikën që do të ndiqte shteti shqiptar në raport me fqinjët ballkanikë. Ai e krahason pretendimin e Serbisë për të pasur një port në Adriatik, njësoj sikur Zvicra e rrethuar me male të thoshte, meqë nuk ka dalje në det, nuk mund të ekzistojë dot në qoftë se nuk i jepet porti i Gjenovës¹¹. Ismail Qemali deklaroi më tej se Shqipëria e pavarur do të jetë një shtet me rreth dy milionë e gjysmë banorë. Ky shtet duhet të përfshijë të tërë Vilajetin e Shkodrës, pjesën shqiptare të vilajetit të Janinës, pjesën shqiptare të Manastirit, pjesën perëndimore të Manastirit përreth Ohrit, Dibrën, Elbasanin, Korçën, sanxhakun e Pejës me Gjakovën, sanxhakun e Prizrenit, një pjesë të Sanxhakut të Shkupit dhe një pjesë të sanxhakut të Prishtinës. Për marrëdhëniet me dy fuqitë të cilat përkrahnin idenë e shtetit të pavarur shqiptar, ai shprehej se dëshironte të kishte marrëdhënie të mira me Austro-Hungarinë dhe me Italinë, në mënyrë që këto dy shtete të mbështesin nevojat tona kulturore dhe ekonomike. Një vendi të vogël i nevojitet përkrahja e shteteve të mëdha dhe është e qartë se kjo mbështetje tek dy vendet aleate të Adriatikut, Austro-Hungaria dhe Italia, do të vijë vetvetiu. Ismail Qemali shprehej se Austro-Hungaria do të kishte vetëm përfitime nga një Shqipëri e pavarur¹². Pushtimi serb i Shqipërisë ndeshi në kundërshtimin e vendosur të Austro-Hungarisë, e cila prej muajsh po ndiqte zhvillimet në Ballkan dhe ishte bërë garantë e autonomisë ose pavarësisë së Shqipërisë. Për të baraspeshuar ekspansionin serb, Austro-Hungaria mendonte të përfshinte në kufijtë e Shqipërisë veriore territoret e Elbasanit, Dibrës, të gjithë Vilajetin e Shkodrës, territoret e Prizrenit dhe të

⁹ Po aty, f.20.

¹⁰ Po aty, f.21.

¹¹ Evarist Beqiri, “Roli i Ismail Qemalit në Pavarësimin e Shqipërisë”, Gazeta Epoka e Re”, 19 nëntor 2024, 09:08.

¹² Po aty.

Pejës¹³. Austro-Hungaria dhe Italia nuk dëshironin një port serb në Adriatik. Me datën 10 nëntor 1912, Austro-Hungaria i drejtohet Serbisë, ku i shpreh se nuk do të toleronte një dalje detare të Serbisë në territorin kombëtar shqiptar¹⁴. Për shkak të kërcënimeve të Austro-Hungarisë, Rusia hoqi dorë nga ideja për ndarjen e tokave shqiptare dhe u pajtua me idenë e krijimit të një shteti shqiptar. Rusia pranoi gjithashtu që mos të ngulte këmbë për daljen tokësore të Serbisë në Adriatik. Austro-Hungaria u pajtua me kërkesën e Rusisë e cila përkrahej edhe nga Franca, për të krijuar një shtet shqiptar autonom të varur nga Turqia, të cilin Rusia e kishte parashikuar si plan për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Qeveria e Vjenës premtojte që në përcaktimin e kufijve të Shqipërisë të merrej parasysh edhe e drejta e kompensimit territorial të aleatëve ballkanik, si shtete fituese në luftë. Në këtë mënyrë populli shqiptar dënohej që më parë të vuante pasojat e një lufte që as se kishte shpallur, e as nuk e kishte humbur.

Për shkak të interesave që kishin fuqitë e mëdha për çështjen shqiptare, aleanca ballkanike u detyrua të hiqte dorë nga detyrimet territoriale e të njihte autonominë e shtetit shqiptar deri në marrjen e vendimeve përfundimtare nga fuqitë e mëdha. Deri me datën 8 maj 1913, Vjena dhe Roma ishin akoma me variantin që Shqipëria të ishte autonome në sundimin Turk, por duke qenë se tashmë roli i Turqisë ishte zbehur shumë, Vjenës dhe Romës nuk i interesonte shumë prania e Turqisë në Shqipëri¹⁵. Në fakt që gjatë muajit Janar 1913, Vjena dhe Roma e kishin hedhur idenë e një pavarësie të plotë të Shqipërisë, ndërsa qeveria Ruse nguli këmbë që Shqipëria të mbetej autonome, nën sundimin turk, por presioni i Anglisë, Francës ndikoi që qeveria ruse të ndryshonte qëndrim. Në mbledhjen që u zhvillua me datën 20 maj të vitit 1913, Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, arriti marrëveshjen në parim për pavarësinë e Shqipërisë. Ndërsa në Traktatin e Paqes nënshkruar me datën 30 maj të vitit 1913, ndërmjet vendeve ballkanike (aleatëve) dhe Turqisë, përcaktohej se Turqia hiqte dorë nga të drejtat e saj mbi Shqipërinë (neni 2), ndërsa Fuqive të Mëdha u njihej e drejta për të zgjidhur çështjen e caktimit të kufijve, si dhe çdo çështje tjetër që ka të bëjë me Shqipërinë.

Veprimtaria e Ismail Qemalit për njohjen e Shtetit Shqiptar

Më 23 dhjetor 1912, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e kryesuar nga Ismail Qemali, i dërgon një telegram përfaqësuesit të saj në Paris Rasim Bej Dinos,

¹³ Egidio Ivetić, “Luftërat Ballkanike”, Sh. Botuese Dituria, Tiranë 2008, f.100.

¹⁴ Po aty, f.101.

¹⁵ Arben Puto, Kristo Frashëri, “Historia e Popullit Shqiptar” Vëllimi III, Sh. Botuese Toena, Tiranë 2007, f.27.

ku i përcakton kërkesat që duhet të paraqesë Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, lidhur me caktimin e kufijve të Shqipërisë, ku ndër të tjera udhëzohet që të paraqesë një memorandum konferencës për një pavarësi sa më të plotë të Shqipërisë, si dhe bëni përpjekje që të vijë në Shqipëri një komision miks që të caktojë kufijtë në vendin tonë jashtë ndikimeve të dëmshme për interesat tona kombëtare¹⁶. Sapo filloi punimet Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, në dhjetor të vitit 1912, një delegacion nga Shqipëria i kryesuar nga Ismail Qemali mbërriti në Londër. Delegacioni shqiptar që në janar të vitit 1913, i paraqiti Konferencës së Ambasadorëve memorandum për kufijtë e Shqipërisë, ku përfshiheshin të gjitha viset shqiptare. Delegatët shqiptarë takuan disa herë përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha që merrnin pjesë në konferencë, ku u përpoqën të lobonin për kufijtë e Shqipërisë.

Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Isa Boletini, gjatë pranverës të vitit 1913, vizituan Romën, Vjenën, Parisin për të lobuar për çështjen Shqiptare¹⁷. Gjithashtu qeveria e Vlorës mbante lidhje edhe me konsujt e qeverive të mëdha që ndodheshin në Vlorë. Nder aspektet kryesore të përpjekjeve diplomatike të zhvilluara nga Ismail Qemali, për njohjen e Shtetit të ri Shqiptar ishte Memorandumi i qeverisë së Vlorës paraqitur me datën 2 janar të vitit 1913, Eduart Greit, Ministrit të Punëve të Jashtme Britanik ku ndër të tjera, Ismail Qemali paraqet në mënyrë të argumentuar historikun dhe vlerat e popullit shqiptar, ku thekson në memorandum, se populli shqiptar formon grupimin etnik më kompakt, më homogjen e të rëndësishëm në gadishullin e Ballkanit. Nder të tjera, në memorandum, Ismail Qemali thekson se Shqipëria është plotësisht e vendosur të bëhet një element ekuilibri dhe paqeje në gadishullin ballkanik, por për tu përmbushur ky detyrim nevojitet para së gjithash homogeniteti tyre kombëtar dhe pavarësia absolute e Shqipërisë¹⁸. Populli shqiptar nuk do të durojë që të drejtat e tij të jenë pjesërisht të sakrifikuara dhe e ardhmja e tij duhet të jetë e ndërtuar mbi baza të qëndrueshme. Pra, nuk mund të kemi paqe në Ballkan në rast se nuk do të njihen kufijtë etnik të çdo shteti¹⁹. Në letërën drejtuar përfaqësuesve të Rusisë, Austrisë, Italisë që ndodheshin në Vlorë, Ismail Qemali pati një komunikim diplomatik të një niveli të lartë në interes të objektivave kombëtare. Ndërsa me datën 5 janar 1913, delegacioni shqiptar takoi në Londër ambasadorin francez Pol Kambo i cili dy ditë më vonë, i raportoi kryeministrit R. Puankare, ku i shkruante se:

¹⁶ Teuta Hoxha, "Ismail Qemali, Përmbledhje Dokumentesh 1888-1919", Sh. Botuese Mësonjëtorja e Parë, Tiranë 2002, f.299.

¹⁷ Arben Puto, Kristo Frashëri, "Historia e Popullit Shqiptar" Vëllimi i III-të, Sh. Botuese Toena, Tiranë 2007, f.28.

¹⁸ Teuta Hoxha, "Ismail Qemali, Përmbledhje Dokumentesh 1888-1919", Sh. Botuese Mësonjëtorja e Parë, Tiranë 2002, f.311.

¹⁹ Po aty, f.312.

Mehmet Konica dhe dy kolegët e tij mbronin me shumë zotësi kauzën për një pavarësi të plotë të Shqipërisë, duke pasur si objektiv shkëputjen nga çdo lloj varësie nga Perandoria Osmane²⁰.

Duke marrë parasysh rrethanat e politikës ndërkombëtare, veçanërisht gjatë fillimit të shekullit XX, pozicionin politik në të cilin ndodhej Shqipëria, si dhe interesat e fuqive të mëdha, mund të dalim në përfundimin se situatë politike dhe diplomatike ishte mjaft e vështirë për shtetin e ri shqiptar. Ismail Qemali si kryetar i qeverisë së re dhe njëkohësisht si ministër i punëve të jashtme, ndërmoi hapat e duhura diplomatike për njohjen e shtetit të ri shqiptar, por këto përpjekje nuk arritën rezultatet e duhura sepse gjithçka do të varej nga kryerja e marrëveshjeve që do të bënin Fuqitë e Mëdha për të përmbushur interesat e tyre strategjike në Ballkan dhe Shqipëri. Ismail Qemali u tregua mjaft i matur në qëndrimet e tij gjatë konfliktit ballkanik. Ai zgjodhi të mbante një qëndrim asnjanes, sepse e konsideronte si zgjidhjen më të arsyeshme dhe më të mundshme në rrethanat e asaj kohe. Ky qëndrim synonte që ta nxirrte Shqipërinë jashtë rrezes së veprimit të së drejtës së luftës, për ti kursyer vendit pasojat e disfatës tashmë të sigurt të Perandorisë Osmane, me të cilën aleatët ballkanikë përpiqeshin të lidhnin edhe fatin e tokave shqiptare²¹. Gjithashtu Ismail Qemali, ndër të tjera i shprehu Vezirit të madh se Shqipëria nuk do të mbështetet tek Italia e as tek Austro-Hungaria, por në të drejtat e shqiptarëve për të ekzistuar si nacionalitet me vete. Në rrethanat e krijuara, Turqia do të ishte një avokate e keqe për Shqipërinë, e kështu që shqiptarët preferojnë ti mbrojnë vetë të drejtat e tyre²². Ismail Qemali dhe qeveria e tij patën dy objektiva kryesorë, të cilat ishin: t'i jepeshin Shqipërisë në kohën e duhur tiparet e një shteti me vete me një minimum organizimi të brendshëm, aq sa lejonte zhvillimi i ngjarjeve në Ballkan dhe të përcaktohej pozita ndërkombëtare e Shqipërisë pas shkëputjes nga Perandoria Osmane dhe për të ndikuar në një drejtim sa më të favorshëm mbi vendimet e pritshme të Fuqive të Mëdha për çështjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe caktimin e kufijve²³. Gjatë takimit që Ismail Qemali zhvilloi në Romë me ministrin e jashtëm Italian San Giuliano dhe me ambasadorin e Austro-Hungarisë Merey, në datën 1 dhe 3 prill 1913, ai shprehu se Shqipëria do të shkëpusë çdo lloj lidhje varësie me Turqinë²⁴. Ndërsa gjatë takimit që zhvilloi në Vjenë me Ministrin e Jashtëm Bertold, më 10 prill 1913, Ismail Qemali i vuri në dukje Bertoldit se Austro-Hungaria po tregohet e ngathët dhe pesimiste ndaj zhvillimeve të Konferencës së Ambasadorëve që po zhvillohej në Londër.

²⁰ Paskal Milo, "Politika e Jashtme e Shqipërisë I", Sh. Botuese Toena, Tiranë 2013, f.89.

²¹ Arben Puto, "Shqipëria Politike 1912-1939", Sh. Botuese Toena, Tiranë 2009, f.46.

²² Po aty, f.47.

²³ Arben Puto, "Shqipëria Politike 1912-1939", Sh. Botuese Toena, Tiranë 2009, f.47.

²⁴ Po aty, f.89.

Bertoldi i shprehu I. Qemalit se ishin të pakta shpresat për të shpëtuar integritetin territorial të Shqipërisë, pavarësisht përpjekjeve që kishte bërë diplomacia austriake²⁵.

Gjatë vizitës diplomatike që zhvilloi I. Qemali në Londër aty nga fundi i prillit 1913, ai u përpoq të ngrinte me forcë çështjen shqiptare, por nuk gjeti asnjë përkrahje nga qarqet zyrtare, si dhe nga përfaqësuesit e Konferencës së Ambasadoreve. Liberalët anglezë mendonin se shqiptarët ishin të gjithë turq dhe myslimanë, ndërsa konservatorët i konsideronin shqiptarët si prishës të paqes, duke i krahasuar me irlandezët. Ai dha një intervistë në gazetën e Londrës “The Evening News”, ku ndër të tjera, ai pranonte se pas disfatës së Turqisë, ishte normale që të behej një rindarje e territoreve në Ballkan, por vetëm mbi bazën e kombësisë, e jo të bëhen mbi kurrizin e tokave shqiptare²⁶. Veprimtaria diplomatike e Ismail Qemalit, nuk mund të shihet apo të analizohet si e shkëputur nga interesat gjeopolitike që kishin fuqitë e mëdha mbi Shqipërinë dhe Gadishullin e Ballkanit. Pavarësisht përpjekjeve intensive diplomatike të zhvilluara nga Ismail Qemali, sërish, statusi politik i Shqipërisë do të varej vetëm nga vendimet e fuqive të mëdha. Gjithsesi, duhet të nënvizojmë se roli i Ismail Qemalit për njohjen e shtetit të ri shqiptar ishte shumë aktiv, sepse nëpërmjet memorandumëve, takimeve dhe lobimeve që zhvilloi me përfaqësuesit e fuqive të mëdha, veçanërisht me ato të Austro-Hungarisë, Italisë dhe Francës, arriti t’u paraqiste fuqive të mëdha synimin final që ishte pavarësia e vendit pa kushte. Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës. Shpallja e pavarësisë shënon një moment historik për popullin shqiptar, sepse nga njëra anë mori fund sundimi gati pesëshekullor i Perandorisë Osmane, nga ana tjetër u krijuan kushtet e reja politike për të dalë nga prapambetja e madhe ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Shpallja e Pavarësisë ishte një fitore e madhe e shqiptarëve edhe kundër politikës antishqiptare të monarkive fqinje ballkanike, kundër synimeve e planeve të tyre për copëtimin e plotë të Shqipërisë. Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë ishte fitore e përbashkët për të gjithë popullin shqiptar dhe për të gjitha forcat që kishin marrë pjesë në luftën për çlirimin kombëtar.

²⁵ Po aty, f.90.

²⁶ Po aty.

Përfundime

Ismail Qemali e shfrytëzoi shumë mirë përvojën e tij si diplomat dhe si ish-drejtnes kryesor në strukturat e larta të Perandorisë Osmane, ku ndikoi në një masë të konsiderueshme në qëndrimet dhe vendimet që do të merrnin Fuqitë e Mëdha për statutin e Shqipërisë, i cili do të vendosej nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, që zhvilloi punimet në periudhën dhjetor 1912 - korrik 1913. Austro-Hungarezët e mbështetën Ismail Qemalin, sepse ata e vlerësonin se ishte i vetmi politikan që mund t'i orientonte dhe bashkonte shqiptarët në këtë moment të favorshëm historik. Qeveria e përkohshme e Vlorës, funksionoi për 14 muaj, por gjatë kësaj periudhe, nuk u njoh nga Fuqitë e Mëdha dhe më 22 janar të vitit 1914, I. Qemali u detyrua të largohej nga drejtimi i qeverisë shqiptare, në një kohë kur Shqipëria ndodhej në një situatë kritike ku kishte nevojë të madhe për një udhëheqje të aftë kombëtare për të përballuar bllokun armiqësor të Fuqive të Mëdha dhe të monarkive fqinje, me të cilat ishin bashkuar edhe një pjesë e figurave politike shqiptare të kohës. Në këto rrethana, I. Qemali largohet nga Shqipëria më datën 24 janar të vitit 1914 dhe vendoset me familjen e tij në Nice të Francës, nga ku vazhdoi veprimtarinë e tij politike dhe luftën për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve. I. Qemali u kthye përsëri në Vlorë nga fundi i majit të vitit 1914, dhe u trondit mjaft kur mori vesh nënshkrimin e protokollit të Korfuzit, i cili cenonte në mënyrë të hapur sovranitetin e shtetit shqiptar dhe ishte në kundërshtim me statusin organik të Shqipërisë të miratuar nga vetë Fuqitë e Mëdha në korrik të vitit 1913. Për këtë problem ai u takua me Princ Vidin por gjatë takimit, ai u zhgënjye shumë për shkak të kujdesit të pakët që treguan Fuqitë e Mëdha në çështjen e zgjidhjes së sovranitetit të plotë të Shqipërisë.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Puto, Arben, “Shqipëria Politike 1912-1939”, Sh. Botuese Toena, Tiranë, 2009.
2. Milo, Paskal, “Politika e Jashtme e Shqipërisë I”, Sh. Botuese Toena, Tiranë, 2013.
3. Puto, Arben, Frashëri, Kristo, “Historia e Popullit Shqiptar” Vëllimi III, Sh. Botuese Toena, Tiranë 2007.
4. Ivetic, Egidio, “Luftërat Ballkanike”, Sh. Botuese Dituria, Tiranë, 2008.
5. Hoxha, Teuta, “Ismail Qemali, Përmbledhje Dokumentesh 1888-1919”, Sh. Botuese Mësonjëtorja e Parë, Tiranë, 2002.
6. Beqiri, Evarist, “Roli i Ismail Qemalit në Pavarësimin e Shqipërisë”, Gazeta “Epoka e Re”, Tiranë, 19 nëntor 2024, 09:08.

7. Jazaj, Agim, “112 Vjetori i Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare dhe Delegatët”, Gazeta “Telegraf”, Tiranë, 24 nëntor 2024.
8. Loka, Nikollë, “Pavarësia e Shqipërisë, një Proces Historik Gjithëpërfshirës”, Gazeta “Shqip”, Tiranë, 3 qershor 2012, 11:02.
9. Koçi, Dorian, “Rrugëtimi drejt Pavarësisë, Gazeta “Dita”, Tiranë 28 nëntor 2024.
10. Derguti, Menduh, Gurakuqi, Romeo, “Historia e Kohës së Re (3), Qytetërimi Perëndimor 1871-1918”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2004.

SUBJEKTE PËR LUFTËRAT E ARDHSHME

Kolonel (R) Zeno JAHAJ

Trajtesë e shkurtuar

Lufta moderne nuk mund të mbështetet më në konceptet dhe subjektet e së kaluarës, pasi jemi pjesë e një mjedisi njerëzor, teknologjik, social-psikologjik dhe gjeografik që po ndryshon me ritme të shpejta. Ndër faktorët kryesorë, më themelori mbetet njeriu - qytetari që jo vetëm e përjeton luftën, por edhe e drejton dhe e menaxhon atë përmes teknologjive të avancuara. Sot, lufta udhëhiqet nga mekanizma modernë, si dronë të komanduar nga distanca të largëta, sisteme vëzhgimi satelitore, armë me precizion të lartë, raketa hipersonike, inteligjencë artificiale dhe komunikime të ndërlidhura në rrjet.

Një çështje themelore mbetet mënyra se si do të zhvillohet lufta e së nesërme - do të bazohet në këto mjete transformuese që po e riformësojnë fushëbetejën, apo do të ruajë ende disa forma tradicionale të konfliktit? Megjithatë, sot dhe në të ardhmen, koncepti i gjeopolitikës po ndryshon: kufijtë nuk janë më barriera të pakapërcyeshme, kontinenti perceptohet si një hapësirë më e vogël dhe oqeanet nuk duken më si pengesa, por si ura të reja ndërveprimi. Lufta vazhdon të ndikohet nga gjeografia, pasi pozita strategjike e një vendi formëson fuqinë e tij, politikën e brendshme dhe të jashtme, kulturën dhe karakterin e konflikteve të ardhshme.

Një sfidë tjetër është shmangia e ideologjive të rreme dhe manipulimeve toksike, të cilat mund të jenë po aq të dëmshme sa mungesa e idealeve. Për këtë arsye, shtrohet pyetja: a do të vijojnë shtetet të hyjnë në konflikte të drejtpërdrejta apo do të lindin alternativa të tjera, më pak të eksploruara, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Duke iu referuar kombit tonë, në realitetin modern, patriotizmi i trashëguar i shqiptarëve duhet të kombinohet me një vizion strategjik. Shqipëria dhe mbarë kombi shqiptar po ecin drejt forcimit politik, ekonomik, avancimit diplomatik dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake, duke i dhënë më shumë identitet dhe prestigj kulturës kombëtare. Sot është momenti për të reflektuar mbi atë që duhet të quajmë “fuqi kombëtare” dhe “forcë kombëtare” në një botë në ndryshim.

Fjalë kyçe: luftë, shtetas, qytetar, ideal, moral, gjeografi, modern, interes, atdhedashuri, kurth, politika, strategji.

Hyrje

Institucione kërkimore, studiues, kompani të industrisë ushtarake, akademi dhe politikanë të panumërt e kanë kthyer temën e luftërave të ardhshme në një çështje qendrore të debatit publik. Këto diskutime janë të ndërthurura ngushtë, natyrisht, me interesa të ndryshme, por edhe me të vërteta thelbësore, ndërsa këndvështrimet mbi to janë po aq të shumta sa edhe aktorët që i trajtojnë.

Në këtë kontekst, gjenerali David Petraeus, një prej strategëve më të njohur të kohës sonë dhe historiani i shquar Andrew Roberts, në librin e tyre “*Konflikti: Evolucionin e Luftës nga 1945 deri tek Ukraina – Kuptimi i Luftës Moderne Sot¹*”, shqyrtojnë evolucionin e luftës pas Luftës së Dytë Botërore. Ata theksojnë rëndësinë e analizës së thelluar të së kaluarës për të kuptuar të tashmen dhe për të parashikuar të ardhmen. Sipas tyre, politikanët dhe gjeneralët kanë përsëritur gabime të njëjta në mënyrë të vazhdueshme, duke dëshmuar vështirësitë që sjell procesi i të mësuarit dhe i përshtatjes ndaj ndryshimeve strategjike.

Nga një këndvështrim tjetër, Elliot Ackerman dhe Admirali James Stavridis, në romanin e tyre “*2034: Një Roman për Luftën Tjetër Botërore²*”, paraqesin një skenar të fuqishëm për një konflikt të mundshëm të së ardhmes. Duke ndërthurur analizën gjeopolitike me ndjeshmërinë letrare, ata eksplorojnë realitetin e një krize globale përmes përjetimeve të personazheve nga vende të ndryshme – SHBA, Kina, Irani, Rusia dhe India. Gabimet e përsëritura nga të gjitha palët shkaktojnë një përplasje ndërkombëtare me pasoja katastrofike, ku SHBA dhe Kina paguajnë një çmim të rëndë, duke ndryshuar përgjithmonë ekuilibrat globalë të fuqisë. E shkruar nga një shkrimtar me përvojë dhe një ushtarak i lartë me karrierë të gjatë, kjo vepër ofron një parashikim të frikshëm, por të mundshëm, të asaj që mund të ndodhë.

¹ David Petraeus, Andrew Roberts, *Conflict: The Evolution of Warfare from 1945 to Ukraine - Understanding Modern Warfare Today*, 2023.

² Elliot Ackerman and Admiral James Stavridis, *2034: A Novel of the Next World War*, 2021.

Temat që lidhen me luftën – qoftë ajo e sotmja apo ajo e nesërmja – mbeten ende në zhvillim dhe do të vazhdojnë të evoluojnë. Ndryshimet në mjedisin njerëzor dhe atë gjeopolitik janë të pashmangshme.

Çështja nuk qëndron tek ekzistenca e moralit apo vullnetit për të luftuar për vendin, kombin apo vlerat – sepse ato do të jenë gjithmonë të pranishme. Ajo që do të ndryshojë është përmbajtja dhe intensiteti i këtij vullneti, në përputhje me natyrën gjithnjë në transformim të faktorëve që mbështesin dhe nxisin luftën. Për këtë arsye, është e pamatur dhe e rrezikshme që politika të mbështetet në ideale të rreme, apo, edhe më keq, në ideale toksike dhe manipulative. Ashtu siç nuk duhet të besojmë se lufta moderne do të zhvillohet vetëm përmes teknologjive të avancuara, pa pjesëmarrjen direkte të njeriut apo pa praninë fizike në terren. Lufta, në të vërtetë, do të jetë rezultat i një sërë faktorësh kompleksë, dhe jo i një elementi të vetëm ‘çudibërës’.

Përse kombet zgjedhin të luftojnë?

Nuk është vetëm një titull i një libri të njohur³ që sillet rreth territoreve dhe ideologjive, por një pyetje thelbësore – dhe një klithmë gjithnjë e më therëse. Sot, në një Europë gjithnjë e më heterogjene, e mbushur me epidemi termash si “demokraci” apo “interes kombëtar”, qytetarët – shpesh në rolin e subjektit – i bëjnë vetes pyetjen më themelore: për çfarë duhet të sakrifikoj jetën time?

Në Luftën e Parë Botërore, miliona të rinj marshuan drejt vdekjes duke besuar se po mbronin nderin kombëtar. Në realitet, shumë prej tyre nuk e kuptonin saktësisht arsyen e luftës, por u mobilizuan nga retorika: atdheu, familja, qytetërimi dhe idealet u bënë më të qarta: liria kundër totalitarizmit, qytetërimi kundër barbarisë. Madje edhe fashistët dhe nazistët, të indoktrinuar në mënyrën e tyre, besonin se po luftonin për të njëjtat aspirata. Këto ishin vizione të botës, bindëse mjaftueshëm për të mobilizuar masa, për të dhënë kuptim, për të ndërtuar përkatësi. Siç vëren me të drejtë gazeta prestigjioze italiane *Difesa*⁴, vlerat shpesh shërbejnë si perde tymi. Termat si “liri” apo “siguri” mund të përdoren për të mbuluar interesa më të thella: qasje në burime, kontroll gjeopolitik, apo përfitime ekonomike. Sepse kush do të ishte realisht i gatshëm të vdiste për një tubacion gazi që kalon pesë a gjashtë shtete më larg? Apo për një traktat bashkëpunimi mes vendesh?

Thelbi është ky: në mungesë të idealeve të ndara dhe të kuptueshme, kur gjithçka përkthehet në gjuhën e interesave financiare ose të prodhimit, çfarë mbetet si bazë e motivimit individual për të sakrifikuar?

³ John G. Stoessinger, *Why Nations Go to War*, 2011.

⁴ “ReArm Europe/Readiness 2030? La deterrenza non nasce da un arsenale”, di Andrea Cucco, *Difesa*, 01/04/25

Interesat – shpesh personale apo elitare – mund të shpjegojnë vendimmarrjen politike, por ato nuk ndezin zemrat e ushtarëve dhe të popullit përtej një pragu të caktuar. Një shtetas i mobilizuar në një vend tjetër mund të shërbejë përkohësisht, por ai nuk do të jetë i gatshëm të bëjë sakrificën përfundimtare për diçka që nuk e ndjen si të vetën. Përvoja e dekadave të fundit ka treguar çfarë do të thotë të vrasësh dhe të vdesësh për arsye të rreme. Nuk jemi më në epokën e ushtrive masive europiane të shekujve XIX dhe XX, ku shërbimi i detyrueshëm nuk ishte vetëm një instrument i fuqisë, por edhe një mjet për ndërtimin e identitetit qytetar. Ai përçonte idenë se “ushtria të bën burrë”, dhe krijonte kohezion social duke bashkuar individë nga prejardhje të ndryshme për një qëllim të përbashkët.

A do të shkojnë shtetasit në luftë?

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, shumica e shteteve europiane vendosën të pezullojnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Në vend të tij, u vendos modeli i ushtrisë profesioniste, ku shërbimi ushtarak bëhet me pagesë dhe në mënyrë vullnetare. Megjithatë, disa vende e ruajtën rekrutimin e detyrueshëm. Qipro, Greqia, Turqia, Austria, Zvicra, Danimarka, Estonia, Finlanda dhe Norvegjia nuk e kanë pezulluar asnjëherë këtë formë shërbimi.

Arsyet për këtë qëndrim janë të ndryshme. Për disa vende, lidhet me afërsinë gjeografike me zonat në konflikt ose për faktin se nuk ishin anëtarë të NATO-s dhe nuk mund të mbështeteshin në garancitë e sigurisë të aleancës, duke rritur kështu ndjenjën e kërcënimit të jashtëm. Në vende të tjera, si Danimarka, shërbimi i detyrueshëm shihet më shumë si një mjet edukimi qytetar dhe formimi social, pavarësisht nivelit të ulët të kërcënimit ushtarak.

Pas sulmit rus ndaj Ukrainës, shumë shtete të Europës po e rishikojnë seriozisht mundësinë për të rikthyer shërbimin e detyrueshëm. Megjithatë, duhet bërë një dallim thelbësor: ligji mund ta imponojë shërbimin, por jo vullnetin për të luftuar. Dhe ky vullnet nuk është njësoj për të gjithë. Ai matet në dy mënyra: a je i gatshëm të luftosh për vendin tënd dhe a je i gatshëm të luftosh për një vend tjetër.

Sipas një sondazhi të Gallup⁵, realizuar në korrik 2024, vetëm 32% e qytetarëve të Bashkimit European shprehën gatishmëri për të luftuar në mbrojtje të vendit të tyre. Ndërkohë, në vendet jashtë BE-së, ky tregues është më i lartë – 60%.

Një faktor kyç në këtë qëndrim është gjeografia, përkatësisht afërsia me shtete që perceptohen si kërcënim. Në Finlandë, ku kërcënimi rus është real, 80.3% e qytetarëve janë të gatshëm të luftojnë. Në Greqi, përballë tensioneve me

⁵ <https://gallup.com.pk/wp/wp-content/uploads/2024/03/GIA-PR-3-V2-1.pdf>

Turqinë, ky numër arrin në 81%. Në vende si Polonia, Estonia apo Suedia, mbrojtja kombëtare është e rrënjosur në kulturën qytetare dhe përbën pjesë të identitetit shoqëror.

Në anën tjetër, Gjermania paraqet një kontrast domethënës. Vetëm 52.5% e qytetarëve të saj shprehen të gatshëm të marrin pjesë në një konflikt ushtarak për vendin e tyre. Kjo ndoshta lidhet me kulturën e pas Luftës së Dytë Botërore, ku theksi është vendosur mbi pacifizmin, diplomacinë dhe shmangien e përfshirjes në luftëra.

Përveç faktorëve gjeopolitikë, identiteti kulturor luan një rol kyç në gatishmërinë e shtetasve për të shkuar në luftë. Vende me histori të gjatë qëndrueshmërie dhe pavarësie, si Greqia dhe Polonia, nxisin te qytetarët e tyre ndjenjën e krenarisë kombëtare dhe angazhimin për të mbrojtur sovranitetin. Në të kundërt, shtete si Austria dhe Holanda, ku identiteti kombëtar lidhet më shumë me neutralitetin historik ose traditën tregtare, shfaqin një gatishmëri më të ulët për përfshirje ushtarake.

Stabiliteti ekonomik është një tjetër faktor. Shtete të pasura si Suedia dhe Finlanda raportojnë nivele të larta gatishmërie për të luftuar, duke reflektuar besimin e qytetarëve te shteti si garant i mbrojtjes së tyre. Kur qytetarët ndihen të mbrojtur dhe të përfshirë nga institucionet e tyre, janë më të gatshëm të sakrifikojnë për to. Ndërkohë, në vendet më pak të sigurta ekonomikisht, si Portugalia, vëmendja e qytetarëve shpesh përqendrohet në prioritetet e tjera. Çështje si: kujdesi shëndetësor, arsimi apo problemet sociale përjetohen si më urgjente sesa ideja abstrakte e mbrojtjes së kufijve kombëtarë, sidomos kur këta kufij nuk perceptohen si të rrezikuar drejtpërdrejt.

Çfarë do të thotë kjo për mbrojtjen e Europës?

Gatishmëria e pabarabartë e shteteve europiane për të luftuar nxjerr në pah një sfidë të madhe për strategjitë e mbrojtjes, si të BE-së, ashtu edhe të NATO-s. Vendet në vijën e parë, si Finlanda dhe Polonia, janë dukshëm më të motivuara, ndërsa shtetet e Europës Perëndimore mund të kenë nevojë për një nxitje më të fortë për të investuar në mbrojtjen kolektive. Kjo mospërputhje mund të vështirësojë ndjeshëm përpjekjet për të ndërtuar një strategji mbrojtjeje të unifikuar në nivel europian. Në këtë kontekst, liderët politikë duhet të angazhohen me qytetarët e tyre. Ata duhet të shpjegojnë se sot, lufta nuk është më një çështje thjesht kufitare, dhe se një mbrojtje e përbashkët është esenciale edhe për ata që nuk ndihen të kërcënuar drejtpërdrejt. Siç thekson Instituti Carnegie⁶, kërkesa që qytetarët të shërbejnë – dhe ndoshta të vdesin – për vendin e tyre, kërkon një kontratë të fortë sociale mes shtetit dhe popullit të vet.

⁶ Europe's Conscription Challenge: Lessons from Nordic and Baltic States

Nëse Europa përmend objektiva si “Gatishmëria 2030”, riarmatimi inteligjent, apo autonomia strategjike, ajo më parë se të blejë apo prodhojë armë, duhet të gjejë arsyet për t’i përdorur ato. Dhe për më tepër, duhet t’i përgjigjet pyetjes: Për çfarë janë të gatshëm të vdesin qytetarët europianë?

Për të krijuar një mbrojtje të qëndrueshme, Europës nuk i duhen vetëm mjete ushtarake, por edhe një bazë ideale e motivuese – ashtu si “leekamanët e Valmy-t” që, me idealin e lirisë, ndaluan marshimin e një ushtrie shumë më të fuqishme. Paraja nuk ka vlerë kur je i vdekur; dhe pa ideale, askush nuk është i gatshëm të vdesë. Nëse qytetarët ndihen të motivuar, ata japin gjithçka – ndonjëherë edhe falas.

Lufta e ardhshme

Elementët evolucionarë dhe revolucionarë të luftës

Lufta Rusi-Ukrainë është përshkruar nga historianë ushtarakë dhe analistë politikë⁸, si Stephen Biddle, si një konflikt që u kthye në një luftë transhesh, pavarësisht valës së madhe të paragjytimeve dhe interpretimeve të ndryshme që e shoqëruan. Disa e shohin atë si modelin e luftërave të së ardhmes, të cilat do të zhvillohen kryesisht përmes teknologjive të avancuara — dronë të komanduar nga distanca, sisteme vëzhgimi hapësinor, armë me precizion të lartë, raketa hipersonike, inteligjencë artificiale, komunikime të avancuara në rrjet, dhe të tjera. Shumë ekspertë theksojnë se ky set i ri mjeteesh po transformon mënyrën e luftimit, duke integruar vëzhgimin e detajuar dhe në kohë reale të fushës së betejës me armë të sofistikuar vdekjeprurëse. Si rezultat, sistemet tradicionale të luftës — si tanket apo taktikat e mëparshme të ofensivës dhe mbrojtjes në shkallë të gjerë — po konsiderohen gjithnjë e më shumë të vjetruara dhe të papërshtatshme për sfidat e sotme.

Por, në anën tjetër, lufta në Ukrainë duket sikur riktheu skena të Luftës së Parë Botërore, ku ushtarët po çapiten në transhe tërë baltë; zonat ku kryhen betejat janë plot me fusha të minuara e gropa predhash artilerie të ngjashme me ato të Luftës së Dytë Botërore. Të gjitha këto ngrenë pikëpyetjen e madhe se ku jemi me konceptin “luftë”: kemi hyrë në një epokë të re, apo thjesht përsëriten format e vjetra? Është një “revolucion në çështjet ushtarake” dhe po eksperimentohet si i tillë që të shërbejë për të kryer me sukses luftërat e ardhshme, apo është belaja e tretë e radhës ndaj së cilës bota po përkushtohet që të mos shndërrohet në Luftën e Tretë Botërore? E kemi një postulat për të dhënë përgjigjen pikërisht nga gjenerali dhe teoricieni ushtarak Carl von Clausewitz, i cili shkruante se çdo epokë ka llojin e vet të luftës dhe kushtet e veta kufizuese.⁹

⁷ White Paper for European Defense – Readiness 2030

⁸ Revista “Foreign Affairs, Shtator-Tetor 2023.

⁹ Clausewitz, Carl von, “On War”, Princeton University Press, 1976, pg. 593

Analizat, vlerësimet dhe gjykimet paraprake se çfarë forme do të ketë dhe me çfarë strategjish e mjetesh do të zhvillohet lufta në epokat e ardhshme janë të nevojshme, por ka disa parametra që nuk do të ndryshojnë kurrë.

Ndryshimi teknologjik ka vazhduar dhe do të vazhdojë të ndikojë në shoqëri dhe sigurinë kombëtare. Shumë nga teknologjitë që janë interpretuar se kanë ndikim vendimtar në luftërat në Ukrainë dhe Gaza, kanë qenë teknologji komerciale që janë përshtatur dhe militarizuar për operacione në fushëbetejë, si dhe për funksione mbështetëse strategjike, të tilla si planifikimi, operacionet e ndikimit strategjik dhe logjistika.

Lidhja globale përmes internetit, tregjet e hapura dhe përdorimi në rritje i inteligjencës artificiale për kërkime dhe zhvillim kanë zgjeruar ndjeshëm aksesin në aftësi ushtarake të avancuara – jo vetëm për shtetet, por edhe për aktorët jo-shtetërorë. Teknikat e reja të prodhimit, përfshirë prodhimin shtesë, kanë ulur ndjeshëm kostot e pajisjeve të caktuara, duke mundësuar shpërndarjen më të gjerë të mjeteve si dronët dhe teknologjitë e mbikëqyrjes. Kjo ka bërë të mundur që aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë të vendosin kapacitete kapacitete të përparuara ushtarake – si mbikëqyrja e vazhdueshme e fushës së betejës dhe aftësitë për sulme me rreze të gjatë. Shembuj konkretë përfshijnë zhvillimin indigjen të raketave me rreze të gjatë nga Ukraina, si dhe aftësitë e synimit dhe mbikëqyrjes të vendosura nga aktorë jo-shtetërorë si Hezbollahu dhe Hamasi. Tre vitet e fundit kanë sjellë një ndërthurje gjithnjë e më të ngushtë midis kapaciteteve civile dhe ushtarake. Dronët komerciale, dikur mjete të lira dhe të lehtë për t'u siguruar, tani po përshtaten dhe modifikohen për përdorim ushtarak – shpesh me efekte të papritura dhe të fuqishme në terren.

Përdorimi i teknologjisë komerciale në komunikim është aq i përhapur saqë është bërë “e vështirë të dallosh rrjetet e komunikimit ushtarak nga ato komerciale”. Në “Ukrainë, të gjitha palët kanë përdorur rrjete komerciale për komunikime ushtarake. Gama e gjerë e të dhënave të sensorëve të bartura përmes rrjeteve komerciale ka ofruar një alternativë të aftë dhe “lehtësisht të disponueshme” ndaj sistemeve të mbyllura të inteligjencës, vetëm për ushtrinë. Në tre vitet e fundit, analiza e inteligjencës bazuar në të dhëna me burim të hapur është rritur në aftësi me rezultate mbresëlënëse. Sot, agjencitë e inteligjencës jofitimprurëse dhe komerciale veprojnë paralelisht – dhe ndonjëherë në partneritet - me agjencitë ushtarake dhe agjencitë e tjera qeveritare të inteligjencës.

Pothuajse të gjitha studimet mbi mjedisin e ardhshëm të sigurisë bien dakord se ritmi i ndryshimit teknologjik është në rritje. Në Ukrainë, ritmi i zhvillimit në sistemet autonome është përshpejtuar përtej të gjitha pritjeve. Këto sisteme

janë bërë mundësues kritikë të operacioneve të suksesshme. Të dyja palët bënë përpjekje të jashtëzakonshme për të prishur sistemet e kundërshtarit dhe për të forcuar sistemet e tyre. Konkurrenca që rezulton është bërë një betejë e përditshme për avantazh, duke nxitur një ritëm marramendës ndryshimi.

Kushtëzimi nga gjeografia

Hapësira tokësore dhe pozita gjeografike ku jetojmë, formësojnë popujt, prodhimin, fuqinë, politikën, zhvillimin shoqëror dhe kulturën e, kështu, edhe natyrën e karakterin e luftërave që ata bëjnë.

Ukraina ndodhet në pjesën qendrore të Evropës Lindore, në udhëkryqin e rrugëve kryesore të transportit nga Evropa në Azi dhe nga shtetet skandinave në rajonin e Mesdheut. Edhe pse me dalje në Detin e Zi (aq sa i ka mbetur pas pushtimit rus të Krimesë dhe pjesës dërmuese të bregdetit juglindor të saj), prapëseprapë mbetet një shtet i kyçur në thellësi kontinentale.



Ukraina – vend i kyçur nga gjeografia, edhe pse me dalje në Detin e Zi

Nga ana tjetër, edhe Rusia, “partneri” i Ukrainës në këtë luftë, është një shtet i kyçur, pavarësisht nga shtrirja kontinentale e saj. Është për këtë arsye që lufta midis tyre është një luftë shtetesh të thellësisë kontinentale. Si e tillë, kjo luftë është e lidhur dhe madje e kushtëzuar nga toka dhe, në rastin më të mirë, nga ajri. Çka do të thotë se domosdoshmërisht do të shndërrohej, siç u shndërrua, në luftë transhesh e fortifikatash. E tillë ishte lufta tetëvjeçare Irak-Iran e viteve 1980-1988, dy shtete të thellësisë kontinentale në Lindjen e Mesme.

I tillë ishte konfiguracioni gjeografik i përplasjes së mundshme midis Traktatit të Varshavës dhe NATO-s gjatë Luftës së Ftohtë. Ishte kryesisht për këtë arsye që vendet e Traktatit të Varshavës, të shtrira në thellësinë kontinentale europiane dhe aziatike, ruajtën dhe zhvilluan gjerësisht konceptin dhe praktikën e transheve.

Pas Luftës së Ftohtë, praktika e transheve u përdor po ashtu dendur gjatë rrethimit të Sarajevës, në Bosnjë-Hercegovinë gjatë viteve të luftërave ballkanike 1992–1996. Arsyeja? Pikërisht sepse edhe Bosnjë-Hercegovina është një hapësirë “e kyçur” në kuadër të rajonit të Ballkanit. Prandaj edhe shtete të



Iraku – vend i kyçur nga gjeografia

mëdha “ngecen” në luftëra të thellësive të tilla kontinentale. Është kjo arsyeja pse Robert Gates, ish-Sekretar Amerikan i Mbrojtjes, teksa bën analizën e luftërave amerikane në thellësi kontinentale, vëren se “Çdo sekretar i ardhshëm i mbrojtjes që e këshillon presidentin të dërgojë përsëri një ushtri të madhe tokësore amerikane në Azi, ose në Lindjen e Mesme

apo Afrikë duhet t’i ekzaminohet koka, siç e ka thënë me aq delikatesë Gjenerali Douglas MacArthur.”¹⁰

Por nuk do të zhvillohen sipas këtij karakteri luftërat e brigjeve kontinentale e oqeanike: lufta hipotetike midis Kinës dhe SHBA, apo ajo midis Iranit dhe Izraelit.

A mund të shkojnë Kina dhe SHBA në luftë?

Këtu del një subjekt tjetër shumë i diskutueshëm për luftën e ardhshme: A do të shkojnë Kina dhe SHBA në luftë?

Kina, nëse përshtatim shprehjen e famshme të gjeopolitistit Tim Marshall, është “e burgosur nga gjeografia”.¹¹ Merrni, për shembull, Kinën dhe Indinë – thotë ai: dy vende të mëdha me popullsi të mëdha që ndajnë një kufi shumë të gjatë, por nuk janë të lidhura politikisht ose kulturalisht. Nuk do të ishte çudi nëse këta dy gjigantë do të kishin luftuar me njëri-tjetrin në disa luftëra, por në fakt, përveç një beteje njëmuje në vitin 1962, ata nuk e kanë bërë kurrë një luftë midis tyre. Pse? Sepse i ndan vargmali më i lartë në botë, ai i Himalajeve, përmes të cilëve praktikisht është e pamundur të përparosh kolona të mëdha ushtarake. Ndërsa teknologjia bëhet më e sofistikuar, sigurisht, po shfaqen mënyra për të kapërcyer këtë pengesë, por pengesa fizike mbetet pengesë fizike dhe kështu të dy vendet e përqendrojnë politikën e tyre të jashtme në rajone të tjera, duke mbajtur një sy të kujdesshëm ndaj njëri-tjetrit.

Ndërkohë, nga lindja e Kinës është deti, i Kinës në emërtim, por që e mbyllin një varg shtetesh jo pak të fuqishme ushtarakisht e, madje, aleatë të sigurt të SHBA: Japonia, Koreja e Jugut, e pak më në jug, Australia. Në veri shtrihet Siberia e ngrirë dhe Mongolia e thatë e shkretëtirtë, ndërsa në perëndim hapet një thellësi kontinentale që shtrihet për mijëra kilometra.

¹⁰ Robert Gates, speech at the “United States Military Academy at West Point”, 25 February 2011

¹¹ “Prisoners of Geography”-Ten Maps That Explain Everything About the World”, 2015, Stribner, p.7



Kina, edhe pse me dalje në det, është një vend i kyçur nga gjeografia

Shkencëtari dhe Profesori i Universitetit Harvard, Graham Allison, ka studiuar 16 raste të 500 vjetëve të fundit kur një fuqi është rritur në atë masë sa ka kapërcyer fuqinë më të madhe ekzistuese dhe ka mbërritur në përfundimin se, në 12 raste, ato kanë shkuar në luftë me njëra-tjetrën, ndërsa në 4 raste, lufta është evituar duke bërë, secila anë, axhustime në qëndrime dhe veprime. Në këtë kuadër, ai ka shkruar librin “Të destinuar për luftë: a mundet që Amerika dhe Kina t'i shpëtojnë Kurthit të Tuqididit?”¹², ku argumenton se si Kina, edhe SHBA, me mendim strategjik, mirëkuptim reciprok dhe me gjetje mekanizmash paqësore, mund ta evitojnë luftën. Sidoqoftë, Profesori, si amerikan që është, konkludon se “SHBA, hë për hë lider në ekonomi dhe në fushën ushtarake, duhet ta menaxhojë këtë rol të saj, ndërsa Kina duhet të rritet pa e provokuar një konfrontim të panevojshëm”!

Sidoqoftë, Kina, në çdo pikëpamje, nuk është e interesuar të hyjë në luftë sepse, me shumë gjasë, prej saj do të dalë e humbur. Kështu që do të detyrohet të gjejë çfarëdo zgjidhje tjetër hibride, por ndoshta jo luftën.

A do të shkojnë shqiptarët në luftë?

Shqiptarët nuk kërkojnë luftë, por historia na mëson se luftërat mund të vijnë edhe pa na pyetur. Lufta e Dytë Botërore ishte shembull i tillë: shqiptarët nuk e zgjodhën, por qenë ndër viktimat e para. Ndaj, një komb që respekton veten

¹²Allison, Graham, “Destined for War: Can America and China Escape Thucydides’s Trap?”, Houghton Mifflin Harcourt, 2017, ku i adresohet përfundimit të famshëm të Tuqididit, i cili shkruante: “Ishte RRITJA e Athinës dhe FRIKA e Spartës se mos Athina i vërsulej Spartës që e bëri luftën të paevitueshme”.

duhet të jetë gjithmonë i përgatitur për t'u mbrojtur – sepse askush tjetër nuk do ta bëjë në vend të tij. Çështja thelbësore është se për çfarë lufte duhet të përgatitemi. Nuk mund të huazojmë receta ushtarake të vendeve me gjeografi, histori dhe interesa të ndryshme nga tonat. Siç theksonte Klauzeviç, çdo epokë ka luftën e saj – dhe kushtet e saj. Gjeografia mund të mos ndryshojë, por interesat, aleancat dhe sfidat ndryshojnë vazhdimisht.

Sipas një sondazhi të Gallup, gjysma e shqiptarëve janë të gatshëm të luftojnë për vendin e tyre. Kjo dëshmon një ndjenjë të fortë patriotike, por kjo ndjenjë duhet të mbështetet nga realitete moderne: një Shqipëri më e konsoliduar politikisht, më e fuqishme ekonomikisht, më e aftë diplomatikisht, më e përgatitur ushtarakisht dhe më e vetëdijshme për identitetin e saj kombëtar.

Pra, nuk është çështja vetëm t'u drejtohem shtetasve se çfarë mund e duhet të bëjnë ata për Atdheun, por edhe se çfarë mund e duhet të bëjë Atdheu për ta. Duke ia ruajtur vlerën thirrjes së famshme¹³ të Presidentit John F. Kennedy drejtuar qytetarëve të vendit të tij në vitin 1961, i referohemi përsëri sondazhit të mësipërm edhe për shtetasit amerikanë: gatishmëria e tyre për të luftuar për vendin e tyre është 41%! Atëherë, nuk mund të mos vihet në dukje se sot, në një mjedis tashmë të globalizuar dhe që do të globalizohet gjithnjë e më shumë, po rrezikohen të tretën shumë vlere identitare. Prandaj është koha për të kujtuar dhe kuptuar se morali kombëtar përbën, të paktën, dy të tretat e lojës së luftës.

Përfundime

Subjektet që lidhen me luftën sot janë të reja, sepse vetë mjedisi në të cilin ndodh, është i ri – si ai njerëzor, ashtu edhe ai gjeografik – madje shpesh për shkak të këtij të fundit. Pyetja “Përse shkojnë kombet në luftë?”, ka marrë përgjigje të ndryshme në kohë të ndryshme – ashtu si edhe besimi fetar, që në kohët moderne ka humbur dimensionin absolut që kishte dikur.

Sot kemi përvojë të mjaftueshme për të kuptuar se njerëzit kanë vlarë dhe vdekur për arsye nga më të ndryshmet. Nuk është se vihet në dyshim atdhedashuria, por realiteti ka ndryshuar. Jetojmë në një botë tjetër, ku interesat nuk ndalen më te kufiri shtetëror, por shtrihen në hapësira globale – kontinenti duket si fshati i dikurshëm dhe oqeani si një plazh.

Ligjet mund të kërkojnë rekrutim, por vullnetin për të luftuar nuk e përcakton dot ligji. Ai matet në dy plane: a je i gatshëm të luftosh për vendin tënd dhe a je po aq i gatshëm për një vend tjetër? Prandaj, Europa duhet të përballet me një pyetje themelore: për çfarë janë të gatshëm të vdesin qytetarët e saj?

13 Në fjalimin e tij inaugurues në cilësinë e Presidentit të SHBA, më 20 janar 1961, John F. Kennedy iu drejtua bashkatdhetarëve të tij amerikanë: “Mos pyesni se çfarë mund të bëjë vendi juaj për ju. Pyesni se çfarë mund të bëni ju për vendin tuaj”

Nuk ka nevojë për ideale të rreme apo manipulime patriotike. Ato janë po aq të rrezikshme sa mungesa e idealeve, sepse nxisin zhgënjimin, cinizmin dhe indiferencën. Nuk mund të mbështetemi vetëm te iluzioni se lufta moderne do të zhvillohet ekskluzivisht përmes teknologjive të avancuara si dronët, satelitët, raketat hipersonike apo inteligjenca artificiale. Këto mjete po ndryshojnë natyrën e fushëbetejës, por nuk e zëvendësojnë plotësisht luftën tradicionale. Armët konvencionale, si tanket apo strategjitë tokësore, mbeten të rëndësishme, veçanërisht në konflikte që zhvillohen në thellësi kontinentale apo në rajone të mëdha. Siç thotë Klauzeviçi, çdo epokë ka llojin e saj të luftës dhe kufizimet e veta.

Lufta kushtëzohet nga gjeografia. Pozita dhe hapësira tokësore ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e popujve, ekonominë, politikën, kulturën dhe, rrjedhimisht, në mënyrën se si ata luftojnë.

Së fundmi, vëmendja kthehet te kombi ynë. Patriotizmi tradicional i shqiptarëve duhet të mbështetet sot në bindjen se Shqipëria dhe mbarë kombi shqiptar po ecin drejt konsolidimit politik, forcimit ekonomik, prestigjit diplomatik, aftësisë ushtarake dhe vetëdijes identitare. Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, ku vlerat kombëtare rrezikojnë të zbehen, është koha të rikujtojmë dhe të kuptojmë thellësisht se çfarë do të thotë fuqi kombëtare dhe forcë kombëtare.

Bibliografia e shfrytëzuar

1. David Petraeus, Andrew Roberts “Conflict: The Evolution of Warfare from 1945 to Ukraine—Understanding Modern Warfare Today”, 2023
2. Elliot Ackerman and Admiral James Stavridis, “2034: A Novel of the Next World War, 2021
3. Stoessinger, John G. “Why Nations Go to War”, 2011
4. Andrea Cucco: “ReArm Europe/Readiness 2030? La deterrenza non nasce da un arsenale”, Difesa, 2025
5. Europe’s Conscription Challenge: Lessons From Nordic and Baltic States
6. White Paper for European Defense – Readiness 2030
7. Revista “Foreign Affairs, Shtator-Tetor 2023.
8. Clausewitz, Carl von, “On War”, Princeton University Press, 1976
9. Robert Gates, speech at the “United States Military Academy at West Point”, 2011
10. “Prisoners of Geography” - Ten Maps That Explain Everything About the World”, 2015, Scribner.
11. Allison, Graham, “Destined for War: Can America and China Escape Thucydides’s Trap?” Houghton Mifflin Harcourt.

